AGIM HAMITI

ODISEJA E NJE DETEKTIVI 1

NGJARJE TE JETUARA

I

SPAÇI

"Burgu, kjo greminë e përuljes njerëzore..."
Xh. London

Çdo kalimtar që shkel për herë të parë në Spaç pushtohet vetvetiu prej një apatie të përgjithshme, të ngjashme me atë që provon njeriu kur padashje bëhet dëshmitar i një jete në agoni. Edhe sikur udhëtari në fjalë të mos jetë i vetëm, duke hyrë në pusin e madh natyror që përbën ky vend, ai do të ndiej nevojën e një heshtjeje soditëse, për tu thelluar në botën e ndjenjave të tij të befasuara.

Vendi është i rrethuar nga të gjitha anët prej një vargu kodrash të larta. Po t'i shikosh prej gropës së Spaçit, ato të krijojnë përshtypjen e dy vargmaleve në formë gjysmërrethi vendosur përballë njëri-tjetrit, ngaqë relievi është tepër i thyer. Në dy pikat simetrike të takimit të tyre, në juglindje e në veriperëndim, shtrati i ngushtë e i thellë i një përroi hap dy dritare natyrore të këtij hauzi të madh.

Shkurret që mbulojnë pjesërisht shpatet e kodrave rrethuese i nënshtrohen një lufte të rreptë me natyrën, për të mbijetuar egërsinë e asaj toke shterpë në procesin e shpërbërjes. Rrënjët e tyre gjysmë të dala mbërthehen fort, duke depërtuar anash gurëve të djegur bojëkafe, ose nëpër të çarat e pllakave të shtresëzuara. Gjethet e tyre mund të shikohen të shpalosura në diell vetëm për pak orë, mbasi, sapo fillon të nxehtit, ato tkurren për të ngadalësuar avullimin e ujit të siguruar me shumë vështirësi.

Në përgjithësi sipërfaqja e tokës është ngjyrë kafe në të murrme dhe del shtresa-shtresa në formë pllakash të thyeshme. Acidi sulfurik, mjaft i pranishëm në ujërat rrjedhëse të kësaj zone, është faktori kryesor i procesit të shpërbërjes së sipërfaqes normale të tokës. Syri mund të të zërë bar shumë rrallë, vetëm në ndonjë vend të rrafshët që rastësia e ka favorizuar për t'i shpëtuar pushtetit shkatërrimtar të acidit. Edhe shtrati i thellë me anë të thepisura i përroit, i cili gjatë verës mbetet pothuajse i thatë, mban ngjyrën e kriprave acide. Këto dukuri të strukturës së paqëndrueshme të sipërfaqes së tokës bien edhe më shumë në sy, për shkak të pjerrësisë së theksuar të shpateve rrethuese.

*

Mbasi ta ketë soditur një copë herë të mirë këtë tokë, viktimë të reaksioneve kimike dhe agjentëve atmosferikë, udhëtari i ardhur rishtas në këto anë, për të kthjelluar disi vorbullën e ndjenjave të tij të trazuara, do ta shprehte befasimin sipas mënyrës së vet, zakonisht në përshtatje me profesionin që ushtron.

Një barí do të belbëzonte:

«Këtu as dhëmbi i deles s'paska ku të ngjisë një fije bari, pa le më gjuha e lopës!»

Në rast se do të ishte murator, mbasi të merrte dy copa guri e t'i përplaste me njëra-tjetrën, duke i parë sesi do të binin të thërrmuara tek këmbët e tij, ai do të buzëqeshte me mosbesim duke murmuritur:

«Dy gurë të tillë nuk i vendoske dot mbi njëri-tjetrin e asnjë lugë gëlqere nuk bëke dot me ta.»

Ndërsa një gjeolog do të deklaronte entuziast:

«Aq sa a zymtë duket në pamje kjo tokë, po aq e praruar është në brendësi.»

Këtë aludim ai do ta bënte për bakrin e nëntokës së atjeshme, i cili përmban edhe një përqindje të ulët ari.

Një specialist i çështjeve policore, sapo ta shikonte këtë gropë si të përgatitur nga ekskavatorë gjigantë, pa u menduar gjatë, do të shprehej shkurt dhe qartë: «Një burg natyror.»

Bashkërendimi i mendimeve të dy specialiteteve të fundit nxori në dritë vendimin e kobshëm qeveritar, për ngritjen në këtë gropë të zymtë të një kampi pune të rëndë të detyruar për të burgosurit politikë, në pranverën e vitit 1968.

Pasi toka kombëtare ishte nginjur së thithuri djersën dhe gjakun e armatës së kokëqethurve të flijuar prej regjimit komunist si armiq të partisë, i erdhi radha nëntokës të kërkonte revanshin. Vargut të gjatë të kampeve të punës së rëndë të detyruar dhe të burgjeve të deriatëhershëm iu shtuan adresa të reja: miniera famëkeqe e Spaçit dhe simotrat e saj të mëvonshme. Të gjitha këto adresa jetëthithëse u furnizuan me kontigjentet e të dënuarve politikë të regjimit komunist. Me Spaçin fillonte kështu era e re e shfrytëzimit nëntokësor të viktimave politike, jetën e të cilëve Drejtoria e Kampe-Burgjeve e llogariste me shifra vagonash me mineral.

II

DJERSË DHE GJAK

“Zoti krijoi lirinë, njeriu skllavërinë.”
M. Zh. Shënié

Çdo fillim është i vështirë, por puna e detyruar në minierë, për kushtet e të burgosurve politikë, përmbante në vetvete një sistem të tërë fillimesh, që krijonin një grumbull vështirësish në progresion. Tani e tutje ata do të ishin të detyruar të punonin në mungesë të plotë të dritës së diellit dhe efekteve kurative të saj për organizmin. Të burgosurit do të thithnin ajrin e kompresorëve të përzier me një koktej të vërtetë gazrash, tymrash, avujsh uji të ndotur dhe erën e rëndë të dekompozimint të minjve të ngordhur e të kalbësirave të minierës së pamirëmbajtur. Gjatë punës treturnëshe do të digjeshin në vazhdimësi tonelata të tëra dinamiti, duke çliruar gazra helmuese me bollëk në atë minierë primitive, ku nuk njihej sistemi i ventilimit. Tymi i vazhdueshëm i llampave të karbitit do të jepte kontributin e tij modest në ndotjen e tërësishme të ajrit, që do të thithnin të burgosurit në frontet e punës. Era e rëndë e këtij ajri u shkaktonte të vjella të dënuarve që hynin për herë të parë në minierën mesjetare të Spaçit. Mushkëritë e të burgosurve, duke thithur nga ky ajër, dorëzonin një nga një mukozat e tyre në luftën e vrazhdë për një ekzistencë torturuese në emër të shpresës.

Në frontet e punës të piritit, ku temperatura luhatej midis 35-40 gradë celsius, burimet nëntokësore të ujërave me përqindje të lartë acidi sulfurik pikonin vazhdimisht mbi trupat e zhveshur të të burgosurve, që nuk duronin dot nxehtësinë. Duke u përcëlluar lëkurën, acidi u krijonte plagë, që ua kthenin në torturë zhveshjen dhe veshjen në punë e në fjetore.

Në tërësi gjendja e kushteve të punës i përgjigjej një niveli mesjetar. Norma e detyruar shumë e lartë, që u kërkohej përditë ose përnatë të burgosurve nga kërbaçi i pakursyer i policisë, bënte që kushtet e sigurimit teknik të figuronin vetëm në letër, të shënuara sa për formalitet nga personeli i lirë. Të burgosurit nuk punonin dot asnjëherë brenda kushteve të parashikuara të sigurimit të jetës, as në ato raste kur kishte vetëm disa orë që nga frontet e punës kishin nxjerrë njerëz të vdekur.

Baza materiale, që shërbente për të krijuar kushte pune më normale (shina, pjatina, çikrikë, dërrasa etj.) çohej në sektorë të tjerë, ku punonin punëtorë të lirë, ndërsa mungesat e mëdha që krijoheshin qëllimisht në Spaç "i plotësonte" policia. Në gjithë këtë mjedis makabër më pak se çdo gjë kushtonte i burgosuri dhe ai i paguante të gjitha dëmshpërblimet, si palë gjithmonë e mundur e një lufte të shfrenuar që ndërrmerrte barbarisht forca mbi të drejtën.

Policia ishte zgjedhur me një studim të posaçëm. Të gjithë personat në uniformë ishin mishërimi më karakteristik i injorancës së virgjër dhe i urisë kronike të asaj zone rurale. Duke i shpëtuar nga mjerimi ekstrem kooperativist, uniforma atyre u kishte siguruar ushqim e veshmbathje vjetore falas, rrogë që

nuk kishin guxuar ta imagjinonin dot më parë, privilegjin e strehimit familjar në qytezën më të afërt industriale, si dhe vend pune të preferuar për gratë. Në të ardhmen e afërt, fëmijve të tyre do t'iu ofrohej bursë shteti për t'u shkolluar, mbasi babai shërbente në një vend pune «me rëndësi të posaçme».

Të vetëkënaqur tej çdo parashikimi, ata fillimisht jetonin si në ëndërr, mbasi kishin shpëtuar nga buka e misrit me racion e gjithmonë pa gjellë. Dhe kur atyre u thuhej se personat me kokë të qethur zero e uniformë bojë kafe të shplarë janë armiq të pushtetit në fuqi, këtë thënie mendja e tyre shterpe e deshifronte sipas kodit të interesit vetjak:

«Këta duan t'ju heqin nga duart mirëqenien që ju ka siguruar pushteti, të cilin donin ta rrëzonin.»

E atëherë ata bëheshin aq agresivë, saqë duhej patjetër ndërhyrja e ndonjë oficeri të komandës së burgut, për të frenuar sadopak *patriotizmin* e tyre, vullkanik. Joshja e interesit material ata i kishte thithur shpirtërisht në ingranazhet e makinës së verbër shtypëse të shtetit.

*

Faktorët e shumtë që ndikonin në keqësimin e përgjithshëm të gjendjes së të burgosurve, duke u gërshetuar me njëri-tjetrin, fuqizoheshin e bëheshin edhe më kërcënues. Hyrjet e minierës, si gojë të hapura kuçedrash grykëse, thithnin tre turnet e punës 24 orëshe. Avujt që nxirnin në natyrë prej barkut të tyre të nxehtë krijonin përshtypjen, se gjahu i gjallë që kishin gëlltitur dhe lëvrinte nëpër rropullitë e tyre i detyronte të çlironin energjinë e tepërt.

«Dalç shëndoshë!». Kjo ishte përshëndetja që shkëmbenin midis tyre të burgosurit e fronteve të ndryshme të punës, kur ndaheshin me njëri-tjetrin në kryqëzimet e galerive. Kjo përshëndetje linte të kuptohej se ata mund të dilnin edhe me barelë prej andej, ose mund të mos dilnin kurrë, siç iu kishte ndodhur bashkëvuajtësve të tjerë.

Kërcitja e një trupi të thyer në armaturën e galerisë ku ata punonin, rënia e një guri, apo rrëshqitjet e dheut mbi kaskat e tyre plastike, u kujtonin të burgosurve se ata në çdo moment mund të bëheshin pré e kurtheve të vdekjes. Paralelisht me torturën fizike dhe luftën psikologjike, ankthi i pasigurisë së përhershme në minierën primitive ua nxinte jetën e përditshme këtyre kufomave të gjalla.

Pushteti i vampirëve të kuq synonte shëndetin e tyre, ndërsa pusitë e vdekjes nëntokësore u kërcënonin jetën. Të ndodhur midis këtyre dy zjarresh të përhershëm, të burgosurit e dërrmuar fizikisht e shpirtërisht bënin një zgjedhje të dëshpëruar: përballë kërcënimit policor, ata detyroheshin të zgjidhnin rrezikimin e jetës. Ndofta vdekja edhe mund t’i mëshironte, ndërkohë që policia e pamëshirshme e kampit nuk e bënte kurrë këtë *gabim ideologjik* ndaj armiqve të partisë.

Shifrat e para të tonëve me mineral sollën edhe viktimat e para, numri i të cilave erdhi duke u rritur vazhdimisht. Megjithëse ata njerëz ishin dënuar pafajësisht me vite burgu, askush nuk përgjigjej për ridënimin e tyre me vdekje pa gjyq. Familjeve të viktimave u ndalohej me ligj tërheqja e kufomave të të afërmve të vdekur brenda telave me gjemba. Gjersa ata ishin dënuar pa kryer ndonjë krim, dënimi i tyre duhej përjetësuar.

Në procesverbalet që motivonin vdekjet aksidentale në minierë kishte lëshuar rrënjë e njëjta shprehje justifikuese:

«U aksidentua se nuk zbatoi rregullat e sigurimit teknik në punë.»

Kur ndonjë i burgosur guxonte të kërkonte zbatimin e rregullave të sigurimit teknik në ndonjë front pune me rrezikshmëri të dukshme, policia e harbuar vërsulej mbi të duke bërtitur:

«Pse, aq të marrë e quani ju pushtetin e popullit, sa të sigurojë edhe jetën e armiqve të vet?»

Mjaft të burgosur i zinte gjumi në galeritë plot lagështirë prej lodhjes sfilitëse të orëve të pasmesnatës. Ata ftoheshin rëndë e përfundonin në një gjendje të pashpresë. Të tjerë gjymtonin veten në ato rrethana ku shëndeti shërbente si një intensifikim i së keqes, me qëllim që të shpëtonin nga puna e rëndë e detyruar për vite e vite me radhë.

Kjo histori e dhimbshme, e shkruar me gjakun e viktimave të saj, u bë aq kërcënuese, saqë as nënshtrimi i markës së lartë shqiptare nuk e përballoi dot pa shpërthimin e një revolte masive të të burgosurve politikë. Ishte hera e parë që shprehej publikisht protesta kundër regjimit shtypës e poshtërues në majin e vitit 1973. Çmimi me të cilin u pagua ajo qe tepër i shtrenjtë. Katër të pushkatuar dhe 86 të ridënuar me një shumë të përgjithshme prej 1400 vjet burg (14 shekuj jetë njeriu!).

Një dhunë jashtë çdo konceptimi njerëzor shpërtheu mbi të burgosurit, të cilët qenë të detyruar t'i nënshtroheshin një sistemi të tërë torturash të shumëllojshme. Por, me siguri, Revolta Spaç ‘73 është më e veçanta në historinë e njerëzimit përsa i përket viktimave të saj të dënuara nga gjyqi me vdekje. Veç katër të pushkatuarve, u krye edhe një varje në litar.

III

TARTI

"*Miqësia e kafshëve me njeriun i tregon këtij se armiqtë i ka brenda llojit.*"

Proverb mongol

Një gjykatë ushtarake dënoi me varje në litar Tartin fisnik, mikun besnik të të burgosurve: qenin që ata e kishin rritur vetë. Të burgosurit e kishin gjetur këlysh të vogël në kampin e sapongritur të Spaçit. Madjé vetë ia kishin çuar edhe emrin. Me një kujdes të përbashkët, ata e rritën Tartin të shëndetshëm dhe mjaft komunikues. Mirëpo me kalimin e kohës ky qen besnik i atyre që e ushqenin dhe e ledhatonin, filloi të shfaqte një dukuri *antiklasore*. Ndërsa tregohej i afrueshëm e i shoqërueshëm me çdo uniformë bojë kafe, Tarti u bë gjithmonë e më agresiv me uniformat jeshile të policisë së kampit. Këta të fundit kishin filluar të shqetësoheshin seriozisht nga sjellja e dyshimtë e këtij qeni.

Gardianët ishin orvatur dy herë t'i lanin hesapet me Tartin, duke u përpjekur ta helmonin. Të burgosurit, e bashkë me ta edhe mjeku i dënuar i kampit, kishin bërë çmos t'ia shpëtonin jetën qenit besnik. Falë organizmit të tij të fuqishëm dhe përkujdesjeve të pakursyera të të burgosurve, këta të fundit arritën t'ia shpëtonin jetën qenit dy herë.

E treta qe e vërteta. Kësaj here policia ishte e gjithëpushtetshme dhe mund të hiqte qafe pa vështirësi edhe një të burgosur (siç edhe kishte ndodhur) e jo më një qen të tyre. Më 30 maj 1973 jeta e Tartit ndodhej në duart vrastare të një grupi gardianësh spaçianë, të cilët mezi prisnin t'i lanin hesapet me të. Në sjelljen dhe karakterin e përbashkët të këtyre policëve nuk mund të gjeje dot kurrë aq fisnikëri sa në një gjest përgëzimi të Tartit, ashtu sikundër edhe në lehjet më të dëshpëruara të Tartit nuk mund të gjeje dot aq shumë egërsi sa vetëm në thirrjen "në rresht!" të njërit prej atyre.

Midis pushkatimit dhe varjes në litar, kjo *gjykatë ushtarake* zgjodhi variantin e dytë të ekzekutimit me arsyetimin:

«Partia jonë zemërmadhe u bëri nder shkaktarëve të revoltës duke i dënuar me pushkatim, jo me varje në litar, siç e meritonin. Prandaj qenin e tyre ne do ta varim patjetër.»

Me të thënë e me të bërë, mbasi qeni nuk kishte të drejtë apelimi të vendimit të tyre në një shtet ku njerëzit trajtoheshin më keq se kafshët. Mirëpo Tarti nuk ua la pa ua kthyer reston uniformave të urryera jeshile edhe në momentet e fundit të jetës së tij. Ndërsa po i hidhnin lakun në qafë, ai kafshoi në dorë kapter Nduen, i cili e mbante veten si specialist qensh.

Në çastet fatale të shpirtdhënies putrat e Tartit përpëliteshin në ajër, sikur donin të mbërthenin policët aq shumë të urryer për të. Për habinë e këtyre të fundit, ai nuk kuiste por, duke zgurdulluar sytë, lëshonte një hungërimë të

mbytur, që dëshmonte më shumë kërcënim e përbuzje, sesa frikë. I habitur nga sjellja e çuditshme e qenit në këtë minutë fatale për të, kapter Prenga e shprehu përsëri dyshimin që kishte shfaqur për Tartin, kur ledhatonte uniformat bojë kafe dhe kërcënonte jeshilet:

«U kam than un, or tëj, se ky asht qen agjent, i futun me qëllim në kamp.»

Këtë herë policët nuk qeshën me këto fjalë, mbasi Tarti po i habiste më shumë me mënyrën e vdekjes, sesa me cilësitë e tij të veçanta në jetë. Te këto krijesa të rritura nëpër honet më të thella të malësive të Mirditës instikti i komunikimit me kafshët ishte më i zhvilluar, se shprehitë fillestare të qytetërimit bashkëkohor. Pikërisht për këtë arsye gardianët arritën ta kuptonin Tartin, për herë të parë e të fundit në jetë, në këtë çast sublim:

Sjellja e kafshës në litar ishte një mesazh proteste e përçmimi ndaj botës që e rrethonte, në të cilën barbaria njerëzore ekzekutonte fisnikërinë shtazore.

IV

SPAÇI DHE VIZITORËT E TIJ

"*Dhimbja është një shekull; vdekja, një çast.*"

B. Gresé

Pas ngritjes së kampit, vizitorët e Spaçit u shpeshtuan dukshëm. Natyrisht, ata nuk ishin turistë kureshtarë të zakoneve të Mirditës rurale, por familjarë a të afërm të të burgosurve, që u vinin për takim.

Buzës së përroit të thellë gjarpëronte rruga e pluhurosur, e cila ishte e vetmja arterie që lidhte këtë plagë të hapur në trupin e shoqërisë bashkëkohore shqiptare me pjesët e tjera të saj. Trysnisë që do të provonin ndjenjat e një vizitori të rastësishëm para ngritjes së kampit, i shtohej edhe dhimbja e mprehtë shpirtërore e atyre që i shikonin të afërmit me kokë të qethur e uniformën bojë kafe, brenda një rrethimi të trefishtë e shumë të lartë telash me gjemba. Sy të përlotur e zemra të lënduara vinin e iknin nëpër rrugën dredha-dredha buzë përroit të thellë, i cili rrëshqiste tinëzisht e pa zhurmë përmbi pllakat e shtratit të tij, sikur të kishte frikë se mos binte në sy të policisë së pamëshirshme të kampit.

E megjithatë, e keqja e vazhdueshme në rrjedhë të kohës bëhet diçka e zakonshme. Edhe vizitorët e pezmatuar të Spaçit, në ndonjë rast, bënin shaka me të afërmit e tyre të burgosur. Kështu një ditë, gjatë takimit me vëllanë e tij, njëri nga këta vizitorë, duke parë kapter Gjokën të kalonte krenar me një lepur të vrarë në dorë, të cilit i numëroheshin brinjët, i tha të vëllait:

— Polic më të shëmtuar dhe lepur më të dobët nuk më kishin zënë sytë deri sot.

— Të denjë për njëri tjetrin – ia priti buzagas vëllai i burgosur.

Po përshtypjet e vetë këtyre banorëve fatkeqë të kampit për Spaçin, cilat ishin?

Mendime të ndryshme ishin shfaqur e ishin bërë shumë përkufizime, por, me sa dukej, tiparet më çnjerëzore e më asgjësuese të këtij kampi shfarosës spikatnin në sfondin e turnit të tretë, atij të natës. Ndofta për këtë arsye një poezi e shkruar prej të burgosurit Zef Jushi, i cili dikur kishte mbaruar studimet në Akademinë Ushtarake Italiane, u vlerësua unanimisht si himni i Spaçit. Autori i saj ishte frymëzuar pikërisht nga pamja rrëqethëse e turnit të tretë:

Thnegla të çuditshme mbi një kërcu vigan,
Atëherë kur jeta fle për me u përtri,
Të lodhur, të përgjumur, ngjitemi në kodrën tënde,
O mal i zymtë, i zi.

Asgjë prej jetës mbetur nuk na ka,
Veç syve të lodhur që në lartësi shikojnë,
Veç zemrave të ngashëruara, për dëshirë thà,
Që rrahin dhe shpresojnë.

Poshtë tok' e zezë, lart një copë qiell na ngeli,
Ku fluturojnë orët, ëndrrat, shpresat mizore,
Qiell i gërvishur me shtylla e gjëmba teli,
Urrejtje e thellë njerëzore.

Ju muzikantë, artistë e poetë,
Pse nuk i lini njerëzimit për kujtim,
Brenga të thella të vazhdojnë gjithë jetën,
Gjer në asgjësim?

Thnegla thashë? ... dhe jo larva,
Që presin krahë me u hedhë në fluturim,
E botën ta mbushin në ato ditë të bardha
Me mjaltë e pickim?

V

TRIDHJETË E NJË

"*Fati është një ligj natyror, kuptimi i të cilit është i pakapshëm, sepse një sasi e madhe të dhënash na çorienton.*"

F. Galiani

Për çudi, data 31 e muajve të privilegjuar të vitit kishte ndikuar negativisht në jetën e mundimshme të Sazan Diksit.

Më 31 maj 1949, kur ai ishte dy vjeç e një muajsh, familja e tij u internua në Kamëz të Tiranës, për shkak të arratisjes së babait. Ndërkohë që gjithë Shqipëria po fundosej në mjerim, kampet e saj të përqëndrimit ishin një kopje e kampeve të Luftës së Dytë Botërore.

Kampet e Kamëzës, Cerrikut dhe Tepelenës do të flijonin fëmijërinë e nëpërkëmbur të Sazan Diksit deri në vitin 1956. Disa qindra fëmijë shqiptarë humbën jetën në ato vite të vështira, kur zia e bukës po bënte kërdinë edhe jashtë telave me gjemba. Ngjarjet e internimit do të linin gjurmë të thella në kujtesën e virgjër fëminore të Sazanit. Para syve të tij të pafajshëm do të shtjelloheshin skena terrori që dridhmonin edhe burrat.

Nënat me fëmijë të vegjël ishin martiret e vërteta në ato qendra shfarosjeje, ku antishqiptarizmi dhe antihumanizmi i ideologjisë më agresive, që kishte njohur njerëzimi në kushte paqeje, po gjymtonte popullin e pafajshëm dhe të ardhmen e vendit. Ndonëse nënat vetë kryenin punë të rënda të detyruara prej komandës së kampit, ato rezervonin diçka prej ushqimit të tyre të pakët, me qëllim që të kishin me çfarë t'i gënjenin fëmijët e uritur në mbrëmje, për t'i zënë gjumi. Për fat të mirë, aparati tretës i këtyre nënave – truri i dytë i organizmit njerëzor – e ndiente sakrificën e tyre dhe solidarizohej me to. Jo pak nga këto heroina dhanë shpirt, në përpjekje për të mbajtur gjallë fëmijët e tyre.

Meqenëse kosa e vdekjes po përparonte shpejt midis radhëve të rralluara të gjeneratës së re fatkeqe, qeveria shqiptare vendosi të lironte fëmijët e internuar, të cilët kishin ndonjë njeri të afërm në *jetën e lirë*, i cili do të ishte i gatshëm të kujdesej për ta. Meqenëse babai i Sazanit kishte qenë djalë i vetëm (nuk kishte as motër), fëmijët e familjes Diksi mbetën sërish në internim. Vetëm pas ngjarjeve hungareze të vitit 1956, ata u liruan me shumë familje të tjera shqiptare.

*

E kthyer sërish në Vlorë, familja Diksi e gjeti shtëpinë e saj të zënë prej familjes së një oficeri të Sigurimit. Në pritje të një vendimi përfundimtar, familja e liruar rishtas prej internimit u strehua në një barakë të vjetër në periferi të qytetit.

Dy muaj më vonë, në mbrëmjen e 31 dhjetorit, një kamion ndaloi para barakës prej dërrasash pjesërisht të kalbura. Një titullar i policisë së Vlorës i komunikoi gjyshes së Sazanit, si kryefamiljare, vendimin e DPB: familja Diksi nuk kishte më të drejtë të jetonte në qytet; ajo dëbohej përgjithmonë në fshatin e origjinës, në Dukat.

Pa e zgjatur, kamioni i zbuluar, i shoqëruar me dy policë, u nis për udhë nën një shi që binte me shtamba. Të strukur poshtë një velenxe të madhe, që ua kishte falur një i njohur kur banonin në barakë, familja Diksi e festoi vitin e ri 1957 duke ndarë një ftua në gjashtë pjesë: gjyshja, nëna, dy vëllezërit dhe dy motrat. Si më i vogli i familjes, Sazani doli i fituar i festës: ai hëngri dy feta ftoi. Gjyshja dhe nëna i dhanë gjysmën e fetës së tyre, me kusht që ai të pushonte së qari prej lagies nga shiu i rrëmbyer, që po e përshkonte lirisht velenxën.

VI

LEXIMI — E VETMJA KËNAQËSI NË JETËN E CUNGUAR

“*Secili prej leximeve tona lë një farë që do të mbijë një ditë.*”
Zh. Rënàr

Dukati i njohur për pikëpamjet kombëtariste, u bë një shesh i luftës së klasave pas triumfit të ideologjisë antikombëtare. Megjithatë familja Diksi kishte kaluar prej breshërit në shi dhe kjo nuk ishte pak për të. Uria ishte zëvendësuar prej ushqimit të dobët, telat me gjemba prej një vule në kartën e identitetit, apeli dy herë në ditë prej paraqitjes çdo mëngjes të kryefamiljarit para zyrës së këshillit popullor të fshatit. Kushtet e jetesës linin shumë për të dëshiruar, por gjithsesi ata e kishin mundësinë ta mbushnin stomakun me lakra pa vaj të përziera me një dorë miell dhe të thithnin ajër të pastër. Nuk i trembeshin më vdekjes nga uria dhe ky ishte çlirim i vërtetë për ta.

*

Sazani e përfundoi shkollën shtatëvjeçare si nxënës i dalluar. Shkollë të mesme në fshat nuk kishte. Për të vazhduar gjimnazin, ai duhej të banonte përkohësisht në Vlorë. Një qetësim relativ i luftës së klasave e mundësoi diçka të tillë, por mbetej problemi kyç: shpenzimi ekonomik. Kjo ishte një ngarkesë e papërballueshme për familjen.

Në letrat e rralla që u dërgonte babai, Sazani kishte konstatuar se ai nuk harronte asnjëherë të pyeste për shkollimin e fëmijëve. Kur mësoi se djali i tij i madh dhe të dy vajzat mbetën me arsim shtatëvjeçar, ai kishte shfaqur interesim për mbarëvajtjen në shkollë të djalit të vogël. Kur mori vesh se Sazani e mbaroi shtatëvjeçaren me rezultate maksimale, babai i dërgoi një letër familjes, duke i bërë thirrje që ta dërgonte në qytet atë, për të mbaruar shkollën e mesme. Ai vetë merrte përsipër shpenzimet vjetore të shkollimit të Sazanit. Megjithëse shteti diktatorial i konvertonte në lekë me një vlerë qesharake dollarët e emigrantëve politikë (ndryshe prej dërgesave të emigrantëve ekonomikë), babai i Sazanit i mbuloi rregullisht shpenzimet shkollore të të birit, ashtu siç kishte premtuar.

Për fat të mirë, midis lëndëve të gjimnazit figuronte edhe gjuha frënge. Meqenëse Sazani e dinte që ishte i privuar prej studimeve të larta për arsye biografie, ai iu përkushtua frëngjishtes, ndërkohë që shkëlqente në të gjitha lëndët. Sazani i përfundoi në tre vjet tekstet shkollore të gjuhës frënge të parashikuar për katër. Profesori i tij i frëngjishtes, një intelektual i kompletuar me biografi jo *të pastër*, e mori vesh situatën në të cilën ndodhej nxënësi i tij më i mirë dhe e mbështeti me zell prindëror në përvetësimin e gjuhës frënge.

Ndërsa nxënësit e tjerë vazhdonin normalisht programin e parashikuar shkollor, profesori bamirës i siguronte Sazanit tekste të një stadi superior dhe e

kontrollonte nga afër ecurinë e tij premtuese. Për më tepër, ai e prezantoi nxënësin e tij të zellshëm me përgjegjësen e bibliotekës së Vlorës, me qëllim që ajo t'i jepte për të lexuar Sazanit libra të zgjedhur në frëngjisht, të cilët fillimisht ia rekomandonte vetë profesori. Në këtë periudhë ajo bibliotekë ishte shumë e pasur me letërsi në gjuhën frënge, që u ishte sekuestruar familjeve të pasura. Meqenëse lexuesit në gjuhë të huaj asokohe ishin mjaft të rrallë, Sazanit iu krijua mundësia të lexonte perla të letërsisë frënge e botërore, të cilat do të krijonin bazën e formimit të tij intelektual. Ndonëse pas vitit 1967 shumica e atyre librave do të hiqeshin prej bibliotekës, atje mbeti gjithmonë një fond i mjaftueshëm letërsie të mirëfilltë, që i mundësoi Sazanit evitimin e humbjes së kohës dhe prishjes së shijes me librat e realizmit socialist. Ai do ta kujtonte gjithmonë me nostalgji këtë kohë të artë leximesh për të, gjë që e vlerësonte si *kapërcim të klonit diktatorial në kulturë*.

Babai i Sazanit kishte mbaruar liceun francez të Korçës dhe dispononte një kontigjent librash të zgjedhur në gjuhën frënge. Para se të arratisej, ai ia kishte besuar një pjesë të tyre një të njohurit të tij, i cili, shumë vite më vonë, ia ktheu Sazanit. Kjo ishte dhurata më e çmuar që mund t'i ofrohej Sazanit në atë periudhë etjeje për lexim.

*

Pas kryerjes së shërbimit të detyrueshëm ushtarak, Sazani rifilloi jetën në fshat. Ishte koha kur, nën shembullin e Revolucionit kulturor proletar në Kinë, prej dy vjetësh kishte shpërthyer një valë e nxehtë e luftës së klasave që dukej se nuk do të zbehej kurrë. Dikur, në kampet e internimit, Sazani i vogël pyeste veten: «Pse këta shqipfolës torturojnë në këtë mënyrë nënat dhe fëmijët shqiptarë?»

Dikur…, por jo më tani. Ai ishte ndërgjegjësuar plotësisht tashmë për rrezikun e të jetuarit në gjirin e një shoqërie të çakorduar, ku lufta e verbër e njeriut kundër njeriut ishte shpallur *forca e përparimit*. Shoqëria *e re* kishte keqtrajtuar tmerrësisht nënat shqiptare, duke gjymtuar kështu të ardhmen e një populli të droguar ideologjikisht. Sazani nuk i lejonte më pyetje të tilla vetes, si dikur në fëmijërinë e mjerë. Ai e dinte se pyetja kërkon përgjigje nëpërmjet arsyetimit, mirëpo arsyeja nuk funksiononte më; ajo ishte shpallur *reaksionare*. Gaforrja nuk mëson dot të eci për së mbari.

Në këto kushte dëshpëruese, Sazani përpiqej të mos u jepte shkak atyre që mezi prisnin ta godisnin përsëri. Ai llogariste vetëm një mik besnik, librin; edhe atë të fshehur në trastën e bukës së misrit, që merrte nga shtëpia për ta ngrënë ugareve. Mirëpo prishja e marrëdhënieve me *Motrën e Madhe*, Kinën, shkaktoi një intensifikim të ndjeshëm të luftës së klasave. Parrulla *revolucionare* e ditës ishte shumë provokuese: «Indiferenti është një armik i maskuar; vetmia është një protestë e heshtur ndaj jetës sonë socialiste.»

Ora e Sazan Diksit kumboi. Megjithë kujdesin e tij të përhershëm, atë e arrsetuan pesë ditë para se të festonte 31 vjetorin.

VII

DOSJA PENALE N° 31

“*Urrejtja e verbër ushqehet me gjithfarë gjërash të vogla.*”
H. dë Balzak

Zyrat e DPB të Vlorës ndodheshin në dalje të qytetit, ndanë të rrugës automobilistike kombëtare që çonte në Fier. Çatia prej betoni e birucave të izolimit të të arrestuarve dukej prej rrugës. Sa herë që i shkonin atje sytë, Sazani thoshte me vete: «Më ndihmoftë fati të mos ta shikoj brendësinë e tyre!»

Mirëpo atij i kishte rënë në pjesë fatkeqësia, jo fati. Sazanin e izoluan në qelinë 3. Ndofta ngaqë nuk kishte ndonjë me n° 31… Ato ishin vetëm 29. E zhytur në një gjysmëerrësirë të përhershme, dy metër e gjysmë e gjatë, nëntëdhjetë centimetër e gjerë dhe mbi katër metra e lartë, biruca i krijonte përshtypjen e një arkivoli të gurtë, kur qëndronte shtrirë në shpinë. Asnjë dritare, përveç një kamareje në tavan të mbyllur me një xham të trashë dhe një grillë të fortë hekuri, ku ishte varur një llampë gjithmonë e ndezur. Drita e saj e zbehtë thithej prej errësirës së thellë, pa arritur ta ndriçonte pjesën e poshtme të birucës. Kjo mungesë e theksuar ndriçimi shërbente si paralajmërim për të arrestuarin, se atje gjithçka rridhte në errësirë.

«Po të arrestuan ndonjëherë, mos harro se personi i parë që do të gjesh në qeli është spiuni yt» – i kishte bërë të ditur Sazanit një i njohur i tij ish-i burgosur politik.

Sazani qe i detyruar të flinte tri javë ngjitur brinjë për brinjë me spiunin e tij. I zhgënjyer prej rezultateve të zhbirimit të veglës së tij të verbër, shefi i hetuesisë [njëherësh hetues i Sazanit] e tërhoqi për ndonjë destinacion tjetër shtegtarin e birucave. Sazani mbeti vetëm në qeli edhe tre muaj e gjysmë të tjerë. Ai flinte i mbështjellë me një batanije të vjetër, e cila përbënte gjithë pajisjet e nevojshme për të fjetur. Si në gjumë edhe i zgjuar, ai e kalonte kohën në shoqërinë e përhershme të morrave të shumtë.

Çdo mëngjes, në orën gjashtë, oficeri i rojës dhe eskorta e tij kontrollonin pjesën e brendshme të birucës. Duke rrudhur fytyrën prej ndotit, një polic kontrollonte në trup të arrestuarin, i cili nuk pushonte së kruari. Kur i izoluari ankohej për morrat, oficeri i rojës ia kthente duke kërcëllitur dhëmbët:

— Ne nuk të ftuam të vije këtu, por të sollëm me pranga. Të kemi armik, jo mik. Në qoftë se ishe më mirë në shtëpi, pse nuk i respektove ligjet? Armiqtë e partisë sonë janë më të neveritshëm se morrat.

Në një pjatë alumini të deformuar e të nxirë nga koha – sa fatkeqë e kishin përdorur atë? – jepej ushqimi përçmues: lëtyrë perimesh në drekë dhe çaj pa sheqer në darkë. Në mëngjes të arrestuarit merrnin racionin ditor të bukës, 500 gramë, me pak marmalatë ose djathë. Një ditë supa ishte shëllirë, ditën tjetër bajate. Luga të bënte për të qeshur: bishti i saj nuk i kalonte tre centimetrat.

*

Në mbrëmjen e ditës së arrestimit, Sazanin e çuan në njërën prej tri dhomave të hetuesisë, me pranga të shtrënguara fort. Atje prisnin katër oficera Sigurimi dhe zëvendësprokurori i rrethit. Shefi i hetuesisë, me cilësinë e hetuesit personal të të arrestuarit Diksi, lexoi motivacionin e arrestimit:

«Agjitacion e propagandë kundër partisë e shtetit»

Pastaj shefi i hetuesisë, duke treguar me dorë një dosje mbi tavolinën e fiksuar në dysheme, shtoi:

— I pandehur, të gjitha hollësitë e veprimtarisë tënde armiqësore ndodhen në këtë dosje penale.

Me sytë mbi dosjen objekt diskutimi, Sazani buzëqeshi hidhur; mbi kapakun e saj shkruhej: *Dosje penale n° 31*.

— Të ardhka për të qeshur? pyeti duke kërcëllitur dhëmbët shefi i hetuesisë. – Natyrisht, ti veprimtarinë armiqësore e ke kryer me ndërgjegje të plotë. Por qesh vërtet ai që qesh i fundit. Dhe të fundit jemi ne që qeshim gjithmonë. Tani urdhëro dhuratën e mirëseardhjes.

Shefi i hetuesisë e goditi të pandehurin e prangosur me shkelm në kërci. Ndërkohë që Diksi u përkul nga dhimbja e këmbës, ai e goditi me të dy grushtat e bashkuar pas kokës. I pandehuri u shemb përtokë, ku secili prej të pranishmëve nuk ngurroi të jepte kontributin e tij në kuadër të dhuratës së mirëseardhjes.

Dy muaj më vonë, shefi i hetuesisë me prokurorin e rrethit patën rastin të argumentonin faktin e mirënjohur, se ishin ata që qeshnin gjithmonë të fundit e jo i pandehuri. Fjalën e mori shefi i hetuesisë:

— Meqenëse ti nuk e pranon krimin e agjitacion propagandës, ne kemi vendosur të ta ndryshojmë akuzën. Sot e tutje je i akuzuar për *përgatitje për arratisje*. Kështu dalim të dy palët të fituar. Nëpërmjet akuzës së re, ne kemi mundësi të të dënojmë deri në 15 vjet burg, jo 10 vjet siç parashikon maksimumi i nenit të agjitacion-propagandës. Ndërsa ti do të biesh në qetësi, mbasi ne i kemi tashmë gati dëshmitarët që do ta vërtetojnë akuzën e re.

— E pranon ndryshimin e akuzës? e pyeti të arrestuarin prokurori i rrethit.

— Mua më kanë arrestuar duke mbjellë misër me kubikë në Dukat, nuk më kanë kapur në kufi që të pranoj akuzën për arratisje – u përgjigj Diksi.

— Vigjilenca popullore e asgjësoi që në vezë planin tënd që të bashkoheshe me babanë në Amerikë – ia priti shefi i hetuesisë. – Yt atë është spiun i CIAs. Po ti, a do të bëheshe një ditë shërbëtor besnik i këtij instrumenti famëkeq të imperializmit amerikan, xhandarit ndërkombëtar?

— Unë nuk kam njohur as babanë, pa le më CIAn – u përgjigj i arrestuari.

— Pikërisht për këtë arsye, ëndrra jote ishte t’i njihje të dy njëherësh. Por, mjerisht, nuk arrite ta kurorëzoje synimin tënd antishqiptar. Ti doje të ndiqje

rrugën e babait, por diktatura e proletariatit do të të japë një mësim të mirë, që nuk do ta harrosh dot kurrë. Vuajtjet që ke provuar gjatë hetuesisë janë vetëm fillimi i shpagimit të borxheve të babait dhe të tuat kundrejt partisë sonë. Kur të shkosh në kampin e punës së detyruar, atje nis larja e vërtetë e hesapeve. Ne nuk ngopemi me gjakun e këlyshit të një agjenti të CIAs.

Në çast, shefi i hetuesisë i zëvendësoi fjalët me vepra. Ai nxori një shkop gome prej sirtarit të tavolinës dhe filloi ta godiste me gjithë forcën e krahut Sazanin, ku të mundte.

*

I dënuar me 14 vjet heqje lirie dhe punë të rëndë të detyruar, më 31 gusht 1978 Sazan Diksi, i mbyllur në një autoburg me fatkeqë të tjerë, udhëtonte për në burgun qendror të Tiranës, prej nga bëhej shpërndarja e të dënuarve rishtas nëpër kampet e punës. I qullur në djersë prej nxehtësisë mbytëse brenda autoburgut të ajrosur vetëm prej dy birave në tavanin metalik, Sazani mendonte me vete:

«Numri 31 është ndoshta burim tersllëku për mua, meqenëse kam lindur ditën e fundit të prillit, i cili është i privuar prej shifrës 31.»

VIII

PAS INTERNIMIT E DËBIMIT — SPAÇI

"*Kufiri i çdo dhimbjeje është një dhimbje më e madhe.*"

E. Cioran

Të veçuar prej të dënuarve për krime ordinere, të burgosurit politikë, radhët e të cilëve shtoheshin me shpejtësi në këtë periudhë, zinin fjetoren më të madhe të burgut qendror. Atje kishte të dënuar rishtas prej rretheve të ndryshme të vendit, të burgosur që ktheheshin prej spitalit apo që do të shkonin atje, të tjerë që transferoheshin nga një kamp pune në një tjetër, ose… shtegtarë birucash. Këta të fundit përbënin një kategori endé të panjohur për shumicën dërrmuese të të burgosurve rishtas.

Të burgosurit e rinj interesoheshin për gjendjen e përgjithshme në kampet e punës. Nga sa dëgjonin, pushtoheshin prej ankthit. Megjithatë, pas disa muajsh izolimi në birucat plot me morra, ata kishin mundësi të bënin dush çdo të shtunë dhe të pinin duhan pa orar. Mirëpo kjo ishte një periudhë kalimtare, që nuk zgjaste shumë. Kampet e punës kishin nevojë për gjak të ri, për ta realizuar e tejkaluar planin e nxjerrjes së mineralit me *punëtorë të detyruar*.

Më 10 shtator 1978 një autoburg përshkonte rrugën malore drejt Spaçit me Sazan Diksin dhe 13 të burgosur të tjerë brenda. Disa prej tyre kishin vjellë. Të tjerëve po u ngrihej të pështjellët prej pamjes së pisët para syve, erës së rëndë dhe tronditjes prej xhadesë gjithë gropa.

Në orën katër pasdite, autoburgu hyri në kamp. Një grumbull i madh policësh e ushtarësh e qarkuan. Duke dëgjuar romuzet e policëve që stigmatizonin *armiqtë* e sapoardhur, Diksit i kaluan mornica. E folura e tyre e papërpunuar – krejt si ata vetë – reflektonte prirjen e tyre të natyrshme në pajtim me brutalitetin e diktaturës. Asgjë nuk i shërben një diktature më shumë sesa injoranca.

Gardianët i urdhëruan të burgosurit të zhvisheshin vetëm në të mbathura. Pastaj filluan t'ua kontrollonin teshat, duke i flakur me përçmim prej morrave. I habitur nga kjo sjellje e policisë, njëri prej të burgosurve i tha shokut që kishte në krah:

— Po ne na kontrolluan kur u nisëm nga Tirana; ç'ne ky kontroll tjetër?

Njëri prej policëve e dëgjoi dhe e goditi me një kuti duhani metalike, që po kontrollonte në atë çast. I burgosuri pësoi një të çarë ndanë të syrit të djathtë dhe gjaku i rrodhi përgjatë trupit lakuriq. Mjeku i burgosur, i cili po kontrollonte higjenën fizike të të sapoardhurve, guxoi t'i kërkonte leje policit agresiv, për ta çuar të plagosurin në infermieri, që ta mjekonte.

— Mos do me e provu e ti i her? iu hakërrua polici duke zgurdulluar sytë.

Pasi bënë dush dhe veshën uniformën e kampit, të burgosurit e sapoardhur u përzien me turmën. Të lodhur prej hetuesisë disamujore dhe udhëtimit të mundimshëm, mysafirët e rinj të Spaçit dëshironin të pushonin. Mirëpo

“mikëpritësit” i kishin vënë në mes, të interesuar sipas rretheve përkatës, dhe nuk reshtnin me gjithfarë pyetjesh. Ndonëse të sapoardhurit kishin disa muaj që ishin shkëputur prej jetës së lirë, banorëve të kahershëm të Spaçit u dukej sikur ata sapo ishin ndarë me botën matanë telave me gjemba.

Diksi vazhdonte të qëndronte i mbështetur pas murit në krye të shkallëve, të cilat do ta bashkonin me të burgosurit e shumtë. Duke përfituar ngaqë nuk e kishin vënë re akoma, ai, me një pamje të menduar, po endte shikimin mbi atë turmë të madhe fatkeqësh që bënin tutje-tëhu, përshëndeteshin, bisedonin, thërrisnin dhe, ç’ishte më e çuditshmja – qeshnin. Kjo i bëri përshtypje të veçantë Diksit. Mbijetesa e të qeshurit, në një vend që ishte ndërtuar posaçërisht prej shtetit për ta vrarë atë, iu duk si një shkelje ligji.

«E pabesueshme, njeriu qeshka edhe këtu», tha me vete.

Me hap të ngadalshëm, ai zbriti shkallët e u përzie me turmën dhe kalvarin e saj të përditshëm.

*

Pas një jave Diksi filloi punën e rëndë në minierë, me tre turne. Vuajtjet e internimit e të dëbimit e kishin përgatitur shpirtërisht, për t’iu bërë ballë vështirësive të reja në rritje. Kjo do të ishte për të një tjetër provë rezistence ndaj së keqes.

Ndonëse masa pesëvjeçare e dënimit me dhunë ekstreme të këtij kampi akorduar nga qeveria pas revoltës së vitit 1973 ishte plotësuar pak muaj më parë, gjendja vazhdonte të mbetej mjaft e tensionuar, për shkak të inercisë revolucionare. Terrori është një element përbërës i diktaturës dhe nuk di të ndalet po aq lehtë sa e merr hovin.

Dhuna e egër ndaj të burgosurve vazhdonte. Madjé, shumica e policëve e quanin të pamjaftueshëm ndëshkimin fizik, pa humbje të përsëritura ndjenjash prej të burgosurve. Në fund të çdo turni pune policia çonte në kamp të burgosur duarlidhur të akuzuar për punë të pamjaftueshme. Aty ata i nënshtroheshin një rrahjeje kolektive prej të gjithë gardianëve që linin turnin e punës, nën sytë flakërues të oficerit të rojës dhe komandantit ose komisarit të kampit. Secili prej policëve, për të shpalosur para eprorëve të pranishëm zellin e tij të pamasë në kryerjen e detyrës, përpiqej të sajonte një metodë të re torture. Pas përfundimit të ceremonisë ndëshkimore, ata izoloheshin për një muaj në biruca.

Këto ishin të ndërtuara me dyer direkt në natyrë. Ana e sipërme e soletës së qelivve ishte në nivel me lartësinë e tokës së gërmuar për sheshimin e vendit ku ishin ngritur. Korridori pa çati i këtyre birucave ishte i mbuluar me një lesë të fortë hekuri, njëri krah i së cilës futej thellë në dhé, kurse krahu tjetër ishte betonuar bashkë me soletën e qelive. Dyert e rënda të birucave ishin lënë enkas 20 cm më lart nga çimentoja e dyshemesë. Shiu ose bora hynin lirisht deri në mes të birucave të ndërtuara prej betoni nga të gjitha anët. Ndërsa gjatë dimrit

nuk mund të flihej dot prej të ftohtit, në verë të izoluarit nuk mbusheshin dot me frymë.

Në rajonin e banimit ushtrohej kontroll i përgjithshëm dy herë në muaj. Për orë të tëra, ushtarë e policë përmbysnin gjithçka nëpër dhomat e fjetjes me shtretër kolektivë tip dyshemeje trekatëshe prej dërrasash të pazdruguara. Në një dhomë 7x6x3 metra flinin 54 të burgosur. Batanijet, çarçafët, dyshekët dhe sendet e tjera personale, si stilolapsa, prerëse thonjsh, zarfa, fletore etj. hidheshin në mes të dhomës dhe ushtarët e policët, me çizmet gjithë ujë e baltë, shkelnin mbi to. Pas kontrollit, të burgosurit për një kohë të gjatë mezi gjenin sendet e tyre. Shpesh ushtarët dhe policët përvetësonin sende që u pëlqenin, si stilolapsa, cigarishte, rripa mezi, etj.. Kush ankohej për një gjë të tillë i nënshtrohej një ndëshkimi të rëndë fizik, mbasi akuzohej se donte të ofendonte qëllimisht personelin ushtarak nga pozita armiqësore e të burgosurit politik.

Gjatë kohës që vazhdonte kontrolli, të burgosurve u lexoheshin *veprat* e Diktatorit për *riedukim*. Një luftë nervash shkatërrimtare, e cila në stinën e dimrit përballohej me vështirësi prej tyre, duke qëndruar në bisht disa orë, mbasi terreni ishte i mbuluar me borë.

Ushqimi, përveç emrit, nuk kishte asgjë të përbashkët me një ushqim njerëzor: shtatë muaj presh (jeshil ose të thatë) të zier dhe pesë muaj speca të ziera. Rrallë ndonjë zarzavate gjatë verës. Jepej edhe nga një racion pilaf orizi i përzier me mel e ndonjëherë pak qumësht si antidot.

Mishin e planifikuar për të burgosurit që punonin në minierë e hanin oficerët, policët, ushtarët e rrethimit të kampit dhe të burgosurit që shërbenin si prapavijë brenda kampit (spiunë të komandës). Në këtë abuzim merrnin pjesë edhe *zogjtë* shtegtarë, siç thirreshin prej të burgosurve spiunët e specializuar të birucave, të cilët përdoreshin prej hetuesive të rretheve, për të mashtruar të arrestuarit rishtas dhe pa eksperiencë gjatë procesit hetimor. Kjo dukuri e habiste shumë Diksin. Ndonëse jeta në internim e dëbim ia kishte mësuar disa prapaskena të krimit shtetëror qysh herët, atij nuk i kishte shkuar kurrë ndërmend, se në mënyrë kaq të hapur mund të mbusheshin autoburgjet me *zogj shtegtarë,* për t'i shpërndarë mandej si qena gjahu anekënd Shqipërisë së terrorizuar. Të njëjtën përshtypje i krijoi atij arrestimi dhe ridënimi brenda në burg *për veprimtari armiqësore* i të burgosurve politikë. Si justifikonej vallë juridikisht një veprim kap absurd? Duke u përpjekur t'i gjente një përgjigje kësaj pyetjeje, Diksit iu kujtua një thënie e Musolinit: *Komunisti është njeri pa ligj*.

*

Ditën që kampin e përfshinin valët e arrestimeve, aty hynin hetuesit e shëndetshëm me çantat e zeza të fryra; këto ishin plot me *prova* të veprimtarisë armiqësore të kryer brenda në burg! Ata shoqëroheshin prej operativit të kampit,

komandantit ose komisarit dhe nga disa oficerë të tjerë të komandës. Pasi dubloheshin rojet e rrethimit më të afërt, fillonte loja *macja-miu*.

Me shenjën e operativit të kampit ose të ndonjë hetuesi, pesëmbëdhjetë a njëzet policë që rrinin në gatishmëri pas murit të portës së brendshme të sheshit ku rreshtoheshin të burgosurit, vërsuleshin me vrap duke u shpërndarë në disa grupe midis të burgosurve të rreshtuar. Secili grup policësh kishte një përgjegjës, të cilit i jepeshin emrat e të burgosurve që do të riarrestonte grupi i tij. Rreshtimi bëhej në bazë të brigadave të punës, ndërsa të papunët veç. Kjo i ndihmonte policët që të gjenin kollaj secili grup *gjahun* e tij. Mirëpo në bazë të udhëzimeve, ata duhej të zhvillonin një lojë spektakolare për sytë e ndezur të gjaksorëve profesionistë me çantat e zeza e të fryra.

Policët bënin sikur nuk i gjenin dot kurbanët që kërkonin. Ata i shtynin të burgosurit sa andej-këtej, i kthenin me fytyrë nga vetja, mbërthenin ndonjërin për t'i hedhur prangat, pastaj, si thoshnin "jo, s'qenka ky!", vazhdonin më tutje. I hidhnin sytë listës me emrat e të burgosurve që do të arrestonin, mblidheshin bashkë sikur do të konsultoheshin për të fiksuar vendndodhjen e personit që kishte radhën për arrestim dhe, mbasi drejtoheshin për tek ndonjë brigadë tjetër, paptritur ndryshonin drejtim dhe mbaronin punë me atë që duhej. Kjo lojë makabre me ndjenjat dhe nervat e të burgosurve vazhdonte gjysmë ore. Personat e arrestuar merreshin nga policë të tjerë, që i çonin duarlidhur në autoburg.

Arrestimet e të burgosurve për *veprimtari armiqësore* brenda në burg u ndërprenë vetëm pas *vetëvrasjes* së kryeministrit M. Shehu. Objektivi kryesor i diktatorit plak kishte qenë gjthmonë mashtrimi i opinionit publik. Pasi qëroi hesapet me pretendentin kryesor për të marrë frenat e pushtetit pas vdekjes së diktatorit të sëmurë, ky organizoi një vizitë në Galarinë e Arteve Figurative. Me këtë Hoxha donte të tregonte se i kishte aq në *terezi* problemet e politikës, saqë i tepronte koha të interesohej edhe për artin! Por goja që i merrej dhe këmbët që mezi e mbanin vërtetonin se ai jetonte në ethe aluçinacionesh dhe fantazma e ish-kryeministrit po i merrte frymën. Atë që Diktatori përpiqej ta mbulonte, po e zbulonte më shumë.

«Si Kozeta e Hygoit, kur kthehej me kovën e rëndë të ujit në Monfermej dhe e zinte nata rrugës nëpër korie» – mendonte me vete Diksi. – «E llahtarisur prej vetmisë në pyll, ajo këndonte për t'i dhënë zemër vetes: “jo, unë s'kam frikë”. Veçse me një ndryshim rrënjësor midis tyre: ajo ishte mishërimi i pafajësisë, ky është mishërimi i krimit.»

Për të bindur opinionin publik se ato që thoshte kllouni plak nuk i kishte me shaka, Diktatori bëri falje për të burgosurit e pafajshëm, pas 20 vjetësh…

IX

EDHE ATA ISHIN NJERËZ…

"*Krimit i jepet shpesh theksi i virtytit prej kriminelëve.*"

Zh. – B. Gresé

Pavarësisht prej qëllimit demagogjik, falja i dha një farë frymëmarrje më të lirë gjendjes anormale të kampit. Edhe të burgosurve të ndershëm iu ngjall disi shpresa, se mund të dilnin një ditë prej burgut. Një gjë të tillë e kishin hequr nga mendja më parë pjesa më e vendosur e më e ndershme e të burgosurve politikë. Pas çdo thirrjeje të tellallit "reparti i të burgosurve të rreshtohet në fushë!", të gjithë të burgosurit e kategorisë së sipërpërmendur visheshin sa më trashë dhe mbushnin xhepat me paketa cigaresh, para se të rreshtoheshin sipas urdhërit. Ata i linin porosi shoku-shokut për ndonjë problem personal apo familjar. Nuk dihej se cilët prej tyre do të rrëmbente vala e asaj dite e cilin do ta kursente për një ditë tjetër në të ardhmen. Dihej vetëm se valët e herëpashershme të arrestimeve synonin pikërisht atë pjesë të të burgosurve, të cilët komanda e kampit i kishte cilësuar *të parehabilitueshëm*. Pra, atë pjesë, e cila alternativës *jetën* ose *moralin*, i kishte dhënë zgjidhje në favor të të dytit.

A kishte kufij mizoria e diktaturës shqiptare?

Në realitet ishte vetëm kapaciteti i fantazisë keqbërëse të shërbëtorëve cinikë të diktaturës, që përcaktonin kufijtë e asaj mizorie, mbasi ligji nuk iu ndalonte asnjë krim ndaj armiqve të partisë.

*

Në muajin mars të vitit 1979, komanda e kampit të Spaçit ekspozoi disa fotografi të jashtëzakonshme në stendat e katit përdhes të fjetoreve. Ato tregonin tre ish-të burgosur të Spaçit të pushkatuar rishtas. Asnjë pushtues i tokës shqiptare nuk ia kishte lejuar ndonjëherë vetes të krenohej me afishimin e pamjeve të tilla: secili prej të ekzekutuarve me një plumb në ballë ishte i lidhur pas një shtylle, me duar në pranga. Gjaku kishte rrjedhur mbi një çarçaf të bardhë, me të cilin u kishin mbuluar leckat e burgut para se t'i pushkatonin.

Për çfarë krimi ishin dënuar me vdekje?

Për dy letra adresuar pushtetit qendror në Tiranë, ku denoncohej veprimtaria antikombëtare e diktatorit Hoxha.

*

Një «hoopaaa!» e zgjatur u tërhoqi vëmendjen të burgosurve të Spaçit që qarkullonin në ato çaste para pallatit të fjetoreve. Një i burgosur u hodh prej

ballkonit të katit të dytë të fjetoreve në tentativë vetëvrasjeje. Duke rënë, kapota e murrme i ishte hapur si parashutë.

Ishte data 6 qeshor 1979. Dy autoburgje po prisnin përbrenda portës së madhe të kampit të mbusheshin me *zogj shtegtarë*. Operativi i kampit po përpilonte listën e tyre. Midis emrave të tjerë, figuronte edhe ai i Filipit, një ish-mësues nga Lezha i burgosur rishtas. Gjatë hetuesisë ai kishte nënshkruar një deklaratë bashkëpunimi me Sigurimin e Shtetit. Megjithatë ai e kishte ndarë mendjen që të mos bëhej spiun birucash. Për këtë arsye, Filipi e refuzoi prerazi propozimin e operativit që të nisej me autoburg për *gjueti*.

I kërcënuar prej oficerit të Sigurimit se do ta paguante shtrenjtë refuzimin e tij, Filipi u hodh prej ballkonit të katit të dytë. Ai nuk vdiq, por pësoi dëmtime të rënda: katër fraktura në këmbë e në duar dhe disa brinjë të thyera. Ndërkohë që po e çonin me barelë në infermierinë e kampit, ai belbëzonte në kllapi:

«Le të vdes, le të vdes, por atë poshtërsi nuk e bëj.»

Megjithë gjendjen e rëndë shëndetësore të Filipit, operativi nuk pranoi që ta çonin në spitalin e Tiranës. Mjeku i burgosur përpiqej me sa mundej ta ndihmonte. Kur Filipi u përmend pas traumës, vizitori i tij i parë qe operativi:

— E, Filip, mendove se do të shpëtoje nga unë, ë? Vdekja nuk të pranoi, se kemi ca hesape bashkë. Shtrëngohu mirë tani, se kur të çohesh në këmbë fillon *loja* e vërtetë me mua.

Megjithë insistimin e mjekut të burgosur se Filipi duhej çuar doemos në spitalin e Tiranës, operativi e bënte veshin të shurdhër. Vetëm kur mësoi se këmbët e të aksidentuarit u gangrenizuan, ai e miratoi shtrimin e vonuar në spital.

*

Në dhjetor të vitit 1979 u fut për herë të parë televizori në kampin e Spaçit. Disa persona u angazhuan për montimin e tij. Të burgosurit prisnin me padurim të soditnin ekranin e vogë, shumica për herë të parë. Për fat të keq, pikërisht atë ditë hetuesit me çanta të zeza vërshuan sërish në kamp; do të bëheshin arrestime.

Midis të arrestuarve qe edhe Muçua, një fshatar nga rrethi i Vlorês, pothuajse analfabet. Sharjet në adresë të diktatorit ishin shndërruar në një serum të pazëvendësueshëm për gjendjen shpirtërore të Muços. Këtë *mëkat* ai e kishte paguar shtrenjtë. I katandisur kockë e lëkurë, me dhëmbë të rënë, pesha e tij trupore nuk i arrinte të 50 kilogramët.

Pavarësisht prej rënies së ndjeshme shëndetësore, Muçua ishte tepër rezistent në tortura. Ndërsa policët e torturonin, ai i shante pareshtur, derisa humbiste ndjenjat. Pas një periudhe të gjatë kohe, gardianët e deklaruan Muçon *psikopat* dhe përgjithësisht nuk merreshin më me të. Por hetuesit me çanta të zeza nuk e harronin kurrë emrin e të burgosurit, që guxonte të shante përditë *udhëheqësin e lavdishëm*.

Meqenëse Muçua nuk kishte parë televizor ndonjëherë, ishte shumë kureshtar ta shikonte atë natë dhjetori. Për herë të parë ai i lejoi vetes t'iu drejtonte një kërkesë persekutorëve të tij të paepur:

— Unë e di që shtëpia ime do të jetë burgu, përsa të jeni ju në pushtet. Veç më lini të shikoj sonte televizorin dhe pastaj më arrestoni kur të dëshironi; këtu më keni. Kam 18 vjet në burg dhe nuk e kam parë me sy këtë shpikje të bukur të shkencës.

Hetuesi u bëri një shenjë me kokë dy policëve dhe Muçua përfundoi në autoburg bashkë me ëndrrën e tij për të parë televizorin. Megjithatë ai pati rastin të shikonte një shpikje tjetër të shkencës: prangat që i kishin hedhur atë ditë ishin vetështrënguese në çdo lëvizje që bënte i arrestuari.

Për mungesë salle, televizorin e vendosën mbi një tavolinë në ballkonin e ngushtë të katit të dytë të fjetoreve. Rreth 1400 të burgosurit zunë vend përballë tij, mbi tarracën ku bëhej numërimi i tyre tri herë në ditë.

Kur televizori filloi të funksiononte, binte një shi i imët. Por ata që e shikonin për herë të parë nuk lëviznin prej vendit. Me nga një copë plastmasi në kokë, ndonëse uji po ua depërtonte rrobat, ata ndodheshin nën hipnozën e pamjeve të ekranit të vogël, që iu kujtonte refrenin nostalgjik: *na ishte dikur jetë e lirë …*

*

Një afishë tek stendat e posaçme denonconte tërthorazi nivelin kulturor të një pjese të të burgosurve politikë të diktaturës. Në krye të afishës lexohej: *adresat duhen plotësuar si më poshtë*. Në qendër të saj ishte ngjitur një zarf i shpalosur që tregonte se ku duhej shkruar adresa e marrësit dhe ku ajo e dërguesit.

Ky ishte një argument bindës se diktatura fuste skllevër miniere në atë kamp, më shumë se kundërshtarë politikë.

X

BAMIRËSIA E NJË DIKTATORI KUSHTON SHTRENJTË

"*Çdo bamirësi që nuk rrjedh nga zemra është e neveritshme*."

Shamfor

Pas faljes, gjithçka nisi nga e para për ata që mbetën brenda telave me gjemba. Si gjithmonë, jeta e tyre ishte pré e lodhjes dërrmuese dhe e monotonisë gërryese. Gardianët patën rastin t'iu thoshin të burgosurve:

— Megjithëse ju jeni duke vuajtur dënimet për krimet e rënda që keni kryer ndaj partisë sonë, udhëheqësi i saj i lavdishëm pranoi t'ju a falte pjesërisht gjynahet. Prandaj është detyra juaj që ta shprehni mirënjohjen ndaj tij, duke realizuar e tejkaluar planin edhe në mungesë të shokëve tuaj që u liruan.

Më 17 nëntor 1982, dy ditë pas aplikimit të faljes, rojet e rrethimit të kampit të Spaçit vranë Rexhepin, një burrë të urtë nga Tropoja, i cili transportonte trupa për në minierë. Pas një burgu të gjatë, atij i kishin mbetur edhe disa muaj për tu liruar, por nuk e lanë. Megjithëse ai kishte qenë 100 m larg nga rrethimi dhe 40 m prej tabelës që tregonte vendin ku s'lejohej qarkullimi, ushtari e vrau. U hap fjala se ai u dënua dy vjet burg, por me siguri pas gjashtë muajsh e kanë liruar dhe e kanë veshur polic në ndonjë burg tjetër. Kështu kishte ndodhur edhe në dy raste të tjera më parë, që me kohë dolën në dritë.

XI

HUMOR VRASTAR

"*Shtypës të dhjamosur, mos i*
përbuzni të shtypurit e dobësuar !"
Zh. Zhuber

Më 10 janar 1983 u ushtrua një kontroll i posaçëm në minierën e Spaçit. Në ekipin e kontrollit merrnin pjesë dy të dërguar të ministrisë së Industri-Minierave, komandanti i kampit të Spaçit i shoqëruar prej një toge gradianësh me shefin e policisë në krye, drejtori i minierës, si edhe drejtori i ndërmarrjes pyjore të rrethit të Pukës. Kryeinxhinieri i minierës dhe asistenti i tij ishin pjesë e eskortës. Dy përfaqësuesit e ministrisë kishin asistuar edhe vitin e kaluar në këtë lloj kontrolli. Vëllimi i madh i punës së kryer i habiti.

— A mund të vizitojmë ndonjë front pune? pyeti njëri prej tyre.

— Sigurisht, iu përgjigj shefi i policisë. – Zef, na pri të shkojmë në ndonjë front pune, ku punojnë të burgosur që nuk janë dënuar rëndë – urdhëroi ai njërin prej policëve të turnit të parë.

I ngrefosur nga përmendja e emrit në prani të mysafirëve të shquar, Zefi i priu grupit të kontrollit. Pas disa minutash, ai ndaloi në fund të një galerie vertikale të pajisur me shkallë druri dhe filloi të godiste me gur tubin metalik të ajrimit.

— Pse e bën këtë? e pyeti kureshtar njëri prej të dërguarve të ministrisë.

Gardian Zefi nuk e la pa shfrytëzuar rastin të shpaloste njohuritë e tij personale në prezencë të zyrtarëve të rëndësishëm:

— Të burgosurit që punojnë atje lart janë armiq të partisë sonë të dashur. Pavarësisht se ata janë dënuar më lehtë nga të tjerët, armiku mbetet gjithmonë armik. Ne nuk duhet të fillojmë t'i ngjisim shkallët e furnelit, pa na ardhur prej së larti i njëjti sinjal. Përndryshe ata mund të shkarkojnë kastile mbi ne ndonjë vagon me mineral, duke u justifikuar se nuk dinin gjë që kishte njerëz në ngjitje.

Ndërsa Zefi po shpaloste njohuritë e tij profesionale, prej së larti erdhi sinjali i tubit metalik. Besnikë të rregullores, policët u ngjitën të parët, pastaj delegacioni. Kur të gjithë ndodheshin në krye të furnelit, komandanti i kampit pyeti Zefin:

— Janë larg prej këtej të burgosurit?

— Rreth njëqind metra. Por sa më shumë t'i afrohemi frontit të punës, aq më tepër do të shtohet pluhuri, mbasi minatori i grupit ka filluar të bëjë birat me martel. Doni t'i thërras dy të burgosurit e tjerë të paraqiten këtu?

— Ide e mirë, Zef. Ne nuk preferojmë të futemi në një pluhur të dendur.

Pas pak, dy të burgosurit u paraqitën tek grupi i vizitorëve.

— Nga je ti? e pyeti komandanti i kampit njërin prej tyre.

— Nga Elbasani.

— Çfarë profesioni ke ushtruar në jetën e lirë?

— Arsimtar.

— Pse je dënuar?

— Agjitacion e propagandë.

— A mund të bëjë një mësues i mirë propagandë kundë qeverisë së popullit të tij?

— Po kur të dënojnë pa bërë gjë?

— Justifikim banal. Çfarë interesi do të kishte partia jonë të dënonte shtetasit e saj të pafajshëm?

— Atë e di ajo vetë.

— Duhet ta kontrollosh mirë gjuhën, përndryshe…

— …do të arrestohesh e do të dënohesh pa dalë prej burgut, kështu si e pësova unë – e deshifroi retiçencën e komandantit të kampit i burgosuri tjetër.

— Me këtë gjuhë të gjatë që paske ti, jam i sigurtë se për agjitacion e propagandë duhet të jesh dënuar, – hamendësoi komandanti duke iu drejtuar të burgosurit tjetër.

— Natyrisht, nuk ka gjë më të lehtë, sesa të dënosh një njeri për fjalë të thëna e të pathëna.

— Çfarë profesioni ke pasur në jetën e lirë?

— Në të ashtuquajturën jetë e lirë kam qenë gazetar.

— Pse e paske ndërruar këtë profesion të bukur me vagonin e Spaçit?

— Kur e vërteta është e burgosur, një gazetar i mirë nuk mund të jetojë në liri.

— Por vjen të gërryej këtu në minierë – e plotësoi komandanti i kampit duke u gajasur.

Të mësuar për të ndjekur shembullin e eprorëve, policët i bënë iso të qeshurës me të madhe të komandantit të kampit. Për inerci, edhe të pranishmit e tjerë iu bashkangjitën korit humoristik.

Kur të qeshurat u qetësuan, ish-gazetari i tha:

— Është më mirë të gërryesh në minierë, sesa të bëhesh varrmihës i së vërtetës, ndërkohë që e quan veten zëdhënës i saj.

— Sa vjet burg je dënuar? e vazhdoi dialogun komandanti i kampit.

— Dhjetë – u përgjigj i burgosuri.

— Sa ke bërë?

— Dhjetë.

— Sa të kanë mbetur akoma?

— Dhjetë.

I revoltuar, komandanti ia priti:

— Mos harro, armik, se policët e pranishëm po e konstatojnë sjelljen tënde dhe nuk do dalësh pa gjë. Po të pyes për dënimin, nuk kam qejf të luaj kungulleshkë me ty.

— Kur nuk keni ju qejf për të luajtur, po unë? Janë hetuesit e gjykatësit ata që paguhen për të luajtur me jetën e të tjerëve. Një javë para se të lirohesha pas

dënimit të parë dhjetëvjeçar, më arrestuan në burg dhe më dënuan edhe dhjetë vjet të tjerë, të cilët sapo i kam filluar.

— Nga je?

— Nga Tir…

Një eksplozion e ndërpreu papritur dialogun e tyre. Marteli i të burgosurit që bënte birat në ballë të frontit të punës heshti. Të shqetësuar prej këtij fakti, dy të burgosurit pranë delegacionit thirën në një gojë:

— Shoku ynë është në rrezik; duhet të shkojmë ta ndihmojmë.

Pa pritur t'iu jepte njeri leje, ata u zhdukën në errësirë duke vrapuar.

— Shoku komandant i kampit duhet të zbresim menjëherë, mbasi ne nuk e dimë se çfarë ka ndodhur – propozoi shefi i policëve.

Ekipi i kontrollit doli me hapa të mëdhenj nga miniera.

XII

ADRESË E RE

"*Kur hidrës i pritej një kokë, menjëherë*
në vendin e prerë i dilnin dy të tjera."
Mitologji

Dhjetë ditë pas kontrollit të lartpërmendur, u hap fjala se nga Spaçi do të transferoheshin 100 të burgosur për në një kamp pune të detyruar tjetër, në rrethin e Pukës. Kampi i Ballshit ishte mbyllur përfundimisht. Të burgosurit e këtij kampi ishin shpërndarë në dy kampe të tjerë të rinj për të dënuarit politikë: në atë të Zejmenit (personat e paaftë për punë dhe ata me moshë mbi 50 vjeç) dhe në atë të Qafë-Barit (të aftët për punë në minierë). Mbyllja e kampit të Ballshit krijoi kështu dy kampe të rinj. Para faljes që u bë, në kampin e Qafës së Barit punonin të burgosur ordinerë, të cilët u zëvëndsuan nga ata politikë.

Në listën prej 104 të burgosurish, emri i Sazan Diksit figuronte midis të parëve. Pas dy ditë qëndrimi të paparashikuar në Spaç, për shkak të dëborës së madhe, më 23 janar 1983 të burgosurit e caktuar për transferim hipën duarlidhur në dy *Ifa*. Ata i kishin lidhur dy e nga dy me zinxhirë të mbërthyer me çelësa, duke i detyruar të ngjisheshin pas njëri-tjetrit në kamionët e mbushura me batanije.

Makinat ishin të mbuluara dhe në fund të secilës prej tyre rrinin dy policë dhe dy ushtarë me shkop gome në dorë. Autokolonës i printe një kamion me ushtarë e me një mitraloz të ngrehur mbi kabinën e shoferit, ndërsa në fund të saj vinte përsëri një makinë tjetër me ushtarë të armatosur, me mitraloz mbi kabinë dhe me dy qena ndjekjeje. Ishte një rrugë malore shumë e vështirë, me borë e plot rreziqe. Të mpirë prej të ftohtit dhe ngjeshjes pas njëri-tjetrit, të burgosurit ndiheshin keq.

Pas tri orë udhëtimi, makinat diku ndaluan. Një i burgosur i sëmurë prej prostatit, i cili ndodhej në krah të Diksit, u kërkoi leje policëve të zbriste i lidhur për të urinuar, mbasi nuk rezistonte dot më. Në vend të përgjigjes, njëri nga policët e goditi fort me shkop gome në sup. Kjo e ndihmoi të burgosurin e sëmurë t'i gjente në çast zgjidhje të sforcuar sikletit të tij fizik.

Rreth orës tre pasdite makinat morën kthesën e fundit që të nxirte përballë kampit të Qafë-Barit, i rrethuar prej pishash. Një lumë i vogël me ujë të kthjellët përshkonte anën veriore të rrethimit të kampit. Ndërsa të burgosurit e atyshëm (të ardhur nga Ballshi) i kishin mbyllur në mensën e kampit, me të sapoardhurit u kryen veprimet përkatëse. Qysh atë mbrëmje u bë ndarja e tyre në brigada të sistemuara nëpër dhoma të veçanta, sipas turneve të punës në minierë. Godina e madhe e këtij kampi kishte shërbyer më parë si fjetore për puntorë të lirë, prandaj kushtet e fjetjes aty ishin më të mira se ato në kampin e Spaçit.

Puna filloi të pasnesërmen. Pesë ditët e para shërbenin për t'u njohur me minierën e re dhe quheshin *ditët e instruksionit*. Vetëm gjatë atyre ditëve nuk kërkohej norma e detyruar.

*

Kushtet e minierës ishin të vështira. Lagështia shumë e lartë e ajrit ua njomte rrobat brënda dy-tri orëve të burgosurve. Një inxhinier gjelogjie i burgosur kishte punuar me një grup specialistësh sovjetikë për studimin e minierës së Qafë-Barit më 1958. Sipas tij, sovjetikët kishin deklaruar se shrytëzimi i asaj miniere bëhej i mundur vetëm në saje të një teknologjie shumë të përparuar. Ministria e Industri–Minierave kishte tentuar tri herë për ta shfrytëzuar atë me punëtorë të lirë, por asnjëherë nuk ia kishin dalë dot ndanë. Më së fundi ishte gjetur zgjidhja: teknologjinë e përparuar e zëvëndësonte më së miri dhuna e prapambetur.

Puna kishte filluar me të burgosur ordinerë. Pas faljes, kishin qenë të burgosurit politikë të kampit të Ballshit që e vazhduan punën atje. Mirëpo vetëm një pjesë e vogël e këtyre të burgosurve kishin qenë në gjendje shëndetësore për punë nëntoke. Por komanda e kampit të Qafë-Barit i kishte futur të gjithë, pa dallim, në minierë. Megjithatë, as dhuna e pafré nuk e kishte bërë dot të pamundurën të mundur. Turni që kishte nxjerrë më shumë mineral kishte arritur me vështirësi shifrën 20 vagona.

Për këtë arsye ardhja e të burgosurve nga Spaçi, të cilët kishin punuar edhe më parë në minierë, u prit me shumë interesim nga komanda e kampit të Qafë-Barit. Synimi i saj ishte të plotësoheshin të gjitha defiçitet e krijuara dhe, më tej, të vazhdohej realizimi dhe tejkalimi ritmik i planit. Kërkesat ndaj të burgosurve vinin duke u rritur dhe garancia e ngopjes së kësaj makuterie i besohej vetëm dhunës policore.

XIII

NJOHJE

"*Rasti është mbret i fatit.*"
V. Hygo

Ndryshe prej minierës së Spaçit, ajo e Qafë-Barit e kishte brenda planin e pjerrët për ulje–ngritjen e vagonave. Me sistem kundërpeshe, uleshin vagonat me mineral dhe ngjiteshin ata bosh. Në krahun e majtë të planit të pjerrët shquanin hyrjet e galerive horizontale, prej nga dilnin vagonat me mineral dhe hynin ata bosh.

Diksin e caktuan me organikë të punonte në planin e pjerrët. Së bashku me një të burgosur tjetër, ata duhej të hiqnin vagonin bosh prej shtratit lëvizës metalik dhe të fusnin në të vagonin me mineral. Kjo punë kërkonte shpejtësi dhe saktësi të madhe veprimesh. Përndryshe, ose do të mbeteshin frontet e punës pa vagona bosh, ose mund krijohej ndonjë avari, deri edhe aksident. Diksi nuk ishte mjaft i shkathët, por këtë mangësi e kompensonte me saktësinë në veprime. Shumë rrallë mund t'i ndodhte ndonjë avari.

Me përjashtim të orës së parë të fillimit të punës, gjithë pjesën tjetër të kohës manovruesit e vagonave e kalonin në lëvizje. Përveç mpirjes së këmbëve nga lodhja, lëvizja e përhrshme kishte edhe të mirën e saj. Lagështia e madhe e minierës të ftohte menjëherë, po të uleshe i djersitur nga puna. Aq më tepër që edhe ajri që thithej ishte i mbingarkuar me avuj uji. Edhe në ato raste, kur gjatë orarit të punës krijoheshin pauza të vogla pushimi, Diksit i ishte bërë zakon të lëvizte nëpër galeri. Ai ulej rrallë dhe për një interval të shkurtër kohe.

Puna e manovrimit të vagonave kishte një gjë pozitive: po ta kryeje normalisht detyrën, pa avari, i shpëtoje përplasjes me policinë. Shmangia e provokimeve të policisë përbënte një prioritet të preokupimeve të Diksit dhe për këtë ai sakrifikonte shumë. Edhe në ato raste kur policë të veçantë krijonin marrëdhënie të pazakonta mirësjelljeje me një pjesë të të burgosurve, Diksi nuk e ndryshonte qëndrimin ndaj tyre. Ai nuk dëshironte të shkëmbente qoftë edhe një përshëndetje të thjeshtë me gardianët e robërisë së tij. Policët e kuptonin mirë këtë gjë dhe nuk e falnin kurrsesi, po t'iu dilte sadopak në shteg. Kjo ishte një arësye më tepër që atij i diktonte një disiplinë të rreptë personale, e cila nuk i kishte munguar.

*

Për manovrimin e vagonave në planin e pjerrët punonin katër persona. Diksi me një të burgosur tjetër punonte lart, kurse dy të tjerët punonin në fund të planit të pjerrët. Lart puna ishte pak më e lodhshme, mbasi duheshin kryer shumë ngjitje e zbritje nga njëra galeri horizontale tek tjetra.

Një muaj pasi Diksi kishte filluar punë në manovrimin e vagonave, ortaku i tij u kërkoi dy të burgosurve që punonin poshtë ta bënin me radhë punën lart, meqenëse në organikë nuk përcaktohej kush duhej të punonte poshtë e kush lart. Kur u shtrua kjo çështje për diskutim midis katër të burgosurve, për çudinë e të tjerëve, njëri nga ata që punonin poshtë u hodh e tha:

— Unë do të isha gati të punoja gjithmonë lart, në qoftë se për ortak do të kisha Sazanin. E di që puna atje është më e lodhshme, por preferencat do t'i ndajmë përgjysmë: unë i lejoj vetes të zgjedh ortakun, kurse ish-kolegu im ka të drejtë të zgjedhë vendin e punës më pak të lodhshëm. Apo ke kundrshtim ti, Sazan? e pyeti ai duke e shikuar në sy.

— Për mua është njësoj – u përgjigj Diksi. – Në të vërtet unë nuk kam ndonjë preferencë as për ortak e as për vend pune.

Dy të burgosurit e tjerë u habitën me këtë lloj propozimi, aspak të dobishëm për atë që e bëri. Ai zgjidhte vullnetarisht vendin e punës më të lodhshëm dhe një ortak më pak të shkathët prej atij që kishte pasur më parë. Mirëpo interesi e eklipsoi shpejt kureshtjen dhe propozimi u miratua dhe u vu në zbatim qysh atë ditë.

*

Në këtë periudhë Diksi kishte vuajtur pesë vjet burg dhe zor se i kishte mbetur ndonjë gjë e errët në njohjen e rrethanave dhe parashikimin e çdo të papriture nga prapaskenat e kampeve të punës. Këtë ndërrim ortakësh ai e priti thjeshtë, pa i kushtuar aspak rëndësi në dukje, por në vetvete e analizoi thellë.

Të burgosurin që bëri propozimin Diksi e kishte në dhomën e fjetjes qysh prej dy muajsh. Ai ishte nga Gjirokastra. E quanin Hamit Meli. Disa cilësi të tij ia kishin tërhequr vëmendjen. Si edhe vetë Diksi, marrëdhëniet e tij me të burgosurit e tjerë Meli i kishte të kufizuara dhe të kontrolluara mirë. Pjesën më të madhe të kohës e kalonte vetëm. Herë pas here shoqërohej me nja dy të burgosur nga rrethi i tij. Kafen dhe duhanin i pinte shumë. Kohët e fundit nuk linte rast pa shfrytëzuar, për t'i ofruar kafe Diksit, ose të lidhte muhabet me të. Nga ana e tij Diksi, pa e fyer aspak, mundohej që të mos i jepte shkak zgjerimit të mëtejeshëm të marrdhënieve me Melin. Megjithatë, edhe ai e kishte ftuar për kafe atë, por zgjidhte një orë të tillë që të kishin pak kohë të lirë: para se të fillonte leximi i detyruar kolektiv i shtypit, ose ndonjë veprim tjetër i parashikuar prej rregullores së regjimit të brendshëm të kampit.

Meli e mbante veten me kujdes; natyrisht brenda kushteve tepër të kufizuara të burgut. Rrobat e trupit i mbante të pastra dhe rruhej rregullisht. Kujdesej për një palë mustaqe të shkurtra, ngjyrë gështenjë, të cilat i shkonin mjaft fytyrës së tij brune me sy të kaltër. Krevatin e rregullonte më mirë se bashkëvuajtësit e tjerë. Ishte i vëmendshëm në bashkëbisedim. Ai e përqendronte shikimin e mprehtë mbi bashkëfolësin, pa ia ndërprerë asnjëherë

fjalën. Pjesën më të madhe të kohës së lirë e kalonte duke lexuar. Adhuronte Zhyl Vernin.

Ka disa libra para të cilëve njeriu duhet të përkulet – i kishte thënë ai një ditë Diksit.

Ky ia kishte aprovuar mendimin.

Kur Diksi gjente rastin të shkëputej prej tij, largohej natyrshëm, pa i lënë shkak për fyerje bashkëvuajtësit jo fort të njohur. Kuptohej që Meli nuk e dëshironte ndarjen, por ai nuk e jepte veten kurrsesi dhe vazhdonte të shëtiste i vetëm. Këtë sedër të atij Diksi e vlerësonte shumë, por në heshtje.

*

Në sjelljen në tërësi të ortakut të ri të punës në kamp, në minierë, me të burgosurit, apo karshi policisë, Diksi dallonte një karakter të fortë, të vendosur dhe rezistent në vështirësi. Meli ishte i pajisur me raport mjekësor, për të mos punuar në minierë. Kishte qenë operuar në stomak dhe vuante nga zemra e veshkat. Ndihma ekonomike nga familja nuk kishte. Mirëpo e pinte shumë duhanin dhe pa kafe nuk bënte dot. Për të mos kompromentuar personalitetin e tij, duke pritur ndihmë prej të tjerëve [gjë që ai si tip nuk do ta pranonte kurrë], Meli kishte zgjedhur rrugën më të vështirë: futjen vullnetarisht në punën e rëndë të minierës. Vetëm ata që e kishin në shpinë barrën e rëndë të punës së detyruar e kuptonin vërtet madhështinë e kësaj sakrifice, për hir të dinjitetit.

Meli kishte qenë i martuar. Kishte një vajzë. Pak para se të binte në burg, e kishte divorcuar gruan. Fill pas divorcit, ai kishte ndihmuar vëllanë e tij për tu arratisur bashkë me një shok. Kufirin e njihte mirë, mbasi i kishte qëlluar të punonte në zona kufitare. Meli vetë kishte planifikuar të arratisej të pasnesërmen e ditës që përcolli vëllanë matanë kufirit. Kjo shtyrje afati kishte ndodhur ngaqë priste të kthehej një shok prej Berati, i cili kishte shkuar atje për ta lënë të shoqen tek prindërit e saj. Kur të vinte ai, do ta kalonin kufirin bashkë. Meqënëse shoku ishte vonuar të kthehej sipas fjalës, Meli ishte detryruar të shkonte vetë në Berat, për ta takuar. Atje e kishin arrestuar.

Këto të dhëna Meli ia kishte bërë vetë të njohura Diksit, kur merrnin kafe bashkë. Ato i vërtetonin edhe dy bashkëqytetarë të Melit, të cilët e kishin njohur atë në jetën e lirë. Për më tepër, njëri prej atyre kishte asistuar në seancën e fundit të gjyqit të Melit. Kjo kishte qenë e vetmja seancë e gjyqit të tij që ishte zhvilluar me dyer të hapura.

Diksi e kishte njohur para disa vjetësh në kampin e Spaçit njërin prej këtyre bashkëqytetarëve të Melit. Ditën e parë që ai e pa Diksin të rrinte me Melin, i ishte afruar, kur kishte gjetur rastin, dhe i kishte pëshpëritur:

— Hamiti, me të cilin ti rrije qëparë, është djalë i mirë. Unë e kam njohur familjarisht qysh në jetën e lirë, megjithëse ai vetë ka punuar e ka jetuar në Tiranë. Por ... më duket se ka qenë ca kohë oficer sigurimi.

Natyrisht, këtë sinjalizim ai ia bënte me qëllim të mirë Diksit, i cili i ishte përgjigjur duke buzëqeshur:

— E kuptoj ç'do të më thuash; të faleminderit.

*

Në fillim, kur i kishin vendosur në dhomat e fjetjes sipas brigadave të punës, Meli kishte zënë një vënd të mirë pranë dritares, në katin e dytë të krevatave. Kur kishte hyrë në dhomë, Diksi kishte pyetur për kureshtje:

— Kush e zuri këtë vendin tek dritarja?

— Unë – i ishte përgjigjur Meli. – Unë e zura, por nuk kam qejf të jem në kat të dytë me krevat. Prandaj, po të duash, i ndërrojmë bashkë vendet e fjetjes.

— Jo, jo, pyeta kot; të faleminderit. Unë mirë jam edhe këtu – e kishte mbyllur bisedën Diksi.

Por Meli i kishte shkuar tek krevati dhe, pasi i kishte dhënë një cigare, i kishte thënë:

— Ai vend fjetjeje nuk është i përshtatshëm për mua. E zura vetëm se nuk doja që të shkonte ai spiuni që fle në krye të radhës përballë. Prandaj më bën nder të ma lëshosh këtë vendin tënd këtu pranë derës e në katin e parë të krevatave.

— Po të jetë ashtu, dakord – i ishte përgjigjur Diksi.

Dhe në çast i kishin ndërruar vendet e dysheqeve.

Meli ishte inteligjent dhe me eksperiencë në jetë. Këtë e tregonte qartë aftësia e tij për tu orientuar drejt nëpër labirintët e vështirë të jetës së burgut. Do të ishte utopi për një person me një intelekt e përvojë të tillë, që të mendonte se do të gjente shteg në vigjilencën vetëmbrojtëse të Diksit, për ta dëmtuar atë. Aq më tepër që ky i fundit, shpejt a vonë, diçka do të mësonte për të kaluarën e ish-oficerit të Sigurimit nëpërmjet bashkëqytetarëve të tij të burgosur, me të cilët edhe Diksi rrinte nganjëherë.

Diksi e ndiente se afrimi i Melit me të ishte një kërkesë shpirtërore e këtij të fundit, motivet e së cilës mbetej t’i vërtetonte koha. Sa më shumë që po e njihte Melin me kalimin e javëve, aq më tepër Diksi po bindej se qëllimi i afrimit të tij me të nuk frymëzohej nga synime të ulëta keqbërjeje. Por një vlerësim i tillë paraprak nuk bëhej shkak pakujdesie në asnjë rast. Ndarja e egjrës prej grurit nuk ishte aspak e lehtë në një kamp pune të detyruar. Gjithmonë i matur e depërtues në vëzhgimet e tij të posaçme, Diksi hidhte hapa të kujdesshëm drejt konkretizimit të parashikimeve të tij, për qëllimin jo keqdashës të Melit për t'u afruar me të.

XIV

DËSHPËRIMI ZBEH KUJDESIN

"*Dëshpërimi është më i madhi i gabimeve tona*."

Vovënarg

Meli shquhej për një shkathtësi të admirueshme në kryerjen e veprimeve të ndryshme, si në punë edhe në rajonin e banimit. Pavarësisht se në çfarë ore shtrihej për të fjetur, gjumi i dilte gjithmonë para se të bëhej zgjimi i kampit. Kur binte çanga për zgjim, Meli e kishte rregulluar krevatin. Ngaqë vetë Diksi ishte disi i plogët, kjo shkathtësi e spikatur e kryerjes së veprimeve me disiplinë të përhershme nga ana e Melit i bënte përshtypje.

Një ditë, duke u përgatitur në dhomën e zhveshjes për t'u futur në minierë, tek shikonte lëvizjet e shpejta e të sakta të Melit (ky nuk e përsëriste kurrë dy herë të njëjtën lëvizje), Diksi i tha buzagaz:

— Kur të shikoj sesa shprehi të janë bërë zhveshjet dhe veshjet e shpejta, më krijohet përshtypja se ti ke mbaruar ndonjë shkollë ushtarake, Hamit.

— Hamendja jote është e saktë në këtë rast. Është e vërtetë që kam studjuar në shkollë ushtarake dhe ky ka qenë njëri nga elementet e jetës sime, për të cilin kam dashur të të flas posaçërisht - iu përgjigj Meli, duke vendosur një kapele doku në kokë, ndërsa shikimin zhbirues e përqendroi mbi bashkëfolësin.

Ata të dy kishin mbetur vetëm në dhomën e zhveshjes, por pikërisht në kohën kur Diksi po përgatitej të vazhdonte bisedën, polici i punës, pasi goditi fort me një bisht kazme derën e dhomës, bërtiti:

— Hajt, shpejt jashtë, se do të mbyllet dera.

Ata dolën të dy. Meli duke rregulluar kasketën e dokut në kokë, ndërsa Diksi duke kopsitur xhaketën, që i ishte këputur copë prapa shpinës.

— E paske me dritare xhaketën – e qesënditi polici, duke përplasur derën pas tyre.

— Po, që ta shikojë edhe kurrizi se nga kush po heq kaq shumë – ia priti Meli duke vazhduar rrugën.

— Ç'ka the ti, kokëqyp? – e pyeti polici, ngaqë nuk arriti ta dëgjonte mirë.

— Fola me shokun tim – ia preu shkurt Meli.

— Kur të flas unë me ty do të flas mirë – ia ktheu polici i skuqur në fytyrë.

Meli u ndal; çehreja i ndryshoi.

Diksi i futi krahun dhe, për ta larguar sa më lehtë, i tha me zë të ulët:

— Na mbeti biseda në mes. Eja vazhdojmë rrugën, lere atë.

Meli ndezi një cigare në ecje e sipër dhe të dy kapërcyen portën e hekurt në hyrje të minierës.

*

Meli i dha një cigare Diksit. Ky e ndezi, ndonëse duhanin e pinte pak. Duke thithur cigaren që mos t'i fikej, Diksi i tha:

— Më i përmbajtur duhet të tregohesh me policët, Hamit. Ata sebep kërkojnë për të na rënë në qafë. Tekefundit për atë paguhen.

— Ashtu është, por nuk mund ta marrësh dot me mend se çfarë alergjie më krijojnë, kur ua dëgjoj zërin. Ata janë të prirur prej natyre t'i telashojnë të tjerët, t'i urrejnë pa i njohur fare. Nuk do të isha kurrë i gatshëm që t'i torturoja ata, siç po na torturojnë ata ne. Amà, nuk do të më dridhej dora t'i qëroja këto shtazë me uniforma.

— Në teori gjithçka ngjan e thjeshtë – buzëqeshi Diksi.

— E kam provuar edhe në praktikë, Sazan, prandaj flas me këtë siguri – iu kundërpërgjigj i vendosur Meli.

Kjo deklaratë e befasishme dhe krejt e veçantë e ortakut të punës e befasoi Diksin. Ky u step për një çast, me sytë të fiksuar tek Meli. Pastaj, për të thyer heshtjen, i tha me një buzëqeshje paksa të sforcuar:

— Edhe shakatë *ushtarakisht* i bën ti, Hamit.

— Në atë që thashë nuk ka asgjë për shaka dhe asgjë jashtë realitetit të jetës sime të dikurshme. Përkundrazi, aroma e gjakut nuk i përshtatet aspak humorit – ia ktheu Meli, duke u mbështetur në një kosh vagoni të përmbysur.

Momentalisht u vendos një heshtje e thellë. Pastaj Meli rimori fjalën me një zë paksa të ndryshuar:

— Kam dashur të të flas edhe më parë për diçka tepër personale dhe shumë të rëndësishme. Më erdhi mbarë për këtë, kur ti më dhe rast me hamendjen tënde përsa i përket mundësisë së kryerjes së ndonjë shkolle ushtarake nga ana ime. Shpëtimi [*kështu quhej njëri prej bashkëqytetarëve të tij që kishte qenë me Diksin në Spaç*] ka respekt për ty dhe jam i sigurt që ai të ka thënë se unë kam qënë oficer sigurimi dikur. Ndërsa unë të jam prezantuar si teknik ndërtimi. Nuk të kam gënjyer, por s' ta kam thënë gjithë të vërtetën. Madjé, për motive sigurie, kam heshtur për pjesën më të rëndësishme të saj. Pikërisht për atë që dua të të flas tani.

«Vitet e fundit para arrestimit, unë kam punuar si përgjegjës sektori në hidrocentralin e Fierzës dhe, më pas, në mirëmbajtjen e monumenteve të kulturës në Gjirokastër. Në dokumentacionin e burgut unë njihem si teknik ndërtimi, por gjithë të vërtetën e jetës sime të mëparshme nuk e di as Shpëtimi dhe asnjë tjetër prej bashkëqytetarëve të mi. Me Sigurimin e Shtetit unë kam punuar në Tiranë. Në Gjirokastër shkoja më shumë si mik atëherë. As pjestarët e familjes sime nuk dinin gjë, se cili ishte aktiviteti im i vërtetë.

Meli e ndërpreu të folurin dhe flaku bishtin e cigares në një pellg të vogël uji midis shinave ku kalonte elektrovozi.

Ata të dy ishin krejt të vetëm pranë galerisë ku fillonte plani i pjerrët. Ishin të veshur me leckat gjithë baltë të minierës dhe prisnin ardhjen e vagonave të parë me mineral prej fronteve të punës. Meqenëse Sazani ishte thjesht dëgjues e

vetëm për vetëm me atë që fliste, vendosi t'i krijonte mundësi bashkëfolësit "ta zbraste thesin". Ndërkohë që Meli e kishte fiksuarr shikimin tek bishti i cigares që po plluskonte mbi ujë, Diksi shtoi si pa të keq:

— Megjithatë Shpëtimi e dinte që ti ke qenë një rast tek gjysmë-vëllai i nënës tënde, i cili ndodhet në Turqi qysh në vitet tridhjetë. Dhe me sa më tha ai, nuk ke shkuar si turist atje.

Meli buzëqeshi hidhur. Diksi vazhdoi fjalën:

— Nganjëherë njeriu që nuk ia di rëndësinë një sekreti e trajton atë si bisedë të zakonshme. Në këtë rast faji nuk është i tij.

Shpëtimi i kishte folur Diksit për këtë çështje më tepër nga sa i tha ky Melit.

— Shpëtimi ka hyrë e ka dalë në shtëpi tonë dhe mund të ketë përfituar nga ndonjë pakujdesi e familjes sime – u përgjigj Meli. – Ngaqë ai profesion zgjati me vite për mua, ndokush prej pjesëtarëve të familjes edhe mund ta ketë shprehur pa teklif ndonjë llaf, lidhur me fatkin që unë dilja me shërbim jashtë shtetit. Megjithatë unë doja të të flisja ty për atë pjesë të aktivitetin tim, për të cilën nuk di gjë askush: as ata që kanë pasur lidhje me familjen time e as vetë familja.

— Ajo është një çështje që të përket vetëm ty dhe askujt nuk i bën mirë që ta vësh në dijeni të sekretit tënd – i tha me një ton të vendosur Diksi, duke mos dashur ta shtynte më tej bisedën që po merrte një drejtim delikat.

— Unë dua t'i bëj mirë vetes time – insistoi Meli me një zë ku dalloheshin nuanca dridhjeje. – Ndodhem në rrethana të tilla, të cilat më kanë detyruar këto kohët e fundit ta çoj shpesh mendjen tek Zoti, të cilin nuk e kam besuar. Duke bërë dikë pjesëtar në sekretin tim, do t'i krijoj një frymëmarrje më të lirë vetvetes; kam nevojë për një gjë të tillë, patjetër. Më shtyn një arsye e fortë subjektive. E di që çdo njeri ka të drejtë të rrëqethet nga e kaluara ime, kur unë afrohem për t'i hapur zemrën, ashtu siç do t’i ndodhte para fantazmës së ndonjë të vdekuri, që do t'i çfaqej për t'i besuar një amanet. Mos e kalo nëpërmend idenë se unë dua të të provokoj, duke të folur për çështjen time delikate. Jo, kurrë, Sazan. Garanci për këtë është fakti që, për ruajtjen e këtij sekreti, unë kam firmosur një deklaratë në hetuesi, mosrespektimin e së cilës e paguaj me kokë. Prandaj edhe në dosjen time penale nuk përmendet fare kjo pjesë e së kaluarës sime.

— Pikërisht për këtë arsye ti duhet t'i qëndrosh besnik vetvetes, duke mos e ndarë me askënd sekretin tënd. Të kërcënohet gjëja më e shtrenjtë – jeta.

— Nuk është gjithmonë jeta gjëja më e shtrenjtë për njeriun, Sazan. Në rrethana të caktuara, ka të tjera gjëra që shndërrohen në një shumëfish të vlerës së jetës së individit.

Papritmas fishkëllima e elektrovozit, që po hynte në minierë, u kujtoi të dyve vonesën në manovrimin e vagonave. Bashkë me elektrovozin hynin edhe policët me brigadierin e lirë, të cilët patjetër duhej të gjenin vagona të manovruar tek plani i pjerrët. Ata iu përveshën me shpejtësi punës.

*

Mbasi i ulën vagonat me mineral të horizontit të parë dhe po ngjiteshin një galeri më lart, Meli pyeti ortakun e punës:

— Sipas radhës së dhomave, a mos na takon ne të dyve sonte të shërbejmë si posta kapanoni, Sazan?

— Po; më lajmëroi qysh në mëngjes përgjegjësi i fjetores: unë jam postë e dytë, ti je e tretë.

— Do t'i ndërrojmë. Unë do të bëj postë e dytë, ti e tretë. S'ka ndonjë gjë të keqe kjo punë, besoj.

— Por as ndonjë gjë të mirë, – e plotësoi Diksi, i cili i kishte bezdi këto ndryshime, se mos i krijonin përplasje me policinë.

— E ka një të mirë, të madhe bile. Dua ta përfundojmë diskutimin që na ndërpreu elektrovozi. Nuk e fillova rastësisht atë bisedë dhe as nuk dua ta vazhdoj thjesht për të vrarë kohën. Jo, përkundrazi. Meqënëse unë nuk e kam problem gjumin, do ta marr shërbimin postë e dytë. Kur të ngrihesh ti, si postë e tretë, unë nuk do të shkoj për të fjetur, por do të vazhdojmë bisedën.

— Mirë, atëherë, gjersa e paske vendosur. Veç duhet të bisedojmë vetëm në korridor, se nuk i dihet. Ndonëse normalisht të tjerët duhet të jenë në gjumë në ato orë të pasmesnatës, ka edhe të papritura.

— As që duhet vënë në diskutim kjo.

XV

JEHONË E NJË TË KALUARE TË TRISHTUAR

“*Kihet besim vetëm tek ata që kanë besim në veten e tyre*.”

Taleirand

Komanda e kampit të Qafë–Barit kishte vendosur një rregull, sipas të cilit të burgosurit duhej të bënin shërbim nate me radhë, në bazë të dhomave. E thënë me fjalë të tjera, ata duhej të ndihmonin gardianët e tyre!

Një forcë e marrosur tallet gjithmonë me të drejtën.

Atë javë brigada e Melit dhe e Diksit shkonte në punë turni i parë. Në darkë përgjegjësi i kapanonit i njoftoi ata se kishin radhën e shërbimit të natës: Diksi posta e dytë, ndërsa Meli posta e tretë. Ky bisedoi me përgjegjësin e kapanonit, i cili pranoi që ata të dy të ndërronin radhën e shërbimit midis tyre. Si postë e parë çdo ditë shërbente vetë përgjegjësi i kapanonit.

Megjithëse Meli e zgjoi gjysmë ore më vonë Diksin, ky nuk e pati të lehtë zgjimin në atë orë. Ortaku i punës e dinte që Diksi e kishte gjumin pikë të dobët. Një natë në minierë, gjatë turnit të tretë, Meli kishte qeshur me të madhe duke dëgjuar Diksin të thoshte me zë të ulët:

«Dreqi ta hajë këtë punë; kur do të ngopem një herë me gjumë?»

Diksi e gjeti kafen gati, si dhe një cigare me filtër – luks i kohës. Ai filloi ta pinte me kënaqësi kafen. Meli nuk ishte vetëm një teljaki kafeje, por edhe një mjeshtër i përgatijes së saj. Ndërsa ai po pinte kafen, Meli filloi të fliste:

— Më është dashur të të hapem nga halli, aspak nga dëshira. Më pak akoma, për të vrarë kohën me diskutimin e një çështjeje, dekonspirimi i së cilës do të më çonte para togës së ekzekutimit. Nuk të kam zgjedhur rastësisht ty për të ta besuar sekretin tim. Përkundrazi, të kam studjuar me shumë vëmendje këta muaj që njihemi bashkë, të cilët, për nga ngarkesat e vuajtjeve dhe të vështirësive të shumëllojshme, barazohen me vite. Nuk ka vend më të përshtatshëm se ky kamp pune i vrazhdë dhe as rrethana më të favorshme se këto që po përjetojmë ne çdo ditë e çdo natë, për të provuar forcën e karakterit, vendosmërinë e njeriut dhe cilësi të tjera të dorës së parë, të cilat karakterizojnë personin e denjë për një sekret të rëndësishëm. Për mua është fat i madh që të njoha. Kam pyetur shumë për ty dhe ato që kam dëgjuar nga persona të ndryshëm kanë qenë pothuajse të njëjta. Duke pasur parasysh çështjen që më preokupon mua, shpresoj se ajo që do të na ndante në jetën e lirë, këtu duhet të na bashkojë.

Meli e ndërpreu për një çast fjalën, u mbush mirë me frymë, thithi fort cigaren, piu një gllënjkë kafe dhe vazhdoi:

— Babai im rridhte prej një shtrese të varfër dhe ka qënë partizan i brigadës së parë. Babai yt, me sa më ke folur ti vetë dhe kushëriri yt që ndodhet këtu, rridhte nga shtresë e mesme, jurist, dhe ka qenë aktivizuar në lëvizjen

kombëtariste. Babai im qe plagosur në luftë dhe vdiq si pasojë e një operacioni që i bënë shumë vjet pas luftës, për t'i nxjerrë një cifël predhe nga kafka e kokës. Sipas fjalëve të nënës, ai më shumë duhet të ketë vdekur për shkak të brengave, sesa nga operacioni. Nëna më pat thënë se gjatë viteve të fundit të jetës së tij të shkurtër, babai përsëriste shpesh: «Derdhëm gjak për t'i sjellë një mynxyrë këtij populli. E ç'fitoi ai nga lufta jonë? Vetëm varfëri dhe frikë. Do të kishte qenë më mirë të më kishte lënë të vdekur në vend kjo cifël predhe, sesa të shikoja pasojat dëshpëruese të luftës sonë.»

«Para se të vdiste, babai e kishte lënë amanet që asnjëri prej djemve të tij të mos vazhdonte shkollë ushtarake. Ndofta ngaqë ai vetë kishte qenë oficer gjithë jetën dhe vdiq i zhgënjyer. Fati e solli që pikërsiht unë, më tersi i fëmijëve, të përfundoja në një shkollë speciale ushtarake. Atje përgatiteshin kuadro për shërbimin sekret, organizmi drejtues i të cilit ishte DSJ [*Drejtoria e Sigurimit të Jashtëm*]. Ky ishte një institucion shumë i pushtetshëm. Aktiviteti ynë përqendrohej kryesisht jashtë shtetit. Në gamën e misioneve të DSJsë përfshihej edhe likuidimi fizik i kundërshtarëve aktivë të regjimit të Tiranës, të cilët mund të ishin shqiptarë të arratisur ose detektivë të huaj. Në këto lloj misionesh ne na kishin aktivizuar qysh në moshën 21 vjeçare.

«Për të siguruar bindjen tonë të detyruar, para se të fillonim aktivitetin jashtë shtetit DSJ na komunikonte *pengjet familjare*. Ata ishin dy prej njerëzve më të dashur të rrethit tonë familjar, të cilët do të ekzekutoheshin në mënyrë mafioze prej Sigurimit, në rast dezertimi nga ana jonë. Gjatë karrierës sime, ka pasur tre dezertime prej radhëve të DSJsë. Në të tre rastet ne na kanë shfaqur sekuenca filmike me aksidente automobilistike të improvizuara prej Sigurimit për zbatimin e dënimit me vdekje të pengjeve, ose me vrasje në forma nga më të ndryshmet. Ata e bënin një gjë të tillë për të na bindur se vdekja e pengjeve tanë ishte e sigurtë, po të dezertonim. Kështuqë, ca në saje të mashtrimit sistematik, ca prej papjekurisë së moshës kur fillonim aktivitetin dhe ca për shkak të rrezikut të pengjeve, DSJ arrinte të na detyronte të bëheshim mish për top, duke u futur në një rrugë pa kthim prapa. Rezultati: një dramë e vërtetë. Ndërsa babai im vdiq i zhgënjyer nga frutet e luftës partizane, unë jetoj i zhgënjer prej fruteve të luftës së ftohtë. Në këtë kamp pune, ku më përplasi regjimi të cilit i shërbeva aq shumë, unë përpiqem ta harroj të kaluarën time, por më kot. Megjithatë e keqja nuk mbaron këtu për mua.

«Edhe në këtë gjendje kaq të dëshpëruar, e ardhmja ime është përsëri e kërcënuar për arsye që unë do të përpiqem të t'i sqaroj. Natyrisht, ti nuk ndryshon dot asgjë nga rrjedha e fatit tim, por rrëfimi im ka një qëllim të dyfishtë. E para, unë jam arrestuar befasisht dhe më duhet të çoj patjetër një amanet të rëndësishëm tek nëna ime, një amanet që do të ma lehtësonte vdekjen, po ta shkarkoja nga shpirti im i rënduar. E dyta, doja që dikush prej bashkëvuajtësve të mi ta dinte se tekniku i ndërtimit Hamit Meli ka qenë detektiv i DSJsë dhe, si i dënuar me kusht, mund të dalë kur të dëshirojë nga burgu, por veç për të rifilluar karrierën e mëparshme. Askujt nuk mund t'i shkojë

ndërmend se unë mund të flas për një temë të tillë me një person, babai i të cilit mund ta ketë pasur ndonjëherë emrin në listat e zeza të DSJsë, si person për tu likujduar fizikisht. Për një sy të zakonshëm, kjo do të thotë që unë të ndodhem përballë një rreziku të dyfishtë tek ti. Pikërisht kanosja e këtij rreziku të dyfishtë e zbeh shumë dyshimin, se unë mund të flas me ty për të kaluarën time si detektiv. Ndërkohë qenë vendimtare edhe cilsitë që gjeta në personin tënd për një përçapje të tillë aspak të zakonshme.

Meli nxori cigaren e fundit nga paketa, flaku kutinë bosh nga dritarja, e ndezi cigaren dhe po bëhej gati të fliste përsëri, kur u dëgjua çanga që lajmëronte zgjimin e kampit. Të dy u çuan menjëherë në këmbë, se dëgjuan hapat e policëve të shërbimit të brendshëm që po ngjisnin shkallët. Ata u futën shpejt në dhomën e gjumit.

XVI

NËPËR LABIRINTET E NJË ÇËSHTJEJE DELIKATE

"*Sekreti midis dy personave është sekret*
Zoti; midis treve, është sekret i të gjithëve."
Proverb persian

Qysh prej natës kur i hapi zemrën Diksit, kontaktet me të iu bënë kërkesë shpirtërore e dorës së parë Melit. Ndërkohë Diksi e mirëpriste praninë e Melit, por ai nuk bëhej asnjëherë nismëtar i asaj bisede të gjatë rrëfimtare, rreth së cilës do të vërtitej dialogu midis tyre, sa herë që do të ndodheshin vetëm. Tashmë Meli e kishte kapërcyer pengesën më të vështirë për të: prezantimin e portretit të tij të dikurshëm, me të cilin lidheshin kujtimet më të hidhura të jetës së tij të deriatëhershme. Ai nuk ndiente më asnjë vështirësi të hynte drejtpërdrejt në temën e preferuar, kur ndodhej vetëm me Diksin. Mirëbesimi ndaj atij që ia dëgjonte ofshamat i krijonte Melit një lirshmëri të tillë komunikimi, saqë ai shtjellonte skenat më tronditëse të rinisë së tij të përgjakur.

Sa herë fliste për ato ngjarje, ish-detektivit i dukej sikur nxirte gulfa-gulfa vrerin e shpirtit të tij. Këtë lehtësim të përkohshëm e paguante me një çmin jo të vogël. Duke kujtuar të shkuarën tronditëse, ai përjetonte ato situata që ishte përpjekur mjaft t'i harronte, por nuk ia kishte dalë dot ndanë. Tani, duke folur, fytyra i ndizej shpuzë e herë-herë i zverdhej krejt, dhe jo rrallë në cepat e syve të kaltër shfaqeshin bula lotësh.

— Ti je i vetmi njeri me të cilin kam folur për brengat e mia – do t'i thoshte ai Diksit një natë në minierë.

Këto kriza periodike ishin një kurim i pazëvendësueshëm për ndërgjegjen e tij të pllakosur nga pendesa. Në rrethanat ku gjendej, Meli po shikonte me sytë e tij të vërtetën lakuriq, barbarinë e atij regjimi për forcimin e themeleve të të cilit ai kishte derdhur gjakun e të tjerëve dhe të tijin: gjatë kryerjes së një misioni në Athinë, ai ishte plagosur paksa mbi rrëzën e kofshës së djathtë. Meli po i njihte nga fare pranë se cilët ishin *armiqtë e popullit*. Ish-detektivi i DSJsë e pohonte vetë se nuk do ta besonte kurrë ekzistencën e një gjendjeje të tillë në burgjet shqiptare, po të mos ishte bërë dëshmitar okular i saj. Më se një herë, ai ishte shprehur:

— Në qoftë se ka pasur ndonjë gjë të domosdoshme për mua në këtë botë, ka qenë pikërisht ky burg.

Një ditë, gjatë punës në minierë, ish-detektivi e thirri Diksin tek një stol dërrase afër daljes së një galerie horizontale pranë planit të pjerrët. Ishte vendi ku ata manovronin vagonat e njërës prej galerive. Atje ai i tregoi një vizatim të gdhendur bukur mbi dërrasën e stolit nga dora e stërvitur e ndonjë të burgosuri ordiner, të cilët kishin punuar më parë në atë minierë. Në të tregohej një zemër njeriu e përshkuar prej një thike. Kjo simbolizonte brengën që përjetonte autori i

vizatimit nga ndarja prej ndonjë njeriu të shtrenjtë, sepse poshtë punimit lexohej: *përsëri do të kthehem*.

Duke i treguar këtë figurë me gisht, Meli i tha shokut të tij:

— Edhe zemra ime përshkohet prej një thike të tillë akulli. Ajo biseda e orëve të vona sikur filloi të ma shkrinte pak dhe dalëngadalë nisa të mbushem me frymë. Ndihmomë të çlirohem prej saj, sa më shumë të jetë e mundur. Prano vetëm të më dëgjosh, pa u mërzitur. Për ty kjo nuk është ndonjë sakrificë e madhe, kurse për mua është një shërbim i madh.

*

Një natë, ndërsa ata të dy po manovronin vagonat, njëri prej policëve të punës u afrua e u tha me një ton gazmor:

— Shtrëgohuni mirë sonte, se do të dalin mbi 90 vagona mineral.

— Gjynah që nuk u bëkan njëqind – ia ktheu me ironi Meli, duke përthyer qafën e çizmes së grisur.

— Farmak e ke atë gjuhë të shkretë, o mustaqe, por ne njëqind vagona do t'i bëjmë për inatin tënd – ia priti polici duke shtrënguar dhëmbët.

— Do t'i bëjnë thuaj, jo do t'i bëjmë – e korrigjoi Meli.

— Mbylle, mustaqe, se do të ta tregoj mirë gramatikën unë pastaj – iu hakërrua polici i bërë spec.

Diksi i vuri dorën në sup ortakut të punës dhe e shtyu drejt vagonit që duhej manovruar. Atë çast arriti një vagon i mbushur treçerek me mineral, mbi të cilin kishin vendosur një të burgosur të dëmtuar rëndë, që po rënkonte. Një vagon i dalë prej shinave e kishte ngjeshur të burgosurin e dëmtuar për anë të galerisë, duke e shembur keq. Prej dhimbjeve të mëdha, ai shante mbarë e prapë qeverinë që e kishte dënuar me *heqje lirie* dhe po i merrte jetën në punë të rëndë të detyruar.

Polici dëgjonte dhe s'fliste, duke mos ditur çfarë t'i bënte të aksidentuarit. Ai ishte njëri prej punëtorëve më të mirë midis të burgosurve dhe gardianit i vinte më tepër keq që ai nuk do të bëhej më për punë. Ndërkohë puna u ndërpre për shkak avarie në njërën galeri, prej nga dilnin më shumë vagona me mineral. Polici u largua për të shoqëruar dy të burgosurit, që do të nxirnin jashtë të dëmtuarin. Duke përfituar nga rasti, Meli nisi trajtimin e temës qendrore të bisedave të tyre:

— Të kam thënë, Sazan, se jam i dënuar me kusht. Unë lirohem menjëherë prej burgut, në qoftë se pranoj të rikthehem në detyrën e detektivit. Pasi më arrestuan në Berat, më futën në një dhomë të veçantë në DP të Bredshme të atij qyteti. Atje më erdhën dy persona, të cilët m'u paraqitën si përfaqësues të Sigurimit të KQ të partisë. Pa asnjë lloj hyrjeje, ata u futën drejt në temë:

«Para dy ditësh, familja juaj u ngrys me biografinë më të mirë në Gjirokastër dhe u gdhi me biografinë më të keqe. Ishit bijtë e një babai që ka luftuar qysh orët e para me brigadën e parë sulmuese dhe vdiq nga plagët e

luftës çlirimtare, siç i kishte hije. Njëri prej vëllezërve të nënës suaj është hero i popullit, ndërsa tjetri dëshmor i luftës për çlirimin e vendit. Po t'iu shtoje këtyre fakteve të admirueshme edhe misionet e realizuara me sukses nga ti kur militoje në DSJ, nuk gjeje dot fjalë për të përshkruar meritat e familjes suaj. Ndërsa sot nuk gjen dot fjalë për të shprehur përmbysjen që ka ndodhur në familjen tuaj:

«Aktualisht ti je vëllai i një të arratisuri, në ndërgjegjen e të cilit ke ndikuar negativisht me sjelljen tënde arrogante dhe përçmuese ndaj realiteti tonë shoqëror. Veç kësaj, tetë udhëtime të tuat me mision jashtë shtetit kanë qenë të kontrolluara nga vëzhgues të posaçëm. Ti je fotografuar në shtete të ndryshme duke biseduar me të arratisur politikë, një krim i rëndë ky që dënohet prej ligjeve në fuqi. Për këto dy arësye të forta e meriton plotësisht arrestimin. Megjithatë partia, duke marrë parasysh edhe të kaluarën tënde si detektivi më rezultativ i shërbimit tonë sekret, s'ka ndërmend të të shtyjë në atë greminë, buzë së cilës ke shkuar me këmbët e tua. Ajo ka vendosur të të japë edhe një herë dorën.

«Duke thënë fjalët e fundit, ai nxori nga çanta dy fotografi dhe, pasi ma tregoi të parën, më pyeti:

— E njeh këtë person?

— Po, iu përgjigja.

«Ishte njëri prej ish-instruktorëve tanë, i arratisur në vitin 1969.

— Po këtë tjetrin? më pyeti, duke më treguar fotografinë e dytë.

— Edhe këtë e njoh – iu përgjigja sërish.

«Ishte një shoku im i profesionit, i arratisur qysh vitin e parë të aktivitetit, më 1971.

«Pastaj ai nxori nga çanta një fije letre të palosur me kujdes dhe ma zgjati duke më thënë:

— Lexoje me vëmendje dhe duam përgjigje përsa shtrohet në të.

«Hapa letrën dhe lexova:

Hamit Meli të lihet i lirë, me kusht që, pas një periudhe tranzitore dyjavore, të pranojë të rikthtehet në detyrën e tij të detektivit, me këtë mision të posaçëm:

Brenda një periudhe katërvjeçare nga dita që do të rifillojë detyrën e detektivit të zbulojë (i ndihmuar edhe nga burimet e tjera informative që disponon shërbimi ynë sekret) dhe të asgjësojë me çdo kusht personat që do t'i rekomandohen.

Në rast mospranimi të këtij propozimi, Hamit Meli të mbahet nën arrest dhe t'iu dorëzohet organeve të hetuesisë.

Për Komitetin Qendror të PPSH
Manush Myftiu

«Kur personi që kisha përballë e llogariti se unë e përfundova së lexuari letrën, urdhëroi me një ton të prerë:

— Vendos dhe përgjigju!

— Dua të mendohem – i thashë – Ndërkohë dua të më sillni dhe pak ujë, se kam etje.

— Jo vetëm ujë, por edhe raki, të cilën ti e do aq shumë – shtoi ai.

«Personi tjetër që e shoqëronte nxori nga çanta një shishe 0,5 kg raki rrushi e mandej të dy dolën jashtë, duke më thënë:

— Ne po largohemi, që të mendohesh në qetësi. Pas një ore do të kthehemi të marrim përgjigjen përfundimtare.

«Duke dalë, ata e mbyllën derën me çelës nga jashtë.

*

«Dilema ime ishte e vështirë. Pas gjashtë vjetësh shërbimi si detektiv, DSJ më kishte pezulluar nga detyra. Shkak u bë alkoolizimi im kronik, si pasojë e të cilit m'u dobësua mjaf vetëkontrolli. Villja vrer pa doganë kundër regjimit që i kisha shërbyer, duke përdorur si shkak çdo dukuri të rëndomtë të jetës së përditshme që më ngacmonte nervat. Pas disa paralajmërimesh, më pezulluan pa afat nga puna, në pritje të reagimit tim. Unë e intensifikova më tej përdorimin e alkoolit. Në këtë drejtim ndikoi mjaft edhe mungesa e dëshirës për tu rikthyer në profesionin e mëparshëm. Ndërkohë DSJ më dërgonte sinjale, se do të ishte e gatshme të më riaktivizonte, sapo të jepja shenjat e para të përmirësimit të sjelljes sime. Ndërsa unë bëja të kundërtën.

«Për shkak të rrahjes së një polici në hotel *Turizmi* në Gjirokastër, më dënuan gjashtë muaj burg. Edhe atëherë më propozuan të ma falnin burgun, me kusht që të rifilloja detyrën e detektivit. Preferova vuajtjen e dënimit. Ndihesha shumë i lodhur nga nervat si prej profesionit të dikurshëm, ashtu edhe prej realitetit të zymtë shqiptar. Sikur të kisha arritur të arratisesha siç mendoja, do të isha tërhequr në jetën private, për të harruar gjithçka. Kujtesa ime e fortë më kishte ndihmuar shumë gjatë veprimtarisë si detektiv. Po aq shumë po më shqetësonte ajo pas braktisjes së profesionit, mbasi nuk më linte të harroja. Harresa është një dukuri e rëndomtë me kosto të lartë: ajo vjen për të prishur punë, kur njeriu nuk e do, dhe e refuzon ftesën e tij, kur njeriu dëshiron të harrojë.

«Pas arrestimit në Berat, DSJ përfitoi prej rrethanave për të më vendosur përballë alternativës së vështirë: burg ose rikthim në detyrën e detektivit. Kur dy përfaqësuesit e KQPPSH erdhën në dhomën ku më kishin mbyllur, unë e kisha pirë të shumtën e rakisë. Pa pritur pyetje prej tyre, u ktheva përgjigjen e përgatitur:

— Nuk mund ta pranoj propozimin tuaj.

«Kryesori prej atyre të dyve u prish në fytyrë. Me sa dukej ishte përgatitur shpirtërisht për të kundërtën, mbasi duhej ta kishte marrë si fillim pazari kërkesën time për tu menduar. Pas një heshtjeje të shkurtër, ai pyeti me një ton të vrazhdë:

— Cila është arsyeja e refuzimit?

— Personi i parë ka qenë njëri prej instruktorëve më të përgatitur të shkollës sonë (ai na mësonte përdorimin e thikës). Këtë fakt e dinë mirë të gjithë ata që e kanë njohur nga afër. Kështuqë ai mbetet gjithmonë superior në konsideratën time si ish-nxënës i tij. I dyti ka qenë shoku im i ngushtë. Edhe këtë gjë e dinë ata që i lidhte puna me ne. Megjithëse ka dhjetë vjet që unë nuk e kam parë, po të vihem përballë tij, e di që nuk do të më bëjë dora ta godit, mbasi me të më lidhin shumë kujtime. Përveç kësaj, askush nuk më siguron dot se ata të dy nuk janë aktivizuar me ndonjë shërbim sekret të huaj, i cili aktualisht i ka në mbrojtje.

— Edhe ashtu mund të jetë; prandaj të është lënë në dispozicion një goxha kohë: katër vjet!

— Sidoqoftë, unë e vlerësoj të pamundur realizimin e këtyre dy misioneve nga ana ime. Vazhdoni veprimet tuaja.

— Këtu përfundojnë veprimet tona. Më tej, janë të tjerë ata që do të merren me ty, pasi të largohemi ne. Para se të ndahemi, po të themi edhe këto fjalë: ke për të vuajtur aq shumë, saqë do të na kërkosh por nuk do të na gjesh dot më. Megjithatë nuk po ta mbyllim plotësisht derën edhe kësaj here, me qëllimin e mirë që në horizontin e së ardhmes tënde të afërt të mos shikosh vetëm tela me gjemba. Po të bëjmë të ditur këtë adresë të shkurtër (ajo përbëhej nga katër fjalë dhe një numër). Fiksoje mirë në kujtesë. Qysh prej këtij çasti e deri sa të plotësohen dy vjet, kurdoherë që mund të ndryshosh qëndrim ndaj ofertës sonë, mjafton t'i thuash hetuesit (gjatë proçesit hetimor) të transmetojë në emër tënd fjalën "dakord" në këtë adresë dhe ti menjëherë do të lirohesh, sipas kushteve që lexove në letrën që të paraqitëm. Kur të jesh në kamp, mjafton një copë letër në këtë adresë me të njëjtën fjalë dhe përsëri do të lirohesh, gjithmonë sipas të njëjtave kushte. Mbetsh me shëndet!

«Pas këtij takimi, më kaluan direkt në hetuesi speciale, ku më katandisën të ecja tre muaj këmbadoras. Më shkatërruan veshkën e djathtë, më bënë me sëmundje zemre dhe ma acaruan më tej sistemin e dëmtuar nervor me seanca elektroshoku. Megjithë këto tortura shkatërrimtare për organizmin tim, unë nuk pranova asnjërën prej akuzave që më bënin. Megjithatë ky fakt nuk i pengoi fare të më dënonin me 17 vjet burg. Por kjo nuk ka më aq rëndësi. Njeriu merret me të shkuarën, kur nuk e kërcënon e ardhmja. Pikërisht këtu “më vret këpuca mua.”

«Muajin e ardhshëm, në gusht, plotësohen dy vjet nga afati që më kanë caktuar ata për tu menduar. Refuzimet përfundimentare të këtyre lloj ofertash DSJ i vlerëson si “dezertim nga detyra shtetërore me rëndësi të posaçme” dhe autorët e tyre i gjykon e i dënon në mungesë. Dhe, ç'është më e keqja, vendimet e dënimeve me vdekje të kësaj natyre ekzekutohen në heshtje. Raste të tilla ka pasur edhe kur unë militoja pranë DSJsë. Në rrethanat e mia, një helmin nëpërmjet ushqimit është mënyra më e thjeshtë dhe më e sigurtë për të më hequr qafe.

— Ushqimi këtu gatuhet dhe ndahet prej të burgosurve. Është e pamundur që ata të pranojnë të bashkëpunojnë me të burgosur për veprime sekrete kaq të rëndësishme – e kundërshtoi Diksi idenë e ish-detektivit.

— Ashtu është. Mirëpo kur unë vazhdoja aktivitetin në DSJ, kisha marrë vesh nëpërmjet shokëve të profesionit, se në raste të veçanta Sigurimi fuste në burgun e Burrelit ndonjë agjent të tij si të burgosur. Ai kontrollonte nga brenda situatën e burgut në përgjithësi dhe persona të caktuar, në veçanti. Një agjent i tillë mund të bënte ç'të donte me jetën e të burgosurve realë, pa i shkuar askujt ndërmend se nga i kishte ardhur e keqja. Të njëjtën ndërhyrje ata mund ta bëjnë ku t'ua dojë puna. Këtë problem po e diskutoj me ty jo se mund t'i gjendet zgjidhje, por për të mos qenë i panjohur për ty. Ashtu siç dëshiroja që dikush ta dinte se unë nuk kam qenë vetëm teknik ndërtimi në jetën e lirë, po ashtu dëshiroj që ti ta dish se ndonjë vdekje e befasishme e imja nuk do të jetë pa shkak të jashtëm.

Diksit i erdhi keq për pozitën e vështirë të bashkëvuajtësit. Në qoftë se brenda televa me gjemba mbretëronte pasiguria e përgjthshme, për Melin kishte shkaqe suplementare pasigurie, edhe më kërcënuese. Ai asnjëherë dhe në asnjë rrethanë s'mund të ishte i qetë.

«E keqja s'paska fund as brënda kësaj të keqeje njerëzore - burgut», – mendoi Diksi, tek po shikonte bashkëvuajtësin në siklet të shumëfishtë.

Me keqardhje të dukshme, ai i tha Melit:

— Më dhimbsesh, Hamit, por veç funksionit të dëshmitarit të heshtur, nuk mund të luaj dot rol tjetër në dobinë tënde. S'kanë thënë kot: «Më mirë një fund i tmerrshëm, sesa një tmerr pa fund.»

Për çduinë e Diksit, Meli i regjur me pusitë e vdekjes mendonte ndryshe:

— Gjendja nuk do të jetë gjithmonë njëlloj, Sazan. Me plotësimin e afatit dyvjeçar, unë do të shpëtoj në ndonjë formë prej tyre: ose do të më heqin qafe, ose do të më hiqen qafe. Cilado që të ndodhë, për mua nuk është e papritur.

*

Javët kalonin e bashkë me to edhe turnet e punës. Herë punonin ditën e flinin natën, herë punonin natën e flinin pjesërisht ditën. Për çudi, me afrimin e gushtit, Meli po tregohej më i kënaqur dhe nganjëherë i thoshte shokut të tij duke qeshur:

— Vapa ikën me gushtin, thotë populli. Në qoftë se vapa e sivjetme nuk do të më marrë me vete, do të përjetojmë bashkë një vjeshtë të freskët, si nga klima natyrore dhe nga ajo njerëzore.

Por koha nuk i vërtetoi parashikimet e tij. Ndonëse pas gushtit po kalonte edhe shtatori, pikërisht atëherë, kur ai mendonte se “e kishin fshirë nga lista”, i ndodhi e patritura më e madhe.

XVII

NË KURTHIN E PROFESIONIT

"*Asgjë nuk ndodh kurrë pa shkak.*"
Xh. Eduards

Më 29 shtator 1983 Meli dhe Diksi punonin turni i dytë në minierë. Në orën dy pasdite niseshin për në punë. Paradite, pas leximit të detyrueshëm të shtypit, ata kishin shkuar të ngushëllonin një bashkëvuajtës për vdekjen e babait. Pas ngushëllimit, të dy u nisën për në dhomën e fjetjes, për tu shtrirë një copë herë, para se të niseshin për në punë. Melin dikush e thirri dhe mbeti prapa, ndërsa Diksi shkoi e u shtri në dhomë. Pasi hëngrën drekë, u nisën për në punë. Vetëm rrugës për në minierë, Diksi e kuptoi se shoku i tij ishte bërë tym, pavarësisht se përpiqej të mos binte në sy.

Ata shkuan më shpejt se çdo ditë tjetër tek vendi i punës. Mbasi i bëri shenjë Diksit që të mos fliste, ortaku i tij i punës filloi të kontrollonte rreth stolit të drunjtë, në kapakun pa poç qelqi të një feneri dritash të mbërthyer në faqe të galerisë dhe në çdo vend të mjedisit rrotull, ku, sipas mendimit të tij, mund të vendosej ndonjë aparat regjistrimi për zërin. Si u sigurua mirë, ai u ul në stolin e drunjtë, ndezi një cigare, i dha edhe Diksit një (veprim ky që u paraprinte shpesh bisedave të tij serioze) e mandej filloi të sqaronte:

— Pikërisht tani, kur unë mendoja se gjithçka do të mbulohej gradualisht nga harresa, ndodhi e kundërta. Personi që më thirri kur po shkonim bashkë në dhomën e fjetjes për të pushuar, pasi u afrua, më tha:

— Hamit, a mund të ndez pak cigaren?

«Kur unë i zgjata cigaren që të ndizte të tijën, të cilën e kishte në buzë, ai shpalosi paksa njërën anë të jakës së xhaketës, ku shquante emblema e DSJsë. Pastaj më pyeti i buzëqeshur:

— Si je me shëndet, *Shkëmbi*?

«Ai po më fliste kështu me pseudonimin që unë kam përdorur gjatë kryerjes së shumicës së misioneve si detektiv. U trondita shumë, por nuk lëviza prej vendit. Pasi ndezi cigaren (natyrisht për të justifikuar thirrjen time), ai vazhdoi pa e fikur buzëqeshjen e shtirë:

— Sot e tutje unë do të shërbej si ndërlidhësi yt sekret me DSJnë. Qendra më ka autorizuar të të njoftoj, se je urgjentisht i thirrur për tu riaktivizuar në detyrën e detektivit. Kaq për sot, vetëm sinjalizimi. Nesër do të bisedojmë gjatë e gjerë dhe do të më japësh përgjigje për ofertën. Ndërkohë dua të të kujtoj se biseda që po zhvillojmë është duke u incizuar.

«Tek vështroja atë fytyrë-maske, tek dëgjoja zërin e tij të më fliste për "riaktivizim", po më bëhej të bërtisja me të madhe dhe të lajmëroja gjithë të burgosurit, se bashkë me ta hante e flinte një oficer sigurimi i maskuar. Ndërkaq e mblodha veten dhe e pyeta:

— A e di ndonjë oficer i komandës se kush je ti në të vërtet?

— Vetëm njëri. Për sot nuk duhet ta zgjasim më. Nesër brigada juaj shkon përsëi mbasdite në punë. Pas leximit kolektiv të shtypit, në orën 11 do të takohemi në dhomën ku fle brigada e ndërtimit. Paradite ata janë në punë dhe dhoma e tyre është bosh. Nesër kam shumë gjëra për të të thënë dhe besoj se do të merremi vesh bashkë. Mirëupafshim nesër në orën 11.

«Ai u largua serbes-serbes, si të ishte ndonjë shok i vjetër burgu. Ndërsa unë mbeta edhe disa çaste pa lëvizur prej vendit. Pastaj, me këmbët që i tërhiqja zvarrë, erdha e u shtriva në dhomë. Ishte ndofta hera e parë që më erdhi aq keq për veten time. Ç'fat i zi! mendoja. Kur unë përpiqesha të të kujtoja sa më rrallë (se ti nuk harroesh dot kurrë, moj e kaluar torturuese!), gjithçka po nis nga e para. Ky paska qenë vërtet një mallëkim.

Kur pushoi së foluri, Meli po merrte frymë me zor.

XVIII

BASHKË NË MINIERËN E NXEHTË DHE NË LUFTËN E FTOHTË

"*Meqë nuk mbetej rrugë tjetër, ai zgjodhi këtë formë heroizmi: të qëndronte besnik*."
M. Burbun

Ngjarja e tronditi Diksin. Papritmas ai e pa veten në qendër të një cikloni, pasojat e të cilit nuk mund të parashikoheshin. Natyrisht, zgjidhja më e qetë e situatës së komplikuar vrullshëm do të ishte pranimi i ofertës së DSJ prej Melit dhe dalja e tij nga burgu. Vetëm kjo mbyllje kapitulli do të shmangte rrezikun që kanoste drejtpërdrejt Melin dhe tërthorazi Diksin. Mirëpo kjo mbetej një e drejtë ekskluzive e Melit: i takonte atij të vendoste për të ardhmen e vet. Diksi mund t'i bënte vetëm ndonjë sugjerim të kujdesshëm. Përndryshe Meli kishte të drejtë të dyshonte në qëndrimin e Diksit, për të mbajtur të njëjtat marrëdhënie me të edhe pas acarimit të mundshëm të komunikimit të tërthortë të ish-detektivit me DSJnë. Kjo ishte një thikë me dy presa, mbasi distancimin e Diksit prej tij, në rast refuzimi të ofertës së re të DSJsë, Meli kishte të drejtë ta interpretonte edhe si një kërcënim të tërthortë për të ardhmen e tij. Ai mund të mendonte se, në rast rreziku eventual, Diksi do ta përdorte ndoshta sekretin e tij të rëndësishëm si varkë shpëtimi.

Në ato rrethana sa komplekse aq edhe delikate, Diksi ishte i detyruar të merrte një vendim të qartë e të prerë, të cilin duhej t'ia bënte të ditur pa asnjë rezervë bashkëvuajtësit, që i kishte besuar jetën e tij. Ndërkohë ai e kuptonte mirë se nga anonte balanca e gjykimit të Melit. Në rast se ky do të kishte qenë i prirur për ta pranuar ofertën e DSJsë për rifillimin e detyrës së detektivit, këtë gjë do ta kishte bërë qysh ditën e arrestimit në Berat. Ose gjatë torturave të rënda në kuadër të hetuesisë speciale. Ose gjatë afatit dyvjeçar që i kishin lënë për tu menduar. Tekefundit do ta kishte pranuar edhe tani që DSJ i trokiti në portën e kampit të Qafë–Barit dhe ndërlidhësi i saj priste përgjigje prej tij. Pse do ta vinte në dijeni Diksin për kontaktin me ndërlidhësi sekret në kamp, nëse Meli kishte ndërmend ta pranonte ofertën e fundit të DSJsë?

Aktualisht Diksi ndodhej para një alternative të qartë: ose aleat deri në vdekje me Melin që i besoi aq shumë, ose të përgjunjej prej përmasave të rrezikut e ta komplikonte më keq situatën, mbasi ish-detektivi me përvojë kishte të drejtë ta shikonte me dyshim personin, që i kishte besuar sekretin. Pra, nëse në rastin e parë i rrezikohej vetëm jeta, në rastin e dytë rreziku i jetës nuk pakësohej fare, përkundrazi, veçse do të mbartte edhe thyerjen morale, injorimin.

Diksi ishte 36 vjeç dhe qyshse kishte njohur veten ai kishte pranuar të hiqte të zitë e ullirit, për hir të dinjitetit. Mjaft të deklasuar si ai e *kishin gjetur fjalën* me Sigurimin dhe flirtonin me të për një jetesë të pështirë. Ai vetë kishte pasur gjithmonë neveri prej pazarllëqeve, që e shndërronin personalitetin e njeriut në

një leckë wc-je të Sigurimit. Prandaj ai nuk ia lejonte vetes kurrë të manifestonte lëkundjen më të vogël në këto kryqëzime të udhëve të fatit. Aq më tepër që Diksi e kishte tashmë të qartë se agjenti i DSJsë me maskë të burgosuri – ndërlidhësi sekret – i kishte studjuar me imtësi marrëdhëniet e Melit me të burgosurit e tjerë dhe i kishte transmetuar relacione të posaçme *qendrës* për gjithçka. Pothuajse gjithë kohën e lirë në kamp Meli e Diksi e kalonin së bashku, qysh prej rrëfimit të ish-detektivit. Në rast se Meli, sipas të gjitha gjasave, do ta refuzonte përsëri ofertën e DSJsë dhe Diksi do të shkëputej prej tij, ndërlidhësi do t'ia transmetonte këtë menjëherë DSJsë. Pse kjo ndarje e papritur midis këtyre dy bashkëvuajtësve, pikërisht në një moment të tillë? Ky do të ishte një tjetër ekspozim ndaj rrezikut.

Nga ana tjetër, a kishte kompensim më të mirë për 36 vjetët e skëterrshëm të jetës së Diksit, i cili e kishte kaluar fëmijërinë në internim dhe po thinjej në burg ku i duhej të vuante edhe nëntë vjet akoma, sesa lufta kundër diktaturës vrastare? Të ndihmonte për ta privuar DSJnë prej detektivit të saj më të mirë, nuk ishte një arritje e vogël për Diksin nga pozicioni i të burgosurit politik.

*

Mbasi i kishte përshkruar detajet sfilitëse të dialogut të tij me ndërlidhësin sekret të DSJsë, Meli e kishte fiksuar shikimin mbi fytyrën e Diksit. Kuptohej që ai po priste me ankth reagimin e bashkëvuajtësit, që e njihte tashmë me hollësi të kaluarën e ish-detektivit. Diksi buzëqeshi para se t'i përgjigjej:

— As që bëhet fjalë se unë mund të ndryshoj qëndrim ndaj teje, Hamit, prej rrethanave të reja që u krijuan. Ti ma besove sekretin tënd jetik, pa e parashikuar një zhvillim të tillë të ngjarjeve. Unë të falënderoj për këtë dhe të jap fjalën se do të jemi bashkë deri në fund të kësaj furtune që sapo ka nisur. Veç dëshiroj që, sot e tutje, ti ta kontrollosh më mirë veten në koniukturat e reja që do të krijohen në mënyrë të paevitueshme. Qoftë edhe për sedër profesionale, ti nuk duhet t'iu japësh rast me fjalorin tënd të shthurur spiunëve të burgut, që të përfitojnë prej pakujdesive të tua për të ulur dënimin e tyre duke dëmtuar ty.

— Si çdo njeri, edhe unë kam dobësitë e mia, Sazan. Por situata tashmë ka ndryshar kryekëput; të njëjtën gjë do të bëj edhe unë.

— E ke vendosur përfundimisht për ta refuzuar ofertën e re të DSJsë?

— Profesioni i detektivit më ka mësuar të mos lë asgjë pezull në jetë, mbasi qëndrimet e lëkundura sjellin gjithmonë pasoja të padëshirueshme. Torturat në hetuesinë speciale, mbasi i kisha shërbyer gjashtë vjet në frontet e luftës së heshtur diktaturës, persekutimi që po i bëjnë familjes sime duke i ndërprerë edhe korrespondencën me mua dhe situata e tmerrshme e kampeve të punës, që po i shikoj me sytë e mi, ma kanë forcuar bindjen, se kundërshtimi i rikthimit në detyrën e detektivit është një prej vendimeve më të drejta që kam marrë në jetë. Aq më tepër që unë nuk do të jem më i vetëm në luftën e pabarabartë që na pret. Më fal, miku im, që po të implikoj në një çështje të vështirë, e cila mund të të

kushtojë jetën. Ti ke vuajtur shumë dhe më vjen keq që ngjarjet rrodhën kështu. Por edhe e kaluara ime është e dhimbshme. Në këtë situatë kërcënuese le të luftojmë së bashku kundër armikut tonë të përbashkët!

Dy shokët besnikë i shtrënguan dorën njëri-tjetrit.

XIX

PËRBALLË NDËRLIDHËSIT SEKRET

“Për të dalë mirë nga një bashkëbisedim duhet admiruar pak, dëgjuar shumë, nuk bën të pretendosh se je mendjehollë, por ta tregosh atë tek të tjerët me sa të mundesh.”

B. Franklin

Të nesërmen Meli hyri në dhomën e caktuar disa minuta më herët. Pas pak atje shkoi ndërlidhësi. Pas përshëndetjes së rastit, Meli i hodhi një sy trupit mesatar, por të lidhur mirë të “lajmëtarit të furtunës” dhe i tha:

— Me shëndet qenke goxha mirë.

— Se ushqehem mirë – u përgjigj tjetri duke qeshur. – Ti e di që dietat i kemi të larta. Apo kujton se mbahem me gjellën e kazanit të kampit?

— Prej sa kohësh je “i burgosur”?

— Afërsisht, nëntë vjet.

Ai i zgjati Melit paketën me filtër. Ky nuk e mori cigaren. Ndërlidhësi e ndezi për vete me një çakmak të bukur.

I burgosuri ndezi një cigare nga paketa e tij dhe thumboi bashkëbiseduesin:

— Paske çakmak me gaz sot, nuk ke nevojë për ndihmën time të ndezësh cigaren.

— Sot ka nevojë shteti për ndihmën tënde, Hamit. Urdhëro lexoje këtë letër.

Ai i zgjati Melit një rryp të gjatë letre speciale mjaft të hollë, të mbështjellë në formën e një cilindri të vogël.

Ish-detektivi e shtjelloi letrën dhe lexoi:

*Për interesa të larta shtetërore, ju ofrohet prej DSJsë një detyrë e rangut të parë në kuadrin e një misioni me rëndësi të posaçme, i koduar “*Misioni i Madh*”. Për riaftësimin tuaj fizik e profesional do të merren këto masa:*

Do të kuroheni gjashtë deri në tetë muaj në një nga klinikat më të mira të botës. Koha e vuajtjes së hetuesisë dhe burgut do t'ju kompensohen në të holla me dhjetëfishin e rrogës që keni pasur si detektiv i Sigurimit të Jashtëm të Shtetit. Shuma arrin shifrën 740 mijë lekë (të reja) dhe do ti jepet në dorë nënës suaj. Të gjithë të afërmit tuaj (vëllezer e motra familjarisht) do të grupohen në Tiranë, duke u sistemuar në punë të përshtatshme.

Ju do të merrni kontakt me specialistë të aftë, për të rifreskuar dhe riaftësuar reflekset tuaja të mirënjohura profesionale. Në qoftë se do të keni ndonjë kërkesë apo dëshirë, plotësimi i së cilës varet prej nesh, nuk do të na mungojë aspak vullneti që t'jua realizojmë. E njëjta gatishmëri duhet t'ju karakterizojë edhe ju në përgjigje të ofertës sonë.

Mospranimi ju ngarkon me përgjegjësi të rëndë.

Për Komitetin Qendror të PPSH

Nexhmije Hoxha

Kur mbaroi së lexuari letrës, Meli e pyeti ndërlidhësi me një ton habie:

— Ç'lidhje ka drejtoresha e Institutit të studimeve marksiste–leniniste, që firmos këtë letër, me shërbimin sekret shqiptar?

— Nuk mud t'i përgjigjem kësaj pyetjeje. Atë do t'ua përcjell shefave në Tiranë, të cilët mund të më autorizojnë për përgjigjen. Tani hidhi një sy kësaj fotografie.

Megjithëse Meli i kishte vënë detyrë vetes që të mos shprehte asnjë lloj ndjenje në bashkëbisedim me ndërlidhësin, pamja e fotografisë e tronditi. Ky sukses i parashikuar bëri që ndërlidhësit t'i qeshte nuri.

Në fotografi paraqitej vëllai i arratisur i Hamitit, Dari Meli, me pranga në duar, dalë para godinës së DSJsë. Megjithëse ishte i prangosur, Dariu qeshte. Kjo tregonte se fotografia ishte përgatitur enkas për ish-detektivin e burgosur.

Pas triumfit të çastit, ndërlidhësi e pa të arsyeshme të bënte sqarimet e nevojshme:

— Yt vëlla është vënë në shërbim të DSJsë. Aktualisht nuk ndodhet në Tiranë. Shefat mendojnë se ai po punon mirë. Para se të më kthesh përgjigjen që duhet t'i transmetoj qendrës lidhur me ofertën e saj, puna e kërkon që ti të mendosh edhe për fatin e mëtejshëm të vëllait më të ri nga ti. Unë kam këtu disa hape të posaçme, të cilat e ngrejnë temperaturën deri në dyzet gradë celsius. Po të pish një prej tyre tani, pas një ore ne do të jemi duke udhëtuar bashkë për në spital, pra, për në DSJ.

— Një veprim i tillë është i pamundur për mua. Unë jam më tepër i sëmurë nga sa mendon qendra. Nuk ka kurim mjekësor që mund të më rikthejë qetësinë nervore dhe reflekset e mia të dikurshme profesionale.

— Kjo është arsyeja e refuzimit të ofertës?

— Të duket e pamjaftueshme?

— E mjaftueshme, natyrisht, por e evitueshme. Për riaftësimin tënd shëndetësor e profesional do të firmosin profesorë të mjekësisë më të zhvilluar bashkëkohore.

— Nuk ka profesor mjekësie që të firmosë sinqerisht për rimëkëmbjen e shëndetit tim të shkatërruar. Veshka ime e djathtë është e dëmtuar dhe unë urinoj gjak shpesh. Sistemin nervor e kam të acaruar tej mase. Krizat e zemrës më janë bërë kronike. Në gjumin e shqetësuar që bëj, unë flas përçart dhe pa dashje dekonspiroj vetveten. Qendra flet përkundruall, pa e njohur nga afër gjendjen time shëndetësore.

— Jo, s'është ashtu, Hamit, gabohesh. Ndryshe nga ç'mendon ti, ne kemi kohë që të vëzhgojmë. Unë kam qenë edhe në kampin e Ballshit për gjashtë muaj që ti qëndrove atje. Edhe këtu bashkë kemi ardhur. Po të duash, mund të të them edhe numrin e vagonave që ke manovruar deri sot në planin e pjerrët.

— Një vëzhgim i sipërfaqshëm nuk i konstaton dot anomalitë e mia nervore dhe organike.

— Detyra ime është që të të sqaroj ofertën dhe udhëzimet e qendrës, jo të ushtroj trysni psikologjike mbi ty, Hamit. Përfundimisht ti do të vendosësh vetë për përgjigjen që unë duhet t'i transmetoj qendrës. Veç duhet të mbash parasysh faktin, se refuzimi kategorik nuk do të kalojë pa pasoja për ty.

— Pasojat mund të jenë edhe më të rënda, në qoftë se paaftësia ime bëhet shkak për dështimin e *Misionit të Madh*.

— Qendra më ka udhëzuar gjithashtu të të njoftoj, se duhet të pranosh të futesh në ndonjë punë të përshtatshme këtu në kamp. P. sh. të peshosh ushqimet e furnizimit ditor të kuzhinës së kampit. Ky është vend pune pa telashe dhe nuk ke të bësh fare me të burgosurit e shumtë. Kjo mund të ndikojë edhe në përmirësimin e gjendjes tënde shëndetësore.

— Faleminderit për interesimin, por unë nuk dua punë më të mirë nga ajo që po bëj.

— Jo, në minierë ti nuk do të hysh më; ky është vendim i qendrës. Nejse, këtu jemi e do të flasim përsëri bashkë. Ke gjë për të thënë nga ana jote?

— Po. Pavarësisht se ne do të vazhdojmë të jemi të dy në të njëjtin kamp, dëshiroj të mos më shqetësosh, me përjashtim të rasteve kur do ta rekomandojë qendra diçka të tillë.

— Pse kjo? pyeti i habitur ndërlidhësi, duke ndezur një cigare tjetër.

Meqenëse Meli nuk iu përgjigj fare kësaj pyetjeje, që nuk kishte lidhje me thelbin e çështjes, ndërlidhësi i tha:

— Në rast se nuk ke gjë tjetër për të shtuar, mund të largohesh. Bashkë do të kontaktojmë vetëm me rekomandim të DSJsë.

Duke thënë këto fjalë, ai u shtri mbi dyshekun ku ishte ulur.

Meli doli pa e përshëndetur. Duke konstatuar se punët po i merrnin rrokullimën, veshët i gumëzhinin e shikimin nuk e kishte të qartë si gjithmonë.

XX

PIKËNISJA E SFIDËS SË MADHE

"*Të dish të besosh është një cilësi shumë e rrallë, që tregon një mprehtësi të ngritur mbi nivelin e së përgjithshmes*."

P. dë Gondí

Të nesërmen, më 1 tetor 1983, Meli u përjashtua nga puna në minierë sipas organikës së re mujore. Të njëjtën ditë, tetëdhjetë të burgosur të kampit të Spaçit u transferuan në atë të Qafë–Barit. Dy autobuza plot me të burgosur duarlidhur ishin vënë në mes nga dy makina me ushtarë të armatosur, policë e qena ndjekjeje. Ata arritën në kampin e Qafë-Barit rreth orës dy pasdite.

Qysh atë ditë u bë shpërndarja e tyre nëpër brigada pune me turne. Shumë prej këtyre të burgosurve kishin qenë me raport mjekësor, të paaftë për punë nëntokësore. Mirëpo numri fillestar i të burgosurve që punonin në minierën e Qafë–Barit ishte zvogëluar dukshëm, ngaqë shumë prej tyre ishin sëmurur si pasojë e kushteve të rënda të minierës.

Në këto rrethana, duke mos pasur rezerva forcash të tjera (arrestimet nga jeta e lirë ishin kufizuar disi) Drejtoria e Kampe-Burgjeve dërgoi në kampin e Spaçit një komision "mjeko-ligjor" të përbërë kryesisht prej hetuesish. Këta konstatuan se shumica e të burgosurve të Spaçit, deri atëherë të pajisur me raport paaftësie për punë nëntokësore, ishin *përmirësuar* nga ana shëndetësore. Pasi ua hoqën raportet mjekësore, i dërguan në minierën e Qafë-Barit, ku shëndeti i tyre do të merrte goditjen fatale.

Ditën tjetër, më 2 tetor, kartelisti i kampit të Qafë-Barit e thirri Melin në zyrë. Duke qenë vetëm për vetëm me ish-detektivin, ai hyri drejt në temë:

— Jam oficer i DSJsë. Kam urdhër të të sistemoj në atë vend pune që do të të pëlqente, prej këtyre që kemi brenda kampit.

— Ju faleminderit, nuk dëshiroj asnjë lloj pune të ofruar me porosi nga lart. Meqenëse keni vendosur të mos më lejoni të hyj më në minierë, të paktën më caktoni të punoj në brigadën e ndëritmit, thjesht si punëtor.

— Pse thjeshtë si punëtor? ia ktheu kartelisti i habitur. – Ti je teknik ndërtimi i diplomaur. Kjo është e regjistruar edhe në kartelën tënde personale; besoj se ti e di këtë.

— Sigurisht që e di, por unë ndihem më mirë punëtor krahu, sesa të merrem me drejtimin e punimeve. Siç e dini, vuaj nga nervat dhe mund të mos sillem si duhet me bashkëvuajtësit e mi.

— Si të duash. Jam gjithashu i autorizuar të të them, se për çdo problem që mund të të lindë, duhet të kërkosh menjëherë takim me mua. Në rast se do të ndërrosh mendje përsa i përket çështjes së punës, unë jam gati që të të sistemoj në çdo kohë atje ku do të dëshirosh.

— Faleminderit, por nuk besoj se do të ndërroj mendje ndonjëherë, – ia ktheu Meli, duke u mëshuar fjalëve të fundit.

Për të zgjidhur problemin e strehimit të të burgosurve që do të vinin prej kampit të Spaçit, mbi tarracën e depove dhe të bibliotekës së kampit të Qafë-Barit u ndërtua urgjentisht një kapanon prej dërrase rreth 25 m i gjatë e 6 m i gjerë. Këtij kapanoni të drunjtë të burgosurit i ngjitën nofkën *maune*.

Me sistemimin e ri të brigadave, pas përjashtimit nga nëntoka Melin e çuan për të fjetur pikërisht në *maune*. Ai nuk ishte më në njëjtën dhomë me Diksin. Tani Meli takohej me shokun e tij vetëm në oborr, kur ai kthehej nga puna

Atë 2 tetor 1983 Sazani punonte turni i parë në minierë. Kur u kthye pasdite në kamp, Meli i doli përpara:

— Me të ngrënë bukë, të pres të vish lart tek sheshi, ku pimë kafenë. Atje do të më gjesh.

Ndryshe nga herët e tjera, Diksi hëngri bukë me të shpejtë dhe shkoi ku e priste shoku.

Besnik i rregullit të tij të përhershëm në prag të bisedave serioze, Meli i dha atij një cigare, ia ndezi (vetë e kishte të ndezur) dhe mandej nisi të fliste pak i impresionuar. Në të vërtet ajo ç'ka i kishte ndodhur do të justifikonte edhe emocione akoma më forta.

*

Në orën nëntë Meli kishte shkuar të pinte kafen e mëngjesit tek një kënd i sheshit sipër kampit, si zakonisht. Ndërsa ai po merrej me përgatitjen e kafesë, njëri prej të burgosurve të ardhur të djeshmen prej Spaçit, i cili qëndronte tek cepi i banjave përkarshi, filloi t'i bënte një sërë shenjash të pakuptueshme. Meqenëse Meli nuk po kuptonte asgjë, i kishte hequr sytë prej andej dhe ishte përqendruar sërish tek xhezveja.

Pas disa minutash, i njëjti person kishte shkuar e ishte ulur mbi një gur, dy-tri metra tej vendit ku rrinte Meli. Rrotull tyre nuk kishte pasur të burgosur të tjerë. Ndonëse Meli e kishte kuptuar se ardhja e atij të panjohuri aty nuk ishte e rastësishme, ai ishte treguar indiferent në pamje dhe bënte sikur s'e vinte re praninë e atij. Disa çaste pasi ishte ulur mbi gur, i panjohuri e kishte thyer heshtjen, duke folur me kokën ulur:

— Hamiti që ke qenë je, apo ke ndryshuar?

— Ai që kam qenë jam. Edhe ndonjë ndryshim të mundshëm e kam bërë vetëm për mirë. Po ti kush je?

— Një ish-shoku yt i profesionit, Guri Streto. Më mban mend apo jo?

— Sikur jemi ndarë dje.

— Po fytyrën ma mban mend mirë?

— Sigurisht. Ti ishe djali më i hijshëm i kursit dhe është e lehtë ta mbash mend fytyrën e një shoku të bukur. A ke ndonjë fotografi me vete të shmallohem me Gurin pa maskë?

— Sot jo, por do ta kem parasysh për të ardhmen. Fizikisht të paskan shkrirë fare – kishte ndërruar temë Streto. – Megjithatë lëkura jote u duhet akoma dhe po interesohen posaçërisht për të tani.

— Guri, ndofta përveç ty mund të ketë edhe ndonjë tjetër të DSJsë këtu, për të cilin ti s'di gjë dhe duke na parë bashkë…

— Mos u shqetëso për këtë çështje, Hamit. Unë e di që këtu ndodhet edhe ndërlidhësi yt me qendrën, përveç ndonjë tjetri. Por mua më kanë caktuar drejtues të veprimeve të këtushme dhe më kanë udhëzuar të të vëzhgoj personalisht nga sa më afër, për të konstatuar gjendjen tënde nervore. E rëndësishme është që të mos dëgjojë askush se çfarë diskutojmë bashkë.

Ata flisnin pa e shikuar njëri-tjetrin në sy. Streto bënte sikur lexonte një gazetë të hapur që mbante në dorë, ndërsa Meli pinte kafenë me fytyrë të kthyer anash.

Pas një heshtjeje të shkurtër, Streto kishte vazhduar:

— Mund të mos isha nxituar për tu takuar qysh sot me ty, por dëshiroja të të bëja të ditur sa më parë një të vërtetë që më rëndon në ndërgjegje, pavarësisht se nuk jam fajtor për të. Vëllanë tënd të arratisur, Dariun, e kemi sjellë në Shqipëri unë me tre shokë të tjerë. Ti e di mirë, Hamit, se ata që na urdhërojnë kanë në dorë fatin tonë e të familjeve tona. Në këto rrethana detyrohemi të bëjmë edhe diçka që nuk e dëshirojmë. Me ndonjë tjetër do ta kisha më të vështirë që të kuptohesha siç duhet për një problem të tillë, por ti i ke provuar vetë këto gjëra. Rëndësi ka që Dariu tani është shumë mirë me shëdet dhe ka filluar të mësohet me kushtet e reja të jetës e të punës.

— Ku e "psonisët" qafirin?

— Në Stamboll. Në një hotel ku kishte zënë dhomë Dariu, zumë edhe ne. Përgjonim me kujdes çdo lëvizje të tij. Kur ai shkoi të bënte banjë, njëri prej shokëve të mi hyri në dhomën e tij dhe i ndërroi një cigare në paketen që kishte në xhep, me një tjetër të po atij lloji të paisur me bar gjumi. Pas banjës, Dariu doli në qytet. Ne e ndiqnim me vëmendje, sepse nga çasti në çast ai mund të pinte cigaren tonë dhe ngelej në rrugë. Pas rreth dy orësh, ai u kthye përsëri në hotel. Ne gjithmonë pas tij. Në mëngjes pritëm të çohej nga gjumi, por më kot. E kuptuam që cigarja e kishte bërë punën e saj. Pasi kaloi ora tetë e gjysmë, u futëm në dhomën e tij. Ishte endé "në gjumë". Dy prej nesh e morën për krahësh, sikur e kishim ndonjë shok të sëmurë. Në rrugë priste furgoni i posaçëm. Për kureshtje shikuam paketën e tij. I kishin mbetur vetëm dy cigare. Pra, cigaren tonë e kishte pirë ndër të fundit.

«Si e sollëm në Tiranë, e shikoja rrallë; vetëm kur e çonin ose e sillnin prej hetuesisë. Ishte shumë i tronditur e i hutuar, dyllë i verdhë në fytyrë. Kur pranoi të bashkëpunonte me DSJnë, u la i lirë. Atëherë e afruam pranë dhe u përpoqëm ta qetësonim e ta ndihmonim. Tani është mjaft mirë me shëndet e me punë.

— E ku merr vesh ai nga punët tuaja!

— Pse, çfarë mendon ti se i kërkojnë të bëjë Dariut? Ti e kupton që ai mbahet peng për ty. Atje ku punon ka shokë të mirë e është i qetë.

— Le të jetë si të dojë, vetë e ka fajin. Unë e bëra timen, e nxora jashtë shtetit. Nuk diti të përfitonte, i bëftë mirë buka e Tiranës tani. Asgjë nuk më mbetet merak. Edhe ti nuk duhet ta ndiesh veten aspak fajtor për atë që ndodhi. E njoh mirë pozicionin tuaj, se e kam provuar vetë. Veç, harrova të të pyes: kur e keni sjellë në Tiranë?

— Nga fundi i shkurtit.

— Nejse, le të kthehemi në temën e duhur. Kush është tani drejtor i DSJsë?.

— *Dofeni*, siç i thonë francezët djalit të madh të mbretit. Por mos mendo se është ai djali me pamje çupline, që ke njohur ti dikur. Ka ndryshuar shumë. E pi duhanin dhe alkoolin më tepër nga unë. Tani e ka kuptuar që pushteti i babait qëndron mbi krime.

— Drejtori i mëparshëm, Mehmet Xhafa, ku gjendet?

— Zoti e di nëse gjendet a s'gjendet më. E gjithë elita drejtuese e DSJsë është e re.

— Po instruktori anglez, që na thoshnin se ishte rob lufte, akoma atje gjendet?

— Jo, edhe ai ka avulluar; pa nam, pa nishan.

— Po shefi i madh që pezulloi mua nga detyra, *Kobra*, siç e thërrisnim midis nesh, nga bëhet? As televizioni e as shtypi nuk po ia përmendin më emrin.

— Kjo është pyetja më e vështirë për mua. Emri i tij konsiderohet tabu në DSJ, Hamit. Në radhët e shërbimit sekret qarkullon një pëshpëritje, se e kanë arrestuar. Por kjo i ngjan më tepër propagandës që synon të shpërndajë nën zë vetë Sigurimi për çështje të veçanta me qëllim të caktuar. Një ditë në DSJ na shfaqën disa sekuenca filmike të gjoja hetuesisë së *Kobrës*. Por ne e kemi njohur nga afër për një kohë të gjatë dhe si profesionistë të këtyre punëve nuk gënjehemi dot lehtë.

— Ishte ndonjë sozi e *Kobrës*?

— Pa dyshim. Nga ana tjetër, thuhej se familja e tij ishte e internuar në Kurbnesh. Unë e kam verifikuar personalisht fallsitetin e këtyre thashethemeve, duke kontrolluar jo vetëm listën e familjeve të internuara në Kurbnesh dhe në qendra të tjera, por i kam kontrolluar edhe në terren ato.

— Si mendon se qëndron e vërteta?

— Çështja *Kobra* është shumë e turbullt, Hamit. Një pasdite isha duke pritur *Dofenin* para selisë së Komitetit Qendror të PPSH. Për çudi, vetura e *Dofenit* ishte e treta ndër tri veturat që ndaluan njëherësh pranë vendit ku po prisja unë. Prej veturës së parë zbriti një person me duar lidhur pas shpine e me kasketë në kokë, të cilin e kishin kapur për krahu dy oficera. Prej veturës së dytë zbritën katër persona, të cilët shoqëruan tre të parët. *Dofeni* u afrua pranë meje e më pëshpëriti: «I arrestuari është *Kobra*. Pas pak ai do të ketë një ballafaqim të fortë në selinë e Komitetit Qendror.» Pas këtyre fjalëve të *Dofenit* e kuptova pse ma kishte fiksuar takimin në atë vend e në atë orë.

— Po gjendja në përgjithësi si është në DSJ?

— Ndërkohë që në mensën e DSJsë shampanja është me bollëk, në pazarin e Tiranës mezi gjendet edhe preshi. Kohët e fundit është bërë një mobilizim i përgjithshëm i detektivëve. Bile janë thirrur edhe kuadro që kishin vite në pension. Po vazhdojnë përgatitje intensive për një mision të veçantë, me sa duket, shumë i rëndësishëm. *Misioni i Madh* e kanë koduar. Palestrat ushtojnë ditë e natë prej zërave të instruktorëve e të detektivëve.

— Sipas mendimit tuaj, për çfarë misioni bëhet fjalë?

— Vështirë të gjendet me hamendje. Një ditë guxova ta pyesja *Dofenin*, nëse do të isha edhe unë pjesëtar i atij misioni. Ai m'u përgjigj prerë: «Patjetër, Guri. Këtë herë ne do të aktivizojmë gjithë potencialin tonë për realizimin me sukses të *Misionit të Madh*. Këtë mision do ta kryesojë Hamit Meli dhe vetëm Hamit Meli»

— Janë mësuar ata t'i bëjnë llogaritë pa hanxhin dhe t'iu dalin sipas kutit të tyre. Por kësaj here nuk besoj se do t'iu eci. Unë jo vetëm që s'do ta kryesoj atë mision, por as nuk do të pranoj kurrë të kthehem përsëri në DSJ. Le të bëjnë ç'të duan.

— Që të vendosësh përfundimisht kështu, duhet të mendosh patjetër edhe kundërmasat e tyre ekstreme. Deri në ç'pikë je përgatitur shpirtërisht për të përballuar trysninë e DSJsë?

— Deri në vdekje. Unë e di që ata nuk kanë asnjë arsye pse të ma kursejnë jetën, ashtu sikundër unë nuk kam asnjë arsye pse të pranoj të rikthehem atje. Ata më sakatuan e më poshtëruan sa mundën në hetuesi, po më marrin shpirtin në burg e po ma çmendin familjen me lloj-lloj makinacionesh të natyrës më cinike. Dhe të gjitha këto, pasi babai im luftoi e vdiq për këtë regjim, ndërsa unë vetë jam përgjakur qysh në moshën njëzet e dy vjeç për interesat e tyre vulgare, duke hequr një të tretën e stomakut për shkak të plagosjes në tokë të huaj. Jo, jo, unë çdo goditje nga ana e tyre do ta mirëpres i vendosur, por "ledhatimin" që duan të më bëjnë e neveris deri në fund, pa mëdyshje.

— Punët e tua ti i di vetë më mirë se kushdo, Hamit, se je i zoti i hallit. Veç dua të të paralajmëroj për diçka: do të të duhet shumë punë, për t'iu shmangur rrezikut të kurtheve, para se çështja të arrijë në një vendim arbitrar nga lart. Do të jesh objekt vëzhgimi i informatorëve të specializuar të DSJsë që do të veprojnë në kamp, ndërkohë që gjithë spiunëve të burgosur, të cilët kanë sadopak lidhje me ty, do t'iu kërkohet të zhbirojnë gjithçka të mundshme rreth teje. Sidoqoftë vetëm nuk do të jeshë – shtoi Streto, duke e shikuar për herë të parë Melin në sy.

— Normalisht një person në gjendjen time të pashpresë do ta mirëpriste ndihmën e ish-shokëve të armëve – ia ktheu ish-detektivi. – Por unë nuk mund t'ia lejoj vetes kurrë që të rrezikoj shokët e mi, për të shpëtuar lëkurën time. Të falënderoj përzemërsisht për besimin që po tregon ndaj meje. Jam i kënaqur që do të kemi rast për të biseduar përsëri bashkë.

— Fjalët nuk sjellin zgjidhje situatash, Hamit… As ne nuk ndjehemi të sigurtë në DSJ.

— I mbyturi nuk pyet prej të lagurit, Guri. Por e ndiej për detyrë morale e shpirtërore të të porosit që, në vendimet e tua të ardhshme, të mos ndikohesh fare prej merakut për fatin tim. Kjo do të ishte pa kuptim dhe pa dobi për ty dhe një brengë për mua.

— Të kuptoj mirë, Hamit. Fati yt, i cili mund të ishte edhe i imi, është një arsye më tepër që u bashkangjitet arsyeve të shumta, të cilat po na përmendin nga letargjia. Janë rrethanat e reja që po krijohen në DSJ, të cilat na imponojnë një qëndrim të ri ndaj diktaturës. Përndryshe do të humbasim si sëpata pa bisht, siç thotë populli. Gjithsesi, këtu do të jemi dhe shpresoj se do të kuptohemi e do të sqarohemi edhe më mirë. Tani, mirëupafshim nesër!

Mirëupafshim, Guri!

XXI

RREZIKU I PËRBASHKËT NXIT BASHKIMIN

"*Të revoltohesh kundër tiranisë do të thotë t'i bindesh Zotit*."

T. Xheferson

Të nesërmen Meli filloi punën me brigadën e ndërtimit. Punohej për zgjerimin e sheshit në anën e sipërme të godinës së kampit. Lëvizej dhé me lopata e me karroca dore. Meli punonte bashkë me një të burgosur tjetër. Ish-detektivi mbushte karrocën me dhé, kurse ai tjetri e derdhte disa metra më larg.

Ata kishin rreth dy orë që po punonin, kur Streto nisi të shëtiste tutje-tëhu tek sheshi. Pasi bëri disa xhiro i vetëm, ai u afrua tek ata të dy dhe i përshëndeti. Kur karroca e dorës u mbush, ai i tha të burgosurit tjetër:

— Ulu shlodhu pak, se do t'i bëj unë disa rrugë. Na edhe një cigare.

Dhe i zgjati një paketë DS.

I burgosuri e falënderoi, mori cigaren dhe shkoi e u ul mbi një dërrasë disa metra më tej. Ndërsa Meli po mbushte përsëri karrocën, Streto filloi bisedën me zë të ulët:

— Vendimi i DSJsë për të të përgjuar ty në burg na befasoi. Asnjëri prej shokëve të kursit nuk pranoi ta merrte përsipër këtë mision. Ç'është e vërteta, *Dofeni* u tregua mjaft i matur dhe u përpoq të na bindte me arsyetim:

— Unë e kam parasysh pozicionin tuaj të vështirë karshi ish-shokut të kursit e të profesionit, por synimi ynë është dhe do të mbetet riaktivizimi i Melit në shërbimin tonë sekret dhe jo komplikimi i mëtejshëm i fatkeqsisë së tij. Ju vetëm do të vëzhgoni gjendjen e tij të përgjithshme nervore, shpirtërore e psikologjike, mbasi këta tregues, që lidhen me aftësinë apo paaftësinë e tij aktuale për detyrën e detektivit, nuk i përcaktojmë dot nëpërmjet kontrolleve mjekësore disaminutëshe, që ne mund të improvizonim tek të burgosurit e atij kampi. Ndërsa ju do ta vëzhgoni Hamitin për një kohë të gjatë, ditën dhe natën. Ky është qëllimi i vërtetë i misionit. Edhe në qoftë se do t'iu udhëzojmë për të siguruar ndonjë material kompromentues për të (dekonspirim të së kaluarës së tij, apo propagandë kundër pushtetit), kjo do të na vlejë vetëm si mjet trysnie për t'i imponuar pranimin e ofertës sonë e jo për të rrezikuar atë. Ju duhet ta kuptoni kaq gjë: në qoftë se ne do të donim ta sakrifikonim Melin, nuk do të kishim aspak nevojë për ndihmën tuaj. Mospranimin e tij do ta cilësonim "dezertim nga detyra", për të cilën shteti e ka shkolluar, dhe ligji do të bënte punën e tij pa ndihmën tuaj.

«Pasi e shqyrtova gjerë e gjatë këtë çështje me ca shokë të mirë, vendosa që ta merrja vetë përsipër misionin e vëzhgimit tënd në burg. Mendoj se nuk kam vepruar gabim, Hamit, si thua?

— Përkundrazi, ke vepruar shumë mirë. Do të kishte qenë gabim t'i linit rrugë të lirë ndonjë tjetri, i cili nuk do ta kishte aspak problem dëmtimin tim. Aq më tepër që po na krijohen mundësitë për të justifikuar diçka me punën tonë.

— Pikërsiht ky ishte qëllimi i vërtetë i ardhjes sime këtu. Me shokët besnikë që diskutova – të gjithë janë të vendosur për gjithçka – e analizuam kështu problemin: duke denoncuar misionin tim tek ti, unë do të rrezikoja jetën, ndërsa ti do të ishe thjeshtë dëgjues, ashtu siç ndodhi në realitet. Për ty, si profesionist, kjo do të shërbente si një provë bindëse, se qëllimi i ardhjes sime këtu ishte i kundërt me qëllimin e atyre që më nisën me mision. Nga ana tjetër, gjithë dokumentacioni sekret që pasqyron të shkuarën dhe të tashmen tënde na u vu në dispozicion. Ne e njihnim hollësisht qëndrimin tënd të vendosur në hetuesi e në burg dhe nuk dyshonim aspak në ndershmërinë dhe besnikërinë tënde. Pavarësisht se unë e fillova bisedën me ty duke të pyetur: "Je Hamiti që ke qenë, apo jo?", e dija qysh më parë se cili ishe ti në të vërtet. Pra, ti për ne ishe transparent. Ndërsa unë, për të siguruar besueshmërine tënde, e dorëzova maskën që më mbulon fytyrën dhe fola me ty si shok besnik, jo si misionar tinëzar.

«Dua të të bëj me dije, Hamit, se brutaliteti i regjimit diktatorial ndaj ty qysh ditën e arrestimit e deri sot ka qenë një mësim i madh për të gjithë ne, ish-kolegët e tu të profesionit. Gjersa ata keqtrajtuan në mënyrë aq të shëmtuar ty, detektivin më të aftë të shërbimit tonë sekret, pse do të na kursejnë ne të tjerëve, po t'ua lypë nevoja? Tekefundit ata mish për top na kanë përdorur gjithmonë ne. Ka shenja të qarta se e ardhmja jonë në DSJ nuk do të jetë pa probleme. Prandaj bashkëpunimi ynë është i domosdoshëm, për të përballuar surprizat e këqija që mund të na vijnë prej *Misionit të Madh*, të cilit ne deri sot i dimë vetëm emrin por jo objektivin dhe pasojat e tij. Të të njëjtit mendim janë dhe shokët besnikë, për të cilët të fola pak më lart. Ata më kanë autorizuar ta diskutoj këtë çështje me ty dhe t'iu transmetoj atyre mendimin tënd.

— Unë jam një i burgosur i sëmurë, aktualisht midis dy zjarresh: nga njëra anë burgu, nga tjetra DSJ. Jeni ju që rrezikoni shumë më tepër nga unë, miqtë e mi. Transmetoju kolegëve besnikë mirënjohjen time të thellë dhe gatishmërinë për të dhënë jetën pa ngurrim në luftë përkrah tyre.

Dy profesionistët e regjur të shërbimit sekret shkëmbyen një shikim kuptimplotë që zëvendësonte nënshkrimin e një traktati.

XXII

VIZITORËT E NATËS

"*«Po» dhe «jo» janë fjalët më të shkurtra e më të thjeshta për tu shqiptuar dhe ato që kërkojnë më tepër vëmendje e kontroll*."
Taleirand

Ditët rridhnin dhe Meli me Streton nuk linin rast pa shfrytëzuar për të biseduar me njëri-tjetrin. Ndërkohë ndërlidhësi e kishte shqetësuar nja dy herë kalimthi Melin për çështje të punës, por ai ia kishte prerë shkurt, se nuk do të pranonte asnjë lloj pune tjetër, veç asaj që po bënte.

Më 14 tetor ndërlidhësi e takoi përsëri Melin. Ky, pa e lënë fare të shprehej, reagoi i nervozuar:

— A të kam thënë të mos më shqetësosh, pa autorizimin e qendrës?

— Me autorizimin e saj po të shqetësoj sot – ia ktheu ndërlidhësi, pa e prishur gjakun. – Sonte do të kesh takim me dy të dërguar të qendrës këtu, në kamp. Orën do të ta njoftoj më vonë – shtoi ai, duke i kthyer krahët.

Pasdite Streto e takoi kastile Melin. Në orën 14 DSJ e kishte njoftuar me radiogram, se në mbrëmje Meli do të zhvillonte një takim zyrtar në kamp.

Me atë rast Streto i bëri të ditur një fakt interesant Melit. Pavarësisht se ai hante e flinte bashkë me të burgosurit (një normë e detyruar për misionin), Streto dispononte privatisht një dhomë komode, çelësin e së cilës e mbante kartelisti i kampit. Ajo ndodhej në të njëjtën godinë me infermierinë e kampit, por në anën e kundërt të saj, në katin e dytë. Hyrjen e kishte nga ana e pasme. Në orën 9 paradite dhe në orën dy pasdite, Streto e gjente këtë dhomë të mbyllur pa çelës. Në këto orë ai lidhej me qendrën me radiogram. Në një frigorifer Streto gjente sende ushqimore me vlerë, fruta, pije freskuese dhe një substancë të posaçme për të hequr prej gojës aromat e artikujve që konsumonte.

Gjatë r*evistës* t*elevizive* të orës njëzetë (shikimi i së cilës ishte i detyrueshëm për të gjithë të burgosurit), Streto iu afrua me kujdes Melit, që qëndronte në këmbë në fund të mensës ku ishte vendosur televizori. Ai e njoftoi se pas dy orësh Meli do të takohej me drejtorin e Sigurimit të Shtetit dhe me një përfaqësues të Sigurimit të Komitetit Qendor të PPSH. Pas këtij takimi, ish-detektivit i ishte rezervuar një surprizë (e cila nuk do të ishte më e tillë pas njoftimit të Stretos): Meli do të takohej me nënën, Dariun – vëllanë ish-të arratisur – dhe vajzën e vetme, Sonilën.

*

Ndonëse detektivëve të DSJsë nuk u lejohej të krijonin familje përsa kohë zhvillonin aktivitet jashtë shtetit (deri në moshën 38 vjeç, të paktën) Meli bënte përjashtim edhe në këtë fushë të jetës. Kur kishte qenë në kulmin e aktivitetit si

detektiv, ai ishte dashuruar me një mjeke të re bjonde nga Korça. E quanin Florika. Pas një viti kishin pasur një fëmijë: një vajzë të bukur me tiparet e kombinuara të babait brun dhe të mamasë bjonde. Meqenëse Florika ishte e mbesa e Mihallaq Ziçishtit, ky kishte ndërhyrë energjikisht tek ministri i Brendshëm i kohës, me të cilin kishte miqësi, me qëllim që mjekja e re të martohej me detektivin e shquar. Me një vendim të posaçëm, Melit iu njoh e drejta e krijimit të familjes para kohe. Atë natë tetori 1983, pas mëse dy vjetësh pa e parë babanë, sytë e pafajshëm të Sonilës së vogël do të shihnin atin plangprishës.

*

Ndërlidhësi e njoftoi Melin se takimi do të zhvillohej në godinën e madhe përballë kampit, jashtë rrethimit të tij. Atje ndodheshin zyrat e komandës së kampit, mensa, fjetoret, dhe mjediset e tjera jetike të oficerëve, policëve dhe ushtarëve të repartit që mbikqyrnin kampin. Takimi parashikohej të fillonte rreth orës 22 e 30 minuta, kur turni i tretë ishte nisur për në punë, ndërkohë që turni i dytë e kishte lënë punën, por akoma nuk ishte kthyer në kamp. Kjo ishte periudha më e qetë e natës në ambientet e kampit, mbasi turni i parë shtrihej detyrimisht për gjumë në orën nëntë të darkës dhe jashtë nuk lejoheshin më lëvizje.

Ndërlidhësi e kishte dyshekun gjithashtu në "maune". Në orën e caktuar, kur të gjithë të burgosurit flinin, ndërlidhësi e goditi tri herë Melin tek këmbët. Ky ishte shtritur i veshur dhe pas pak filloi të zbriste ngadalë prej krevatit, për të mos shqetësuar të tjerët. Tek dera e jashtme e priste ndërlidhësi.

Për çudinë e ish-detektivit, ai e çoi tek dera e bibliotekës së kampit Melin. E hapi atë me çelës dhe nxori prej një sirtari të mbyllur po me çelës dy uniforma oficerësh. Njërën ia zgjati Melit, duke i thënë: "vishu shpejt!"

Pasi u veshën ushtarakë të dy, dolën e u drejtuan për tek porta e kampit, ku ndodhej oficeri i rojës. Jashtë nuk dukej asnjeri; madjé as polici i shërbimit të brendshëm. Vetëm atëherë e kuptoi Meli arsyen pse ishte kartelisti oficer roje atë ditë. Ky i shoqëroi deri jashtë portës së madhe të kampit. Mandej ata u drejtuan për tek zyrat e komandës. Si u ngjitën në korridorin e katit të dytë, ndërlidhësi e çoi Melin deri tek një derë afër fundit të korridorit. Si i tha: "hyrë këtu!", ai hapi derën dhe vetë u tërhoq pas.

*

Ish-detektivi u gjend në një dhomë të pajisur mirë, me një tavolinë të madhe në mes dhe me kolltuqe rreth saj. Aty kishin zënë vend dy burra të mirëmbajtur, rreth të pesëdhjetave secili. Me të hyrë Meli brenda, ata u çuan në këmbë. Drejtori i Sigurimit të Shtetit e përshëndeti i pari:

— Si je, shoku Hamit?

— Nuk jam “shoku Hamit”, por i burgosuri politik Hamit Meli, i dënuar me 17 vjet heqje lirie dhe me punë të rëndë të detyruar – u përgjigj sa serioz aq edhe i vendosur ish-detektivi.

Për një çast drejtori u prish në fytyrë, pastaj rimori fjalën:

— Sidoqoftë, ne nuk e mohojmë të kaluarën tënde të shkëlqyer, si detektivi më rezultativ i shërbimit tonë sekret. Njerëzit edhe gabojnë, por kjo nuk e përligj mohimin e tyre. Aq më tepër ndonjë rast si i yti. Veprimtaria jote e suksesshme në Sigurimin e Jashtëm të Shtetit është krenari për DSJnë. Për ato faqe të ndritura të misioneve të realizuar me sukses, shteti të është përherë mirënjohës.

— Nuk është nevoja ta shprehni me fjalë “mirënjohjen” tuaj ndaj meje. Ju atë e keni treguar me vepra gjatë hetuesisë speciale, si edhe gjatë vuajtjes së dënimit në këtë kamp pune të detyruar.

— Nuk u fillua mirë biseda – ndërhyri përfaqësuesi i Sigurimit të KQPPSH. – Respekti që ne tregojmë karshi ty, Hamit, është i ndërgjegjshëm. Ne nuk e manifestojmë atë as për etiketë e as për hipokrizi mashtruese. Ne jemi profesionistë dhe ylli i dikurshëm i shërbimit tonë sekret na imponon vetvetiu respekt, pavarësisht se në ç'pozitë shoqërore ndodhet ai aktualisht.

— Ylli im ka përfunduar prej kohësh. Përmendja e asaj të kaluare, në kushtet në të cilat ndodhem unë sot, ka ngjyrat e një qesëndie.

— Ky nuk është gjykim i drejtë – foli përsëri drejtori i Sigurimit. – Ti ndofta mund të presësh shumë gjëra të padëshirueshme nga ana jonë, Hamit, por qesëndi jo, kurrën e kurrës. Përkundrazi, bilanci i misioneve të realizuar nga ti, gjatë kohës që ke ushtruar profesionin e detektivit, përbën një rekord absolut në analet e shërbimit tonë sekret. Megjithëse ke milituar vetëm gjashtë vjet në Sigurimin e Jashtëm, shifrën e misioneve që ke realizuar ti jo vetëm që nuk e ka barazuar dot asnjë detektiv, por as nuk i janë afruar sa duhet; as ata që kanë dyfishin e stazhit tënd në aktivitet.

— Ajo i përket së shkuarës. Një të shkuare që nuk ka asgjë të përbashkët me të tashmen time.

— E shkuara dhe e tashmja e çdo personi janë të pandashme, Hamit.

Duke thënë këto fjalë, ai i zgjati Melit një paketë DS.

— Faleminderit, por unë nuk i pi ata – ia ktheu Meli dhe e ndezi nga paketa e tij *Partizani*.

— Mos e do me të dredhur? Kemi edhe ashtu – i tha drejtori duke nxjerrë një kuti të bukur duhani nga xhepi.

— Jo, jo, ju faleminderit. Nuk e ndërroj duhanin, se më shkakton kollë. Pi vetëm nga këta cigare gjithmonë.

— Edhe nga ata kemi ne – i tha përfaqesuesi i Sigurimit të Komitetit Qendror, duke nxjerrë nga xhepi një *Partizani* tip tjetër. – Ndize këtej, të paktën.

— Njësoj është; unë e ndeza tani – u përgjigj i qetë Meli.

Ai e kishte ndarë mendjen të mos pranonte asgjë prej tyre, nga frika e ndonjë kurthi, për ta tërhequr pastaj pa ndjenja në Tiranë.

*

Për disa minuta po sundonte një heshtje e thellë. Atë e theu zëri i drejtorit:

— Pavarësisht se biseda mori një rrjedhë që i largohet disi boshtit qendror të temës, çdo debat me ty, Hamit, është i dobishëm. Ne na duhet të njohim sa më mirë mentalitetin tënd të sotëm, pas vuajtjeve të pësuara në hetuesi e në kamp. Por, natyrisht, para së gjithash, ne na intereson të dimë gjendjen tënde shëndetësore: si ndihesh fizikisht, Hamit?

— Lexoni raportin që ka lëshuar mjeku pas hetuesisë speciale në Tiranë dhe do ta keni të qartë, se cila është gjendja ime e vërtetë shëndetësore. Ajo është një përgjigje specialisti me shkrim për pyetjen tuaj.

— I kemi lexuar dhe analizuar relacionet shkresore që përmende. Përsa i përket trajtimit të keq, që të është bërë në hetuesi, jemi të ndërgjegjshëm se do të të mbetemi boxhlinj: nuk ta kompensojmë dot këtë. Por edhe ti mund t'i kesh shtetit borxhe në ndonjë drejtim tjetër. Prandaj është mirë që, për interesat e larta të popullit dhe të atdheut, t'i lëmë mënjanë borxhet dhe të merremi vesh midis nesh për atë që kemi ardhur. Ta vemë theksin tek gjërat që na bashkojnë, jo tek ato që na ndajnë; kjo do të jetë rruga më e dobishme për të dy palët.

— Ka borxhe që nuk harrohen aq lehtë – tha Meli me një pamje të zymtë në fytyrë.

— Sidoqoftë, ne nuk duhet të prishemi kurrë midis nesh për një "po" ose për një "jo". Të themi të drejtën, ne nuk e presim nga ti sonte "jo-në". Ne të bëjmë thirrje të angazhohesh në misionin më të madh e më të rëndësishëm që ka organizuar ndonjëherë shërbimi ynë sekret, relativisht i ri por jo pa përvojë. Shoku Ilir na ka porositur të të themi që të mos na kthesh përgjigje përfundimtare sonte, në qoftë se ajo anon nga "jo-ja". Ai dëshiron shumë që të takoheshit qysh nesër në Tiranë bashkë, por edhe po ndodhi ndryshe, shoku drejtor i DSJsë nuk rri pa ardhur të të takojë vetë këtu.

— Edhe unë do të dëshiroja të takohesha me shokët e mi dhe me atë vetë në Tiranë, por për plotësimin e kësaj dëshire nuk disponoj më mundësi. Unë kam mbaruar përfundimisht edhe si njeri i zakonshëm, pa le më si detektiv.

— Në qoftë se e ke fjalën për arsye shëndetësore, ne nuk do të kursejmë asgjë për të të kuruar kudo që ta lypë nevoja. Në rast se ty të mungon vullneti për tu riaktivizuar në shërbimin tonë sekret, si pasojë e ndonjë këndvështrimi të ri të problemeve tona politike, atëherë kjo është një çështje tjetër, mjeku i së cilës jë vetëm ti. Por për asnjë çast nuk duhet të harrosh të kaluarën e familjes dhe, veçanërisht, të kaluarën tënde.

Në kohën që drejtori i Sigurimit të Shtetit përfundoi ligjëratën e mësipërme, personi tjetër kishte përgatitur kafetë në një paisje të posaçme dhe i ofroi një filxhan Melit. Ky nuk e mori. Mospranimi i kafesë i indinjoi dukshëm të dy zyrtarët e lartë. Vetëm kjo sjellje e ish-detektivit fliste më tepër se gjithë fjalët e tij.

Duke refuzuar kafenë, Meli iu përvesh pjesës më të vështirë e më vendimtare të mbrojtjes së tij: kundërshtimit të akuzës së tërthortë të drejtorit të Sigurimit të Shtetit, se pikëpamjet politike të ish-detektivit kishin ndryshuar nën ndikimin e torturave në hetuesinë speciale dhe prej kontakteve me të burgosurit politikë në kamp. Me këtë objektiv të qartë, Meli iu kundërvu aludimit të drejtorit:

— Vullneti për të milituar në radhët e shërbimit sekret shqiptar mua nuk më ka munguar asnjëherë. Ju vetë pohuat pak më parë, se shifra e misoneve të mi të realizuar me sukses nuk është arritur akoma prej detektivëve të DSJsë. Edhe sikur të supozohet për një çast, se mua më mungon aktualisht vullneti për të milituar përsëri në ato organe, nuk duhet të pranohet kurrsesi nga një logjikë e shëndoshë, se mua më mungon vullneti për të jetuar. Në qoftë se do të ishte kështu, unë nuk do t'i duroja me vetëmohim vuajtjet e mëdha të hetuesisë e më pas ato të burgut. Unë nuk jam miop e as utopist, që të filloj tani ristrukturimin tim ideologjk e politik, ndërkohë që me emrin tim lidhet një e kaluar e tillë, një fragment i së cilës do të mjaftonte për t'i bërë të padobishme përpjekjet e mia donkishoteske për rehabilitim.

Duke dëgjuar Melin të fliste në këtë mënyrë, dy mysafirët e natës, shumë të vëmendshëm, nuk po ia ndanin sytë. Ata i kthenin vetëm nganjëherë mekanikisht filxhanët e kafesë. Zyrtarët e lartë të Sigurimit po konstatonin se *gjahu* i tyre, pas orvatjeve të dëshpëruara për tu fsheshur nëpër shkurret pa rrënjë të justifikimeve të kota, iu ekspozua më së fundi i zbuluar synimeve të tyre. Dhe *gjahtarët* e regjur nuk ngurruan aspak për të tërhequr këmbëzën e çiftes. Me të mbaruar fjalën Meli, drejtori i Sigurimit të Shtetit, i bindur për gjendjen e pashpresë të të burgosurit për t'i qëndruar besnik mospranimit të fillimit, e mori fjalën i sigurtë në triumfin e tij.

XXIII

«NË EMËR TË POPULLIT» — KUNDËR POPULLIT

"*Despotët flasin në emër të popullit,*
shtetarët përparimtarë flasin në emër të ligjit."
Sh. Anvar

— **M**ë vjen vërtet mirë, Hamit, që gjendja jote shëndetësore, i sëmurë e i stresuar, nuk ta ka dobësuar fuqinë e mendimit. Ky është sukses për ty në radhë të parë, dhe në rastin konkret, edhe për ne që e kemi marrë këtë rrugë në emër të interesave të larta të popullit. Në saje të gjykimit tënd të kthjellët, edhe ne e kemi më të lehtë komunikimin dhe mirëkuptimin reciprok. Nuk po e fsheh: u habita e u emocionova tek të dëgjoja të analizoje aq drejt të kaluarën dhe të tashmen tënde. Kjo është në të mirën tonë të përbashkët. Cili do të ishte fitimi ynë, sikur ti të ngeleshe në burg, vetëm pse gabove një herë? Po sa herë e ke rrezikuar ti jetën në lulen e rinisë, për të realizuar misionet e shumtë që të janë ngarkuar? Do të ishte një humbje e madhe shoqërore dhe një dhimbje shpirtërore për ne sonte, si profesionistë dhe si njerëz, të të kthenim krahët e të largoheshim, pa rënë në ujdi për të mirën e përbashkët.

«Duke folur hapur me ty, po të pohoj se mendja na shkonte nganjëherë për keq. Ndofta burgu, me vrazhdësinë e tij të natyrshme dhe elementin heterogjen që e përbën, mund të kishte ndikuar negativisht në mentalitetin tënd. Kjo do të kishte qenë humbje për të dy palët. Prandaj ndjehemi të kënaqur që në thelb të bindjeve të tua nuk je influencuar nga ndonjë ideologji e kundërt me tonën. Jashtë këtij rreziku, ne do t'ia falim borxhet që i kemi njëri-tjetrit. Për ne ti mbetesh gjithmonë ashtu siç të fola në fillim: shoku Hamit. Edhe ne për ty duhet të mbetemi ata që kemi qenë përherë: shokë armësh të babait tënd dhe të tutë. Prandaj ne dëshirojmë me gjithë zemër që rrugën për në Tiranë ta bëjmë së bashku.

Duke pirë cigare në heshtje, Meli e kishte dëgjuar me vëmendje ligjëratën e drejtorit të Sigurimit. Kur ky heshti, ish-detektivi mori fjalën:

— Dëshira juaj është edhe imja. Por unë nuk ia lejoj dot vetes të vij në Tiranë si figurant, në një kohë që shërbimi ynë sekret i është përveshur punës për realizimin e një misioni sa të rëndësishëm, aq edhe të vështirë. Sistemi im nervor është dëmtuar rëndë prej seancave të elektroshokut, kurse reflekset e mia profesionale ekzistojnë vetëm në kujtimet e së kaluarës. Tani unë e tradhëtoj veten edhe në gjumë: flas përçart pikërisht atë që ruaj si sekret në ndërgjegje. Edhe sikur të shpresoja në një mjekim të suksesshëm të koleksionit të sëmundjeve patologjike në organizmin tim, asnjë ndërhyrje mjekësore nuk mund ta normalizojë më sistemin tim nervor; unë e ndiej këtë. Për këto arsye, do të ishte naivitet nga ana ime që, i nxitur nga dëshira e madhe që kam për tu rikthyer pranë shokëve dhe detyrës së mëparshme në DSJ, të mos marr parasysh mundësitë e mia aktuale. Vlerësimi objektiv i raportit dëshirë-mundësi, më

detyron t'ju bëj të ditur me keqardhje, se për mua është përfundimisht i pamundur rikthimi në DSJ dhe rifillimi i detyrës së detektivit.

Tek dëgjonin me vëmendje Melin të fliste në këtë mënyrë, dy mysafirët e lartë po provonin një zhgënjim të paparashikuar disa minuta më parë. Veçanërisht fjalët e fundit të ish-detektivit, të shprehura me tonin e një deklarate të qartë e të prerë, shkaktuan tek ata një shqetësim të tillë, që dy zyrtarët e lartë nuk arritën ta fshihnin dot.

Drejtori i Sigurimit të Shtetit lëvizi mbi kolltuk me nervozizëm dhe ndezi cigare. Pastaj i tha kolegut të tij: "e shikon!", dhe iu drejtua i indinjuar të burgosurit, pa e fshehur revoltën:

— Kësaj i thonë, *fjalë mos prish e punë mos mbaro*. Fillimisht ne mendonim se ndoshta vuajtjet në hetuesi e në burg ta kishin dobësuar arsyen, për të parë dritën e së vërtetës. Por jo, qenkemi gabuar rëndë. Ti jo vetëm që di ta dallosh lehtë të vërtetën në dritën e saj, por arrin të bësh edhe më tepër se kaq: shikoke edhe në errësirën matanë kësaj drite, duke dalluar, me sa duket, feksjen e një të vërtete në lindje e sipër. Shumë bukur e trajton problemin tënd nën dritën e realitetit tonë dhe këtë e përdor si maskë, për t'iu përkushtuar pastaj shpirtërisht anës tjetër të medaljes: asaj që fillon, sipas teje, matanë horizontit të epokës tonë. Duke shprehur gjithë atë gjoja dëshirë për tu rikthyer në DSJ, ti paske vetëkonstatuar degradimin tënd nervor e profesional! A mos vallë, Hamit Meli, ëndërron të bëhesh *hero i dy epokave*, po pati tjetër veç tonës?

Sarkazma ishte sëmbuese, veçanërisht për nervat e acaruara të ish-detektivit. Ky u zverdh paksa dhe, pasi i hodhi një shikim të rreptë zyrtarit që kishte folur, ia ktheu pa ngurruar:

— Tregohuni pak më të kujdesshëm! Mos i merrni kaq të ngushta kthesat, se këtej nga Puka rrugët janë malore, me shumë kthesa e me dëborë. Pak më parë unë isha *shoku Hamit*, krenaria e shërbimit sekret shqiptar, ylli i DSJsë, shoku juaj i armëve në të kaluarën dhe që mund të bëhesha përsëri i tillë edhe në të ardhmen. Sa pak u desh që të përmbysej gjithçka!

«Përsa i përket teorisë *hero i dy epokave*, ja ku po ua them hapur: nuk do të dëshiroja kurrë të isha hero i tillë në asnjë epokë. Duke menduar të kaluarën time, mua gjithçka më lidh me realitetin e epokës që po jetojmë. Matanë këtij realiteti, unë e shikoj veten në bangon e të akuzuarit, për veprimtarinë time të suksesshme në radhët e shërbimit sekret shqiptar. Ju mund të mendoni si të doni për mua dhe të shpreheni me çfardo lloj fjalori ndaj meje. Kjo është puna juaj, ashtu sikundër është e drejta ime të mos marr përsipër një barrë që nuk e ngre dot, vetëm për t'ju bërë qejfin juve.

— Domethënë kjo është përgjigjja jote përfundimtare lidhur me thirrjen tonë? e pyeti përfaqësuesi i sigurimit të Komitetit Qendror.

— Po. Natyrisht, ju mund ta vazhdoni bisedën për këtë çështje, por përgjigjja ime do të mbetet e pandryshuar.

— Është për të ardhur keq që ti ngujohesh në kullën e kokëfortësisë tënde të mirënjohur. Megjithatë ne nuk mund ta vazhdojmë më tej këtë bisedë, kundër

dëshirës sate. Ndofta ti harrove, por ne të thamë qysh në fillim të bisedës se shoku Ilir na ka porositur të mos kthesh përgjigje përfundimtare negative, pa u takuar me atë vetë.

— Gjersa ju më kërkoni një përgjigje, unë jam i detyruar t'jua jap.

— Ne po e quajmë se nuk të kemi kërkuar përgjigje përfundimtare dhe po e mbyllim këtu këtë bisedë, duke e lënë të hapur diskutimin për herë tjetër.

*

Ndërkohë ata përgatitën përsëri kafe. Këtë herë vetëm dy filxhanë.

Drejtori i Sigurimit të Shtetit e ndryshoi temën e bisedës:

— Një shoku yt i ngushtë na ka thënë se dikur ke dashuruar me gjithë shpirt një studente nga Varshava. Dëshiron që të informohemi nëse është martuar apo jo?

— S'ka asnjë rëndësi më ajo çështje; histori e harruar.

— Sipas të dhënave që disponojmë, aq sa sukses ke pasur në realizimin e misioneve, po aq ke qënë i dhënë edhe pas femrave. Një grumbull i madh fotografish, që të kanë gjetur shokët e DSJsë e që tani ndodhen në arkivin tonë, dëshmojnë qartë se ke pasur marrëdhënie me femra prej shumë vendeve të Evropës. A mund të na thuash, cilat prej tyre të kanë pëlqyer më shumë?

— Eshtë një formë torture kjo, që më detyroni të kujtoj vitet e rinisë në jetën e lirë jashtë shtetit. Sonte për darkë unë kam ngrënë vetëm dy kokrra patate, se çaji nuk kishte fare sheqer – u përgjigj me një buzëqeshje të hidhur ish-detektivi.

— Si e keni ushqimin këtu? vazhdoi me pyetje drejtori.

— Të keq.

— Disa armiq të poshtër, që ndodhen në këtë kamp, nuk meritojnë ushqim më të mirë – u skërmit drejtori i Sigurimit.

— Nuk ka miq në një kamp pune të rëndë të detyruar – vërejti ish-detektivi.

— Sipas mendimit tënd, a ka njerëz të pafajshëm mes të dënuarve në kampin tuaj?

— Shumica.

— Gjithmonë sipas gjykimit tënd, sa persona mund ta meritojnë dënimin në këtë kamp?

— Maksimumi pesëmbëdhjetë vetë.

Ata buzëqeshën lehtë, u çuan në këmbë dhe drejtori i tha:

— Të faleminderit që na i le edhe pesëmbëdhjetë, të paktën. Ne do të dalim një copë here. Besoj se do të na jesh ndopak mirënjohës kur të kthehemi.

XXIV

BRENGOSJE

“*Zemra e një nëne është kryevepra e dashurisë*.”

Proverb francez

Disa minuta pas largimit të tyre, në dhomën ku gjendej Meli u futën nënë Rakibeja, Dariu dhe Sonila. Në qoftë se Meli nuk u befasua prej vizitës së të afërmve të tij – siç parashikonin dy zyrtarët e lartë të Sigurimit – kjo ndodhi për meritë të Stretos.

Meli hoqi kapelën e oficerit dhe e pushtoi nënën në krahë. Ajo filloi të ngashërehej dhe po i merrej fryma.

— Pse po vonohesh kaq ti babi, pa ardhur fare në shtëpi? e pyeti Sonila, ndërkohë që ai po e përqafonte.

— Do të vij së shpejti, vogëlushja ime – ia ktheu i ati.

— E, more, pehlivan, e bëre kurbetin, ë? i tha ai të vëllait.

— Lere, mos më fol, – u përgjjgj Dariu duke u skuqur.

Dy vëllezërit u takuan, pastaj u ulën të gjithë. Sonila foli e para:

— Mamaja më ka thënë që ti je në spital, po këtu nuk duket si spital, babi.

— Këtu ku po takohemi ne nuk është spital, por atje ku rri unë spital është.

— Po pse po takohemi natën bashkë?

— Që të mos na shikojnë të sëmurët e tjerë. Ata nuk kanë njeri t’iu vijë në takim dhe mërziten po t’ju shikojnë.

Ish-detektivi i bëri shenjë të vëllait të merrej me Sonilën, ndërsa ai vetë e përqafoi sërish nënën, duke i thënë:

— Kurajo, nënë! Tregohu e fortë, siç je në të vërtet. Mos harro që s'ke ardhur vetë këtu, për tu shmalluar me djalin, por të kanë sjellë të tjerë për qëllimet e tyre. Ndjenjat e tua si nënë ata nuk i shikojnë si bij nënash dhe lotët e tu i quajnë një tregues më tepër në favor të pazarit të tyre me këto ndjenja. Kam shumë nevojë të më kuptosh, nënë, prandaj po t'i them me dhimbje këto fjalë. Sonte nuk do ta kesh të lehtë një gjë të tillë, mbasi nuk është as momenti i përshtatshëm, për të të dhënë sqarimet e duhura. Për një gjë duhet të jesh e sigurtë: je njeriu më i shtrenjtë për mua dhe nuk do të ngurroja aspak për të bërë gjithçka të mundur për të plotësuar dëshirat e tua, që për mua janë të shenjta, veç kthimit në atë detyrë që më ka katandisur të neveris veten. Por, mjerisht, mua pikërisht kjo më kërkohet dhe më dhimbsesh sa unë e di, kur ta copëtoj zemrën duke të thënë: më fal, se nuk e bëj dot këtë. Ti jë nënë, dhe si e tillë, nuk duhet të pranosh që kthimi im në shtëpi të jetë rezultat pazarllëqesh të neveritshme.

Me instiktin e saj prej nëne, ajo e ndjeu vuajtjen e të birit në ato çaste të vështira dhe u përpoq t’i vinte në ndihmë:

— Unë të dua, bir, sa s'thuhet, dhe dëshiroj të të kem pranë sa më parë. Por punët e tua ti i di vetë. Nuk ka njeri qejf të rrijë në burg, por në qoftë se ta do

puna të mos pranosh që të lirohesh, edhe në burg ti nuk je i vetëm. Të gjithë nëna e të dashur kanë, kështu si ti; nuk kanë dalë prej gurit, Hamit.

Ai e shtrëngoi fort në kraharor dhe për disa çaste qëndruan ashtu në heshtje.

Dera u hap. Dy zyrtarët e lartë u futën në dhomë. Drejtori i Sigurimit të Shtetit iu drejtua Melit:

— Besoj se nuk bëmë keq që t'i sollëm të afërmit të shmalleshe me ta.

— Në qoftë se i keni sjellë për t'u shmallur me mua – ky është një qëllim i mirë – ia ktheu detektivi i burgosur. – Por në rast se nga prania e tyre prisni ndonjë lloj ndihme – ky është një mjet i keq.

Të dy zyrtarët buzëqeshën si me pahir. Përfaqësuesi i Sigurimit të Komitetit Qendror i tha nënë Rakibesë:

—Ne i duam të mirën Hamitit, sidomos kur ajo lidhet me të mirën e përbashkët. Por, si i thonë fjalës, ngandonjëherë njeriut edhe kur i thua "shëndet!", i duket sikur i thua "plaç!".

— Hamiti nuk ka pasur nevojë për këshillat e mia, kur ju e dekoronit për punën e tij të mirë – i tha nëna fytyrëvrenjtur. – Tani ai është më i pjekur në moshë dhe më me eksperiencë në jetë, ndërsa punët e tij janë aq të ngatërruara, saqë unë nuk kuptoj dot më asgjë prej tyre. Kur njeriu flet për një gjë që nuk e kupton dot, padashur thotë "plaç!", në vend që të thotë "shëndet!".

Zyrtarët e lartë buzëqeshën me pahir për të dytën herë brënda pak minutave. Pastaj drejtori i Sigurimit të Shtetit u tha:

— Tani takohuni, se duhet të ndahemi. Hamiti nuk pranoi të udhëtonim së bashku për në Tiranë.

Nuk foli më askush. Nëna i zgjati ish-detektivit dy çanta meshini plot me ushqime. Nga cilësia e bagazheve, Meli e kuptoi se ato nuk ishin të nënës, pavarësisht se ia jepte ajo. Ai nuk pranoi t'i merrte. Të dy zyrtarët u vrenjtën në fytyrë, por nuk folën. Nëna e dinte mirë që po të thoshte "jo!" Hamiti, ishte e kotë ta zgjasje me të. Ajo nxori nga njëra çantë një kuti me kafe të bluar dhe i tha me një ton lutës:

— Merr këtë, të paktën, të keqen nëna! E ka bluar nëna me dorë të saj, se e di që ti e do shumë kafenë.

— Më fal, nënë, por nuk mundem – u përgjigj ai i tronditur edhe vetë.

Duke futur përsëri kafenë e bluar në çantë, nëna qau, por nuk bëri zë. Ish-detektivi e shtrëngoi fort në krahë, e puthi disa herë, e i tha:

— Mos u mërzit, nënë; ti je e fortë dhe unë jam i ri. Ne do të jetojmë përsëri bashkë. Ki besim në fjalët e mia!

Nëna nxori një shami dore nga xhepi dhe ia dha të birit, duke iu lutur:

— Mos ma kthe këtë, shpirt' i nënës! Fshihu me të, sa herë të të marrë malli për mua. Unë do e ndiej çdo herë që ti do ta përdorësh.

— Faleminderit, nënë! Këtë shami unë do ta ruaj si një kujtim të çmuar.

Duke thënë këto fjalë, ish-detektivit iu drodh zëri dhe dy bula lotësh i dolën tek cepat e syve. Ai e dinte mirë se e ëma vuante nga zemra dhe nuk ishte i

sigurtë nëse do të takohej më me të, apo jo. Duke vënë re sesi po dridhej ajo para tij, Meli i fshiu sytë nënës me shaminë që sapo i dha dhe e përdori edhe vetë. Pastaj u përshëndet me të vëllanë, përqafoi Sonilën dhe doli.

Kishte kaluar ora tre e ditës së re. Ishte një natë e ftohtë tetori dhe toka kërciste nga çizmet e tij prej oficeri, tek po ecte pas ndërlidhësit për tu futur në kampin e përgjumur. Pas më pak se dy orësh do të bëhej zgjimi me çangë, e cila sinjalizonte fillimin e ciklit të ri 24 orësh të jetës plot mundime.

Si hoqi uniformën e oficerit, Meli u rikthye në *maune*. Duke parë të burgosurit që flinin, ai tha me vete:

«Vampirët që u takuan me mua nuk bëjnë dot kurrë gjumë kaq të qetë.»

U shtri pa u zhveshur dhe e zuri një gjumë i thellë prej shkrehjes nervore.

XXV

KOMPLOTI NGJIZET

“*Frika që i ka populli është një dërrasë e kalbur që thyhet nën këmbët e tiranit me rastin e parë*.”

F. Noli

Për çdo ditë Meli zhvillonte dy seanca bisedimesh me interes të psoaçëm: njërën me Streton, kur Diksi ishte në punë, dhe tjetrën me këtë të fundit kur ishte në kamp.

Ndërkohë Streto kishte filluar të dyshonte se Meli i kishte folur Diksit për sekretet e tij. Mirëpo kur ai ia hidhte me marifet fjalën për shokun e burgosur, Meli i linte të kuptonte se nuk kishte dëshirë të fliste për këtë çështje. Cili ishte shkaku? Kësaj pyetjeje Streto nuk i jepte dot përgjigje të plotë, ndonëse orientohej deri në një farë mase se çfarë e shtynte Melin të hezitonte për të folur lirshëm për shokun bashkëvuajtës. Mangësitë e përgjigjes së plotë të kësaj pyetjeje lidheshin me faktin se Streto e njihte vetëm fizikisht Diksin. Ndërsa ky, nga ana e tij, dinte gjithçka për Streton, por fizikisht nuk e njihte, mbasi ai vepronte me maskë në kamp.

Megjithatë, falë përvojës së tij të gjatë si detektiv, Streto e kuptonte se së shpejti do të binte kjo tabu e Melit dhe ky do t'i fliste lirisht për Sazanin. Dhe për këtë nuk gabohej.

Dy muajt e parë të *burgut* që kishte kaluar në Spaç e kishin lodhur shumë Streton. Ndërsa tani ai po ambientohej aq mirë, sa një ditë i tha Melit:

— Bisedat që po zhvillojmë në mjediset e këtij kampi më kanë joshur kaq tepër, saqë do të më vijë sinqerisht keq kur të shkëputem ndonjë ditë prej tyre. Ky qe një variacion i rrallë për mua. Më mësoi ca gjëra që njeriu nuk i mëson dot në asnjë universitet të botës dhe në asnjë mjedis tjetër shoqëror. Gjithashtu më ndihmoi të shkëputem përkohësisht nga shumë gjëra të oborrit qeveritar, të cilat e neutralizojnë të shijuarin e jetës si yndyra e tepërt në gjellë oreksin.

Sikur DSJ ta kishte parandier kënaqësinë që po përjetonte Streto në këtë shtegtim misterioz, ditët e fundit të tetorit atë e lajmëruan të kthehej në Tiranë "për çështje pune". Ky njoftim e dëshpëroi. Para se të largohej, ai i tha Melit:

— Më beso, tani më duket se po më privojnë nga jeta e lirë dhe po më fusin në burg. Në një farë mase, kështu është vërtet për mua. Në qoftë se këtu jam fizikisht "i burgosur", shpirtërisht jam i shpenguar dhe mendimet e mia të lira mund t'i diskutoj për orë të tëra me ty. Atje unë do të jem fizikisht i lirë, por, si gjithmonë, do të më duhet të mendoj ndryshe e të flas ndryshe. Ndrydhjet e përhershme të mendimeve e ndjenjave janë pranga në shpirt dhe për njeriun është më mirë të jetojë me pranga në duar, sesa me pranga në shpirt. Me shokët besnikë që kam atje na takon rrallë të ndodhemi vetëm për një kohë të gjatë e të

bisedojmë shtruar. Sidoqoftë, do të përpiqem që në vendin tim të vijë ndonjëri prej tyre. Nëpërmjet tij do të të vë në dijeni për gjithçka. Mirëupafshim, Hamit!

Të dy shokët u përqafuan të mallëngjyer. Ata nuk e kishin imagjinuar dot kurrë se mund të takoheshin ndonjëherë në burg. Dhe nuk i dihej nëse pas kësaj ndarjeje do të takoheshin më apo jo.

Largimi i papritur i Stretos dëshpëroi jo vetëm Melin, por edhe Diksin. Nëpërmjet tij, ata kishin mësuar shumë të reja për gjendjen e brendshme të vendit, për të cilat ishte në dijeni vetëm rrethi i ngushtë i pushtetit diktatorial.

*

Një javë pas largimit të Stretos, autoburgu solli një grup të burgosurish të rinj, Kishte edhe nga ata që ktheheshin nga spitali ose transferoheshin prej ndonjë kampi tjetër.

Në mbrëmjen e asaj dite, gjatë revistës televizive të orës njëzet, të cilën Meli e shikonte në këmbë prej fundi të mensës, iu afrua pranë një i burgosur i ri. Me sytë në ekranin e televizorit, ai i pëshpëriti Melit:

— Ke shumë të fala nga Guri. Më ka dhënë një letër dhe një fotografi për ty. Kur të mbarojnë lajmet, eja pas meje jashtë të t'i jap.

Pas lajmeve, Meli doli nga mensa dhe ndoqi personin që i kishte folur me zë të ulët. Ky u afrua tek stenda e afishimit të gazetës, e cila ndriçohej prej një llampe elektrike. Pa i shkëputur sytë nga gazeta e afishuar, ai i pëshpëriti Melit:

— Na lexoje letrën. Fotografinë, pasi ta shikosh, do të ma kthesh përsëri.

Meli shpalosi pusullën e vogël dhe lexoi:

I dashur Hamit,

Ashtu siç dëshironim, arrita të dërgoj aty shokun tonë të shkollës e të pikpamjeve – Afrim Pahia. Me të do të kaloni si jo më mirë. Jam "xheloz" për kënaqësinë që do të provoni. Për gjithçka të re do të të njoftojë Afrimi. Dëshiroj të takohemi sa më parë së bashku.

Të fala,

Guri

P–S. Për fotografinë nuk harrova.

Pasi lexoi letrën, Meli u përqendrua tek fotografia. Ajo paraqiste fytyrën e hijshme të një tridhjetëvjeçari mjaft simpatik, me flokët e zes të krehur anash me shije. Me sytë mbi fotografi, Meli buzëqeshi dhe murmuriti:

«E ka merituar nofkën *bukuroshi*, që i kishim ngjitur. Një fytyrë kaq e ëmbël, mbi një trup atleti 180 cm të lartë, është e pamundur të mos tërheqë vëmendjen e të tjerëve.»

Duke i kthyer fotografinë Pahisë, ai e pyeti:

— Guri të udhëzoi të më takoje në mencë gjatë revistës televizive?

— Po. Ai më ka folur me hollësi për gjithçka. Do të dëshiroja shumë që edhe bashkë të kalonim po aq mirë sa keni kaluar me Gurin.

— Patjetër; ndofta edhe më mirë, mbasi ti po e gjen terrenin të përgatitur për një gjë të tillë.

Pahia buzëqeshi i kënaqur. Meli e pyeti:

— Ku ta caktuan vendin e fjetjes?

— Në atë kapanonin me dërrasa, mbi tarracë.

— Ne të burgosurit pa maskë e quajmë *maune* atë kapanon. Kur e shikon të rrethuar nga të gjitha anët prej borës së ngrirë, i ngjan vërtet një mauneje që ka ngecur në mes të akullnajave,

— "Maunia!" përsëriti duke qeshur Pahia. Po për ku *lundron* kjo maunia juaj?

— Drejt Brigjeve të Lirisë. Megjithëse ajo vetë s'lëviz dot prej vendit, atë e çojnë peshë ëndrrat dhe shpresat e atyre që lëngojnë brenda saj.

Në këtë çast u dëgjua çanga për gjumë. Të dy shokët, veç e veç, u drejtuan për në *maune*.

*

Klima e ashpër e dimrit pukjan nuk e mori për mirë Pahinë. Qysh ditët e para ai u ftoh pak dhe e zuri kolla. Por, ndërsa me të ftohtin dhe ashpërsinë e klimës në tërësi ai po mësohej pak nga pak, ajo që e tronditi seriozisht ishte gjendja e paimagjinueshme e jetës brenda telave me gjëmba:

— Të shkretët njerëz, po si mund të kalohen vitet kështu? pyeste i trishtuar Melin.

— Jo vetëm vitet, por edhe dekadat – i përgjigjej ish-detektivi, i cili e njihte tashmë në majë të gishtave gjendjen në kampet e punës. – Vetëm në këtë kamp janë disa persona që kanë vuajtur mbi 20 vjet burg pa ndërprerje dhe kanë akoma vite të tëra për të bërë. E ka marrë krismën prej kohësh kjo punë, Afrim, por ti si dukesh, a u aklimatizove ndopak me egërsinë e këtyre maleve në dimër?

— Eshtë mjaltë egërsia e natyrës, në krahasim me egërsinë e njeriut – insistonte Pahia, i cili nuk çlirohej dot nga mbresat tronditëse të realitetit që po përjetonte. – Shikoi fytyrat e pagjak të të burgosurve të rrudhur e të thinjur para kohe! Shiko me çfarë zhelesh injoruese i kanë veshur dhe çfarë shfrytëzimi që u bëhet! Jo, jo, është më mirë ta vrasësh njeriun, sesa ta torturosh e ta poshtërosh në këtë mënyrë. Paskemi qenë prapa botës, Hamit, s'paskemi ditur gjë fare! Dhe e mbanim veten për oficera madhorë të Sigurimit të Jashtëm, duke qenë krejt të verbër për ç'ka ndodhte brenda!

— *Ai që bën poçin, di t'i vendos edhe vjegat*, thotë populli. Organizimi ka qenë i tillë që të mos merrej vesh se ç'bëhej matanë këtij gardhi të hekurt. Jo vetëm ne, që nuk na lidhte puna me çështjet e brendshme të vendit, por edhe drejtoritë e tjera të MP të Brendshme, veç asaj të Kampe-Burgjeve, nuk dinë sot më shumë nga sa dije ti, para se të hyje këtu**.**

— Si mendon ti, Hamit, vetëm merita e organizimit qeveritar është arsyeja e vërtetë e kësaj miopie shoqërore?

— Absolutisht jo. Për mendimin tim, faktori bazë është niveli kulturor. Kultura profesionale, kur nuk plotësohet me kulturë të përgjithshme, me kalimin e kohës ia kufizon horizontin njeriut brenda limiteve të profesionit, duke e shndërruar në një automat me aftësi të orientuara tërësisht në një drejtim. Atëherë vetvetiu je kthyer në një miop për mjedisin e mëtejshëm shoqëror.

«Në një shoqëri të ndërtuar për së mbari, një tip i tillë jeton i ndershëm e i qetë. Por në *mbretërinë e djallit* ky engjëll naiv është një kafshatë e imët për t'u kapërdirë. Një rol të rëndësishëm në këtë drejtim luan edhe tradita. Unë vetë, p. sh., i cilësuar *detektiv i klasit të parë*, kur erdhi puna, nuk arrita dot të arratisesha! u shpreh me një ton vetëpërbuzës Meli.

— Ashtu është, Hamit, ashtu – e aprovoi Pahia duke e avancuar linjën e arsyetimit të bashkëbiseduesit. – Ne tani në DSJ nuk arrijmë të kuptojmë se çfarë ka ndodhur konkretisht, që po organizonet me kaq ngut e përkujdesje ky mision i posaçëm, ndonëse do të jemi protagonistë të tij. Duhet ta pohojmë se me defekte të tilla në formimin tonë mbetemi borxhllinj si ndaj të tjerëve, ashtu edhe ndaj vetvetes.

Këtë bisedë ata të dy po e zhvillonin një mbrëmje të ftohtë, pranë një zjarri të vogël ndanë të sheshit, nga ana e sipërme e kampit. Meqenëse të burgosurve nuk u lejohej të hynin nëpër fjetore para orës nëntë të darkës, kur bënte shumë ftohtë komanda e kampit i lejonte të ndeznin zjarre të vegjël tek sheshi, me kusht që t’i fiknin mirë kur të largoheshin.

Ndërsa zjarri ku ata të dy po ngrohnin duart ishte në rënie, Pahia nisi t’i fliste ish-detektivit për dy ngjarje befasuese që kishin ndodhur në Tiranë, të cilat interpretoheshin si një shenjë e keqe për të ardhmen e tyre.

XXVI

MJEGULLNAJË…

"*Një popull i tradhtuar prej kreut të tij*
është një popull i flijuar në heshtje."
A. Shakur

Në pasditen e 17 qershorit 1983, DSJ ishte informuar për praninë e një agjenti të huaj në Tiranë. Nën komandën e Stretos, një grup detektivësh të shërbimit sekret u vu në gjurmim të tij, ndërkohë që rrjeti informativ i Sigurimit ishte në gjendje alarmi. Pas një pune intensive, grupi i detektivëve të komanduar prej Stretos kishte arritur ta konstatonte fizikisht agjentin. Duke e ndjekur me shumë vëmendje, ata po prisnin momentin më të përshtatshëm për ta arrestuar. Agjenti i huaj kishte hyrë në një lokal, ku ndodheshin dhe tre klientë të tjerë. Ai ishte ulur në një tavolinë të veçuar dhe kishte porositur një gotë verë.

Pas pak, ndjekësit e tij, të ndarë prej njëri tjetrin, u futën në të njëjtin lokal. Kur të gjithë kolegët e tij kishin zënë vend nëpër tavolina, Streto kishte shkuar tek banakierja. Pasi i kishte treguar dokumentin e posaçëm, ai e kishte porositur që t'iu bënte llogarinë përmbyllëse tre klientëve të parë, duke i njoftuar me mirësjellje se duhej të dilnin jashtë.

Mirëpo kur në lokal kishin mbetur vetëm detektivët shqiptarë dhe agjenti i huaj, ky i fundit u kishte bërë një surprizë të madhe. Ai kishte thirrur kamerieren dhe e kishte porositur t'iu çonte nga një gotë verë të gjithë klientëve të pranishëm, me përjashtim të Stretos.

Pasi e kishte pirë verën e tij, agjenti u kishte bërë sfidën e dytë detektivëve shqiptarë. Ai kishte shkuar tek tavolina e Stretos dhe me një shqipe të çalë i kishte thënë: *jam në dispozicionin tuaj*.

Gjatë procesit hetimor, ai kishte paraqitur dokumentet personale – agjent i KGBsë – dhe kishte dhënë shpjegimet përkatëse pse gjendej në Shqipëri. Meqenëse ishte nisur me mision në Greqinë veriperëndimore, ai ishte pajisur edhe me një pasaportë shqiptare, që ta kishte për çdo eventualitet. Ndërsa ishte duke kryer misionin në atë zonë kufitare me Shqipërinë, shërbimi sekret grek kishte rënë në gjurmët e tij. Për t'i shpëtuar arrestimit, ai kishte hyrë në Shqipëri. Duke përdorur pasaportën shqiptare, ai kishte fjetur pesë net në pesë hotele të ndryshëm të Tiranës. Meqenëse ai kishte hyrë në territorin shqiptar në rrethana vetëmbrojtjeje, pa kryer asnjë lloj veprimtarie antishqiptare, agjenti sovjetik pretendonte të lihej i lirë. Ky kriter respektohet prej shumicës së shërbimeve sekrete të botës, mbasi kryhen verifikimet përkatëse.

Mirëpo agjenti sovjetik vazhdonte të mbahej i izoluar edhe disa ditë pas shpjegimeve që kishte dhënë. Në këto rrethana, ai kishte kërkuar të takohej patjetër me ndonjë anëtar të kabinetit të ministrit të Brendshëm, por më kot. Vetëm pas një jave, ai kishte pasur një takim kokë më kokë me *Dofenin*. Pas këtij takimi, ai u la i lirë të largohej nga Shqipëria.

Me porosi të vetë *Dofenit*, agjentin sovjetik e kishin shoqëruar në aeroportin e Rinasit Streto me Pahinë. Në çastin që po ndahej me shoqëruesit e tij për të hyrë në avion, agjenti u kishte bërë sfidën e tretë detektivëve shqiptarë. Duke u paraqitur një dokument tjetër të shpalosur, ai u kishte thënë me shqipen e tij të çalë: «Ja se kush jam unë në realitet!»

Mbi dokumentin e shpalosur Streto dhe Pahia lexuan emrin e një agjenti anglez me famë botërore të viteve shtatëdhjetë.

Stretos i kishte rrëshqitur cigarja prej gishtave, ndërsa agjenti anglez i kishte thënë me një buzëqeshje domethënëse:

«Mos u mërzit, djalosh! Para meje u ka rënë cigarja përtokë shumë detektivëve me përvojë. Lutiu Zotit, të mos takohesh herë tjetër me mua!»

Më pas, Streto dhe Pahia e kishin analizuar me vëmendje ndodhinë e agjentit anglez. Disa pyetje mbeteshin pa përgjigje bindëse: Si ishte e mundur që agjenti anglez të kishte fjetur pesë net në hotelet e Tiranës, ndërkohë që shqipja e tij e cunguar e denonconte qartë nënshtetësinë e tij të huaj dhe hotelxhinjtë ishin të gjithë bashkëpunëtorë të Sigurimit? Nga e kishte marrë vesh ai se ishte pikërisht Streto komandanti i grupit të ndjekjes? Pse agjenti anglez u lirua menjëherë pas takimit vetëm për vetëm me *Dofenin*?

Tek dëgjonte Pahinë t'i përshkruante këtë ngjarje tronditëse, Melit iu kujtuan fjalët që i kishte thënë Streto gjatë bisedës së parë me të në kamp:

«Ka shenja të qarta se e ardhmja jonë në DSJ nuk do të jetë pa probleme. Prandaj bashkëpunimi ynë është i domosdoshëm, për të përballuar surprizat e këqija që mund të na vijnë prej *Misionit të Madh*, të cilit ne deri sot i dimë vetëm emrin, por jo objektivin dhe pasojat e tij.»

Por kishte edhe më …

*

Tre muaj pas ndodhisë me agjentin anglez, një ngjarje tjetër kishte tronditur shërbimin sekret shqiptar. Brenda një nate (duke u gdhirë 15 shtatori 1983) ishin vrarë nëpër shtëpitë e tyre pesë oficerë të DSJsë. Të pesë vrasjet ishin identike: me nga një plumb revolveri me silenciator në mes të ballit. Tre prej tyre kishin qenë të martuar. Atentatorët kishin përdorur ilaç gjumi të fortë, para se të kryenin vrasjet. Këtë e vërtetonte fakti që familjarët e viktimave kishin mbetur rreth 24 orë *në gjumë*. Sipas rezultateve të ekspertizës, atentatorët i kishin fshirë gjurmët e tyre me anën e një pluhuri të shpërndarë në dysheme, i cili lëngëzohej shpejt dhe zhdukte çdo shenjë.

Kjo ngjarje kishte mbjellë panik në DSJ. Cilët ishin autorët e këtyre vrasjeve në një qytet si Tirana, ku qarkullimi ndërpritej para mesnate?

*

Pas përshkrimit të këtyre dy ngjarjeve tronditëse, Pahia i tha Melit:

— Mos mendo se ne në DSJ e kemi jetën më të sigurtë sesa ti këtu, Hamit. Kurrsesi. *Misioni i Madh* fsheh një mister që qëndron si shpata e Demokleut mbi kokat tona. Pse na i fshehin neve objektivin e këtij misioni, gjersa do të jemi pjesëmarrës të tij? Kërcinimi i së ardhmes së panjohur na ka detyruar që të bashkohemi një grusht shokësh besnikë, për të mos shkuar si cjapi tek kasapi në *Misionin e Madh* misterioz. Jemi të lumtur që ti u bashkove me ne. Ky lajm i mirë që na solli Guri na gëzoi të gjithëve. Sido që të vijnë punët, të paktën do të kemi njëri-tjetrin.

Pahia i shtrëngoi dorën në errësirë Melit dhe u nis për në *maune*. Ish-detektivi u interesua të shuante edhe thëngjijtë e fundit që kishin mbetur prej zjarrit.

XXVII

MIDIS SË QESHURËS E TË QARIT

"*Mjerimi i paralizon të gjitha veprimtaritë njerëzore, pa përjashtuar as atë të mendjes*."
H. Luis Menken

I befasuar, Diksi ngriu në këmbë në prag të derës së fjetores. Meli, i ulur në një dyshek kashte të katit të parë të krevatëve, po qeshte me lot. Në pritje që shoku i tij t'i shpjegonte arsyen e këtij humori të rrallë, Diksi buzëqeshi edhe vetë. Gjithmonë duke qeshur me të madhe, Meli i tregoi me dorë dy të burgosur që po grindeshin me llafe pranë një dritareje të fjetores, prej nga dukej qartë një rostiçeri në buzë të lumit të vogël, që qarkonte anën veriore të rrethimit të kampit. Klientët e përhershëm të asaj rostiçerie ishin shoferët që transportonin mineralin e minierës për në Laç, si edhe oficerët dhe ushtarët e repartit që mbikqyrnin kampin e Qafë-Barit.

Një kameriere e re, e veshur me të bardha, i tërhiqte si magnet shikimet e të burgosurve të etur për jetë të lirë. E ndërgjegjshme për rolin e saj eksitues, kamerierja, kur ishte e ngeshme, ulej në karrige në krye të shkallëve para rostiçerisë. Nxirte një pasqyrë të vogël prej xhepit të përparëses së bardhë dhe fillonte të bënte tualet. Duke buzëqeshur, ajo fiksonte herë pas here shikimin e syve të zes tek dritarja më e afërt e fjetores përballë saj.

Kujt i buzëqeshte ajo? Të gjithëve dhe askujt. E sigurtë se në ato çaste ajo ishte objektivi i shikimeve të uritura të të burgosurve, kamerierja e re argëtohej duke luajtur rolin e saj sugjestionues. Të burgosurit e njihnin fizikisht të gjithë kamerieren, ndërsa ajo nuk njihte asnjërin prej tyre. Ata nuk dinin asgjë për jetën e saj private, ajo e dinte se të gjithë ata ishin të privuar prej jetës private, për të cilën veç mund të ëndërronin. Kamerierja e re shërbente si katalizator i atyre ëndrrave.

Kur nuk kishte klientë në rostiçeri, ajo shkonte ndanë të lumit për të mbushur ndonjë bidon ujë. Atje bënte sikur shpëlante këmbët, duke ngritur lart përparësen e bardhë. Ndërkohë shikimi i saj djallëzor përqendrohej tek dritarja më e afërt, pas së cilës kishte gjithmonë të burgosur që nuk donin ta humbisnin rastin e lumtur e njëherësh të mundimshëm.

Atë 7 nëntor të vitit 1983, Meli kishte hyrë në fjetoren e brigadës së Diksit, për t'i çuar gazetën *Sporti* nën jastëk. Pranë dritares *fatlume* (kjo ishte pika më e afërt e vrojtimit të objektit të dëshiruar), ai kishte parë dy të burgosur, të cilët po grindeshin me fjalë midis tyre. Meli kishte ndërhyrë për t'i qetësuar. Mirëpo kur kishte mësuar shkakun e grindjes, ish-detektivi kishte shpërthyer në të qeshura të papërmbajtura dhe ishte ulur në dyshekun e kashtës, ku e gjeti Diksi.

Cili ishte shkaku i grindjes? Secili prej dy të mjerëve përpiqej ta bindte tjetrin se kamerierja i buzëqeshte vetëm atij, prandaj ai duhej ta linte vetëm tek dritarja. Secili paraqiste *provat* e veta lidhur me përkatësinë e buzëqeshjeve.

— E qeshura me lot i shkon shumë kësaj skene për të qarë e për të qeshur, Hamit, – i tha Diksi shokut të tij, kur po dilnin jashtë.

XXVIII

FITORE PA TROFE

"Më mirë luaj me një këlysh luani, se me luanin plak që po jep shpirt."
W. Shekspir

Në pasditen e atij 7 nëntori ndërlidhësi e lajmëroi Melin se natën e ardhshme kishte një takim tjetër zyrtar.

— Pas lajmeve të orës 20, më prit tek stenda e shtypit të ditës – e porositi.

Meli kishte vetëm pak minuta që po priste tek stenda, kur aty erdhi ndërlidhësi dhe e orientoi për veprimet e mëtejshme:

— Do të nisemi qysh tani për në takim. Do të bëjmë sikur jemi duke shkuar në infermieri të kampit. Godina ka një hyrje tjetër nga prapa. Ti atje do të shkosh vetëm dhe do të ngjitësh shkallët. Në krye të tyre, do të gjesh një person tjetër, i cili do të të tregojë ç'duhet të bësh më tej.

Kur ish-detektivi ngjiti shkallët, në krye të tyre po e priste buzagas përfaqësuesi i Sigurimit të Komitetit Qendror, me të cilin ishte takuar para tri javësh. Ai e përshëndeti si i njohur i vjetër dhe e shoqëroi drejt një dere disa metra më tutje. Meli e mori me mend që takimi do të zhvillohej në dhomën e përdorur nga Streto, të cilën tani e përdorte Pahia.

Kur hyri në dhomë, Meli gjeti *Dofenin*, drejtorin e Sigurimit të Shtetit dhe një person të tretë që nuk e njihte. Të tre ata u çuan në këmbë dhe e takuan me radhë ish-detektivin.

Pasi u ulën, *Dofeni* e zbërtheu krejt xhuboksin bojë mjalti dhe nisi bisedën me një pyetje *limonadë*:

— Sa ditë ka që ka rënë kjo dëborë e madhe, Hamit?

— Rreth një javë – u përgjigj Meli.

Dofeni i ofroi një cigare *DS.* Ish-detektivi e mori dhe e ndezi.

— Ke ndonjë pakënaqësi për mënyrën e sinjalizimit nëpërmjet ndërlidhësit? qe pyetja e dytë.

— Për mënyrën e sinjalizimit nuk kam vërejtje, por për vetë ndërlidhësin, po. Më ka mërzitur, duke u përpjekur të më imponojë një vend pune që nuk më pëlqen.

— Gjë që rregullohet kollaj kjo – tha *Dofeni* me zë të qetë. – Rëndësi ka të arrijmë të merremi vesh për atë që duhet. Unë iu kisha thënë këtyre shokëve, kur erdhën për të të takuar para tri javësh, që të mos ktheje përgjigje përfundimtare negative, pa u takuar me mua. Natyrisht, me anën e kësaj porosie unë nuk doja t'i rezervoja vetes rastin e padëshiruar, që të jem i pari për të dëgjuar përgjigjen tënde refuzuese karshi ofertës sonë. Përkundrazi, unë nuk mendoj se ty të shkon ndërmend një përgjigje e tillë.

Meli nuk foli. Pas një heshtjeje të shkurtër, e mori fjalën drejtori i Sigurimit të Shtetit:

— Hamiti të krijon përshtypjen se nuk është kundër ofertës sonë, por nuk ka bindje në riaftësimin e tij – vërejti ai.

Pa pritur ndonjë përgjigje prej Melit, foli vetë *Dofeni*:

— Tipat si Hamiti janë të kursyer në premtime, mbasi premtimin e dhënë e quajnë borxh. Kjo besoj e bën të duket disi konfuz në marrjen e vendimit. Aq më tepër që ne, gjirokastritëve, na karakterizon kursimi në gjithçka. Apo jo, Hamit? – e pyeti ai.

Një fillim kaq i rafinuar i bisedës po e bezdiste ish-detektivin. Ai e dëgjonte me vëmendje çdo fjalë, por kishte vendosur të fliste sa më pak që të ishte e mundur dhe të argumentonte sa më mirë atë që do të thoshte. Pyetjes së *Dofenit*, ai iu përgjigj:

— Çdo njeri serioz, që flet me përgjegjësi e jo për mashtrim, e quan borxh premtimin e dhënë. Mua më bën konfuz në sytë tuaj bindja se nuk kam mundësi që të bëj premtimin e dëshiruar, si për ju edhe për mua vetë.

— E kam dëgjuar me vëmendje bisedën tuaj para tri javësh, e cila na erdhi e regjistruar në DSJ – i tha *Dofeni*. – Por dëshiroj t'i dëgjoj direkt nga goja jote sonte, se cilat janë konkretisht ato pengesa, që ti mendon se ta bëjnë të pamundur kthimin në DSJ.

Pasi Meli shtroi ankesat e tij të zakonshme, e mori përsëri fjalën *Dofeni*:

— Unë kam sjellë këtu njërin prej mjekëve tanë më të mirë. E vizitoni, ju lutem, – iu drejtua ai personit të tretë, që nuk kishte njohur ish-detektivi.

Mjeku nxori dy aparate nga çanta dhe i tha Melit:

— Zhvishu në mes e lart!

Pas një ekzaminimi të vëmendshëm, mjeku shpjegoi konstatimet e tij.

— Një gjendje shëndetësore mjaft e rënduar. Zemra nuk i funksionon mirë. Veshkat, veçanërisht e djathta, gjithashtu. Ndërkohë ka një dobësi të përgjithshme fizike, e cila ndikon në rënien e imunitetit organik.

— A mund të kurohet në këto kushte?

— E pamundur. Një provë e tillë do të sillte një shkallëzim të mëtejshëm të keqësimit të gjendjes.

— Duke pasur parasysh kushtet në tërësi të vuajtjes së dënimit në një kamp pune të rëndë të detyruar, cili është raporti i konsumimit organik të të burgosurit, krahasuar me kushtet e jetës së lirë? vazhdoi me pyetje *Dofeni*.

— Këtë përgjigje po jua jap i mbështetur në të dhënat e studimeve shkencore të kryera posaçërisht në vende të tjera. Një vit burg në këto kushte është i barabartë me katër vjet mplakje në jetën e lirë.

— Sa kohë punove në minierë ti, Hamit? iu drejtua *Dofeni* Melit.

— Dhjetë muaj.

Mjeku mori përsëri fjalën:

— Para se të niseshim për këtu, unë kontrollova raportin mjekësor të lëshuar pas përfundimit të hetuesisë speciale që ka kaluar Hamiti. Në bazë të tij rezulton se ai ka pësuar defekte të rënda organike.

— Sido që të jetë puna, ne nuk do të kursejmë asgjë për rigjenerimin tënd organik, Hamit, – i premtoi *Dofeni*. – Siç je vënë në dijeni, do të kurohesh në klinikat më të mira të botës për një periudhë kohore gjashtë deri në tetë muaj. Edhe pas kësaj, ne do të interesohemi posaçërisht për çdo kurë të re që mund të dalë në ndonjë vend me mjekësi të zhvilluar, e cila do të vlerësohet e dobishme për forcimin e shëndetit tënd, duke ta siguruar me çdo çmim.

«Përsa i përket trajtimit të pamerituar që të është bërë në hetuesinë speciale, ne jemi të ndërgjegjshëm që do të të mbetemi borxh. Le të të ngushëllojë sadopak fakti, që unë pak kohë kam që jam në korent të këtyre punëve. Kur ke qenë ti në hetuesi, unë nuk e kam ditur mirë se çfarë funksionesh kryente konkretisht shërbimi sekret i një shteti.

— Në qoftë se nuk e ke ditur ti, e dinin të të tjerët, – ia ktheu fytyrëngrysur ish-detektivi.

— Kjo është e vërtetë, Hamit, veç mos harro se pas spastrimeve të rëndësishme që u bënë në kryeministri dhe në M.P. të Brendshme, nuk e gjente dot kollaj guri vendin e tij.

Meli tundi kokën në heshtje. *Dofeni* zgjati dorën drejt paketës *Partizani* të ish-detektivit, mori një cigare dhe e ndezi.

— Si mendon Hamit, nuk do ta ndryshosh qëndrimin tënd? filloi të fliste me një ton tjetër drejtori i DSJsë. – Më vjen keq për këtë sjellje. Yt vëlla, Dariu, po punon mirë, megjithëse nuk është profesionist. Nuk kemi asnjë vërejtje në adresë të tij. Por pesëdhjetë si ai nuk na hyjnë në punë, sa ti vetëm. Na duhesh Hamit, na duhesh shumë, prandaj po të kërkojmë me kaq këmbëngulje. Mundohu t'i kuptosh mirë këto fjalë që po t'i përsëris. Jemi gati të të plotësojmë çdo kërkesë tënden. Shprehu pa ndrojtje për gjithçka, mjafton që të ndryshosh qëndrim, të kthehesh në DSJ. Duhet ta dish mirë, se bën gabim të rëndë në qoftë se të rritet mendja që po të lutemi. Në rast se kërkesën tonë e quan si një të keqe që të zuri derën (gjë që mua do të më dëshpëronte), atëherë përpiqu që midis dy të këqijava të zgjedhesh më të voglën.

— Qysh me sinjalizimin e parë nga ana juaj, e kam analizuar më së miri gjithçka. Nuk kam lënë pas dore as zgjedhjen midis dy të këqijave të mundshme. Të marr përsipër një detyrë që nuk e realizoj dot, do të thotë që të ballafaqohem me një dështim të sigurtë. Dështimi për një detektiv të dalë nga burgu fare lehtë mund të cilësohet si një sabotim politik. Në rrethana të tilla, e keqja më e vogël për mua është shmangia nga përgjegjësia e një detyre, që i tejkalon mundësitë e mia aktuale.

— Kjo shmangie nga detyra, siç të pëlqen ta cilësosh ti, në një kohë që po të bëhet e qartë se shteti ta ka shumë nevojën, nuk është asgjë më pak se një dezertim - ia priti me ton të prerë *Dofeni*.

— Nuk është dezertim, por tërheqje për paaftësi – tentoi të mbrohej Meli. – Normalisht e drejta për një tërheqje të tillë duhej të më njihej edhe para rënies në burg.

— Klasifikimin juridik të këtyre veprimeve e bëjnë ata që interpretojnë ligjet, jo kushdo, – i tha gjithë seriozitet *Dofeni*.

Meli nuk foli.

Deri në atë çast kishin pirë nga dy kafe të shoqëruara me një gotë pije me ngjyrë. Ish-detektivi nuk kishte refuzuar asgjë, me përjashtim të gotës së dytë të pijes.

Shefi i gjithëpushtetshëm i DSJsë i bëri një propozim:

— Siç e more vesh prej fjalëve të mjekut, ne nuk të kurojmë dot në kushtet e vështira të këtij kampi pune. Nga ana tjetër, ti nuk po vendos që të kthehesh përsëri në gjirin tonë. Prandaj jam i mendimit që të të lirojmë prej burgut me këtë kusht: të të gjejmë një punë të mirë në Tiranë dhe të vish në DSJ vetëm dy herë në muaj. Kjo s'të prish ndonjë punë besoj.

— Gjersa unë nuk jam në gjendje t'jua plotësoj dëshirën sipas kërkesës fillestare, nuk dua të më bëni asnjë lloj privilegji.

— Shëndeti është domosdoshmëri në jetë, Hamit. Si të jesh pro nesh apo kundër, ti nuk mund të realizosh asgjë pa shëndetin. Prandaj mospranimi yt në këtë rast, nuk më duket i bazuar në arsye.

Meli nuk polemizoi.

*

Dofeni s’po ia ndante sytë ish-detektivit të pabindur; ky gjithashtu.

Ky duel shikimesh, i frymëzoi subjektin e vazhdimit të bisedës drejtorit të DSJsë:

— Gjatë bashkëbisedimit me ndërlidhësin, ti i kishe bërë një pyetje, për të cilën ai nuk ishte i autorizuar të të përgjigjej. Përgjigjen po ta jap unë tani. Sitemi organizativ i shtetit tonë parashikon kuadro të zgjedhura prej organeve përkatëse dhe kuadro të emëruara nga lart, për merita të veçanta. Karriera e nënës sime i përket kategorisë së dytë që përmenda.

— Unë ia drejtova atë pyetje ndërlidhësit, mbasi e njihja nënën tënde si drejtoreshë të Institutit të studimeve marksiste-leniniste, por jo me pushtet në shërbimin sekret shqiptar.

— Nuk është e thënë që ti t’i dish të gjitha, vetëm pse ke milituar gjashtë vjet në radhët e DSJsë, – ia ktheu Dofeni me një ndjenjë të kuptueshme nënçmimi.

Për shkak të kësaj përgjigjeje të thartë, Meli ndjeu kënaqësi që kishte vendosur paraprakisht t’i fliste me “ti” e jo me “ju” *Dofenit*. Si për t’ia përforcuar bindjen në vendimin e drejtë që kishte marrë ish-detektivi, drejtori i DSJsë i bëri një pyetje që nënkuptonte vetëvlerësim:

— Meqenëse jemi bashkëmoshatarë, a të kujtohet të më kesh parë në Tiranë, Hamit?

— Po. Në vitin 1969 ke ardhur një natë në qytetin *Studenti* me djalin e Mehmet Shehut. Kishte mjaft roje rreth lokalit ku u futët ju, prej nga dëgjohej muzikë e huaj, e ndaluar për ne të tjerët.

Dofeni buzëqeshi, tundi lehtë kokën e i tha:

— Lëvizje të tilla i kam pasur të rralla, prandaj më kujtohet ajo natë. Festonim ditëlindjen e një shoku nga Korça. Meqë ra fjala, po ti, Hamit, e feston ditëlindjen këtu?

— Fatkeqësitë që më kanë zënë derën nuk më lejojnë të kem respekt e dashuri për ditën që më solli në këtë botë të mundimshme.

— Vlera e jetës nuk nënçmohet, në të gjitha rrethanat. Por që ta gëzosh atë, duhet shëndeti në radhë të parë, pastaj fati. Një njeri i sëmurë nuk mund ta gëzojë jetën, çfarëdolloj kushtesh të mira të ketë. A i dëgjove fjalët e mjekut lidhur me shëndetin tënd?

— Sipas fjalëve të mjekëve, unë tani duhej të ecja këmbadoras. Ndofta nuk jam në atë gjendje shëndetësore që u dukem atyre.

Atë çast u servirën kafetë e treta. Përkohësisht sundoi qetësia.

*

— Pse nuk pranon të futesh në ndonjë punë të rehatshme këtu në kamp, apo ke frikë se të quajnë spiun të komandës të burgosurit e tjerë? e pyeti papritur drejtori i DSJsë me një buzëqeshje të lehtë.

— Po – iu u përgjigj pa hezitim Meli. – Dihet prej gjithë të burgosurve, se këto lloj punësh vetëm atyre personave u jepen.

— Mirë atëherë, vazhdo të punosh aty ku je; vetëm na lejo që, nëpërmjet kanaleve tona, të të ndihmojmë me 300 lekë të reja çdo muaj.

— Jo, jo s'është nevoja – nxitoi të përgjigjej Meli. – U jam përshtatur mjaft mirë këtyre kushteve dhe ndonjë mungesë e rastit nuk më bën fare përshtypje.

— Meqenëse jeta e lirë të qenka mërzitur dhe nuk e preferoke në çdo formë që po ta ofrojmë, a mund të na japësh ndonjë mendim për misionin tonë?

— Unë di vetëm se po përgatisni një *Mision të Madh*, si nga vlera e realizimit edhe nga shkalla e vështirësisë. Por nuk di se për çfarë misioni bëhet fjalë konkretisht, që të mund të jepja ndonjë mendim.

— Për atë që kemi nevojë të të tërheqim mendimin, do të të pyes unë vetë. Rëndësi ka që ti të jesh i gatshëm për tu përgjigjur.

— Patjetër.

— Për fazën e parë – zbulimin e objektivit – na duhet të veprojmë në pesë a gjashtë shtete evropiane. Kryesisht perëndimorë, por edhe lindorë. Sipas mendimit tënd, si është më mirë, të veprojmë më parë në shtetet perëndimorë dhe, po nuk rezultoi gjë, të kalojmë pastaj me forca të përqendiruara në shtetet

lindorë, apo t'i ndajmë detektivët në grupe më të vegjël qysh në fillim dhe të vazhdojmë gjurmimin njëkohësisht në të gjitha vendet ku dyshojmë?

— Unë mbështes idenë e gjurmimit të njëkohshëm në të gjithë shtetet ku mendoni se duhet kryer një veprim i tillë, veçse me një qendër drejtuese jashtë Shqipërisë. Kjo lehtëson ndjeshëm manovrimet e nevojshme të diktuara nga rrethanat. Në rast se paraqitet nevoja e përqendrimit të grupeve të veçantë në një shtet të vetëm (p.sh., pas sigurimit të ndonjë të dhëne të saktë në ndonjërin prej shteteve në fjalë), diçka e tillë realizohet pa vështirësi. Vonesa e gjurmimit favorizon gjithmonë atë që fshihet.

— Cila është mosha më e përshtatshme e detektivëve që duhen angazhuar për *Misionin e Madh*?

— Për mendimin tim, në një mision kaq të rëndësishëm duhen mobilizuar detektivë me përvojë, por që kanë njëherësh edhe energjinë dhe dinamizmin e moshës. Zakonisht cilësi të tilla mbart mosha 35 deri në 40 vjeç.

— Ç'rol mund të luajnë femrat në një mision të tillë?

— Si në çdo mision, femrat kanë aftësi katalitike në zhbllokimin e sekreteve. Por në një mision kaq delikat duhen pasur parasysh edhe masat parambrojtëse të kundërshtarit, për të mos rënë në bllof.

Pas një heshtjeje të shkurtër, *Dofeni* formuloi konsideratën e tij për takimin:

— Idetë që më dhé ishin sa të dobishme, aq edhe të çiltra. Në përgjithësi ato kanë qenë edhe mendimet tona. Përsa i përket çështjes për të cilën erdhëm, unë mendoj se fitorja është e imja, pavarësisht se, tani për tani, do të mbetet një fitore pa trofé, gjersa nesër nuk do të shkojmë bashkë në DSJ, siç shpresoja unë. Por kjo do të ndodhë patjetër një ditë, mbetet thjeshtë çështje kohe. *Shkëmbi* e ke pasur pseudonimin në aktivitet dhe si shkëmb po qëndron. Të adhuroj për vendosmërinë, po aq sa të urrej për mospranimin e ofertës sonë me propozimin e parë. Pushteti ynë disponon leva të tilla, me të cilat mund të lëvizë nga vendi çdo *shkëmb*. Mbaje mend këtë që po te them: si sot një vit ti do të militosh patjetër në radhët e DSJsë, me hir ose me pahir. Natën e mirë, e mirëmbetsh!

Meli takoi dorën me *Dofenin* dhe të pranishmit e tjerë e doli jashtë. Dëbora e ngrirë shndriste nga rrezet e hënës në prishje, duke sajuar një peizazh dimëror joshës.

«Bukuria që vret», tha me vete detektivi i burgosur.

Kjo skicë e mirënjohur e Migjenit, poetit dhe shkrimtarit të tij më të preferuar shqiptar, iu kujtua Melit, ndërsa po hynte në *maune* të bënte një sy gjumë.

XXIX

PËRGJIMI INTENSIFIKOHET

“*Ndodh që njeriu të bëhet i vendosur nga dobësia dhe guximtar prej ndrojtjes*.”
La Roshëfukó

Qysh prej ditës që Streto i bëri të ditur Melit se do të ndodhej në një rreth të hekurt përgjimi si pasojë e refuzimit të ofertës së DSJsë, ish-detektivi me Diksin kishin diskutuar gjerësisht së bashku, për t'i bërë parapritat e duhura çdo rreziku të mundshëm. Meli e dinte nga përvoja e profesionit të dikurshëm se DSJ do të bënte çmos për të siguruar informacion kompromentues kundër tij. Kjo do t'i krijonte mundësinë pastaj ta riarrestonte ish-detektivin dhe ta vinte para alternativës së dëshiruar për synimet e saj: dënim kapital për dekonspirim, ose rikthim në detyrë. Natyrisht, një vendim të tillë DSJ mund ta merrte edhe pa sigurimin e materialeve kompromentuese që synonte, por në fund të fundit Meli donte të mos jepte vetë shkas për një gjë të tillë. Më tepër nga kaq nuk bënte dot.

Meli me Diksin morën në analizë personat me të cilët kishte marrëdhënie ish-detektivi. Ndonëse ky ishte dorështrënguar në krijimin e këtyre marrëdhënieve, sidoqoftë nuk mund të thuhej se jetonte i vetmuar. Ata vendosën që, qysh prej asaj dite, Meli duhej ta konsideronte veten si përpara hetuesit në praninë e tyre. Ndërkohë ai nuk duhej të bënte asnjë ndryshim të dukshëm në marrëdhëniet e jashtme me ta. Lindja e “pse-ve” duhej evituar me çdo kusht në atë situatë tensioni e pasigurie.

Me sa dukej, kartelisti do të ishte organizatori i rrjetit të brendshëm informativ të kampit me objektiv ish-detektivin. Ky u bind për këtë, pas ndodhisë së mëposhtme.

Një ditë Meli ishte ulur tek një cep i sheshit ku shëtisnin të burgosurit. Po rilexonte romanin *Njëzet mijë lega nën det*. Ky libër i shkrimtarit të huaj më të pëlqyer të tij e kishte *fundosur* edhe vetë Melin në fund të detit, kur dikush ia bllokoi me një fije letre faqen e librit. I revoltuar, ai ngrit sytë dhe pa bashkëqytetarin me të cilin ishte dënuar si grup (pikërisht për atë kishte shkuar Meli në Berat ditën që e arrestuan).

— Sa herë të kam thënë të mos më shqetësosh, kur jam duke lexuar? reagoi i revoltuar ish-detektivi.

— Mos u nxeh, Hamit, se ky ngacmim është për të mirën tënde – i tha ai me zë të ulët. – Do të besoj një sekret, por më parë duhet të më japësh fjalën që nuk do të nxehesh.

— Pse, është një sekret që mund të më revoltojë?

— Pak a shumë…

Meli mbylli librin dhe i tha:

— Shprehu lirshëm; të jap fjalën se do të të dëgjoj i qetë.

— Duhet të tregohesh i kujdesshëm; kartelist Et'hemi të ka vënë në shënjestër.

— Nga e di ti?

— Më thirri në zyrë dhe…

Fillimisht ai u përtyp duke u skuqur, pastaj heshti.

— Shprehu deri në fund; të thashë që nuk do të nxehem.

— Më kërkoi që ta informoja për ty, duke më premtuar se do të ndikonte në uljen e dënimit tim, po qe se informacionet e mia do të ishin të dobishme.

— Po ti, si iu përgjigje?

— Ai më kërcënoi: «Nëse nuk pranon të më informosh, do të të transferoj në burgun e Burrelit». Ti e di që një transferim i tillë është i tmerrshëm për mua.

— Po pastaj, me çfarë detyre të ngarkoi kokretisht?

— Kartelist më tha: «Ti e ke bashkëqytetar Hamitin dhe e di që ai ka qenë disa vjet oficer sigurimi në Tiranë. Në rrethana të volitshme, gjatë bisedave me të përpiqu të mësosh diçka për veprimtarinë e tij atje: çfarë ka bërë konkretisht, apo ku e ushtronte aktivitetin. Gjithashtu kur Hamiti, i mërzitur apo i sëmurë (e dimë që ai vuan nga shëndeti), vjell vrer kundër pushtetit popullor, ti duhet t'i regjistrosh sharjet e tij në këtë mikroregjistrues zëri. [Kartelisti ma shpjegoi dy herë sesi vihej në funksionim aparati i vogël]. Kompensimi për një shërbim të tillë do të jetë në vartësi të vlerës së informacionit të siguruar: nga ulje dënimi deri në lirim prej burgut. Kjo varet nga rezultatet e punës tënde.»

«Unë e pranova propozimin e kartelistit vetëm për t'i shpëtuar transferimit në burgun e Burrelit. Por isha i vendosur që nuk do ta kryeja kurrë këtë akt të ulët dhe do të lajmëroja ty patjetër për rrethanat në të cilat gjendesh. Tani do të veproj si të më thuash ti: po deshe jam gati t'ia kthej kartelistit aparatin regjistrues, duke i thënë se nuk e bëj dot këtë punë. Qysh dje që e kam marrë, më ka prishur qetësinë. Nuk e di si u ndodha aq bosh që e pranova, por tani e kam ndarë mendjen: çfarë të më këshillosh ti, do ta bëj pa ngurrim. Më fal, Hamit, që u tregova kaq i dobët.

Duke thënë këto fjalë, ai u skuq në fytyrë dhe sytë iu mbushën me lot.

Melit i erdhi keq kur e pa në atë gjendje, ndonëse fillimisht ishte revoltuar në vetvete. Ish-detektivi e dinte që ai nuk ishte keqbërës, por përballë kërcëninit të pushtetit ishte disi i lakueshëm; edhe gjatë procesit hetimor kishte manifestuar shenja të tilla. Megjithatë në këtë rast ai e dënoi vetë aktin e tij dhe e meritonte faljen. Meli vendosi që ta ndihmonte për të dalë pa telashe nga situata në të cilën ndodhej bashkëqytetari i tij:

— Më mirë do të kishte qenë që ti të mos ta pranoje një propozim të tillë. Tani që kjo ka ndodhur, ne do ta zgjidhim problemin në mënyrë të tillë që as ti të mos dëmtohesh dhe as mua të mos më dëmtosh. Qetësohu.

Pas disa ditësh, Meli zhvilloi posaçërisht një bisedë me bashkëvuajtësin dhe bashkëqytetarin e tij, të cilën ky e regjistronte. Ish-detektivi ia kishte dhënë me të shkruar pyetjet që ai duhej t'i bënte në bisedë e sipër. Përgjigjet Meli i kishte përgatitur me vëmendje. Ato nuk përbënin rrezik për të, por as nuk linin

të dyshohej fare për fallsitetin e bisedës. Ky qe i vetmi material informativ që mundi të vilte karteisti i kampit prej Hamit Melit gjatë gjithë periudhës së përgjimeve intensive ndaj tij.

*

Atë ditë që bashkëqytetari i tij i foli për mikroregjistruesin duke ia treguar atë [ishte sa një sahat i vogël xhepi], Meli u interesua të merrte kontakt me Pahinë.

— Po ti, Afrim, paske vendosur të bësh prova teknike me zërin tim, që nuk më ke thënë se në kamp po përdoret edhe një aparat regjistrimi për të më përgjuar? e pyeti pa e fshehur një dozë revolte.

— Po përdoren tre aparate të tillë, jo një – ia ktheu Pahia duke qeshur. – E ç'rëndësi ka kjo? Gjithë materialin informativ që mbledh kartelisti gjatë javës me spiunët e tij, ma dorëzon mua në dorë çdo të premte në dhomën time të fshehtë. Unë bëj seleksionimin e materialit, duke nisur në DSJ vetëm atë pjesë të tij që e vlerësoj të padëmshëm për ty. Po të ndodhë që të më vijë ndojë material që të rëndon vërtet, unë e çregjistroj atë pa vështirësi. Faktikisht nuk është regjistruar asgjë e tillë dhe unë s'kisha pse të ngutesha për të të shqetësuar ty. Bile pikërisht pse nuk kanë funksionuar si duhet kanalet e këtushme informative, DSJ ka futur në kamp një kuadër të saj me shumë përvojë, me të burgosurit që erdhën pardje. Ky përbën vërtet një rrezik real. Megjithëse unë u vura në dijeni për ardhjen e tij, informacionet e tij ai do t'i nisë drejtpërdrejt në DSJ, pa kaluar fare nga unë. E gjen dot me mend se cili është ky *mysafir* që na ka ardhur, Hamit? *Brinjashi*, besoj se të kujtohet.

— E ku harrohet një krijesë aq e poshtër si ai! shkrofëtiu Meli i mërzitur prej këtij lajmi të keq. – Si nuk ka ndërhyrë Guri ta anullonte ardhjen e tij!

— Nuk ka pasur mundësi. Në DSJ po kërkohet me insistim material kundër teje. Në analizën e fundit që kanë bërë atje, është theksuar se punët nuk po ecin mirë në këtë drejtim. *Brinjashi* ka dalë vullnetar, i bindur se do të arrijë të nxjerrë diçka në dritë. Para një çerk ore kaloi lart, për tek sheshi.

XXX

CILI ISHTE *BRINJASHI* ?

"*Nuk mund të rrëzohesh më*
poshtë sesa përtokë."
D. Kostolani

Shkolla e lartë speciale e shërbimit sekret që kishte kryer Hamit Meli ishte katërvjeçare. Ajo kishte një rregull krejt të veçantë: në të regjistroheshin studentë vetëm një herë në katër vjet. Pra, duhej të përfundonin ciklin e plotë katërvjeçar të shkollës studentët e regjistruar, pastaj regjistroheshin studentë të tjerë. Si rrjedhim, në shkollën speciale të shërbimit sekret shqiptar studentët kishin vetëm shokë kursi, shokë klase, por jo shokë shkolle. Kjo i forconte së tepërmi marrëdhëniet midis tyre gjatë katër vjetësh.

Vetëkuptohet që studentët e regjistruar në atë shkollë zgjidheshin prej familjeve me biografi politike të shkëlqyer për kohën. Jo rastësisht, sa herë ndaheshin diplomat e studentëve të asaj shkolle, diktatori vetë asistonte rregullisht në ceremoninë e rastit. Gjithashtu kur bëheshin dekorime për detektivët për misione të ndryshme të kryera prej tyre, ai ua dorëzonte me dorën e tij dekoratat.

Rregulli i veçantë i shkollës speciale të shërbimit sekret shqiptar nuk ishte aspak formal, por i studiuar mirë dhe me një objektiv të qartë. Gjatë dy viteve të para të shkollës studentët përfitonin një kulturë të përgjithshme të ngjashme me atë të universiteteve me disiplinë të fortë. Natyrisht, prioritet kishin dy-tri lëndë që lidheshin me shërbimin sekret dhe psikologjinë, si edhe përgatitja fizike e studentëve të zgjedhur me tregues të përshtatshëm. Por gjer në përfundim të vitit të dytë të shkollës, ata njiheshin vetëm me anën më spektakolare të shërbimit inteligjent: zhbirimin e sekreteve duke sfiduar rrezikun. Ndërkohë ata përvetësonin më së miri teknikën e radiotransmetimit dhe përballimin e situatave të papritura në mision: si uria, etja, izolimi etj.. Për këtë, instruktorët i detyronin studentët të jetonin dhjetë ditë në zona të izoluara, tërësisht me mjete rrethanore. Dhe kjo nuk ndodhte vetëm një herë.

Mirëpo falë moshës, temperamentit dhe fizikut të tyre (përzgjedhja e studentëve u besohej specialistëve agjentë të DSJsë nëpër rrethe), kjo temë interesante policore i joshte ata, duke i dhënë ngjyra aventure jetës së tyre rinore.

Ishte pikërisht në vit të tretë që studentët binin në kontakt për herë të parë me anën tjetër të medaljes: mjetet që do të realizonin qëllimin. Atëherë atyre u mësohej me ngulm se vrasja nuk përbënte krim, kur kryhej për interesat e larta të partisë dhe autori i saj nuk quhej kriminel, por hero. Ata duhej të mësonin përdorimin e përkryer të thikës, të helmimit, të kurtheve të larmishme, të përgjimeve speciale, të atentateve me armë pa zë etj, etj.. Të gjitha këto studentëve u paraqiteshin si veprime të domosdoshme, për t'i njohur në kuadrin

e kryerjes së një misioni të vështirë të shërbimit sekret, por jo si qëllime të vetë misionit të tyre.

Ndërsa në vitin e katërt të shkollës, atyre u flitej më hapur. Instruktorët e regjur u bënin më së fundi të ditur se, krahas misioneve të zbulimit në kuadër të shërbimit sekret, ata do të kryenin edhe atentate në shtete të tjera kundër detektivëve të huaj, ose shqiptarëve të arratisur që i sillnin telashe partisë. Ndërkohë u caktonin edhe *pengjet familjarë*, pas dy turneve *turistikë* nëpër Evropë të shoqëruar prej instruktorëve. Kjo ua bënte atyre të pamundur kthimin prapa. Sikur studentët ta mësonin këtë fakt në vit të parë apo të dytë të shkollës, pak prej tyre mund ta vazhdonin atë deri në fund. Pikërisht për ta evituar diçka të tillë, regjistrimet në atë shkollë bëheshin vetëm një herë në katër vjet.

*

Brinjashi ishte katër vjet më i moshuar nga Meli dhe po aq kohë para tij kishte nisur aktivitetin në DSJ. Ai njihej si një ndër detektivët më të vendosur të DSJsë; një krjesë e predispozuar tërësisht për krim.

Melit i kujtohej një ngjarje e vitit 1974, e cila zbulonte qartë karakterin pervers të *Brinjashit*. Me rastin e 30-vjetorit të ardhjes në fuqi të regjimit komunist në Shqipëri, në DSJ shpërndaheshin çmime speciale për detektivët që kishin realizuar misionet më të spikatur të shërbimit sekret shqitar në vite. Si gjithmonë, diktatori ishte i pranishëm në ceremoninë solemne.

Brinjashit iu dha çmimi i tretë për asgjësimin me thikë në një rrugë të Brukselit të një intelektuali shqiptar të arratisur, i cili shkruante artikuj të ashpër kundër regjimit të Tiranës. Kur mori medaljen prej dorës së diktatorit, *Brinjashi* kishte deklaruar:

— Do të isha i lumtur sikur herën tjetër të realizoja ndonjë mision që do të meritonte çmimin e parë, pa le të vritesha edhe vetë duke e realizuar atë.

— Kështu ju do partia – kishte thirrur i ekzaltuar diktatori, duke i shtrënguar dorën.

Ky cinizëm i tejskajshëm e bëri *Brinjashin* të neveritshëm në sytë e detektivëve të tjerë të DSJsë.

Një ditë kolegët e Melit po shikonin në televizor një emision shkencor, i cili bënte fjalë për teknikën e vjeljes së helmit të gjarpërinjve në një laborator të posaçëm. Ata kishin vënë re të habitur një lloj gjarpri tepër të neveritshëm, i cili nuk zvarritej drejt përpara, si gjithë të tjerët. Me trupin e mbështjellë përgjysmë, ai rrëshqiste anash. Atë lloj gjarpri shkencëtarët e thërrishin *brinjashi*. Duke marrë shkas prej faktit se detektivi në fjalë gjatë ecjes e hidhte këmbën e majtë me majën e këpucës të nxjerrë paksa jashtë, këtë nofkë ata ia ngjitën edhe këtij gjarpri të DSJsë. Për inat të atyre që ia ngjitën nofkën, ai e përdori atë si pseudonim në kryerjen e disa misioneve, duke ua bërë së tepërmi qejfin me këtë gjest domethënës shefave të tij cinikë si ai vetë.

Me futjen e *Brinjashit* në kamp rrethi i përgjimit ishte bërë kërcënues për Melin. Sa herë binte fjala për të, ai i thoshte Diksit:

— Inat kije, por foli hakun. Sa për profesionin, nuk ia ha qeni shkopin; është detektiv i talentuar.

Megjithatë Meli ishte i qetë dhe i prerë në vendimin që kishte marrë. Me fatin e tij tashmë ishin lidhur përfundimisht shokët e tij të kursit, të cilët përbënin ajkën e DSJsë. Në betejën e madhe që kishte nisur midis ish-yllit të shërbimit sekret shqiptar dhe DSJsë po përfshiheshin shumë fate, shumë interesa e shumë synime. Aktualisht Meli u kishte marrë krahët atyre dhe lufta e tij e heshtur niste brenda kalasë së shërbimit sekret shqiptar.

Megjithatë fjalën e fundit, si gjithmonë, do ta thoshte forca dhe ajo fliste tërësisht për palën tjetër. Edhe në atë rast detektivi i burgosur e kishte vendosur të asgjësohej duke asgjësuar, jo në pasivitet. Sa për arratisje jashtë shtetit (siç i kishte propozuar një natë Pahia) as që i shkonte mendja. Ai kishte hesape për të larë me diktaturën dhe nuk donte ta shmangte përplasjen me të.

XXXI

KURTH I DËSHTUAR

"*Tiranëve në përgjithësi nuk u mungojnë pretekstet*."

E. Byrk

— **Ç**farë ke në këtë zarf, Sazan? e pyeti i buzëqeshur Meli.

— Tri fotografi, që kisha në xhep ditën e arrestimit.

— Mund t'i shikoj?

— Pse jo?

— Kjo është nëna jote, besoj, – hamendësoi Meli, duke i treguar njërën prej tyre Diksit.

— Nënat në përgjithësi njihen lehtë, Hamit.

— Sidomos nënat e hidhëruara – tha duke psherëtirë ish-detektivi.

Meli e shikoi gjatë fotografinë, para se të merrte tjetrën.

— Paske pasur flokë shumë të bukur, Sazan. Sa shumë ke ndryshuar! Transformimi yt fizik është më i dukshëm se i imi.

— Edhe e kaluara ime ka qenë shumë më e mundimshme se e jotja.

— Pa dyshim. Por tani vuajtjet i kemi të njëllojta. Cili është ky personi tek fotografia tjetër që keni pozuar bashkë? Më ngjan si fytyrë e parë.

— Një berber tiranas, admirues i flokëve të mi. Një ditë u qetha rastësisht tek ai. Kur u ndamë më dha fjalën se ishte i gatshëm të më qethte gratis, në rast se do të shkoja në lokalin ku punonte, sa herë që do të ndodhesha në Tiranë. Ai e mbajti fjalën dhe me kalimin e kohës zura miqësi me të. Dy muaj para se të më arrestonin, dolëm në fotografi bashkë.

— Mos e kishte lokalin në *rrugën e Durrësit*?

— Po.

— Të kujtohet emri i tij?

— Po; e quanin Fredi.

— Çfarë koiçidence! Ti ke qenë klienti i tij i preferuar, ndërkohë që Fredi ka qenë berberi im i preferuar. Ai ishte vërtet i pasionuar për zanatin dhe muhabetçi i ëmbël. Ta dija që do të rridhnin punët kështu, do të kisha pozuar edhe unë me Fredin. Në këtë mënyrë do të kishim pasur një kujtim të përbashkët.

— Ku na vinte radha mua e Fredit të zinim shoqëri me ty atëherë! – i tha duke qeshur Diksi.

— Jo, Sazan jo, nuk është ashtu. Unë në Gjirokastër kam pirë raki edhe me arixhinj për gallatë.

— Arixhinjtë shikoheshin me një sy indiferent prej Sigurimit, ndërsa unë e Fredi do i trembeshim miqësisë me ty në atë kohë. Megjithatë edhe këtu ne kemi të njëjtin berber.

— Jo vetëm që na qeth, por edhe na rruan – shtoi Meli duke qeshur. – Meqë ra fjala, do vish të shkojmë të rruhemi, Sazan?

— Jo, më duhet të shkruaj një letër.

Duke shkuar tek berberi, Melin e takoi kalimthi ndërlidhësi me DSJ. Duke ngadalësuar hapin, ai i tha:

— Hamit, sonte do të takohesh përsëri me drejtorin e DSJsë. Takimi nuk do të zhvillohet në mjediset e kampit, por në Fushë-Arrês.

— Nuk pranoj takim larg kampit – ia ktheu ish-detektivi.

Ndërlidhësi deshi ta sqaronte më tej, por Meli i ktheu krahët e u largua. Ai nuk e shqetësoi më. Qysh prej takimit të parë me Dofenin, ndërlidhësi tregohej i kujdesshëm me Melin.

Ishte data 11 dhjetor 1983.

*

Pasdite vonë Pahia i bëri të ditur Melit se, me refuzimin e tij për të shkuar në Fushë-Arrës, ai kishte bërë të dështonte tentativa e *Dofenit* për ta marrë me vete në Tiranë. Drejtori i DSJsë kishte në xhep një dekret të Kuvendit Popullor për lirimin e Melit nga burgu. Të njëjtën ditë u liruan dy të burgosur të tjerë prej kampit të Qafë-Barit po me dekret. Ndryshe prej këtyre dy të burgosurve, të cilëve ua komunikoi komanda e kampit lirimin, Melit do t'ia komunikonte vetë *Dofeni* në Fushë-Arrës. Shoqëruesit e tij kishin sjellë edhe një kostum, veshje të brendshme e këpucë në numrin përkatës të Melit, i cili figuronte ende në regjistrat e DSJsë. Mospranimi i ish-detektivit për të shkuar në Fushë-Arrës e kishte revoltuar *Dofenin*. Por ai nuk hiqte dorë prej takimit, i cili do të zhvillohej natën tjetër në kamp. Përkrah *Dofenit,* do të ishte i pranishëm në atë takim edhe Guri Streto.

XXXII

BIZNES POLITIK ME LETRA TË HAPURA

"*Fajtori nuk mund të bëhet dhe gjykatës; Ndryshojnë nga natyra dhe kundërshtohen nga njëra-tjetra*."

W. Shekspir

Para darke ndërlidhësi e takoi përsëri Melin dhe i njoftoi vendimin e *Dofenit,* se takimi i parashikuar për atë natë në Fushë-Arrës do të zhvillohej të nesërmen mbrëma në kamp, në të njëjtën dhomë ku ishte zhvilluar takimi i parë.

Kur u paraqit atje natën e ardhshme, ish-detektivi gjeti po ata persona që e kishin shoqëruar edhe në takimin e mëparshëm *Dofenin*, me përjashtim të mjekut. Këtë e kishte zëvendësuar Streto, i cili ishte kishte zënë vend në krahun e djathtë të *Dofenit.*

Meli u takua me të gjithë dhe u ul. *Dofeni* i dha një cigare, ia ndezi dhe e ndezi edhe për vete. Pastaj nisi bisedën:

— Dje shokët e Inspektoriatit rrugor të Pukës nuk na lejuan të vinim këtu, për shkak të dëborës së madhe, që e bënte të pasigurtë udhëtimin. Për këtë arsye, ne menduam ta zhvillomin takimin në Fushë-Arrës. Mund të më thuash, pse nuk pranove të vije atje?

— Udhëtimi me makinë në këto rrugë të vështira malore më shqetëson shumë nga nervat. Pastaj e merrja me mend se problemi nuk do të ishte aq urgjent, mbasi për urgjencat qeveria përdor edhe helikopterë – u përgjigj Meli me zë të shtruar, me pamje të qetë e me sytë tek *Dofeni*.

— Ne mund ta sillnim edhe helikopterin, po ta dinim se atij ti do t'i bindeshe – i tha *Dofeni*, duke vënë buzën në gas lehtë.

Edhe ish-detektivi buzëqeshi, por s'foli.

Drejtori i DSJsë mori fjalën përsëri. Ato që tha nuk ishin më pak se një akuzë në adresë të Melit:

— Sipas pohimeve të shokëve që të kanë njohur mirë dhe në bazë të materialeve shkresore që disponojmë në DSJ për personin tënd, ti je karakterizuar gjithmonë nga mania e kundërshtimit dhe e kokëfortësisë ndaj eprorëve. Veç kësaj, ke manifestuar edhe një prirje për t'i sfiduar kuadrot tona në çdo drejtim të mundshëm, deri ku të të arrinte krahu.

Duke thënë këto fjalë, sytë e *Dofenit* u ndeshën me ata të detektivit të burgosur. Ky po e shikonte me një mosbesim të dukshëm. Duke e ngritur zërin, *Dofeni* e përshkallëzoi mësymjen:

— Ti ke synuar me çdo kusht ta bëje për vete bashkëshorten e shefit të hetuesisë të Gjirokastrës. Dhe ia ke arritur qëllimit. Ky veprim nuk ka qenë frymëzuar thjesht prej dëshirës seksuale, se ajo të pëlqente si femër e bukur, por

vetëm e vetëm se ishe grindur me të shoqin dhe i kishe thënë: *do të më njohësh se kush jam*!.

Ish-detektivi u impresionua për një çast. Kjo i erdhi pak prej fillimit të paparashikuar të bisedës dhe më shumë ngaqë kishte besuar se marrëdhëniet e tij me gruan e shefit të hetuesisë kishin mbetur sekrete. Kjo ishte një prej femrave të rralla për mosekspozimin e së cilës ai ishte kujdesur posaçërisht. Nga inati ai vendosi të kundërshtonte:

— *Më mirë të të dalë syri, sesa nami,* ka thënë populli. Unë nuk kam dhënë shkak për një gjë të tillë, por kur gjykohesh nga pozitat e forcës nuk ...

— Dëgjo, Hamit – ia preu fjalën në mes *Dofeni*. – Këtu nuk ka vend për lojra fjalësh. Ne s'na ka tepruar koha që të vimë ta vrasim këtu me ty. Përkundrazi, jemi mjaft të preokupuar dhe çdo orë ka vlerën e një dite në rrethanat aktuale në DSJ. Përpiqu të më kuptosh si duhet, se kjo është më shumë për të mirën tënde. Unë e fillova në këtë mënyrë bisedën, për të ta bërë të qartë se prirja jote për sfida nuk do të rrëshqasë gjithmonë si në gjalpë. Vjen një çast që i hiqet vija përmbyllëse llogarisë dhe bëhen hesapet e fundit. Sonte do të bisedojmë bashkë në një mënyrë krejt të veçantë. Dhe për ta realizuar plotësisht këtë do ta vë veten time në rolin tënd. Për sa kohë do të konstatoj se në linjën e arsyetimit tënd për të kundërshtuar ofertën tonë do të ketë një dozë të drejte morale, unë do të vazhdoj të të toleroj. Kur ky kundërshtim do të zhvishet prej çdo lloji të drejte morale, atëherë ky çast do të jetë sinjali *s.o.s.* i tolerancës sime. Ndërkohë po të bëj një propozim konkret: A pranon ta drejtosh *Misionin e Madh* nga selia e ndonjë prej ambasadave tona, e cila do të ishte plotësisht jashtë rrezikut?

— Unë nuk e kam refuzuar ofertën e rikthimit në profesionin e detektivit për shkak të frikës për jetën time. Gjatë kryerjes së misioneve kur militoja në DSJ unë e kam rrezikuar sa e sa herë jetën, duke qenë më i ri në moshë. Mua më ka penguar e më pengon vetëm frika e dështimit për shkak paaftësie, pas erozionit të vlerave profesionale që kam pësuar për shkak të vuajtjeve në hetuesi e në burg.

— Në veprimtarinë e vështirë të shërbimit sekret ka pasur, ka e do të ketë përherë edhe dështime. Ne po përgatitemi me të gjitha forcat që disponojmë, për ta realizuar me sukses *Misionin e Madh*, por do ta pranonim edhe dështimin, si fakt që ekziston.

— Pozicioni im delikat si i burgosur politik ma bën të pamundur pranimin e dështimit të atij misioni me rëndësi të veçantë, në rast se do të pranoja të merrja pjesë në të; aq më tepër po ta kryesoja.

— Gjersa DSJ, ashtu si çdo shërbim sekret i botës, e njeh edhe dështimin si pjesë e pamohueshme e një misioni, ti nuk ke arsye të këmbëngulësh në të kundërtën deri në këtë pikë. Po të flas me sinqeritet, Hamit.

— Edhe unë do të përgjigjem me të njëjtin sinqeritet. Unë kam arsyet e mia që këmbëngul në mospranimin e dështimit të *Misionit të Madh*, nuk e bëj për qejf këtë. Nga përvoja e mëparshme, unë e di mirë që DSJ i analizon me imtësi

shkaqet e dështimit të një misioni të rëndësishëm. Çdo hije dyshimi për mungesë vullneti apo aftësie në adresë time, si ish-i burgosur politik, mund të interpretohet lehtësisht si sabotim. Dhe dihet se cilat do të ishin pasojat atëherë për mua. Nga ana tjetër unë kam shumë vjet që jam shkëputur prej shërbimit sekret, ndërkohë që ish-kolegë të mitë kanë arritur me siguri një nivel të lartë përgatitjeje profesionale. Duke folur hapur dhe me sinqeritet, në këto rrethana më intrigon diçka që unë nuk arrij ta kuptoj dot: çfarë misioni qenka ky që kërkoka doemos kryesimin tim?

Një pauzë heshtjeje e thellë e pasoi këtë pyetje të papritur të ish-detektivit. Drejtori i Sigurimit të Shtetit dhe përfaqësuesi i Sigurimit të KQPPSH ulën kokat. Pas një heshtjeje të shkurtër, *Dofeni* u përgjigj me një pamje të menduar:

— Unë mund të ta them në çast se çfarë misioni është dhe ti do ta kuptosh menjëherë pse këmbëngulim që ta kryesosh patjetër ti. Por më parë duhet të më japësh fjalën se, po ta thashë, do të pranosh rikthimin në detyrë.

— Është kusht i vështirë ky për mua.

Drejtori i DSJsë u prish në fytyrë dhe foli me një dozë nervozizmi të përmbajtur:

— Sonte kam ardhur të flas me letra të hapura me ty, Hamit. Këtë do ta bëj për të të dalë nga borxhi, para se të të them fjalët e fundit: *paç veten në qafë*!. Për të qenë i lehtësuar në ndëgjegje kur të t'i them këto fjalë, do të të krijoj lehtësitë maksimale të mundshme lidhur me pranimin e ofertës që po të bëjmë. Konkretisht: përveç të drejtës që do të kesh për ta kryesuar *Misionin e Madh* nga një ambasadë e jona jashtë rrezikut, do të të pajisim edhe me një autorizim special, sipas të cilit ty do të të njihet e drejta ta braktisësh detyrën, pa asnjë pasojë, sapo të marrësh vesh se qeveria jonë është në përmbysje e sipër. Gjithashtu do të jesh paraprakisht i pajisur me të gjitha dokumentet e duhura për të filluar një jetë të qetë, krejt tjetër. Po me këto kushte pranon, Hamit? e pyeti *Dofeni* hijerëndë.

Pavarësisht se në pamje s'kishte ndryshuar asgjë qysh prej fillimit të takimit, gjendja kishte ardhur gradualisht duke u tensionuar. Jo vetëm që çdo nxitim ishte i papranueshëm, por përgjigjja duhej llogaritur mirë prej ish-detektivit në atë çast vendimtar. Meli shikoi me bisht të syrit Streton. Ky ishte mbështetur plotësisht pas kolltukut, ndërsa shikimin e kishte mbërthyer në një pikë të tavanit. Kuptohej lehtë që edhe atë e kishte përfshirë i njëjti tension. Meli u përgjigj duke i shqiptuar qartë fjalët:

— Më vjen sinqerisht keq që mbetem gjithmonë në të njëjtën përgjigje, por kushtet e saposhtruara më krijojnë përparësi në një tregues, që për mua është i dorës së dytë: sigurimi i së ardhmes personale. Unë për këtë nuk kam menduar fort as kur isha shumë i ri e pa eksperiencë profesioni e jete, jo më tani që flas nga brenda burgut. Në këto kushte, prej pranimit të ofertës së kthimit në detyrën e detektivit unë do të kisha vetëm fitim, po të isha në gjendje përsëri ta kryeja atë. Arsyeja e vërtetë e mospranimit tim – paaftësia për ta ushtruar sërish atë detyrë – nuk lidhet me interesin tim për të ardhmen.

XXXIII

DOFENI APO I ATI ?

"*Bëmë baba, të të ngjaj*!"
Shprehje popullore

Pasi afishoi një buzëqeshje skërmitëse, drejtori i DSJsë iu kundërpërgjigj gjithë mllef:

— Ajo lidhet dhe lidhet shumë bilé. Por këto lidhje janë tinëzare, me fije të padukshme, por efikase. Pikërisht pse e dimë që ekzistojnë këto fije misterioze në mentalitetin e çdo njeriu, ne po përpiqemi të të ndihmojmë që të çlirohesh prej tyre. Të thashë qysh në fillim të këtij takimi, se do ta vendos veten në rolin tënd, për të gjykuar sa më objektivisht qëndrimin tënd përfundimtar. Nga pozitat e tua aktuale, unë nuk e kuptoj dot se çfarë do të humbisje ti po të rikthesheshe në DSJ, edhe sikur regjimi ynë të kishte vetëm gjashtë muaj jetë akoma. Me kushtet që po të ofrohen, ti fare mirë mund ta kaloje edhe këtë fragment kohe në pushtet dhe, po erdhi ndonjë situatë kërcënuese për qeverinë tonë, kris e ik pastaj. Një kompromis të tillë mund të mos ta pranojë një njeri me duar të pastra dhe me një të kaluar të qetë, por jo ti, autori i 112 misioneve të realizuar. Pse nuk pranon ta jetosh me kapacitet të plotë edhe atë interval kohe që i paska mbetur regjimit tonë, sipas llogarive të tua? Kthehu në shtëpinë tënde, djalë plangprishës, se ti je i zhytur në gjakun e shkaktuar prej këtij regjimi dhe *i mbyturi nuk pyet prej të lagurit*.

Provokimi i *Dofenit* me këtë të folur të vrazhdë ia arriti qëllimit të synuar. Ai e irritoi detektivin e burgosur deri në atë masë, saqë ai flaku tej kujdesin e vetëmbrojtjes dhe i doli rrezikut ballë për ballë, në fushë të hapur:

— Sepse nuk dua ta rris më tej shifrën e kobshme të misioneve të mi të realizuar – ia ktheu ish-detektivi me zërin që i dridhej, dyllë i verdhë në fytyrë.

Streto kafshoi buzën e poshtëme dhe mbylli sytë. Kjo që bëri Meli ishte njësoj si ta prishje agjërimin ditën e fundit të ramazanit.

Ofensiva e drejtorit të DSJsë vazhdoi e pamëshirshme:

— Po pse more, zoti *Shkëmbi*, si i bën ti llogaritë? Po qe se regjimi ynë do të rrëzohet, ti mendon se do të mbetesh në hije, vetëm si teknik ndërtimi? Atëherë dikush do të vijë këtu me albumin e misioneve që ke kryer dhe do t'iu thotë të burgosurve të tjerë:

«E shikoni këtë person? Në realitet ky nuk është vetëm tekniku i ndërtimit, Hamit Meli, siç e njihni ju, por edhe detektivi *Shkëmbi*, rekordmeni absolut i shërbimit sekret shqiptar për këto dekada. Prandaj ky duhet varur të paktën njëqind herë, që të mund të lajë pjesërisht borxhin e tij karshi viktimave.»

«Atëherë, ata kokëqethurit që flenë pak më tej kësaj godine, nuk do të jenë në gjumë si tani. Ndoshta edhe sonte ata shikojnë në ëndërr skena hakmarrjesh për vitet e lëngimit të tyre dhe plagët e tjera që u ka shkaktuar regjimi ynë, si armiq të tij. Sonte ato janë ëndrra, por mund të mos mbeten përgjithmonë të

tilla. Dhe kur të vijë ai *Dikushi* me albumin e aktivitetit tënd në duar, ata që sot janë bashkëvuajtësit e tu, nesër do të të varin me tel me gjemba në ndonjë shtyllë të rrethimit të kampit. Ndërsa ne, jo vetëm që kemi mundësitë e mbijetesës të përmbysjes së regjimit tonë, se jemi të lirë e të pajisur mirë me gjithë ç'do të na duhen, por edhe duart nuk i kemi të lyera me gjak si ti.

Duke thënë këto fjalë të përçartura, drejtori i DSJsë filloi të fërkonte duart, sikur donte ta vërtetonte edhe fizikisht pohimin e kobshëm që kishte bërë. Njëkohësisht me të, edhe dy zyrtarët e tjerë po bënin të njëjtin gjest banal. Këtë herë edhe Streto po i shikonte me sytë e ndezur shpuzë nga urrejtja gjestet e këtyre komedianëve të gjakut.

Sakaq Meli vendosi *të luftonte në këmbë*. Pa mbajtur asnjë rezervë dhe pa llogaritur asnjë pasojë, ai u hodh me të gjitha forcat e tij në kundërsulm:

— Ata kokëqethurit, për të cilët fole, unë i njoh më mirë nga sa i njeh ti, mbasi bashkëjetoj me ta. Atyre u kanë qethur flokët, por mendjen nuk ua qethin dot. Para se ta varin në tel me gjemba detektivin *Shkëmbi*, ata do t'i bëjnë të paktën dy pyetje:

«Kush t'i rekomandoi për t'i goditur ata persona, që ti nuk i njihje fare dhe që nuk kishin ndonjë asmëri me familjen tënde? Po *Makarovën* pa zhurmë krisme kush ta dha?»

«Ata do të konstatojnë gjithashtu, se unë nuk kam pranuar të godit mbi bashkëkombasit e mi, me përjashtim të dy misioneve të fillimit. Në këto rrethana, mbasi të varin detektivin *Shkëmbi* me tel me gjemba, ata do të kërkojnë me insistim organizatorët e këtyre krimeve, personat që përgjigjen për jetën e të paktën 488 shqiptarëve të vrarë jashtë atdheut prej DSJsë, në kuadër të luftës së ftohtë, deri në kohën që unë u shkëputa prej shërbimit sekret shqiptar. E atëherë do të rezultojë se unë kam vetëm duart me gjak, kurse ju e keni të gjithë trupin të lyer me gjak shqiptari.

Fjalët e fundit të detektivit të burgosur ushtuan si bombë në mes të dhomës. Ai ishte zverdhur krejt në fytyrë dhe herë-herë i merrej goja prej revoltës së papërmbajtur. Duart i dridheshin dhe shikimi i ishte mjegulluar. Brenda pak minutash ai ishte transformuar krejt.

*

Në dhomë vazhdoi të sundonte një heshtje varri. Dëgjohej vetëm tik-taku i një ore muri, e cila dukej sikur llogariste sekondat e qetësisë torturuese. Gjendja ishte tendosur deri në atë shkallë, saqë nuk suportonte dot më as shqitimin e një rrokjeje çfardo.

Drejtori i DSJsë e shtyu tutje filxhanin e kafesë, të pirë përgjysmë, me pjesën e pasme të pëllëmbës së dorës dhe ndezi përsëri cigare. Heshtja vazhdonte ende dhe tek secili prej tyre ajo tani bënte një efekt më provokues sesa fjalët më të rënda.

Pasi thithi disa herë thellë cigaren, *Dofeni* foli me një zë të tjetërsuar, paksa të ngjirur:

— Nuk bëj dot më tepër as për misionin tonë e as për të mirën tënde. Po të them vetëm një gjë: sa të jem ky që jam, edhe kaq po pata në dorë [me thuan e gishtit të madh ai takoi mollëzën e gishtit të vogël] ti nuk do ta nxjerrësh dot lëkurën prej burgut. Mos u ndruaj nga ndonjë vdekje e papritur. Vdekja në një formë që nuk e pret është komode; ne nuk kemi ndërmend të ta rezervojmë ty një favor të tillë. Po vendosëm që të ta heqim lëkurën, do të të bëjmë ta përjetosh mirë e mirë fundin tënd, para se t'i mbyllësh sytë përgjithmonë. Kot nuk ke pranuar cigare dhe ushqime në takimin e parë, kur të erdhi nëna. Asgjë nuk do të të vijë papritur. Dhe për çdo gjë që mund të të vijë në të ardhmen, unë tani të them me plot gojën: *paç veten në qafë*! Mund të largohesh.

Detektivi i burgosur u ngrit në këmbë. Pasi tha nëpër dhëmbë *natën e mirë*!, ai u drejtua për tek dera. Përshëndetjes së tij iu përgjigj vetëm Streto.

Duke dalë jashtë, ish-detektivi po habitej me vete, sesi po e linin të kthehej në kamp pas këtij takimi.

XXXIV

BANALITETI I MJERIMIT

"*Vetëm koha e zbulon njeriun e drejtë;*
një ditë e vetme zbulon të pabesin."
Sofokliu

Informacionet javore, që kontrollonte për çdo të premte Pahia, mbetën të zbehta, të parëndësishme. Ky ishtre frut i kujdesit të posaçëm të ish-detektivit. Por kur lufton me fatin gjithmonë nga pozitat e të mundurit, jeta ka shumë dyer prej nga mund të hyjë fatkeqësia.

Çapini, njëri prej spiunëve më të devotshëm të kartelistit të kampit në radhët e të burgosurve për çështjen Meli, shpresonte shumë të përfitonte prej sharjeve të zakonshme të ish-detektivit në adresë të çiftit diktatorial. Ai e kishte marrë me kënaqësi mikroaparatin e incizimit tek kartelist Et'hemi, i bindur se nuk do të dilte bosh.

Mirëpo ndryshimi rrënjësor i Melit në vetëkontroll e la si peshkun pa ujë Çapinin. Sa i zhgënjyer edhe i dëshpëruar, ai po ndiqte një rrugë të tërthortë informimi me qëllim të dyfishtë: të justifikonte dështimin e tij në zotimet që kishte marrë para kartelistit dhe, në të njëjtën kohë, ta kompensonte mungesën e informacionit me një analizë të rrethanave të reja. Kjo shërbente indirekt si një sugjerim për ndryshim taktike nga ana e kartelistit, gjë që dëshmonte përkushtimin e veçantë të Çapinit në detyrën që i ishte ngarkuar.

Një ditë të shtunë Pahia takoi Melin dhe e pyeti i indinjuar:

— A ka ndonjë arsye Çapini që ta urrejë Sazanin?

— Përkundrazi, Sazani e ndihmon herë pas here në mësimin e frëngjishtes. Por duhet të kesh një gjë parasysh, Afrim: Çapini është një interesaxhi i paskrupull.

— Çfarë keqbërësi! Në një letër që i kishte dhënë pardje Et'hemit shkruante:

«Prania e Sazan Diksit më pengon shumë në vjeljen e informacioneve tek Meli. Jam i bindur se ai është edhe shkaktari i ndryshimit që ka bërë Meli kohët e fundit në kontrollin e fjalorit të tij në të shprehur.»

«Para disa ditësh edhe *Brinjashi* kishte dërguar në DSJ një relacion të ngjashëm, ku bënte një sugjerim të rrezikshëm: "Njeriu më i besuar i Hamit Melit në kamp është pa dyshim Sazan Diksi. Jam i mendimit që ai të arrestohet dhe të detyrohet të bashkëpunojë me ne. Në duart tona ai do të ishte një letër e fortë për zhbirimin e Melit."

«Për fat të mirë, pardje *Brinjashi* ka dërguar në DSJ një mesazh tjetër me përmbajtje të kundërt: "E tërheq propozimin e mëparshëm për këtë arsye: në qoftë se do të arrestohej Sazan Diksi nën çfardo motivi, Hamit Meli do ta kuptojë menjëherë pse bëhet kjo dhe do të reagojë. Ka të ngjarë që ai ta pranonte ofertën tonë nga halli, por duke pasur parasysh natyrën e tij agresive dhe

hakmarrëse, Meli do të ishte një person i rrezikshëm në radhët e shërbimit tonë sekret, i armatosur e me pushtet. Jam i mendimit se një kthim i tij me detyrim në DSJ është më tepër i dëmshëm sesa i dobishëm. Kam tentuar të hyj në komunikim me Diksin, por nuk ia kam arritur. Ai është një natyrë e mbyllur dhe nuk krijon lehtë marrëdhënie me të tjerët.”

«Ky ndryshim mendimi i *Brinjashit* është i favorshëm për ne, Hamit, në situatën aktuale – konkludoi Pahia.

*

Çapini ishte nga rrethi i Gjirokastrës. Sjellja e tij agresive ndaj Melit po e habiste ish-detektivin, më shumë sesa po e revoltonte. Ai nuk ngurronte fare ta dëmtonte sa të mundte Melin, vetëm që të përfitonte vetë nëpërmjet keqbërjes.

— Çapini është një interesaxhi kaq cinik saqë jetën time, apo të kujtdo qoftë, ai nuk e barazon me disa vite burg që mund të përfitojë, duke më dëmtuar nëpërmjet informacioneve tek kartelisti. Zelli i tij i pamasë për të shkëputur ndonjë informacion nga unë më irriton kur më flet. Ka një kategori njerëzish të prirur në keqbërje, të nxitur nga interesi dhe nga shpirti njëherësh. Kur isha në aktivitet, kam njohur një vajzë, sjellja e së cilës më ka lënë mbresa të jashtëzakonshme.

Ai ia tregoi Diksit ndodhinë e rrallë.

XXXV

KUJTIM I HIDHUR

"*Kujtimi i lumturisë nuk është më lumturi;*
kujtimi i dhimbjes është përsëri dhimbje."
Lord Bajron

Kur ishte 25 vjeçar, detektivi Meli kishte njohur një izraelite të bukur në Insbruk të Austrisë. Dikur nëna e saj kishte qenë bashkëpunëtore e shërbimit sekret shqiptar. Me kohë, nëpërmjet nënës ishte rekrutuar edhe e bija, falë përfitimit material të konsiderueshëm.

Më 1974, zonjusha 28 vjeçare izraelite kishte krijuar kastile marrëdhënie dashurie me një pesëdhjetëvjeçar të dënuar me vdekje në mungesë prej qeverisë shqiptare. Në këtë rast ajo do të ishte bashkëpunëtorja e detektivit Meli në kryerjen e misionit.

Një çerek ore para se të priste *të dashurin* në shtëpinë e saj private, izraelitja e kishte futur Melin në një dhomë tjetër.

Mysafiri kishte ardhur në orën tetë të mbrëmjes. Për të kaluar kohën, Meli shfletonte revista pornografike. Pas një ore, izraelitja kishte shkuar atje dhe i kishte thënë me pamje e zë të qetë:

— Ejani; gjithçka përfundoi.

Detektivi kishte shkuar në sallon i ndërgjegjshëm për skenën që do t'i shfaqej para syve: dashnori i helmuar dergjej në një divan i mbuluar me një kuvertë blu. Ata e ngritën viktimën të dy dhe e zbritën në bodrumin e shtëpisë, ku përgatitjet për eliminimin e kufomës ishin bërë para kohe. Mbasi e dogjën mirë me një solucion të posaçëm, mbetjet i flakën në një lumë shumë larg prej shtëpisë. Gjatë kryerjes së këtyre veprimeve, që mpinin disi edhe vullnetin e profesionistëve të regjur, detektivi 25 vjeçar ishte habitur prej pasionit me të cilin vepronte izraelitja e bukur.

Mbasi kishin përfunduar punë, natën vonë kishin bërë dush. Pastaj kishin pirë kafe të fortë. Ndërkohë izraelitja kishte përgatitur shpejt një darkë ekstra, që e kishte pasur gjysmë të gatshme. Shend e verë, ajo e kishte ftuar Melin të ulej në tryezën e shtruar me verë të shtrenjtë.

Për fat të keq, detektivi ndiente një përzierje në stomak, që ia kishte prerë oreksin. Kontrasti që bënte bukuria e izraelites së re me cinizmin e saj shpirtëror kishte shkaktuar një reaksion të paprovuar më parë tek ai. Detektivi ishte ulur në tryezë dhe me pahir kishte takuar gotën me izraeliten e qeshur. Pastaj ishte sforcuar për të ngrënë diçka prej gjellëve të shijshme. Por veprimet e shtira nuk kishin zgjatur shumë. Ai e kishte falënderuar partneren për darkën e përgatitur, ishte ngritur nga tryeza dhe kishte shkuar në sallon, ku kishte ndezur cigare. Qejfmbetur, vajza e re kishte shkuar e ishte ulur pranë tij.

Me një shprehje habie në fytyrë, ajo e kishte pyetur:

— Prej sa kohësh e ushtroni këtë profesion?

— Prej afro katër vjetësh.

— Po si shpjegohet kjo sjellje, atëherë?

— Ndodh që veprime të tilla të më shkaktojnë efekte të padëshirueshme.

— Kurse unë, përkundrazi, e kryej me pasion një mision të tillë. Dihet që njeriu është qenie e vdekshme. Si të gjithë njerëzit, edhe ai do të vdiste një ditë. Gjersa vdekja e tij sot ishte e dobishme për mua, pse u dashka që të filozofoj për vitet e jetës që ai humbi? Për kompensim, në prag të lamtumirës, unë i dhurova një seancë seksuale mbresëlënëse. Duke e shtrënguar në krahë, ndihesha e eksituar prej idesë që ai do të bëhej fli i dashurisë për mua. Sa e çuditshme është jeta! Ëmbëlsinë e saj më joshëse ajo e ruan pikërisht në guaskën e vdekjes. Atë që bëra unë sonte me atë, dikush tjetër mund ta bëjë në të ardhmen me mua. Eja ta shijojmë jetën përsa ta kemi fat, pa e vrarë mendjen për andrallat e saj!

Gishtat elegantë të zonjushës me thonjtë e ngjyer në të kuq kishin rrëshqitur përmes flokëve të detektivit, ndërkohë që fytyra e saj e ëmbël po i afrohej asaj të Melit. Ky vendosi instiktivisht dorën mbi gjoksin e vajzës, për të penguar afrimin e mëtejshëm të fytyrës me flokët si penda e korbit. E fyer tej mase prej këtij gjesti brutal, izraelitja e kishte fshikulluar me shikimin e saj të përflakur, duke i thënë me një ton përçmues:

— Keni ngatërruar profesion, djalosh. Lufta e ftohtë nuk i përshtatet një mashkulli me zemër çupline. Përpiquni të gjeni një punë tjetër, mundësisht në Kryqin e Kuq.

Detektivi kishte tentuar të justifikohej:

— Më falni, zonjushë, por ky ishte një çast dobësie, e cila nuk ka lidhje fare me personin tuaj.

Izraelitja ishte tërhequr në dhomën e saj, pa e përshëndetur.

XXXVI

INSTIKTI I CINIKUT

"Ç'është një cinik? Është një njeri që e di çmimin e çdo gjëje, por nuk njeh vlerën e asgjëje."

O. Vild

Gjatë gjithë kohës që kishte punuar në DSJ, Meli nuk kishte pasur kurrë marrëdhënie normale me *Brinjashin*. As pranonte vizitë prej tij e as ia kishte shkelur ndonjëherë pragun. Madjé, dy vitet e fundit që punonte në DSJ, Meli nuk i fliste me gojë fare, mbasi *Brinjashi* ishte bërë shkak të dënohej gjashtë vjet burg një djalë i ri tiranas, vetëm pse e kishte shtyrë detektivin e DSJsë në hyrje të stadiumit, ndërkohë që nuk e njihte fare se kush ishte. Për shkak të kësaj ndodhie të shëmtuar, ai kishte pasur edhe një përplasje të drejtpërdrejt me *Brinjashin*, e cila kishte përfunduar në kanosje me armë prej Melit. Vetëm ndërhyrja e një kolegu, që i lëvizi dorën Melit në çastin e fundit, e kishte shpëtuar *Brinjashin* nga vdekja. Qysh atëherë ata ishin bërë armiq për vdekje midis tyre.

Për mendimin e Melit, ishte pikërisht urrejtja ndaj tij që e kishte nxitur më tepër *Brinjashin* të dilte vullnetar në misionin e burgut. Nuk kishte rast më të përshtatshëm për hakmarrje ndaj Melit, i cili mbetej detektivi më i mirë shqiptar në historikun e DSJsë. Kjo ia shtonte edhe më tepër revoltën *Brinjashit*.

I etur ta dëgjonte nga afër zërin e kundërshtarit të tij të përhershëm të rënë nga vakti, apo të shkëmbente dy fjalë me të, *Brinjashi* kishte bërë tentativa afrimi me të burgosurin Hamit Meli në kamp. Natyrisht, i bindur që ish-detektivi nuk dinte asgjë sesi po luhej në prapaskenë me fatin e tij. Meli i kishte shmangur afrimet e *Brinjashit* pa manifestuar as më të voglën pakënaqësi ndaj tij.

Mirëpo me intuitën e profesionistit të regjur, një natë *Brinjashi* diti ta shfrytëzonte me efikasitet rastin e përshtatshëm. Atë mbrëmje Meli po ngrohej pranë një zjarri të vogël me dy të burgosur të tjerë. Diksi ishte në punë. *Brinjashi* u afrua atje, nxori nga xhepi një xhezve të mbështjellë në qeskë plastmasi dhe u drejtua atyre të treve:

— A ka mundësi ta përgatis kafen në zjarrin tuaj?

Një ish-oficer ushtrie iu përgjigj duke qeshur:

— Të ndiejmë erën e kafesë sonte është privilegj për ne. Me njëqind gramë që na japin në muaj, ne nuk shtyjmë dot as dy javë. Diktatorit i vjen keq që nuk mund të na racionojë dhe oksigjenin.

— Për sa kohë që ai i gjori nuk do t'ia gjejë dot zgjidhjen këtij problemi delikat, ne do të mbushemi frymë me të dy mushkëritë për inat të atij – ia ktheu *Brinjashi* duke qeshur dhe u ul ndanë të zjarrit.

— Edhe sikur të jetonim në Brazil, diktatori do na ndalonte të konsumonim më tepër se njëqind gramë kafe në muaj – tha ish-oficeri.

Shakaja e tij shkaktoi një të qeshur të përgjithshme, veçse arsyeja e qeshjes së Melit ndryshonte nga ajo e të tjerëve.

— Racionimi është simbol varfërie që e kënaq së tepërmi shpirtngushtësinë e diktatorit tonë – e avancoi më tej shakanë *Brinjashi*. – Mua ma ka dërguar familja një pako kafe, me rastin e martesës së vëllait të vogël. Prandaj do t'ju gostis të gjithëve me nga një filxhan kafe, nëse pranoni.

— *Peshqeshin e pranon dhe mbreti* – ia ktheu ish-oficeri duke fërkuar duart nga kënaqësia. – Në këtë acar unë do të gjerbja edhe lëng lajthishë, jo më kafe.

— Ndërsa unë, po të marr një kafe tani, mbetem gjithë natën pa gjumë – tha Meli. Pastaj ai iu drejtua *Brinjashit*: – Urimet e mia për martesën e vëllait.

«Megjithëse ti je djal i vetëm», tha me vete ish-detektivi.

— Të faleminderit, byrazer – ia ktheu *Brinjashi*. – Por meqenëse nuk do të pish kafe, urdhëro të paktën një bonbonë me mente.

— Patjetër. Kjo është e mirë për në mëngjes, para se të ndez cigare.

— Po të isha në vendin tënd, unë do ta kisha rrufitur që tani – i tha ish-oficeri duke lëpirë buzët.

— Edhe unë po të isha në vendin tënd, ashtu do kisha vepruar – ia priti duke qeshur Meli. – Por, siç e shikon, unë tani jam duke pirë cigare.

Tek po shikonte *Brinjashin* duke përgatitur kafet në zjarrin që po dobësohej, Meli solli ndërmend marrëdhëniet e acaruara me të në DSJ dhe tha me vete:

«Megjithëse ky i pashpirt është dëshmitar okular i gjendjes së mjeruar të të burgosurve, nuk i durohet pa i provokuar, ndonëse ky veprim nuk lidhet fare me misionin e tij. Vetëm dërrasat e arkivolit mund ta drejtojnë kurrizin e një gungaçi. Ah, sikur ta dije, *Brinjash*, se jam unë që po tallem me ty në këto çaste e jo ti me mua, siç të gënjen mendja! Do t'ia shikosh mirë sherrin misionit që ke marrë përsipër, për të ndëshkuar mua. *Ai që dëshiron t'i bëjë gropën tjetrit, bie vetë brenda* – thotë populli.»

XXXVII

LAJM DËSHPËRUES

"*Diktatura, si një murtajë shkatërrimtare,*
ndyn gjithçka prek."

P. Shelei

Të nesërmen e debatit të ashpër me *Dofenin*, Melit i filloi një krizë veshkash. Me ndërhyrjen energjike të kartelistit të kampit, DSJ i dërgoi një kurë të fortë të shoqëruar me vitamina. Kartelisti ia dha kurën dhe vitaminat ndihmësmjekut të kampit, duke e porositur që Meli t'i pinte ilaçet në prani të tij.

Kur arriti në treçerek të kësaj kure, ish-detektivit i filluan krizat e zemrës. Atij i shpërtheu gjaku nga goja dhe e shtruan urgjent në infermierinë e kampit. Kartelisti njoftoi përsëri qendrën. DSJ dërgoi menjëherë një kardiolog me përvojë. Sipas fjalëve të tij, ai kishte sjellë një kurë për zemrën të kohëve të fundit. Ishte një injeksion që bëhej drejtpërdrejt në sektorin e zemrës, me anën e një shiringe të posaçme, pak të lakuar. Për çdo natë, në orën njëzet, mjeku i bënte një të tillë Melit.

Me kalimin e ditëve, mjeku dhe ish-detektivi po miqësoheshin. Kardiologu kishte qenë për specializim në disa shtete. Meqenëse ai punonte në DSJ prej një kohe të gjatë, e njihte të kaluarën e Melit. Ata diskutonin për qytetet perëndimore dhe qendrat turistike që u kishin pëlqyer më shumë.

Një natë ai i tha ish-detektivit:

— Drejtori i DSJsë, shoku Ilir, ka mbetur shumë i pakënaqur prej takimit të fundit me ty. Me pahir pranoi që të të kuronim.

Ish-detektivi buzëqeshi hidhur, por nuk foli. Mjeku vazhdoi me zë të ulët:

— Unë e kuptoj deridiku gjendjen tënde, Hamit. Është e lehtë që të japësh këshilla, por t'i vësh ato në jetë duhet punë. Veç dua të të jap në mënyrë miqësore një prorosi: po t'u krijuan kushtet, interesohu për shëndetin. Hetuesia speciale të ka lënë me defekte të rënda. A ke ndonjë fëmijë, të paktën?

— Po, kam një vajzë – iu përgjigj Meli po me zë të ulët.

— Të të rrojë! Më vjen keq që po ta them, por sipas raportit mjekësor të lëshuar pas përfundimit të hetuesisë speciale, ti nuk je më në gjendje fizike të lindësh fëmijë.

Ndonëse Meli nuk e dinte nëse do të dilte ndonjë ditë prej burgut apo jo, ky lajm i hidhur e dëshpëroi pa masë. Atë çast ai ndjeu kënaqësi për qëndrimin që kishte mbajtur ndaj *Dofenit* në takimin e fundit.

«Të poshtërit!» – shau me vete. – «Dhe duan t'iu shërbej përsëri!»

Mjeku vazhdoi të fliste:

— Ti nuk më mban mend, por unë të kam vizituar një herë për zemrën gjatë hetuesisë speciale në Tiranë. Atëherë ti ishe në një gjendje të tillë, që nuk do të mbaje dot mend as fytyrën e nënës tënde, e jo më timen. Të shkuara e të harruara! – e përfundoi fjalën ai, duke i hedhur dorën në qafë Melit.

Ndërsa ish-detektivi vazhdonte kurën e zemrës dhe, krahas saj, bisedat e ngrohta me mjekun, në kamp u vunë re shenja të uljes së tensionit, ndryshe nga ç'pritej. Dy javë pas takimit të fundit të Melit me *Dofenin*, DSJ tërhoqi nga misioni i kampit *Brinjashin*. Dekorata, që ai kishte ëndërruar kur doli vullnetar për në misionin e burgut, u shndërrua në një dush të ftohtë prej qendrës.

*

Sipas lajmeve që po i vinin Pahisë, ulja e tensionit kishte filluar edhe në mjediset e DSJsë. Papritmas palestrat kishin heshtur, pas një periudhe të tensionuar e plot zhurmë nga zërat e atyre që stërviteshin dhe të atyre që drejtonin.

Atmosfera e kampit u lehtësua më tepër kur DSJ tërhoqi edhe ndërlidhësin.

Largimi i *Brinjashit* dhe i ndërlidhësit prej misionit të burgut solli automatikisht zbutjen e trysnisë së DSJsë mbi Melin. Si më i afti prej gjithë të tjerëve, Pahisë i kishin besuar të vëzhgonte reagimin e mëtejshëm të Melit, pas debatit të zjarrtë të 12 dhjetorit me drejtorin e DSJsë. Hapja e letrave deri në fund gjatë takimit me *Dofenin*, tregonte se drejtuesit e shërbimit sekret shqiptar i kishin konsumuar të gjitha skemat taktike, që kishin vënë në dispozicion të çështjes *Shkëmbi*.

I kënaqur nga kjo rrjedhë e re e ngjarjeve, Meli i tha buzagas Diksit:

— Do të më ndihmonte edhe mua Zoti një ditë, se nuk kam, bërë vetëm keq në këtë jetë!

Duke thënë këto fjalë, ai nisi të tregonte një ngjarje të jetuar, e cila shërbente si një ngushëllim i vogël për të kaluarën e tij.

XXXVIII

BAMIRËSI

"*E qeshura jonë më e sinqertë,*
Me vuajtje është ngarkuar;
Këngët tona më të arrira
Janë këngët e dëshpërimit."
P. Shelei

Një ditë në DSJ u ishte lexuar detektivëve një *listë e zezë*, ku përfshiheshin emra personash të dënuar me vdekje në mungesë nga qeveria shqiptare. Ekzekutimi i tyre do të kryhej prej detektivëve të shërbimit sekret shqiptar në shtetet ku ata jetonin.

Në atë listë gjendej edhe emri i Neshet Kolonjës. Për këtë person babai i Melit i kishte folur me shumë simpati familjes së vet. Ndonëse Kolonja kishte qenë pjesëmarrës në lëvizjen kombëtariste gjatë viteve të luftës, ai e kishte ndihmuar së tepërmi popullatën e krahinës në ato kohë të vështira, pa dallim bindjesh ideologjike.

Me të dëgjuar emrin e Kolonjës, Melit i ishin kujtuar fjalët e mira që u kishte thënë babai për të. Ai kishte vendosur në çast t'i shpëtonte jetën këtij njeriu. Gjatë ndarjes së misioneve, për eliminimin fizik të Neshet Kolonjës ishin caktuar dy detektivë, meqenëse ai kishte kryer studime të larta ushtarake në Itali.

Rregullat e DSJsë nuk i lejonin detektivët që t'i tregonin njëri-tjetrit për misionet e ardhshme. Mirëpo me kalimin e kohës, ata, si kolegë pune, kishin bërë zakon të kundërtën. Pasi e kishte marrë vesh se cilët detektivë ishin ngarkuar me asgjësimin e Kolonjës, Meli ishte futur si pa teklif në bisedë me ta. Fillimisht u kishte folur për misionin që duhej të ndërmerrte vetë në Belgjikë, pastaj i kishte pyetur për misionin e tyre. Meli kishte mësuar mandej adresën e saktë të Kolonjës, ditën kur do të niseshin dy detektivët për kryerjen e atij misioni, si dhe kishte shikuar me vëmendje disa fotografi të të dënuarit me vdekje në mungesë. Ai ishte nisur për jashtë shtetit tri ditë para atyre të dyve. Po atë natë kishte shkuar në Itali.

Neshet Kolonja banonte në një lagje të Napolit. Të nesërmen në mëngjes Meli ishte pozicionuar në një vend të përshtatshëm përballë banesës së Kolonjës. Në kujtesë kishte të fiksuar njërën prej fotografive të të dënuarit në mungesë, të realizuar vetëm një muaj më parë. E kishin fotografuar nga afër (natyrisht, në padijeni) dhe tiparet i dalloheshin qartë.

Rreth orës nëntë Kolonja kishte dalë nga shtëpia. Pasi kishte blerë dy gazeta, ai kishte shkuar më këmbë deri në një park të qytetit. Atje ishte ulur në stol dhe kishte filluar të lexonte gazetat. Ishte i veshur me një kostum kafe. Ndonëse ishte tek të shtatëdhjetat, mbahej mirë. Tek e shikonte ashtu, të qetë e paqësor në punën e tij, detektivi Meli mendonte se ç'do ta gjente së shpejti atë njeri fisnik, po të mos ndërhynte ai.

I ulur në një stol tjetër më larg, Meli e kishte lënë të lexonte një copë herë të mirë. Pastaj kishte vendosur t'i shkonte për t'i folur, meqenëse nuk kishte njerëz afër në ato çaste. Meli mbante veshje amerikane, flokët pak të gjatë. Atij plaku të mirë nuk i shkonte kurrë ndërmënd se ata të dy ishin prej të njëjtit vend, madje prej së njëjtës krahinë, por fati i kishte përplasur në mënyra të ndryshme në atë park të Italisë.

Duke ecur me hapa të ngadalshëm, Meli ishte afruar pranë stolit dhe e kishte përshëndetur:

— Mirëdita, zotëri!

Kolonja ishte befasuar ose, më saktë, ishte shqetësuar. Duke dëgjuar gjuhën amtare në rrethana krejt të paparashikuara, ajo bënte më shumë efektin e sirenës së alarmit në psikologjinë e tij prej ushtaraku lidhur me rreziqet që mund t'i kanoseshin prej atdheut të braktisur, sesa mbillte nostalgji në shpirtin e tij prej mërgimtari.

Kolonja kishte drejtuar menjëherë trupin, i ishte përgjigjur përshëndetjes dhe e kishte pyetur rrëmbimthi:

— Cili jeni ju që më flisni shqip?

— Një bashkëatdhetari juaj; jemi të dy prej së njëjtës krahinë – i ishte përgjigjur Meli buzagaz, për ta qetësuar.

— I kujt jeni ju, more djalë? e kishte pyetur ai, duke marrë frymë me zor.

— I Shuaip Melit, nga Gjirokastra.

Deklarimi i identitetit ishte një gabim i rëndë për një detektiv në aktivitet, por Meli e kishte bërë këtë nga keqardhja për shqetësimin që i krijoi Kolonjës.

— Kam respekt për babanë tuaj, pavarisisht se lufta na ndau në dy kampe. Por politika ka punën e saj, njerëzit kanë të tyren – ishte përgjigjur Kolonja.

— I bazuar pikërisht në këtë parim, kam ardhur sot tek ju. Politika ka punën e saj, ne tonën si njerëz. Babai im ju ka kujtuar gjithmonë me respekt për sjelljen tuaj të mirë gjatë viteve të vështirë të luftës. E ndiej për detyrë dhe e kam për nder t'ju ndihmoj me një informacion të rëndësishëm për sigurimin e jetës suaj. Pas dy ditësh, do të nisen nga Tirana për këtu, në Napoli, dy persona, detyra shtetërore e të cilëve do të jetë asgjësimi juaj fizik. Merrni sa më parë masat përkatëse për sigurimin e jetës.

Kolonja ishte shqetësuar shumë dhe habitur po aq. Ai kishte filluar të fliste i hutuar:

— Po pse, more djalë, çfarë i kam bërë unë qeverisë shqiptare? Lufta është luftë. Popullin unë e kam mbrojtur edhe gjatë viteve të luftës, sikundër paskeni dëgjuar edhe prej prindërve tuaj. Çfarë rreziku mund t'i vijë sot qeverisë shqiptare nga një plak si unë, që po i ngrys ditët e fundit të jetës në dhé të huaj, pa bërë asgjë te keqe?

— Më falni, zotëri, që ju shqetësova. Unë i kuptoj brengat tuaja dhe i respektoj ato; prandaj kam ardhur këtu. Por çështja për të cilën ju fola nuk varet nga unë dhe tashmë, nga askush – ishte përpjekur ta sqaronte Meli. – Nuk është

koha të diskutohet më për të. Bëhet fjalë për një vendim qeveritar, i cili është në prag të ekzekutimit. Interesohuni pa humbur kohë ta evitoni atë.

Duke i thënë këto fjalë, Meli i kishte zgjatur dorën për tu ndarë. Ndërkaq, Kolonja e kishte mbledhur veten dhe i kishte thënë me ton të vendosur:

— Nuk pranoj në asnjë mënyrë të ndahemi kështu bashkë. Ju do të vini patjetër në shtëpinë time.

— Eshtë e pamundur, zotëri; ky do të ishte një gabim i rëndë për mua. Aq më tepër që shtëpia juaj tani edhe mund të përgjohet.

Meli ishte i ndërgjegjshëm, se për debatin që po zhvillonin, Kolonja dispononte një kartë të fortë, përdorimi i së cilës do ta thyente përfundimisht balancën në favor të tij. Ndërsa detektivi bamirës shpresonte se plakut të tronditur nuk do t'i shkonte mendja në atë pikë, Kolonja papritur kishte goditur në qendër të rrethit 10:

— Në qoftë se nuk do të vini sonte në shtëpinë time, unë do t'ju quaj gënjeshtar ose, më keq akoma – provokator.

— Më vjen keq, zotëri që shkuat kaq larg. Me qëllim që ju të mos dyshonit për mua, unë u prezantova hapur tek ju, gjë që përbën një shkelje të rëndë të ligjit në pozicionin tim. Por meqenëse ju mendoni kështu, unë jam i detyruar të vij patjetër sonte në shtëpinë tuaj. Më prisni pas orës dhjetë të darkës.

— Oh, kjo është një kënaqësi e vërtetë për mua – ishte shprehur plaku i çliruar më së fundi nga streset. – Ne do t'ju presim në çdo orë që të vini. Përveç gruas, kam edhe një djalë e një vajzë të rritur. Megjithëse ata nuk flasin dot shqip, jam i sigurtë që do të gëzohen shumë.

Pak pas orës dhjetë, Meli kishte respektuar fjalën e dhënë. Djali dhe vajza e Kolonjës (i pari i kishte përfunduar studimet e larta, kurse ajo ishte në vazhdim) e kishin vënë në mes dhe e përqafonin si vëllanë e tyre. Babai i kishte sqaruar për gjithçka dhe ata nuk dinin si t'ia shprehnin mirënjohjen e tyre, së bashku me nënën italiane. Meli fliste me ta italisht, gjë që ua kishte shtuar së tepërmi gëzimin.

I zoti i shtëpisë i kishte bërë të ditur detektivit se, qysh të nesërmen, ata do të niseshin familjarisht për në Francë, ku do të qëndronin tre muaj. Më pas, do të emigronin në SHBA.

Dy detektivët e nisur me mision për eliminimin e Neshet Kolonjës kishin gjetur vetëm shtëpinë bosh. Pas disa muajsh, ata kishin bërë edhe një përçapje tjetër pa dobi. Mandej DSJ e kishte mbyllur kapitullin Neshet Kolonja.

XXXIX

MELI U FLET BASHKËLUFTËTARËVE PËR DIKSIN

"*Edhe në dyshim duhet të zgjedhësh të qenët besnik*."

F. Moriak

Disa ditë pas tërheqjes së ndërlidhësit, Streto u rikthye papritur në kampin e Qafë-Barit. Ai u takua me Melin në prani të Pahisë, duke u transmetuar një lajm të rëndësishëm. Me propozimin e *Dofenit*, pesëshja e bërthamës drejtuese të *Misonit të Madh* (ku bënte pjesë dhe vetë Streto) kishin vendosur për anullimin e atij misioni. Drejtori i DSJsë e kishte justifikuar propozimin e tij me një deklaratë sa të shkurtër edhe të sipërfaqshme: *për shkak të koniukturave të reja politike.* Ndonëse Streto ishte i bindur se kjo shprehje abstrakte, që motivonte anullimin e *Misionit të Madh*, fshihte ende misterin e saj, ai ishte shumë i kënaqur që DSJ do t'i hiqej qafe Melit dhe ata mund të përpilonin më me qetësi ndonjë plan të përbashkët për të ardhmen e tyre. Tani ata mund të diskutonin edhe për tema të tjera.

— Hamit, ne mendojmë se ti i ke folur Sazanit për ne. Është e vërtetë kjo? e pyeti papritur Streto.

— Unë nuk jam përpjekur t'jua fsheh këtë të vërtetë – u përgjigj tërthorazi Meli. – Bile kam qenë i bindur që ju e kishit konstatuar vetë këtë fakt. Për më tepër, para disa ditësh unë kam folur gjatë e gjerë me Afrimin për çështjen e Sazanit.

— Po, Guri, është vërtetë – pohoi Pahia. – Por s'na kanë lënë andrallat e tjera që të të flisja për bisedën e zhvilluar me Hamitin për shokun e tij bashkëvuajtës.

Streto vazhdoi me pyetje:

— Ç'mendon Sazani për ne, Hamit?

— Po ju përsëris fjalët e tij në ligjëratë të drejtë:

«Është një befasim i madh për mua që në kulmin e piramidës famëkeqe të Sigurimit të Shtetit, pikërisht në DSJ, të ketë kuadro me mendime e ndjenja të tilla. E admiroj bashkëpunimin tënd me këta shokë besnikë, që nuk mashtrohen prej pushtetit dhe mirëqenies që gëzojnë. Puna e portretizon njeriun. Kush i shërben dhunës është një instrument i së keqes. Por në qoftë se jehonat e ndërgjegjes të bëjnë thirrje të kthesh rrugë dhe ti e bën këtë kthesë në cilëndo pjesë të udhës qoftë, atëherë ti nuk je më ai që ishe. Nën ndikimin e pendesës, mund të bëhet hero edhe një njeri me të kaluar të dyshimtë. Evoluimi i ideve është një proces i njohur njerëzor, veçse idetë e mira duhen transformuar në veprime të mira. A nuk po bëjnë pikërisht këtë sot shokët e tu të DSJsë?»

— Në bazë të dokumentacionit që disponon DSJ, babai i Sazanit ka punuar për CIA - n. Të ka thënë gjë ai për këtë? – u interesua Streto.

— E nga mund ta dijë Sazani këtë gjë? – iu përgjigj pyetjes me pyetje Meli. – Kur është arratisur babai, Sazani ka qenë dy vjeç. Në hetuesi i kanë thënë se babai yt ka punuar për CIAn, por ata i përdorin shpesh për shantazh gjëra të tilla, ti e di mirë këtë.

— Jo, jo, në arkivat e DSJsë ka një dosje për të atin e Sazanit; unë e kam lexuar vetë atë – insistoi Streto. – Ato materiale janë të ilustruara me fotografi e me data.

Në vazhdim të kësaj bisede, Streto me Pahinë u interesuan edhe për hollësi që i bënë përshtypje Melit. Për më tepër, këtë bisedë ata e rihapën edhe dy herë të tjera më vonë.

Pas një jave, Streto u rikthye në Tiranë me urdhër të qendrës.

XL

VIT I RI NË SKËTERRËN QAFË–BAR

“Zot, majën e hollë të shpirtit duhet t’ia kishe zdrukthuar njeriut, që ai të mund t’i bënte ballë kësaj bote.”

Xhon Kic

Më 31 dhjetor 1983 një erë e ftohtë veriore e ngriu borën e shkelur, duke shkaktuar një rënie të temperaturës deri në minus 13° Celsius. Për shkak të kushteve të ashpra klimaterike, brigada e ndërtimit e kishte ndërprerë punën prej katër ditësh.

Pahia po bënte lëvizje të shpejta për tu nxehur, duke përplasur këmbët pas borës së ngrirë, kur Meli i tha duke qeshur:

— Një pseudo i burgosur meriton të persekutohet nga natyra, Afrim.

— Për fat të keq natyra nuk e bën dot dallimin midis një të burgosuri të vërtetë dhe një të rremi – ia ktheu ai buzagaz.

Qysh prej tërheqjes së agjentëve të tjerë të DSJsë prej misionit të burgut, Meli me Pahinë komunikonin pak më lirshëm se më parë. Nga ana tjetër, me rastin e festës së fundvitit kuadrot e komandës së kampit, përfshirë edhe kartelist Et’hemin, kishin shkuar pranë familjeve. Në kamp gjendej vetëm oficeri i rojës dhe gardianët e shërbimit të brendshëm.

— Dimri është i egër në këtë kamp në zemër të Alpeve, por unë do të kem rastin të festoj një vit të ri të paharruar këtu – vazhdoi bisedën Pahia, pa e ndërprerë përplasjen e këmbëve mbi dëborë. – Nuk e imagjinoja dot kurrë, se do ta festoja një ditë këtë ngjarje të shënuar në një kamp pune të detyruar bashkë me ty. Jeta është vërtet e çuditshme, Hamit.

— Po vitin e ri 1983, ku e festove?

— Në Spanjë. Ndodhesha atje me shërbim.

— Komandanti i kampit i ka urdhëruar gardianët të na lejojnë sot të ndezim zjarre tek sheshi, duke filluar nga ora pesë pasdite deri në mesnatë, në çastin e ndërrimit të viteve – e sqaroi Meli. – Do të festojmë një vit të ri romantik, në qiell të hapur.

— Romantizmi i skllavërisë bie era marrëzi – buzëqeshi Pahia. – Por mendoj se do të jetë e vështirë të ndezni zjarre jashtë, mbi dëborën e ngrirë.

— Burgaxhinjtë e vërtetë janë mësuar t’i bëjnë ballë çdo vështirësie, Afrim. Ke për të parë sa mirë do t’i ndezin zjarret ata këtu jashtë.

— Bashkë me Sazanin do ta bësh festën?

— Jo, Sazani mendon ndryshe. Meqenëse kur të errësohet mirë nata, ti do të vish t’i kalosh me mua disa orë sonte, Sazani ka vendosur të na lërë vetëm. Unë mendoj se gjykimi i tij është i drejtë. Megjithatë edhe ai nuk do ta ndezë larg prej nesh zjarrin.

*

Në orë pesë pasdite shumica e të burgosurve shkuan tek sheshi, për të zënë secili vendin e tij, ku do të ndizte zjarrin. Meli dhe Diksi gjithashtu. Në një distancë të afërt midis tyre, ata pastruan secili me kazëm pak vend prej dëborës së ngrirë, shtruan copa druri mbi tokë dhe sipër tyre ndezën zjarret. Atje do të gatuanin darkën e lamtumirës së vitit 1983.

Ora po shkonte shtatë e gjysmë dhe sheshi gumëzhinte prej të burgosurve të ndarë grupe-grupe pranë zjarreve të tyre, kur Pahia shkoi tek Meli. Megjithë zjarret e shumtë që flakëronin anembanë sheshit, ecja mbi terrenin e rrëshqitshëm ishte e vështirë. Nata e ftohtë po e bënte edhe më të rrëshqitshme borën e ngrirë. Të burgosurve u duhej të transportonin drutë për zjarret, ushqimet dhe ujin për gatimet.

Në kuzhinën e vogël private, ku kishte vetëm pesë vende gatimi, do të gatuanin me radhë të burgosurit e sëmurë dhe më të moshuarit e kampit. Pikërisht këtyre të burgosurve u ishte rezervuar e drejta prej bashkëvuajtësve që të shkonin të parët në mensë, për të festuar vitin e ri të mjerimit.

Megjithëse të burgosurit në shesh nuk harronin për të çuar dru në zjarr që, përveç gatimit, të ngroheshin edhe vetë, acari po ua ngrinte rrobat pas shpine. Ata bënin ushtrime, përplasnin këmbët përtokë, thërrisnin, qeshnin. Uji i valuar i një tenxhereje, që rrëshqiti prej gurëve ku e kishte vendosur i zoti, i dogji këmbën një të burgosuri, i cili përfundoi në infermieri. Një tjetri i ra të fikët, për shkak të tensionit të ulët të gjakut, dhe shkoi për t'i bërë *shoqëri* të parit në infermieri.

Në mes të poteres së përgjithshme të asaj nate të veçantë, të burgosurit diskutonin me gjallëri për gatimet e tyre, shkonin të huanin diçka që u mungonte tek ndonjë bashkëvuajtës dhe ktheheshin sërish pranë tenxheres së tyre. Gatimet në ato kushte nuk e vlenin mundimin e përgatitjes së tyre, por të burgosurit nuk hiqnin dorë nga festa edhe në atë gjendje mjerimi ekstrem. Ata nuk dëshironin të kishin brejtje ndërgjegjeje më vonë, pse e neglixhuan një provë se edhe ata ishin ende në mes të të gjallëve. Të burgosurit festonin ikjen e një viti të mundimshëm, që i kishte bërë të vuanin e të plakeshin më shumë. Katër të burgosur kishin humbur jetën në minierë gjatë atij viti; edhe ata e kishin festuar vitin e ri para dymbëdhjetë muajsh, siç po festonin bashkëvuajtësit e tyre atë natë të acartë…

Të burgosurit politikë po festonin një vit të ri që shënonte dyzetëvjetorin e ardhjes në pushtet të komunizmit shkatërrimtar në Shqipëri: një ngjarje e kobshme për ta. Ata kishin punuar gjatë gjithë muajit dhjetor pa pushim, me qëllim që të mos futeshin në minierë dy ditët e para të vitit të ri. Dy ditë pushimi, pa punë të detyruar, meritonin të kremtoheshin më shumë sesa festa e ndërrimit të viteve.

Një i burgosur rrëshqiti e u shemb përtokë, duke mallëkuar fatin. Një bashkëvuajtës nxitoi t'i vinte në ndihmë. Edhe ky rrëshqiti, duke u përplasur pas të parit. Të dy shpërthyen në të qeshura të marra.

Një ish-mësues nisi të recitonte një poezi kushtuar lirisë. Duartrokitje e ovacione pasuan recitimin. Papritur ish-mësuesi e goditi me shkelm tenxheren e tij që po valonte, duke përsëritur dy vargje të poezisë:

Çfarë ke moj zuska liri,
Që s'do të na shikosh me sy?

Një valë e re duartrokitjesh e ovacionesh shoqëruan rrokullisjen e tenxheres mbi borën e ngrirë.

*

I shtangur nga ç'po ndodhte përreth tij, Pahia nuk linte t'i humbiste asnjë grimë nga ato ngjarje të rralla të një nate të veçantë. Me theks mallëngjyes, ai i pëshpëriti mikut të tij:

— Çfarë spektakli i paimagjinueshëm, Hamit! Kjo që po ndodh sonte këtu mund të mbajë çdo emër, përveç asaj të festës. Nuk e beson njeri në botë, se sot ndodhin gjëra të tilla. Fotografimet që po bëj me *çakmakun* tim do të kenë vlerë të jashtëzakonshme ndonjëherë në të ardhmen.

— Në realitet kjo nuk është festë, Afrim, por një tentativë e dëshpëruar për të vrarë mërzitjen. Kulmi i dëshpërimit manifestohet shpesh me të qeshura absurde, apo jo?

— Ashtu është. Nuk thuhet kot: *ekstremet takohen*. Të burgosurit sonte mendojnë më tepër se kurrë për familjet e tyre të braktisura, të cilat festojnë gjithashtu në mes të varfërisë e lotëve. Të shkretët këta njerëz! Jeta për ta është bërë sinonim i vuajtjes. Dhe konsumohen duke shpresuar më kot, se Zoti do t'i ndihmojë një ditë.

— Në qoftë se vendos vërtet Zoti për fatet e njerëzve, shpresa është marrëzi. Zoti nuk mund të zhbëjë atë që bën vetë, gjersa ka vendosur që në këtë botë të ketë despotë dhe skllevër, terroristë dhe të terrorizuar, miliarderë dhe lypsarë, gjeni dhe budallenj. Kush do ta pengonte Zotin për të krijuar një botë ideale, në qoftë se do të kishte qenë i tillë qëllimi i tij?

— Megjithatë janë pikërisht të persekutuarit e fatit që e besojnë më shumë Zotin. Megjithëse diktatori ynë paranojak i shkatërroi me dinamit xhamitë e kishat në vitin 1967, ai feston sonte në mes të luksit me familjen e tij dyzetëvjetorin e karrierës politike, si asnjë udhëheqës tjetër i Evropës Lindore. Ndërsa viktimat e tij të pafajshme robtohen të festojnë vitin e ri në mes të borës e të mjerimit.

— Lutjet e këtyre fatkeqëve ndaj Zotit janë modeste: ata dëshirojnë të kthehen pranë familjeve dhe të kenë një strehë, ku të fusin kokën. Por megjithëse Zoti mund t'i gëzojë këta njerëz vetëm duke ua lehtësur hallet, vuajtjet e tyre vijnë gjithmonë duke u shtuar. Disa prej këtyre të burgosurve nuk

dinë ku të shkojnë kur lirohen. Nën presionin e Sigurimit, familjet e tyre i kanë braktisur dhe harruar.

— Në përgjithësi edhe detektivët pensionistë të DSJsë i bëjnë një mbyllje të zymtë jetës. Zakonisht përfundojnë alkoolikë e të divorcuar.

— *Ky stan këtë bulmet ka*, thotë populli, Afrim. Të luftosh për të forcuar rrënjët e një diktature është njësoj sikur të shkosh të porositësh arkivolin, para se të bësh vetëvrasje. A nuk hedh dritë të plotë mbi këtë të vërtetë të trishtë gjendja ime aktuale? Një pirg me dekorata akorduar prej Kuvendit Popullor për misionet e kryer nuk mjaftuan që të më bëhej një trajtim konform ligjeve të rrepta të diktaturës në hetuesinë speciale. Proçedura penale e ndalon torturën ndaj të arrestuarit, ndërkohë që torturimi deri në vdekje i armiqve të partisë vlerësohet normale prej organeve hetimore. Mua më kanë gjymtuar gjatë hetuesisë speciale, megjithëse vlerësohesha prej tyre si detektivi më i mirë i DSJsë. Aktualisht ata nga njëra anë më bëjnë thirrje të kthehem në profesionin e vjetër, nga ana tjetër nuk janë të gatshëm të më kurojnë pa kushte jashtë burgut, ndërkohë që unë jam mjaft i sëmurë. Por duke pasur parasysh të kaluarën time, unë nuk…

Në bisedë e sipër, Meli provoi një thelë nëse kishte zier apo jo. Ushqimi i kaloi keq dhe atij iu bllokua frymëmarrja. Duke qeshur me zë, Pahia filloi ta godiste në mes të shpatullave për t'i zhbllokuar frymëmarrjen.

Kur Meli u mbush sërish me frymë, Pahia i tha me shaka:

— Diktatori dhe ti keni lindur të dy në lagjen *Palorto* të Gjirokastrës, prandaj nuk ke të drejtë ta përbuzësh. Përndryshe, ja se ç'të gjen.

*

Mbasi shijuan gatimet e tyre në mes të acarit, të burgosurit filluan ta braktisnin sheshin. Ata nuk i rezistonin dot më të ftohtit, për ta pritur vitin e ri jashtë. Sidoqoftë, ai do t'i gjente brenda telave me gjemba, si tek sheshi edhe në fjetore. Meli e Pahia, të ndarë prej njëri-tjetrit, bënë të njëjtën gjë.

XLI

LAJME BEFASUESE

"*Të gjitha të vërtetat e mëdha në fillim trajtohen si blasfemi*."
B. Shou

Më 19 janar 1984 DSJ e thirri Pahinë në Tiranë. Duke u ndarë me Melin, ai i premtoi se do të përpiqeshin ta vinin në dijeni për çdo të re. Mirëpo kaluan ditët që i kishin mbetur janarit, kaloi edhe shkurti 1984 dhe ata, jo vetëm që nuk po dukeshin, por prej tyre as nuk kishte mbërritur ndonjë sinjal.

Një mbrëmje në fillim të marsit, në orën që Meli po merrte ilaçet si zakonisht, Streto e takoi disa minuta në këmbë jashtë infermierisë. Ai ishte pa maskë, i veshur me kostumin karakteristik të DSJsë. Lajmet që i bëri të ditur ishin sa të rëndësishëm edhe të habitshëm:

Më 26 janar, ditën e enjte, Streto ishte martuar me motrën e gruas së *Dofenit*, duke u bërë baxhanak me këtë të fundit. Krushqia kishte qenë nismë e vetë drejtorit të DSJsë. Tri ditë pas martesës, Streton e kishte thirrur diktatori në vilën e tij. Toni me të cilin i kishte folur Hoxha kishte qenë tepër familjar:

— Urimet e mia për martesën, Guri! Dëshiroj që miqësia ndërmjet Ilirit dhe ty të jetë e përhershme, për të mirën e përbashkët. Miqtë e familjes sonë janë të shumtë, por kush ka shumë miq si numër, ka pak miq të vërtetë. Ti do të jesh njëri prej këtyre të fundit, gjersa të ka zgjedhur me shumë dëshirë vetë Iliri. Të kemi studjuar mirë, para se të jepnim miratimin e realizimit të kësaj miqësie. Tek ti kemi gjetur cilësitë e përshtatshme të një miku me vlerë për djalin tonë të madh. Me kalimin e kohës rrethi miqësor i një familjeje si e jona evoluon paralelisht me koniukturat politike. Unë kam pasur miqtë e mi; im bir do të ketë të tijtë. Mirëkuptimi dhe besnikëria në miqësinë e bashkëpunimin tuaj do të jetë në të mirë të të dyve. Ju vaftë mbarë!

Miqësia e re kishte shërbyer si një impulsim i ndjeshëm për karrierën e Stretos. Ai nuk ishte më vetëm krahu i djathtë i *Dofenit* në drejtimin e shërbimit sekret shqiptar, por edhe zëvendësdrejtor i DSJsë, si edhe përgjegjës organizativ i Sigurimit të Komitetit Qendror të PPSH.

Duke vepruar në rrethanat e reja të miqësisë së lartë e të pozitës së fuqishme, Streto, falë intuitës profesionale dhe aftësisë së spikatur të komunikimit, kishte arritur të mësonte se *Misioni i Madh* ishte anuluar pas një vizite misterioze të diktatorit Hoxha në Londër. Kishte qenë pikërisht kjo vizitë që kishte krijuar *koniukturat e reja politike*, për të cilat kishte aluduar *Dofeni*, kur i kishte propozuar pesëshes drejtuese të *Misionit të Madh* anulimin e tij.

Duke i bërë të ditur këtë lajm, Streto i tha Melit:

— Nuk besoj se *Dofeni* ma krijoi mundësinë për tu njohur me këtë sekret për shkak të miqësisë së re si baxhanakë, ose thjesht nga mirëbesimi. Jo, diçka e rëndësishme zien në superpushtet, por nuk ka dalë akoma në sipërfaqe. Pas

varrosjes së Myslym Pezës, më 13 shkurt, Enveri pësoi infarkt të miokardit. U njoftua menjëherë Londra për gjendjen e rënduar të tij. Pas gjashtë orësh kardiokirurgu më i mirë anglez dhe asistenti i tij zbritën në Rinas.

«Pas një ndërhyrjeje kirurgjikale disaorëshe në zemrën e diktatorit, gjendja e të sëmurit erdhi duke u përmirësuar. Megjithatë kardiologu i famshëm deklaroi: "Një infrakt tjetër në të ardhmen do të ishte fatal për të." Në kohën që Hoxha ishte i sëmurë, vetëm Nexhmija, *Dofeni* dhe unë (më rrallë se dy të parët) kishim të drejtë të hynim në dhomën e tij. Ramizi dhe byroistët e tjerë, kokëulur e të përlotur, i prisnin gjithmonë në sallon lajmet për ecurinë e shëndetit të diktatorit. Të entuziazmuar prej rezultatit të operacionit, Nexhmija me *Dofenin* i shpërblyen me 25 milionë dollarë kardiokirurgun me nam botëror dhe asistentin e tij. Ata qëndruan gjashtë ditë në Tiranë. Në një rast kardiokirurgu anglez u shpreh:

«Po të isha ndodhur në Londër ditën që u sëmur udhëheqësi juaj, do të kisha ardhur më shpejt në Tiranë. Mirëpo qyshkur u bëra i njohur për bisturinë e suksesshme, nuk qëndroj në Londër më shumë se pesë muaj në vit, prej kërkesave që kam anekënd botës. Kam qenë tek koka e krevatit të Frankos gjatë agonisë së tij dhe qeveria spanjolle më shpërbleu me 15 milionë dollarë.»

«Pasi u largua kardiokirurgu nga Tirana, *Dofeni* më tha një ditë: "Guri, ka të ngjarë që së shpejti të bëjmë edhe unë e ti një vizitë në Londër." Nuk besoj se këtë e tha rastësisht e as i nxitur nga vlaga e miqësisë së re. Kam parandjenjën se do të të sjell lajme edhe më të habitshme herës tjetër, Hamit. Tani do të më falësh se më duhet të nisem për udhë menjëherë. Erdha enkas nga Tirana, se këto lajme nuk doja të t'i dërgoja me person të tretë.

— Faleminderit. As unë nuk dua ta zgjas më këtë bisedë, që më çoroditi krejt. Po e humbasim busullën; nuk po marrim vesh nga kemi ardhur e ku po shkojmë. Të bukur socializëm që paskemi ndërtuar në brigjet e Adriatikut!

— Kam edhe diçka të dhimbshme për të thënë, Hamit. Unë e Afrimi kishim vendosur të mos të ta përmendnim këtë, por heshtja e mëtejshme nuk ka kuptim.

— Atëherë?

— Kolegun tonë, Genc Daka, e pushkatuan; një alarm për të gjithë ne.

— Si the?

— Më dëgjove shumë mirë, Hamit…, mirëupafshim!

— Mirëupafshim! belbëzoi i tronditur ish-detektivi.

XLII

GUXIMI SFIDON KRIMIN

"*Vetëm përballë rreziqeve të*
mëdha shpalosen kurajot e mëdha."
Zh. – F. Rënjar

Lajmet e fundit e tronditën Melin. Profesioni i detektivit atë e kishte mësuar që ta shikonte botën si një xhungël dhe jetën si një luftë që zhvillohej sipas ligjeve të xhunglës. Për këtë arsye ai e kishte më të lehtë se një qytetar i thjeshtë për ta justifikuar në ndërgjegjen e tij luftën e egër për pushtet, në kuadër të diktaturës. Meqenëse të gjithë pjesëmarrësit e kësaj lufte të paprinciptë ishin të pamoralshëm, triumfin e diktatorit ai e vlerësonte si atribut të më të fortit në xhunglën e pushtetit suprem.

Mirëpo ky lloj arsyetimi qëndronte për sa kohë diktatori mbështetj në forcat dhe në aftësitë e tij. Misteri i suksesit të Hoxhës, duke u ndriçuar në sytë e ish-detektivit prej informacioneve të Stretos, po ravijëzonte një palë të tretë. Kjo dukuri e re i shkelte rregullat e luftës së xhunglës, me të cilat ai ishte mësuar.

— Xhunglat e politikës janë më të egra se ato të Afrikës – i tha ai Diksit pas takimit të fundit me Streton. – Mjerisht unë unë nuk orientohem dot në to, sidomos në ballafaqimin e parë. Duke e gjykuar me mendjen e sotme ngjarjen që më tregoi Afrimi lidhur me agjentin anglez, që ishte paraqitur si rus, tani i jap shpjegimin e duhur. Skenari i asaj ndodhie ka qenë përgatitur prej vetë *Dofenit* në marrëveshje me shërbimin sekret anglez, për të frikësuar detektivët e DSJsë, të cilët do të bien patjetër në gjurmët e zhvillimeve të fundit politike, për të cilat aludonte Guri. Qëllimi i terrorit është gjithmonë nënshtrimi dhe heshtja. Detektivët e DSJsë duhet të kafshojnë gjuhën dhe të mos iu shkojë kurrë ndërmend t'ia drejtojnë as vetes pyetjen: nga na doli kaq papritur kjo miqësi me militaristët e derisotshëm të Londrës? Jam i bindur se për të njëjtën arsye e kanë pushkatuar edhe detektivin Genc Daka, pavarësisht prej akuzës që i kanë ngritur. Genci ishte njeri sedërqar që nuk e njihte frikën dhe mund t'iu krijonte probleme në DSJ, kur të dilnin në dritë marrëdhëniet sekrete të diktatorit Hoxha me Londrën. Emrin e tij për tu eliminuar e ka rekomanduar me siguri instruktori anglez, i cili vepronte pranë DSJsë qysh me organizimin e shërbimit sekret të diktaturës. Për atë ne na thoshin se ishte rob lufte, por kuptohet që ka qenë i deleguar i Inteligjencë Servisit pranë shërbimit sekret shqiptar. Ai e njihte shumë mirë Gencin dhe ia ka vënë emrin në rreth të kuq, para se të largohej për në Londër, me krijimin e koniukturave të reja politike. Një popull i tradhëtuar, si puna jonë, shkon mish për top.

*

Gjatë bisedave të mëvonëshme me shokët, Meli mori vesh detajet e fundit dramatik të Dakës, me të cilin ai kishte pasur marrëdhënie të ngushta dhe kishin kryer disa misione së bashku jashtë shtetit. Streto dhe Pahia e dinin që Meli do të hidhërohej për ish-mikun e tij, prandaj kishin ngurruar t'ia përmendnin atë ngjarje, prej së cilës ata ishin bindur edhe më tepër se situata kërcënuese u impononte unitetin midis tyre.

Historia e fundit të detektivit Genc Daka ishte mjaft e dhimbshme.

Në kuadrin e përgatitjeve për *Misionin e Madh*, në nëntor 1983 DSJ nisi një grup prej njëzet detektivësh në Evropën Lindore. Misioni i tyre ishte të verifikonin funksionimin e bazave të shërbimit sekret shqiptar, pas përmbysjeve që kishin ndodhur në Kryeministri dhe në M.P. të Brendshme. Organizimi i aktivitetit të njëzetë detektivëve të ndarë në nëngrupe me destinacione të ndryshme iu besua kuadrit me përvojë të DSJsë Genc Daka, i cili do ta drejtonte misionin e përgjithshëm prej selisë së ambasadës shqiptare në Sofje.

Dhjetë ditë pasi kishin nisur nga puna, Daka konstatoi se gjashtë detektivë nuk bëheshin më të gjallë; pra, ishin arratisur. Për këtë ai lajmëroi qendrën në Tiranë. DSJ i dha urdhër të ktheheshin të gjithë në Shqipëri sipas rregullit: në fillim Daka me dy ndihmësit e tij dhe mandej pjesëtarët e tjerë të grupit. Kur u njoftuan për t'u kthyer para kohe në Tiranë, u arratisën edhe katër detektivë të tjerë. Dakën dhe shokët e tjerë që u kthyen i arrestuan me të mbërritur në DSJ.

Nëpërmjet një gjyqi rrufe ushtarak me dyer të mbyllura, Daka dhe zëvendësi i parë i tij u dënuan me pushkatim; tetë të tjerët me burgime të rënda. Meqenëse zëvendësi i Dakës kishte një të afërm në Byronë Politike, atij iu fal jeta. Vendimi i dënimit me pushkatim të Dakës mbeti i pandryshuar.

Ashtu siç e parashikonin ata që e njihnin nga afër, Daka i pafajshëm kishte mbajtur një qëndrim mahnitës në gjyqin e rrufeshëm ushtarak dhe, veçanërisht, para plotonit të ekzekutimit.

Ai kishte kërkuar që në çastin e pushkatimit të tij të ishin të pranishëm edhe kolegët e DSJsë. Prej tyre kishte shkuar vetëm Streto, i cili fliste sa me dhimbje, aq edhe me admirim për vdekjen heroike të 34 vjeçarit Daka.

Pasi e kishin zbritur nga makina brenda vendit të rrethuar me roje të afërta, ku do të kryhej ekzekutimi i tij, Daka i prangosur ishte ulur ndenjur dhe buzëqeshte nën dritën e prozhektorëve të *Gazeve*. Në gjysmëerrësirë qëndronte grupi vëzhgues i ekzekutimit dhe një kamerë. Ai kishte filluar të fliste shumë i qetë. Demaskonte makinacionet e regjimit diktatorial, i cili dënonte atë dhe shokët e tij të pafajshëm, për të terrorizuar të tjerët.

Pasi kishte shkarkuar pjesën kryesore të urrejtjes së akumuluar, Daka kishte thithur thellë cigaren e tretë që po pinte radhazi dhe, si flaku bishtin e saj në drejtim të atyre që ishin në gjysmëerrësirë, ai përfundoi duke thënë:

— Megjithëse jam i ri, unë e meritoj vdekjen, mbasi kam marrë në qafë njerëz që nuk i njihja e nuk më njihnin. Dhe këtë gjë të shëmtuar e kam bërë për

hir të interesave të një grushti morrash, të cilët nuk u ngopën së thithuri gjakun e këtij populli fatkeq. Unë deri dje u shërbeja atyre verbazi, ashtu siç u shërbeni ju sonte, duke ndenjur në errësirë, se mos ju shikoj fytyrat. E vërteta nuk i trembet dritës, ndërsa ju i trëmbeni, se jeni kundër saj.

«Kam kërkuar që sonte të ishin edhe shokët e mi të pranishëm në ekzekutimin tim. Nuk e di nëse i keni sjellë apo jo. Gjersa ju nuk e respektoni njeriun gjatë gjithë jetës, nuk më habit fakti që të mos ta plotësoni as kërkesën e tij të fundit. Doja që kolegët e mi të shikonin me sytë e tyre sesi i shpërblen regjimi komunist ata që i shërbejnë verbërisht. Kjo verbëri absurde më revolton së tepërmi në bilancin përfundimtar të jetës dhe ma lehtëson së tepërmi vdekjen.»

Ai ishte çuar me vrull në këmbë, kishte zbërthyer plotësisht zinxhirin e xhakaventos me duart e prangosura – duke lënë të kuptohej se ishte gati për çastin fatal – dhe, duke vendosur duart në fund të barkut, kishte thirrur fort:

«Po jua them me plot gojën se plumbat tuaj unë do t'i pres këtu!»

Daka nuk kishte pranuar t’i lidheshin sytë. Pas fjalëve të tij të fundit në jetë, ai kishte pështyrë fort në drejtim të togës së ekzekutimit.

Vendimi rrufe i dënimit të tyre e kishte çuar Dakën para plotonit të ekzekutimit me veshjen që kishte pasur dhe flokët e gjatë të paprekur. Streto ishte tronditur shumë prej sjelles sfiduese të Dakës. Në çastin që ky po thoshte fjalët e fundit, era e natës i shpupuriti flokët dhe i hapi kanatat e xhakaventos.

Me krismën e armëve, Streto kishte humbur ndjenjat.

XLIII

XHILDA DHE DETEKTIVI RUMUN

"*Pendesa është varka që nuk mbytet kurrë*."
V. Hygo

Duke përfunduar përshkrimin e skenës tronditëse të pushkatimit të Dakës, Melit iu njomën sytë. I mallëngjyer, ai i tha Diksit:

— Profesioni i detektivit paska qenë një mallëkim për ne. Sa shumë i kam merituar fjalët injoruese të një vajze italiane nga Bolonja dhe buzëqeshjen-akuzë të një detektivi rumun, të vrarë dikur në Bukuresht!

— Nuk mbaj mend të më kesh folur për gjëra të tilla – i tha me zë të ulët Diksi, i përfshirë deridiku edhe vetë prej emocioneve të bashkëfolësit.

— E di, e di që s'të kam folur për këto dy ngjarje. Megjithëse jemi kuptuar mirë bashkë, nuk doja t'i përmendja këto ndodhí. Tani do të t'i them, i nxitur nga dëshira hakmarrëse ndaj vetes, për ta pirë deri në fund kupën e hidhur që më ofroi fati.

«Dy vjet pasi kisha filluar profesionin e mallëkuar, u njoha me një vajzë nga Bolonja. Ishte e bukur, por e varfër. Nuk kishte as makinë të sajën. Mirëpo gjendja ekonomike nuk e pengonte fare që të ishte e gëzuar dhe krenare. Unë e kisha bërë si rregull t'i lija me takt një shumë të hollash, para se të ndaheshim. I kisha thënë se isha ekonomist dhe kisha shkuar për specializim në Itali. Ajo e kuptonte që unë të hollat ia lija me gjithë zemër dhe nuk fyhej, por i pranonte duke qeshur e duke më falënderuar.

«Pas ca kohësh, për fatkeqësinë time, m'u mbush mendja që emrin e saj t'ia rekomandoja qendrës sonë, si kandidate e mundshme për krijim baze. DSJ na kishte porositur që t'i gjuanim raste të tilla. Propozimi im u miratua menjëherë dhe unë u nisa për në Itali me disa çeqe nëpër xhepat sekrete. U takova me Xhildën (nuk do t'ia harroj emrin kurrë!) dhe vendosa të rrija dy ditë me të. Ditën e dytë, në një çast që unë e gjykova të volitshëm, fillova larg e larg sondazhet, për të përgatitur terrenin e përshtatshëm për propozimin tim. Fillimisht Xhilda nuk reagoi keq ndaj pyetjeve të mia të bëra enkas. Ajo kishte qënë më e zgjuar nga ç'e kisha gjykuar unë. Pasi m'u krijua përshtypja e gabuar se ajo ishte e epshme për synimin tim, i bëra propozimin, duke i vënë theksin begatisë ekonomike, që do t'i siguronte miratimi i ofertës nga ana e saj. Duke thënë fjalët e fundit, i nxora dy çeqe të majmë.

«Mjaftoi ky gjest i imi për ta transformuar atë në çast, nga një kone e llastuar në një luaneshë të egërsuar. M'i rrëmbeu çeqet nga dora, i afroi tek buzët e saj dhe pështyu mbi ta. Duke buzëqeshur me përçmim, ndërsa fytyra i ishte ndezur zjarr, m'i përplasi në gjoks. Gishtat, me të cilët kishte kapur çeqet, i fshiu fort pas xhaketës sime. Pastaj hapi me rrëmbim çantën, nxori prej andej disa kartmonedha të barasvlefshme me shpenzimet që kishim bërë atë ditë dhe m'i zgjati mua. Hezitova t'i mirrja, por ajo e kishte vendosur dhe më tregoi me gisht

policin diku tutje. I detyruar, i mora të hollat e Xhildës, të cilat më dukeshin si resto e turpit tim të madh. Nuk guxoja t'i drejtoja sytë mbi të. Me kartmonedhat ende në dorë, dëgjova të më thoshte me një ton përçmues:

— Hiqni dorë nga ky profesion i ulët! Eshtë e pamundur të mos pendohemi një ditë, po vazhduat në këtë rrugë.

«Më përshëndeti dhe u largua me hapin e saj të zhdërvjellët. Kur ktheu kokën për të parë në drejtimin tim, unë akoma nuk kisha lëvizur prej vendit. Shikimi i saj më solli në vete.

«Kishin kaluar më shumë se dy vjet nga kjo ndodhí dhe unë e kisha harruar pothuajse fare Xhildën, kur një ditë u ndodha përsëri në Bolonja. Ishte prag Krishtlindjesh. Unë kisha hyrë në një supermarket artikujsh ushqimorë dhe po sodisja disa vitrina tërheqëse. Papritur një dorë u mbështet lehtë mbi supin tim. U ktheva rrëmbimthi dhe, i tronditur, u ndodha ballë për ballë me Xhildën e bukur. Iu përgjigja përshëndetjes së saj i turbulluar, sikur takimi ynë i fundit të ishte zhvilluar vetëm disa orë më parë. Ajo e kuptoi menjëherë shkakun e vërtetë të hutimit tim dhe e vuri gishtin drejt e në plagë:

— Me atë profesion vazhdoni akoma? më pyeti, duke më fshikulluar me shikimin inteligjent të syve të saj të bukur.

«Nuk po dija ç'ti thosha, se ajo tashmë e kuptonte që unë nuk ndodhesha në Itali për *specializim*. Belbëzoja sa për të thyer heshtjen, pa thënë dot asgjë. I turpëruar nga kjo çoroditje para një femre, u rrotullova për tu larguar. Në çastin që i ktheva krahët, zëri i saj i ëmbël, me një tingëllim patetik, shqiptoi fjalët: "povero tu!". Kjo ishte etiketa e merituar e gjendjes sime të vërtetë. Para se të dilja nga porta përballë, ktheva edhe një herë kokën: ajo po më ndiqte me sy dhe atë çast më përshëndeti me dorë. Nuk guxova t'ia ktheja përshëndetjen dhe dola me nxitim nga supermarketi.

«Sa zili e kisha në ato çaste jetën e saj të shpenguar e gazmore! Isha gati të jepja gjithëçka vetëm për të shijuar, qoftë edhe për një moment, jetën e hareshme të asaj fluture italiane!

Ish-detektivi fliste me sytë të mbyllur përgjysmë e qepallet të njomura. Me siguri ai "ndodhej" përsëri në supermarketin tërheqës të Bolonjës dhe dora e ngritur e Xhildës në përshëndetjen e fundit të mbetur pa përgjigje, ishte simbol lamtumire i jetës së qetë, të gëzuar e të lirë.

Pasi e mbaroi tregimin, Meli mbështeti kokën në të dy pëllëmbët e duarve.

— Paske filluar të thinjesh edhe ti, si unë, – i tha Diksi për të ndërruar bisedë, duke parë fije të bardha nëpër flokët gështenjë të ish-detektivit.

— Edhe unë po thinjem, por jo si ti, – iu përgjigj pas pak Meli. – Ti thinjesh nga jeta e sforcuar, nga vuajtjet e përhershme dhe nga brengat që të kanë shkaktuar të tjerët, ndërsa unë thinjem nga vuajtjet dhe brengat që u kam shkaktuar të tjerëve dhe nga pendesa për të kaluarën time. Arrijmë në të njëtën pikë, të nisur nga dy antipode. Të gjithë ata që të njohin ty, e dinë përse jë thinjur dhe do të ta respektojnë thinjien e parakohshme. Të gjithë ata që më

njohin mua do të qeshin me thinjien time, ashtu siç qeshi dikur detektivi i vrarë, ndodhinë e të cilit do të ta tregoj tani.

*

Pa i lënë kohë Diksit të ndërhynte, për të mos ta lejuar të fliste për një ngjarje që do ta acaronte më tej gjëndjen e tij të tronditur, ish-detektivi nisi të fliste pa ndryshuar pozicion, me kokën në mes të të dy duarve:

— Isha regjur me peripecitë e profesionit tim, kur më nisën me mision në Bukuresht. Duhej likujduar një detektiv me banim në atë qytet. Kisha një javë që ndodhesha në kryeqytetin rumun dhe arrita të vihesha në gjurmë të personit të kërkuar. Atë mbrëmje ai ishte me dy shokë të tjerë në një park. Ndenjën deri vonë, se ishte verë e nxehtë. Dikur u duk se do të largoheshin të tre. Për fatin e tij të keq, ai u nda nga shokët dhe, ndërsa ata po largoheshin, detektivi shkoi tek një shatërvan aty pranë për tu freskuar. Në një çast të volitshëm veprova ndaj tij. Qëndrova pak për ta fotografuar (ashtu duhej). Pas spazmave të shpirtdhënies, fytyra iu tendos në një buzëqeshje të spikatur, e cila më tronditi jashtë mase. U largova i hutuar dhe, pas disa sorollatjeve të pakontrolluara, u gjenda përsëri përballë buzëqeshjes tragjike që po më torturonte. I ktheva krahët dhe, ndërsa zemra po më rrihte sikur do të çante kraharorin, tërhoqa këmbët zvarrë nga munda. S'di gjë se sa eca, vetëm mbaj mend se buzëqeshja rrëqethëse m'u shfaq për herë të tretë përpara.

«Në këtë krizë e sipër, e kuptova se gjendesha përballë një rreziku fatal: do të kapesha me presh në duar. Fillova të numëroj me zë, për të siguruar përqendrimin sa të mundja. Me përpjekje të mëdha, arrita të largohem zemërdridhur, se mos ballafaqohesha përsëri me buzëqeshjen fshikulluese.

Kur u qetësova në hotel, mendoja me vete:

“Vdekja e tij qeshte me jetën time.”

«Një varg të përafërt e kisha lexuar në një vepër të Shekspirit. Sfida e Xhildës dhe buzëqeshja në shpirtdhënie e këtij detektivi (e cila ishte më tepër sesa një sfidë) janë ndër kujtimet më të dhimbshme të jetës sime, në saje të të cilëve unë kam konstatuar rrëzimin tim në jetë.

XLIV

DIKTATORI HEQ MASKËN E MARKSISTIT

"*Koha do t'iu thotë gjithçka brezave të ardhshëm. Ajo është një llafazane që flet kur nuk e pyesin*."

Euripidi

Më 23 mars 1984 *Dofeni* e autorizoi baxhanakun e tij, Streton, të shkonte në kampin e Qafë-Barit, për të takuar detektivin e burgosur. Ai do t'i transmetonte një mesazh të rëndësishëm Melit në një takim kokë më kokë me të. Organizator i takimit do të ishte njeriu i DSJsë në kamp, kartelisti. Ky ishte një shanc i rrallë për dy shokët besnikë të bisedonin lirshëm, pa u shqetësuar fare se mos i pëgjonte ndokush.

Megjithëse ish-detektivi e kishte parashikuar që zhvillimi i mëtejshëm i ngjarjeve do të ishte befasues, Streto i tha qysh në fillim me një buzëqeshje të zbehtë:

— Përpiqu të ruash gjakftohtësinë, Hamit, se do të dëgjosh ngjarje që të luajnë tepelekun e kokës.

Ato ç'ka i tregoi Streto mikut të tij besnik e justifikonin plotësisht paralajmërimin e tij.

*

Pak ditë pasi Streto ishte kthyer në Tiranë pas takimit të fundit me Melin, atë e kishte thirrur *Dofeni* për një bisedë të rëndësishme. Baxhanaku i kishte bërë të ditur se së shpejti do të niseshin për në Londër: *Dofeni* vetë, Streto dhe një detektiv tjetër.

Më tej drejtori i DSJsë i kishte thënë:

— Unë të zgjodha ty, si një nga kuadrot më të aftë e më me përvojë në DSJ, për këtë udhëtim shumë të rëndësishëm në Londër. Njëkohësisht edhe si bashkëpunëtorin tim më të besuar dhe, për më tepër, si mikun tim personal. Dua të të bëj të ditur se *Misioni i Madh* organizohej për eliminimin e *Kobrës*, i cili ka arritur të arratisej dhe është vënë në shërbim të CIAs. Për më tepër, në takimin tripalësh, që do të zhvillohet në ambasadën amerikane në Londër, *Kobra* do të jetë i pranishëm përkrah palës amerikane. Pra, lufta e heshtur ia la fjalën diplomacisë së fshehtë. Në këtë takim me rëndësi të veçantë, i cili fillon më 15 mars, unë do të përfaqësoj palën shqiptare. Natyrisht, i mbështetur prej organizatorëve të këtij takimi, anglezëve. Dua që ti të zgjedhësh një shok ndër më të mirët, për të ardhur me ne. Ju të dy do të jeni shoqëruesit e mi. Duhet ta vendosësh qysh sot se cilin shok do të marrësh me vete, mbasi sonte babai do t'ju presë ju të dy për një bisedë të shkurtër, para nisjes sonë për në Londër.

Streto kishte zgjedhur si shoqërues të dytë të *Dofenit* detektivin Fatmir Merdari, shokun e tyre të kursit dhe të grupit komplotues. Duke pasur parasysh temperamentin pak prej rebeli të Merdarit, Streto e kishte porositur shokun e tij në prag të takimit me diktatorin:

— Fatmir, përpiqu të tregohesh disi entuziast gjatë audiencës me Hoxhën. Diktatorët janë të ndërgjegjshëm që meritojnë të urrehen, por pikërisht për këtë arsye ata nuk e durojnë dot ftohtësinë ndaj tyre, të cilën e quajnë shprehje urrejtjeje dhe të ndëshkojnë rreptë.

Në orën e caktuar, Streto dhe Merdari u paraqitën në vilën e Hoxhës. Ky i priti në prani të Nexhmijes dhe të *Dofenit*. Ligjërata e diktatorit kishte qenë shokuese për dy mysafirët e tij:

— Më 10 nëntor 1982 unë deklarova në televizion se *Kobra* dhe banda e tij ishin arrestuar dhe u ishin dorëzuar organeve hetimore. Në të vërtet ai është arratisur dhe aktualisht punon për CIAn. Qeveria jonë e ka dënuar atë me vdekje në mungesë. Për ekzekutimin e këtij vendimi ne organizuam *Misionin e Madh*, të cilin e pezulluam kur morëm vesh se *Kobra* mbrohet nga CIA. Por kjo çështje nuk përfundon me kaq. Në kuadër të këtyre zhvillimeve, është parashikuar një takim tripalësh në Londër midis CIAs, Inteligjencë Servisit dhe DSJës. Në përfundim të këtyre bisedimeve, të cilat nuk parashikohen të jenë të lehta, do të arrihet në një kompromis përfundimtar me leverdi reciproke.

«Shërbimi sekret shqiptar do të përfaqësohet në këtë takim prej drejtorit të DSJës, Ilirit. Një aleat i fuqishëm do të jetë përkrah nesh në këto bisedime: Inteligjencë Servisi. Interesat e veta e detyrojnë Anglinë të na mbrojë deri në fund në përplasjet me CIAn dhe *Kobrën*. Pra, në realitet bisedimet e Londrës do të jenë më saktë dypalëshe sesa tripalëshe. Debatet bazë do të zhvillohen midis CIAs dhe Inteligjencë Servisit. Ju jeni të rinj dhe do ta shikoni me sytë tuaj sesa të fortë janë anglezët në fushën e shërbimit inteligjent. Në këtë drejtim ata rivalizojnë në mënyrë të denjë me superfuqinë amerikane – aleatin e tyre të përjetshëm. Duke respektuar parimin e barazisë, është vendosur që bisedimet të zhvillohen në territorin anglez, por në godinën e ambasadës amerikane në Londër. Iliri nuk e ka përvojën e duhur për bisedime komplekse e me shumë të panjohura, prandaj ai ka nevojë edhe për mbështetjen tuaj morale gjatë ditëve që do të qëndroni në kryeqytetin anglez. *Kapiteni i mirë njihet në furtunë*. Në të mirë të së ardhmes së popullit e të atdheut, ju uroj rrugë e punë të mbarë!

XLV

I VDEKURI NGJALLET — TË GJALLËT ZVERDHEN

> "*Një komb, i cili është i mërzitur nga terrorizmat e qeverisë kombëtare deri në atë pikë, sa të preferojë invazionin e huaj dhe ta quaj si të vetmin shpëtim, është i dënuar fatalisht ta humbasë pavarësinë politike*."
>
> Fan Noli

Ditën e nisjes për në Londër, sytë e stërvitur të Stretos dhe të Merdarit kishin dalluar shenja tronditjeje tek *Dofeni*, pavarësisht se ky përpiqej ta zotëronte veten në pamje.

Takimi tripalësh kishte zgjatur një javë: nga data 15 deri më 21 mars 1984. Gjatë zhvillimit të bisedimeve Streto e Merdari prisnin në një holl të ambasadës. Shumë seanca duhej të kishin qenë *të nxehta*, mbasi anglezët qëndronin pranë *Dofenit* në intervalet e pushimeve, duke e inkurajuar. Në një rast, një zyrtar i moshuar anglez, pjesmarrës i takimit, i kishte hedhur dorën në qafë *Dofenit* dhe i kishte thënë në prani të Stretos e Merdarit:

— Mos u mërzit fare, djalosh. Gjithçka do të shkojë sipas parashikimeve tona. Le të na quajnë *luan* i *plakur*, por ne mbetemi gjithmonë luanë.

*

Një ditë pala angleze me *Dofenin* ishin tërhequr për konsultime. Përfaqësuesit e CIAs ishin të lirë. Papritur tek holli ku rrinin Streto me Merdarin kishte shkuar *Kobra* i shoqëruar prej një personi tjetër rreth të 45-tave, i cili e fliste rrjedhshëm shqipen. Shoqëruesi i *Kobrës* u ishte drejtuar Stretos dhe Merdarit me një gjuhë figurative:

— Kur *Kobrës* i hiqet dhëmbi i helmit, ai jo vetëm që nuk është më i dëmshëm por, përkundrazi bëhet shumë i dobishëmm për të luftuar *kobrat* e tjerë. *Kobra* nuk është më ai i dikurshmi; ka ndryshuar shumë. Tani ju mund të merreni vesh fare lehtë me të.

Krahasimi brutal e kishte fyer *Kobrën* në prani të Stretos dhe Merdarit, para të cilëve ai kishte qenë gjithmonë autoritar. Një venë e tëmthës së djathtë i kishte rrahur fort, por ai e kishte gëlltitur në heshtje fyerjen dhe kishte marrë fjalën:

— Një luftë e ashpër po zhvillohet për të ardhmen e Shqipërisë ndërmjet CIAs dhe Inteligjencë Servisit, që e quan çifligun e tij të kahershëm. Përpiquni të bëheni të dobishëm për vendin dhe për veten tuaj, sa nuk është vonë. Vini një gur për së mbari në themelet e së ardhmes së popullit tonë. Mundësitë për këtë do t'ju krijohen. Duke filluar prej muajit maj, në Shqipëri do të vijnë «turistë» [thonjëzat ai i kishte bërë me gishta në ajër] amerikanë me pasaporta franceze.

Bëni ç'është e mundur të merrni kontakt me ta. Porositeni Hamit Melin të mos angazhohet në favor të anglezëve në një situatë të tillë, se do të pendohet. Ju uroj mendjekthjelltësi në marrjen e vendimeve!

Pas këtyre fjalëve, ata ishin larguar të dy andej nga kishin ardhur.

Streto dhe Merdari nuk e kishin thyer heshtjen.

Kur kishin përfunduar bisedimet dhe ishin duke u kthyer në Tiranë, *Dofeni*, i tronditur e i zbehtë si fildishi, i kishte thënë baxhanakut:

— Guri, jemi katandisur që nuk vlejmë as sa një pallto demodé.

Trashëgimtari i diktatorit kishte nënshkruar në Londër fazën e dytë të kolonizimit sekret të Shqipërisë, atë pas vdekjes së diktatorit. Tradhtia kombëtare e trashëguar prej të atit i rëndonte sadopak në ndërgjegje *Dofenit*, i cili e nënshkroi atë akt tradhtie më 1984 në Londër, në të njëjtën moshë që i ati kishte nënshkruar marrëveshjen e parë sekrete të bashkëpunimit me Inteligjencë Servisin më 1943 në këmbim të pushtetit.

*

Pasi i shpjegoi ato që dinte rreth bisedimeve sekrete të Londrës, Streto i tha Melit:

— Arsyeja e vërtetë për të cilën *Dofeni* më nisi për këtu është se pritet që përfaqësues të Inteligjencë Servisit të të bëjnë ty së shpejti një propozim direkt, me qëllim që ta rifillosh karrierën në radhët e shërbimeve të tyre sekrete. Meqenëse je keqtrajtuar nga qeveria shqiptare në hetuesi e në burg, ata mendojnë të të tërheqin në Angli, duke të krijuar fushë veprimi në një klimë tjetër. *Dofeni* më ka dhënë një letër për ty. Gjithashtu më ka autorizuar të të them edhe verbalisht që të mos pranosh të mobilizohesh në radhët e Inteligjencë Servisit, pa u rikthyer më parë në DSJ. Sidoqoftë, kësaj here do ta kesh më të lehtë mospranimin e ofertës angleze, se përkrah tyj (në hije, natyrisht) do të jenë *Dofeni* dhe DSJ.

— Kur mund të vijnë *aleatët* londinezë këtu? e pyeti me ironi Meli.

— Brenda pesë ditësh, më tha *Dofeni*.

Ndërkohë filloi të binte çanga pa reshtur.

— Më duhet të iki tani – i tha Meli – Kemi mbledhje gjithë të burgosurit me komisarin.

— Atëherë, mirëupafshim nesër – e përshëndeti Streto.

— Mirëupafshim – ia ktheu ish-detektivi me pamje të menduar.

Ai u drejtua për në mensën e kampit, ku zhvilloheshin zakonisht mbledhjet. Bëhej një reçension i veprës së diktatorit *Rreziku angloamerikan për Shqipërinë*.

Me kokën të mbështetur mbi dy pëllëmbët e bashkuara të duarve, Meli dëgjoi për më se një orë ligjëratën pompoze të komisarit të kampit, mbi rolin historik të udhëheqësit legjendar, për mbrojtjen e *pavarësisë* së atdheut prej synimeve grabitqare imperialiste.

Ndërkohë ai mendonte për takimin e afërt me anglezët.

XLVI

ANKTH

> “*Duhet pritur gjithçka në politikë, ku gjithçka është e lejuar, me përjashtim të të qenit i befasuar*.”
>
> Sh. Morrà

Melit i kujtohej se shumë vite më parë kishte lexuar në një libër të hershëm deklaratën e një zyrtari të lartë anglez lidhur me synimet britanike ndaj Shqipërisë. Ajo mund të përmblidhej në këto fjalë:

«Ne do ta bëjmë Shqipërinë margaritarin më të ndritshëm të gjerdanit perandorak britanik.»

Në atë kohë ish-detektivi nuk i kishte kushtuar vëmendje kësaj deklarate mbasi, historikisht, edhe kur Anglia njihej si *mbretëresha e deteve* dhe perandoria britanike jetonte lavdinë e saj koloniale, gjerdanit të tyre perandorak i mungonte perla shqiptare. Me sa dukej atdheu kryeneç i *barinjve shqiptarë* nuk i përshtatej dot kolonizimit legal e botërisht të njohur, për tu pajtuar me një vend nderi në gjerdanin perandorak britanik.

«Aq më mirë për ne» – menduan projektuesit e atij gjerdani – «Margaritari shndrit më shumë në errësirë, sesa në dritë.»

Synimit të vjetër iu shërbye me metoda të reja. Kolonelë e gjeneralë me përvojë të Inteligjencë Servisit u instaluan për vite të tëra gjatë Luftës së Dytë Botërore pranë shtabit të përgjithshëm partizan, duke bërë të gjitha investimet e mundshme, në planin kombëtar e ndërkombëtar, për karrierën e ardhshme politike të Hoxhës. Me vizitën e tij misterioze në Londër në tetor 1983, diktatori antishqiptar i jepte *ok* testamentit politik të pasvdekjes në marrëdhëniet me padronët e tij anglezë, të cilat deri atëherë kishin qenë *top sekret*.

Në pritje të *mysafirëve* anglezë, Meli po përjetonte një ankth të paprovuar më parë. Për dyzetë vjet me radhë, populli shqiptar nën udhëheqjen e *partisë së lavdishme marksiste-leniniste* ishte krenuar se po ndërtonte kështjellën e vetme të komunizmit në botë, duke hedhur valle në gojën e ujkut imperialist.

Babai i Melit dhe gjithë brezi i tij kishin luftuar e vuajtur në varfëri për ndërtimin e socializmit, ndërkohë që diktatori i kërcënonte me grushtin lart në çdo kongres *militaristët* e Londrës dhe *imperialistët* e Washingtonit. Vetë Meli dhe kolegët e tij të DSJsë kishin rrezikuar jetën sa e sa herë në kuadër të luftës së ftohtë kundër imprializmit e revizionizmit. Ata nuk e kishin imagjinuar dot kurrë një skenar kaq kriminal e poshtërues të luftës për ndërtimin e socializmit imagjinar, ndonëse kishin hasur gjatë aktivitetit të tyre paqartësi të mbetura enigmë.

P. sh. Afrim Pahia në një rast kishte eliminuar në Kopenhagen të Danimarkës një detektiv japonez, i cili jo vetëm që nuk kishte qenë ndonjëherë në Shqipëri, por ndofta as nuk e dinte fare se ekzistonte një vend me këtë emër.

Për interesa të kujt duhej vrarë ai? Mirë 488 shqiptarët e arratisur që dëmtonin interesat e partisë, apo duheshin vrarë për hakmarrje ideologjike gjatë viteve që punoi Meli në DSJ, po mbi 1100 detektivë të huaj, shumica e të cilëve nuk kishin qenë kurrë në Shqipëri dhe nuk përmendej asnjë fakt për veprimtari antishqiptare në adresë të tyre, për interesa të kujt ishin goditur? Pse DSJ ua ndalonte detektivëve shqiptarë të shkonin në Angli, ndërkohë që ata bridhnin lirisht gjithë pjesën tjetër të Evropës?

Dikur Meli dhe kolegët e tij nuk u jepnin dot përgjigje këtyre pyetjeve, por qyshse diktatori hoqi maskën e marksistit dhe lavdëroi efikasitetin e *aleates* Angli, për ata ishte qartësuar e vërteta e një epopeje të tërë – epoka e socializmit spekulativ. Diktatori shahej ditën e puthej natën me *aleatët* londinezë. Një natë të tillë do të përjetonte së afërmi edhe Hamit Meli. Ky fakt po e turbullonte detektivin e burgosur.

*

Në orën nëntë paradite të 25 marsit 1984, DSJ i transmetoi me radiogram Stretos lajmërimin se të nesërmen, më 26 mars, në orën 22 e 30 minuta, do të zhvillohej takimi i përfaqësuesve të Inteligjencë Servisit me Hamit Melin. Në takim do të ishte i pranishëm edhe vetë *Dofeni*.

Po më 25 mars mbërriti tek zyrat e komandës së kampit të Qafë-Barit Pahia, të cilit i bënte shoqëri kartelisti. Ndërsa ditën që do të zhvillohej takimi, një përfaqësues i Sigurimit të Komitetit Qendror iu bashkangjit shoqërisë së kartelistit me Pahinë. Ndërkohë brenda në kamp nuk kishte tashmë asnjë agjent të DSJsë.

Takimi do të zhvillohej në të njëjtën dhomë, ku ishin zhvilluar dy takimet me *Dofenin*. Në orën e caktuar, vetë kartelisti e shoqëroi Melin deri tek hyrja e pasme e godinës ku ndodhej infermieria e kampit. Ish-detektivi u ngjit vetëm në katin e dytë. Në korridor po e prisnin Streto, Pahia dhe përfaqësuesi i Sigurimit të KQ.

— Eja vishu shpejt, Hamit, se tani fillon takimi – i tha Streto.

— 1 veshur jam; unë nuk po shkoj në opera – ia ktheu Meli serioz.

— Ka urdhëruar drejtori i DSJsë të vishesh me rroba të reja. I kanë sjellë kastile nga Tirana.

— Le t'i kenë sjellë edhe nga Londra. Unë do të shkoj me rrobat që kam veshur.

— Hamit, po deshe…

— Të lutem, Guri, ti e di që kur unë vendos, nuk ndryshoj qëndrim – ia preu shkurt Meli.

Streto nuk e zgjati më. Ai shkoi tek dera e dhomës ku do të zhvillohej takimi dhe kërkoi *Dofenin*. Mbasi shkëmbyen disa fjalë me zë të ulët, Streto u kthye sërish tek Meli. Ai e njoftoi se mund të shkonte në takim me uniformën e kampit, gjersa e kishte vendosur kështu. Pastaj ai i pëshpëriti tek veshi:

— Bëj kujdes, Hamit! Personi që kryeson takimin ka qenë pjesëtar i palës angleze në bisedimet e Londrës.

XLVII

ALEANCË SEKRETE APO KOLONIZIM SEKRET ?

"*Dashuria që kanë anglezët për lirinë nuk i pengon ata të pranojnë skllavërinë e të tjerëzve*."

V. Hygo

Kur hyri Meli në dhomë, gjithë të pranishmit u çuan në këmbë. Ai u takua me ta dhe u ul në vendin që i kishin rezervuar. Atje ndodheshin katër anglezë dhe *Dofeni*. Ish-detektivit i bëri përshtypje fakti që përkthyesi ishte anglez.

Takimin e kryesonte një person i thinjur, rreth 65 vjeç, me trup të drejtë e i mbajtur mirë. Një palë syze të ndritshme ia fshehnin sytë. Në të dy anët e tij ishin ulur dy zyrtarë të tjerë anglezë me moshë rreth të pesëdhjetave. Njëri prej tyre qëndronte paksa më i tërhequr, me një kamerë të vogël në dorë. Përkthyesi, një djalosh i shëndetshëm, me fytyrë të lezetshme dhe barseta të gjera, ishte ulur pranë Melit. *Dofeni* kishte zënë vend në ballë të tavolinës së gjatë.

Kur Meli u ul, kryesuesi i takimit i hodhi një shikim të vëmendshëm kokës së qethur të të burgosurit të qëndisur nga thinjat, fytyrës së murrëtyer me mustaqet e shkurtra majëzverdhura, syve të kaltër, të mullosur e me rrathë mavi dhe peliçes së tij të pambuktë të grisur në disa vende e dalëboje krejt. Mandej ai pyeti *Dofenin*:

— Ky është Hamit Meli?

Pasi mori përgjigje pohuese, anglezi nxori një fotografi prej një albumi që kishte përpara dhe ia zgjati ish-detektivit, duke i thënë:

— I hidhni një sy kësaj fotografie dhe bëjeni vetë krahasimin; keni ndryshuar shumë.

Meli shikoi fotografinë, buzëqeshi hidhur, dhe ia ktheu atë përsëri anglezit, pa thënë asnjë fjalë. Fotografia ishte e vitit 1972, kur Meli ishte 23 vjeç. Ky kishte qënë një vit i bujshëm në karrierën e tij si detektiv.

Pas një heshtjeje të shkurtër, anglezi vazhdoi:

— Midis qeverisë sonë dhe partisë suaj ka ekzistuar gjithmonë një aleancë e fuqishme, e cila, për të qënë efikase, është lypsur të mbahej sekrete. Kjo aleancë ka lindur qysh në vitet e Luftës së Dytë Botërore, kur, si aleatë me njëri-tjetrin, ne luftonim nazi-fashizmin.

Ndërsa anglezi fliste, *Dofeni* tundte kokën në shenjë miratimi.

— Në të gjitha situatat e vështira që ka kaluar partia juaj, dhe ato nuk kanë qenë të pakta, – theksoi anglezi – ne ia kemi ofruar ndihmën tonë si miku mikut. Por ja ku erdhi një çast që ndihma jonë nuk duhet kufizuar vetëm në kanalet e diplomacisë së fshehtë, por duhet të jetë e pranishme edhe në riorganizimin e shërbimit sekret shqiptar, pas ngjarjeve të fundit politike në Tiranë. Dihet që shërbimi sekret është rrënja e çdo shteti. Kuadrot e DSJsë, si njerëz të profesionit, e kuptojnë rëndësinë e ruajtjes së sekretit të këtij bashkëpunimi, për

të cilin ata aktualisht janë dëshmitarë okularë. E njëjta gjë kërkohet edhe nga ju vetë, pavarësisht se këto bisedime po i zhvillojmë në një kohë që ju jeni i burgosur politik i regjimit në fuqi.

«I kam dëgjuar të regjistruara bisedat që ju keni zhvilluar me eprorët e DSJsë. Më vjen mirë që e keni në konsideratë të kaluarën tuaj dhe të familjes suaj. Për ne sonte ju jeni ai që keni qenë dikur për DSJnë: detektivi më rezultativ dhe më i talentuar, ylli i padiskutueshëm i shërbimit sekret shqiptar. Harrojeni momentalisht gjendjen në të cilën ndodheni, përpiquni të çliroheni nga mbresat e hetuesisë e të burgut, para se të vendosni për të ardhmen tuaj. Është në të mirën tonë të përbashkët, që ju të rikrijoni figurën e shkëlqyer të karrierës suaj të dikurshme. Ne nuk do të kursejmë asgjë për t'iu ndihumar në këtë drejtim.

«Duke studjuar thellësisht karakterin tuaj nëpërmjet materialeve që na janë servirur dhe duke mbajtur parasysh trajtimin e pamerituar që ju është bërë në hetuesi e në burg, ne e shikojmë të udhës që ta evitoni kontaktin vizual me eprorët e Tiranës, të paktën përkohësisht, në startin e karrierës suaj të ardhshme. Meqenëse tani e tutje Inteligjencë Servisi dhe DSJ do të veprojmë si dy shërbime sekrete aleate, ne kemi menduar që ju ta rifilloni karrierën tuaj duke milituar në radhët e shërbimeve sekrete britanike. Besoj se e kuptoni lehtë, që edhe atje ju do të kontribuoni për interesat e larta të vendit tuaj.

Ndërsa zyrtari anglez po thoshte fjalët e fundit, Meli nxori qetësisht nga xhepi i peliçes së pambuktë një fletë letre, të cilën e shpalosi përpara vetes. Pastaj me një copë laps bëri një shenjë mbi të. Sapo anglezi pushoi së foluri, Meli u përgjigj:

— Në qoftë se unë do të kisha urrejtje për eprorët e DSJsë, ajo nuk to të ishte thjesht vizuale dhe nuk do të shuhej në saje të largësisë gjeografike që do të më ndante me ta.

— Çfarë e keni atë letër përpara? u interesua ta dinte anglezi.

— Unë vuaj nga sistemi nervor e herë-herë edhe nga mungesa e përqendrimit të duhur në të menduar e në të shprehur, zotëri. Veç kësaj, unë jam një i burgosur politik dhe ndonjë gabim në diskutim mund të më krijojë probleme. Në këto rrethana jam i detyruar t'iu referohem në të folur disa shënimeve paraprake që kam bërë, në saje të të cilëve orientohem.

Ndërkohë që përkthyesi po i transmetonte fjalët e fundit të të burgosurit, zyrtari anglez buzëqeshi lehtë, fërkoi për një çast unazën e gjerë e të bardhë që mbante në gishtin përkatës të dorës së majtë, dhe pastaj i adresoi Melit këto fjalë:

— Nuk duhet t'ju shkojë mendja gjithmonë për keq; kjo dukuri e pengon mirëkuptimin tonë. Si rrjedhojë, ajo vështirëson arritjen e suksesit të takimit tonë. Ju keni arësye të manifestoni shqetësime të tilla, si pasojë e pasigurisë që ju ka shoqëruar nga dita e arrestimit e në vazhdim. Ne e kuptojmë këtë. Por, nga ana tjetër, unë nuk kam aspak dyshim se ju jeni plotësisht në gjendje të vlerësoni drejt rrethanat e reja që ju krijohen me pjesëmarrjen tonë në këtë takim.

«Përsa i pëket propozimit tonë, unë mendoj se është e pamundur të mos t'ju krijojë një farë ngacmimi për qetësinë tuaj shpirtërore prania e eprorëve të DSJsë. Ata ua kanë pohuar me gojën e tyre, se ju mbeten borxhlinj për trajtimim e ashpër që ju është bërë në hetuesinë speciale, pavarësisht se drejtuesit e sotëm të DSJsë nuk kanë qenë atëherë.

Meli iu përgjigj me sytë mbi letër, pa e shikuar anglezin:

— Edhe në qoftë se do të ekzistonte një ngacmim i tillë për qetësinë time shpirtërore nga prania e eprorëve shqiptarë, ai do të ishte i papërfillshëm përballë dashurisë dhe respektit të thellë që ushqej unë për popullin dhe për vendin tim, të cilëve u këndoi me aq pasion e dashuri shtegtari juaj romantik, Bajroni i madh.

Zyrtari anglez qeshi. Ndofta këtë qeshje me ëndje profesionistit të regjur të Inteligjencë Servisit ia frymëzoi ideja se kjo *Nënë e rreptë burrash të egër* (siç e quante poeti anglez Shqipërinë) ishte koloni e fshehtë e tyre dhe përballë tij ndodhej një bir plangprishës i saj.

Pasi i nguli shikimin e tij zhbirues që poshtë xhamave të ndritshëm të syzeve fytyrës zeshkane të Melit, i cili në atë çast po thithte cigaren, anglezi bëri një vërejtje sa të hollë edhe pikante:

— Do të ishte mjaft e pëlqyeshme nga ana e jonë, sikur ju të thoshit gjithmonë vetëm atë ç'ka ndieni për çështjen që flisni.

Nën ndikimin e shikimit të përqendruar të anglezit, Meli ngriti sytë mbi xhamat e syzeve të bashkëfolësit. Aludimi i hollë i zyrtarit anglez rreth mungesës së sinqeritetit të detektivit të burgosurit për ato që kishte thënë e sëmboi Melin me sistem nervor të acaruar. Të tregohej hipokrit në ato rrethana, ku nuk i kishte mbetur gjë tjetër për të humbur veç lëkurës, dorëzimi i të cilës do të ishte fundi i kalvarit, ishte shumë fyese për sedrën e sëmurë të Melit. Ndërkohë ai e kuptonte se, që përgjigjja e tij të ishte e efektshme në masën e nevojshme, duhej që gjyqit të ndërgjegjes, që i kishte bërë anglezi, t'i përgjigjej në të njëjtën mënyrë.

I burgosuri e përqendroi shikimin në letër dhe iu drejtua dialoguesit me një pyetje:

— Si është e mundur që të vlerësohet *e pranueshme* nga ana e juaj ndërgjegjja e një detektivi, që për motive personale do të sakrifikonte interesat e larta të vendit të tij? Sa më i shtirë të jetë sot ai në sjellje, aq më i rrezikshëm do të jetë nesër në aktivitet, i lirë e i armatosur.

I vëmendshëm në fjalët që po i përkthehesin, kryesuesi i takimit heshti për një çast, kur Meli mbaroi së foluri. Pastaj u duk sikur deshi të thoshte diçka, por ndryshoi mendim. Mori kafen që i servirën atë çast dhe nisi ta pinte në heshtje.

XLVIII

DOFENI ENTUZIAST

"*Nuk duhet gëlltitur besim më shumë nga sa mund të tretësh*."

H. Helis

Që nga çasti që Meli nuk kishte pranuar të vishte rroba të tjera, *Dofeni* kishte dyshuar mjaft në sjelljen e të burgosurit gjatë takimit me anglezët. Por gradualisht ai e kishte mbledhur veten, duke konstatuar reagimet e kujdesshme të Melit. Në kohën që po pinin kafe të shoqëruar me një pije me ngjyrë, drejtori i DSJsë pothuajse çakërrqejf, bënte spirale në ajër me tymin e cigares. Për mendimin e tij, ajo copë letër që i kishte dërguar detektivit të burgosur me Streton e kishte bërë tamam punën.

Meli pinte kafe, si gjithë të tjerët, por pijen me ngjyrë nuk e preku. Cigaret i ndizte njërën pas tjetrës. Përkthyesi anglez, shumë i zellshëm e i shkathët, nuk e la të burgosurin ta ndezte asnjëherë nga paketa e tij pa filtër e me duhan të rëndomtë.

Pasi e piu kafen përgjysmë, kryesuesi i takimit foli me zë të ulët me njërin prej kolegëve të tij dhe pastaj iu drejtua Melit:

— Gjatë takimeve që keni zhvilluar me eprorët e Tiranës, ju e keni vënë theksin mbi gjendjen tuaj të rëndë shëndetësore, si një ndër shkaqet kryesore të mospranimit për tu riaktivizuar. Ne ju japim fjalën se do t'ju kurojmë në mënyrë të tillë, që edhe ju vetë do të habiteshit me gjendjen shëndetësore që do të përfitonit.

— As eprorët e Tiranës nuk kursehen për kurimin tim – ia ktheu ish-detektivi. – Edhe ata më kanë premtuar se do të më kuronin në klinikat më të mira të botës për disa muaj. Nëpërmjet jush, edhe ata tani kanë mundësi të barabarta për një gjë të tillë. Duke i llogaritur të kuruesheme pasojat patologjike të organizmit tim të rrënuar, dobësimi i reflekseve profesionale mbetet një ndër pengesat kryesore, të pakapërcyeshme për mendimin tim.

— Ne ju sigurojmë se edhe reflekset profesionale do t'ju ripërtriheshin me ndihmën mjekësore dhe me ushtrimin e kurseve speciale të shkollës sonë të shërbimit sekret.

— Të gjitha këto ndihma ju mund të m'i siguronit edhe në Tiranë. Me specialistët tuaj, një kursi të tillë unë mund t'i nënshtrohesha edhe në DSJ, po të arrinte atje puna.

— Pse këmbëngulni kaq shumë në qëndrimin tuaj në Shqipëri? Çfarë përshtypje krijon në psikologjinë tuaj rifillimi i karrierës në radhët e një shërbimi sekret të huaj, por aleat me DSJnë?

— Një ofertë e tillë në kushtet e të burgosurit politik, ku unë kam humbur të drejtat e qyetarit të lirë të Republikës, por jo të drejtën e kësaj qytetarie, më tingëllon si një ridënim me mohim nënshtetësie.

— Po fakti që vëllai juaj militon në radhët e DSJsë, nuk ju ngarkon me asnjë detyrë në ndërgjegje, për të ndihmuar vëllanë më të vogël e pa përvojën e duhur dhe që, mbi të gjitha, ndodhet atje vetëm për shkakun tuaj?

— Vëllai im duhet të kryej me ndërgjegje detyrat që i ngarkohen, pa e çuar mendjen fare tek unë. Ndërkohë unë nuk duhet të marr përsipër një detyrë që i tejkalon mundësitë e mia, vetëm për hir të faktit se vëllai im militon në radhët e DSJsë.

— Po ju them, pa mburrje, se vetëm gjatë vitit të kaluar mbi tre mijë detektivë të huaj kanë kërkuar të punonin për interesat e shërbimeve tona sekrete; madje me kushte të diktuara nga ana jonë. Ndërkohë ne po ju bëjmë kërkesë këmbëngulëse të angazhoheni në radhët e Inteligjencë Servisit, ndërsa ju nuk pranoni. Mos vallë ky është një nënvleftësim nga ana juaj për shërbimet tona sekrete?

Meli, i cili e kishte të qartë se as ai që i tha këto fjalë nuk i besonte, buzëqeshi duke menduar me vete: *një ish-detektiv i DSJsë guxon të nënçmojë njërin prej shërbimeve sekrete më të fuqishëm të botës*!?

Pa e shuar buzëqeshjen, ai u përgjigj:

— Nuk besoj se ka ndonjë detektiv serioz në botë që t'ia lejojë vetes të nënçmojë shërbimet sekrete britanike, të cilat rivalizojnë për vendin e parë përkrah shërbimeve sekrete më të fuqishëm të kohës. Sikur të kisha mundësi t'i përgjigjesha pozitivisht ofertës suaj, unë as nuk e imagjinoj dot se çfarë vendi mund të zija atje.

— Një vend nderi – ia priti flakë për flakë zyrtari anglez, duke e shfrytëzuar në maksimum edhe minimumin e mundësisë që i krijoi Meli me shprehjen e tij të shkujdesur.

Sakaq ish-detektivi u përpoq ta mbyllte aty për aty të çarën që krijoi:

— Një vend nderi i një shërbimi sekret prestigjioz, si i juaji, do të ishte një shumëfish i mundësive të mia edhe para se të më ndodhte ky erozion i vlerave profesionale që kam pësuar.

— Një prej arkitektëve të shërbimit sekret shqiptar, duke diskutuar në rrethana disi të veçanta për çështjen tuaj, u shpreh:

«E para fjalë që ka mësuar Meli në jetë është "jo". Dhe po e tha një herë atë fjalë, është kohë e humbur kot të merresh më tej me të.»

«Me sa po shikoj unë, ai paska pasur shumë të drejtë – tha anglezi.

Melit i shkoi mendja tek takimi tripalësh i Londrës ku, sipas fjalëve që u kishte thënë *Kobra* Stretos dhe Merdarit në hollin e ambasadës amerikane, duhej të ishte diskutuar kalimthi dhe çështja e tij. Pas një pauze të shkurtër, ai u përgjigj:

— Vlerësimi i tij nuk ka qenë i bazuar, zotëri. Përkundrazi, unë mendohem mirë para se të them "*po*" ose "*jo*".

Kryesuesi i takimit ndryshoi temë:

— A keni njohur ndonjë angleze gjatë aktivitetit tuaj?

— Po, kam njohur një vajzë që vazhdonte studimet në universitetin e *Sorbonës*.

— A ju ka lënë mbresa të mira? pyeti i buzëqeshur zyrtari anglez.

— Shumë të mira.

Ish-detektivi thoshte të vërtetën. Njohjen me atë vajzë, e cila binte në sy në fakultetin e saj, Meli ia kishte përshkruar me detaje Diksit. Kujtim i veçantë prej studentes angleze ishte fakti që ajo kalonte në orgazëm duke qarë prej eksitimit.

— Si e quanin? e pyeti bashkëbiseduesi.

— Nuk ia them emrin – iu përgjigj me të qeshur Meli.

— Do të bënit më mirë, po të na i thoshit – insistoi anglezi.

— Bëhet fjalë për një ngjarje të kaluar, e cila nuk paraqet asnjë interes për tu përmendur – ia ktheu Meli.

— Mirë, atëherë, a mund të na thoni se cilat fermra ju kanë pëlqyer më shumë?

— Italianet.

— Me sa më kanë thënë, ju jeni marrë mjaft me femra, megjithëse DSJ ka synuar t'ju kufizojë deri në një farë mase. Ndërsa disiplina profesionale e Inteligjencë Servisit nuk e përfshin një klauzolë të tillë. Përkundrazi, detektivët më të shquar anglezë kanë spikatur edhe në marrëdhëniet me femrat. Ne mendojmë se marrdhëniet me femrat, kur detektivi nuk bëhet skllav i ndjenjave, i stimulojnë rezultatet e tij profesionale.

— Jam i të njëjtit mendim me ju – e aprovoi Meli.

— Cili ka qënë misioni më i vështirë i karrierës suaj? – ndryshoi përsëri temë kryesuesi i takimit. – Unë mendoj se misioni më i vështirë mund të mos dalë ai që është parashikuar për i tillë. Madjé mund të rastisë që detektivi të hasë vështirësi të paparashikuara për kryerjen e një misioni edhe kur është në kulmin e rendimentit profesional.

— Ndaj të njëjtin opinion me ju.

Meli filloi të fliste për misionin më të vështirë që kishte kryer.

Si për të ilustruar karrierën e shkëlqyer të detektivit të burgosur, anglezi i tha:

— Në vitin 1972 ju, së bashku me një anglez dhe një japonez, keni qenë njëri prej tre detektivëve më rezultativë të botës, përsa i përket numrit të misioneve të realizuar brenda një viti. Arritjet tuaja janë një krenari e vërtetë për DSJnë, si shërbim sekret i vogël e relativisht i ri.

Duke përfituar nga rasti, Meli, i nxitur nga kureshtja profesionale, bëri pyetjen e parë:

— Sa është shifra më e lartë e realizuar prej detektivëve tuaj më të mirë gjatë karrierës së tyre? Besoj se kjo nuk përbën sekret.

— Aspak. Ja ku po ju a them unë: 170. Ata janë krenaria e Inteligjencë Servisit – shtoi anglezi duke i theksuar mirë fjalët.

XLIX

FAJTORËT BËHEN GJYKATËS

"*Fjalët janë droga më e fuqishme*
e përdorur për mashtrim."
R. Kipling

Pas një hopi heshtjeje të përgjithshme, kryesuesi i takimit i dha bisedës një kthesë befasuse:

— Në vitin 1974 ju keni vrarë një detektiv francez me origjinë angleze. Ne kemi të drejtë t'ju kërkojmë llogari për gjakun e tij.

Tashmë Meli ishte i sigurtë se jo vetëm ai detektiv, por dhe shumë të tjerë si ai, ishin goditur nga DSJ me rekomandim dhe për llogari të Inteligjencë Servisit. Çfarë aktiviteti antishqiptar mund të kishte kryer një detektiv francez me origjinë angleze, i cili nuk kishte qenë kurrë në Shqipëri?

Duke sjellë ndërmend këta fakte irritues, Meli i hodhi një shikim të rreptë fytyrës së anglezit, i cili, pasi e kishte lëshuar si "pa teklif" atë shprehje akuzuese, po shfletonte me nge albumin që kishte përpara. Ishte albumi i misioneve të realizuar nga detektivi i burgosur, të renditura në mënyrë kronologjike. Pa i shkëputur sytë prej fytyrës së anglezit, Meli i tha:

— Shfletojeni pak nga fillimi albumin që keni në dorë. Në të do të shikoni edhe fytyrat e dy shqiptarëve të vrarë pa qenë fare detektivë. Bashkëkombasi juaj, edhe sikur të jetë goditur pa ndonjë arsye tjetër, të paktën ishte detektiv, profesionist i shërbimit sekret. Aktivitetin tim të dikurshëm unë e kam kryer për interesat e larta të vendit tim; të paktën kështu më thuhej. Është interesant fakti që unë si detektiv duhet t'i jap llogari qeverisë suaj për misionet e kryer prej një shërbimi sekret aleat, i drejtuar nga një parti me të cilën, sipas fjalëve tuaja, keni pasur aleancë të përhershme sekrete.

Anglezit i kaloi një hije buzëqeshjeje në fytyrë. Pa i shkëputur sytë prej albumit, ai u përgjigj:

— Pranimi i ofertës sonë mjekon shumë plagë tuajat.

Detektivi i burgosur ia priti përnjëherë:

— Në qoftë se misionet tona të dikurshme sot quhen krime, unë nuk do të pranoja kurrë që ndëshkimin e mundshëm të një krimi të kryer ta evitoja duke kryer një ose disa krime të tjerë.

Anglezi nuk foli më. Kuptohej që ai nuk kishte parashikuar një zhvillim të tillë të dialogut. Fillimisht atij i ishte dukur një veprim i padenjë matja e forcave si i barabartë me një njeri të shpërfytyruar prej vuajtjeve të burgut. Por realiteti kishte folur ndryshe. Gjatë gjithë dialogut ish-detektivi kishte dhënë përgjigje të holla e të qëdrueshme, nëpërmjet të cilave ai ia kishte arritur të mbronte personalitetin dhe synimet e tij.

*

Duke shfletuar albumin e hapur mbi tavolinë, zyrtari anglez po shikonte me vëmendje shënimet përbri fotografive, të cilat ilustronin misione të ndryshme. Megjithëse ato nuk ishin të shkruara në gjuhën e tij, ai e kuptonte lehtë, me intuitën e profesionistit të thinjur, se ata emra qytetesh me shkronja latine ishin skenat e misioneve të kryer prej të burgosurit që kishte përballë: Bari, Athinë, Lisbonë, Bruksel, Varshavë, Barcelonë, Amsterdam, Baku, Marsejë, Ankara, Oslo, Beograd etj, etj..

Anglezi i shkëputi për një çast sytë prej albumit dhe e përqendroi shikimin mbi ish-detektivin.

— A ndienit kënaqësi kur qarkullonit nëpër Evropë në moshë të re, për të kryer misionet tuaja? e pyeti.

— Fillimisht po – u përgjigj Meli. – Pastaj gjithmonë e më pak.

— Sipas vlerësimit tuaj, cila do të ishte renditja e merituar e shteteve më kryesorë të Evropës, në bazë të kontributit që kanë dhënë popujt e tyre për zhvillimin kombëtar dhe të mbarë njerëzimit?

— Italia, Gjerm...

— Akoma s'i largon dot për asnjë çast nga mendja *sinjorinat* e bukura italiane? ndërhyri anglezi, duke ia ndërprerë fjalën në mes.

I befasuar prej këtij veprimi, që binte ndesh me maturinë dhe gjakftohtësinë e treguar deri atë çast prej drejtuesit të takimit, i burgosuri heshti, me një buzëqeshje të ngrirë në buzë. Ai deshi të thithte cigaren, por i ishte fikur. Përkthyesi anglez, i gatshëm si gjithnjë, ia ndezi me çakmakun e tij.

Ndoshta për të kompensuar disi nxitimin e tij të pazakontë, zyrtari anglez po e shikonte i buzëqeshur Melin në heshtje. Pyetjen e radhës ai ia drejtoi pa e fikur buzëqeshjen:

— Mirë që nuk dashkeni më të militoni në shërbimin sekret por, të paktën, pse nuk pranoni të jetoni i lirë?

— Unë jam një i burgosur politik i dënuar nga të njëjtët ligje si gjithë bashkëvuajtësit e mi. Nuk dëshiroj që e kaluara ime, së cilës unë nuk i shërbej dot më, të më ofrojë privilegje të veçanta – qe përgjigjja e Melit.

Anglezi nuk e zgjati më bisedën. Këto pyetje, të cilat nuk kishin lidhje të drejtëpërdrejtë me qëllimin e takimit, tregonin se ai nuk priste më asnjë ndryshim në qëndrimin e të burgosurit.

Drejtuesi i takimit u çua në këmbë. Të njëjtën gjë bënë edhe të tjerët. Ai iu drejtua Melit me këto fjalë:

— Po ju a them hapur: kam tre vjet më shumë se mosha juaj që militoj në këto organe dhe një zhgënjim të tillë nuk e kisha provuar ndonjëherë. Mendoj se juve nuk duhet t'ju imponohet më asgjë. Besoj se edhe zoti Ilir i këtij mendimi do të jetë. Për konsideratën time çështja juaj paraqet një interes të veçantë. Për këtë do të vë në dijeni edhe kolegët e mi në Londër. Gjithmonë do të pyes për ju.

Duke thënë fjalët e fundit, ai i zgjati dorën Melit. Në pritje të këtij çasti, detektivi i burgosur e ruante në majë të gjuhës shprehjen me të cilën kishte vendosur ta mbyllte këtë takim:

— Në qoftë se Anglia do të ishte Shqipëri e Shqipëria Angli, dhe një anglez i ndodhur në rrethanat e mia do ta kishte pranuar ofertën që m'u bë mua sonte, vetëm atëherë unë ju a njoh të drejtën për të më urryer. Në rast të kundërt, dëshiroj të ndahemi si miq të mirë, ashtu siç ju vlerëson regjimi ynë në fuqi.

Drejtuesi i takimit bëri një gjysmë rrotullimi dhe u lëshua mbi kolltuk. Edhe të tjerët u ulën përsëri, me përjashtim të të burgosurit.

Si ndenji pak në heshtje, zyrtari anglez i zgjati përsëri dorën Melit, pa thënë asnjë fjalë. Ashtu vepruan edhe kolegët e tij. Ndërsa *Dofeni*, i entuziazmuar, i shtrëngoi fort dorën me të dy të tijat.

Në sallon Melin po e prisnin me padurim Streto e Pahia. Kur morën vesh sesi ishte mbyllur takimi, ata e shtrënguan fort në krahë shokun e tyre të burgosur. Ndërkohë me ta u bashkua edhe *Dofeni* buzagaz dhe përfaqësuesi i Sigurimit të KQPPSH. Tepër i kënaqur, drejtori i DSJsë u takua përsëri me Melin, duke i thënë:

— Nuk të lëmë më vetëm në kamp. Do t'i them Fatmir Merdarit të vijë të rrini ca ditë bashkë, sa të shmalloheni. Të lumtë, Hamit, na nderove me të vërtet!

Detektivi i burgosur u takua ngrohtësisht me shokët dhe doli.

Frynte një erë e lehtë nga lindja dhe bënte ftohtë. Ai mbërtheu mirë peliçen e pambuktë dhe nxitoi hapat mbi dëborën e ngrirë. Sytë i shkuan tek çizmet e çara të llastikut, për shkak të të cilave duhej t'i hidhte hapat me kujdes.

«Si tollumbat e *Lulit të vocërr*» – tha me vete dhe mendja i shkoi përsëri tek Migjeni, i cili kishte jetuar dikur këtyre maleve.

«Si do të shkruante, vallë, poeti elokuent i mjerimit, po të kishte qenë dëshmitar i takimit të kësaj nate?»

Me këtë pyetje të mbetur pezull në mendje, e zuri gjumi në *maune*.

L

HESHTJE ANKTHNDJELLËSE

"*Pritja është një zinxhir që lidh të gjitha dëshirat tona*."

Monteskië

Pas takimit me anglezët, Meli priste nga dita në ditë futjen në kamp të detektivit Fatmir Merdari. Ky ishte premtim i vetë drejtorit të DSJsë dhe atij nuk ia bënte dot fjalën dy askush.

Fatmir Merdari ishte me origjinë nga Korça, por lindur e rritur në Tiranë. Ai ishte njeri i komunikueshëm, inteligjent, mjaft guximtar, por paksa i rrëmbyer. Në këtë cilësinë e fundit, e cila nuk i përshtatej mirë profesionit të detektivit, Merdari ngjasonte me vetë Melin. Ndofta kjo veti e përbashkët kishte ndikuar në lidhjen e një shoqërie të fortë midis tyre. Ata kishin ndërmarrë edhe misione të përbashkëta jashtë shtetit, që i kishin realizuar me sukses.

Kuptohej që *Dofeni* ishte vënë në dijeni të shoqërisë së dikurshme ndërmjet Melit e Merdarit, prandaj e kishte vënë gishtin pikërisht mbi këtë të fundit, për ta autorizuar të *burgosej* përkohësisht në kampin e Qafë-Barit, që t'i bënte shoqëri mikut të tij të hershëm.

Mirëpo ditët po kalonin dhe Merdari nuk po dukej. Fillimisht Meli mendoi se ai ndodhej me shërbim jashtë shtetit. Mbasi të kthehej në Tiranë, udhëtimin e parë ai do ta bënte me siguri për në kampin e Qafë-Barit.

Kaluan dy javë nga dita e takimit me anglezët dhe heshtja vazhdonte ende. Bile jo vetëm që Merdari nuk po bëhej i gjallë, por Meli nuk po merrte asnjë sinjal edhe prej shokëve të tjerë. Detektivi i burgosur ishte i bindur se *Dofeni* u nda mjaft i kënaqur prej tij, si asnjëherë më parë. Në pamundësi të Merdarit, për çfarëdolloj arsyeje, drejtori i DSJsë do të dërgonte dikë tjetër në kamp, për ta sqaruar Melin si qëndronte puna.

Nga ana tjetër, edhe Streto e Pahia me shokë nuk do të linin gur pa lëvizur për ta vënë në dijeni Melin rreth arsyes së vonesës, ndërkohë që e dinin shumë mirë se bashkëluftëtari i tyre i burgosur kishte të drejtë të shqetësohej.

I bindur se diçka kishte ndodhur, Meli ia shprehu shqetësimin e tij Diksit:

— Nuk më duken mirë punët, Sazan; ka diçka që nuk shkon në këtë mes. Guri me shokët e dinë mirë se kjo heshtje e gjatë e tyre ne na lë në ankth të madh. Aq më tepër që, sipas fjalëve të Gurit në takinim e fundit, ata kanë krijuar një goxha grup shokësh të profesionit, të vendosur për t'iu kundërvënë interesave angleze dhe diktatorit në rrethanat injoruese ku po punojnë aktualisht. Në luftën e heshtur e keqja mund të të gjejë atëherë kur nuk e pret fare.

«Guri më vuri në dijeni se kishin në plan të rrëmbenin ndonjë anëtar të elitës drejtuese të misionarëve anglezë që bujnë në hotel *Tirana* si turistë. Bile vetë shefin do ta gjuanin si macja dhjamin. Donin t'i bënin një hetuesi të fortë, për ta detyruar të shprehej rreth planeve të tyre të ardhshme për Shqipërinë. Ka

të ngjarë që, duke u përpjekur për të realizuar këto synime, diçka t'iu ketë ndodhur. Përndryshe ata nuk do të rrinin kurrë mbi dy javë në heshtje. Të paktën kalimthi do të dukej patjetër ndonjëri prej tyre. Duhet të përgatitemi për lajme të këqija, Sazan.

Duke thënë këto fjalë, ish-detektivi mblidhte fort buzët dhe tundte kokën i pezmatuar.

LI

SITUATË E TURBULLT

“*Pamundësitë tona na acarojnë*.”
Zh. Zhubér

Pas dy ditësh Melin e thirrënn në infermieri. Kur u paraqit atje, ai gjeti mjekun e burgosur së bashku me një person të panjohur. Mjeku i burgosur e sqaroi:

— Në kontrollin e fundit mjekësor që iu bë të burgosurve të kampit tonë në aparatin e florografisë, ti ke dalë i sëmurë, Hamit. Drejtoria e Kampe-Burgjeve ka dërguar një kurë për ty me këtë mjekun nga Tirana.

Duke thënë këto fjalë, ai shikonte herë mjekun e ardhur prej kryeqytetit, herë Melin, si për t'i prezantuar respektivisht tek njëri-tjetri. Ndërkaq, mjeku i ardhur i tha me takt mjekut të burgosur:

— Më duhet t'i bëj një vizitë të ngeshme e të përgjithshme Melit. Prandaj, në qoftë se ti ke ndonjë punë, je i lirë të dalësh.

Mjeku i dënuar e kuptoi se ç'duhej të bënte. Ai stakoi prizën e furnellës ku po zienin shiringat dhe sistemoi disa shishe me barna që kishte mbi tavolinë. Pastaj i tha mjekut kryeqytetas:

— Unë do të shkoj të psonis, se sot është futur shitësi në kamp. Ai vjen vetëm dy herë në muaj këtu. Po u vonova, ja ku e keni çelësin e derës, në rast se do të dilni pa u kthyer unë.

Mjeku tjetër mori çelësin, u çua prej karriges dhe shkoi e mbylli derën pas atij që doli. Pastaj u afrua tek dritarja, lëvizi pak cepin e perdes prej kambriku dhe, pasi endi shikimin nëpër oborrin e kampit, u kthye nga Meli e i zgjati një copë letër duke i thënë:

— Shokët janë mirë; mos u bëj merak. Nuk të kanë ardhur dot, se ashtu duhej. Po pate gjë për të thënë, mund të flasësh pa ndrojte.

Meli e falënderoi dhe hapi letrën, ku njohu shkrimin e Stretos:

I dashur Hamit,

Nuk kemi mundur të vijmë, për arsye pune. Gjithashtu nuk të premtojmë dot se kur mund të vijmë. Letërprurësi është i yni. Po pate gjë për të thënë, shprehu.

Të fala nga "të gjithë", Guri.

P–S. Dariu të zëvendësoi.

Fjalët e fundit i bënë përshtypje Melit, por shqetësimi i tij kryesor nuk lidhej me të vëllanë. Prandaj ai iu drejtua mjekut me të tjera pyetje:

— A mund të më flasësh më konkretisht për gjendjen e shokëve? Ç'janë ato punë që ua bëjnë të pamundur ardhjen e njërit prej tyre deri këtu?

Mjeku u përgjigj me një buzëqeshje të lehtë:

— Ato punë ti mund t'i marrësh me mend më kollaj nga unë. Por, me sa kam dëgjuar prej shokëve, mund të të them vetëm se *aleatët* kanë shprehur rezerva të ndjeshme ndaj faktit, që për survejimin tënd në burg janë dërguar pikërisht ish-shokët e tu të shkollës së shërbimit sekret. Pas takimit të zhvilluar me ty, anglezët i kanë kushtuar shumë vëmendje çështjes sate. Për këtë arsye *Dofeni* nuk guxoi të të dërgonte njeri këtu, sipas premtimit.

Në vazhdim të kësaj bisede, Meli mësoi se *aleatëve* u ishte lëkundur besimi lidhur me ruajtjen e sekretit në DSJ. Ndërsa disa kuadro angleze ishin gjithmonë të pranishëm në mbledhjet e rëndësishme të DSJsë, ata nuk pranonin pjesëmarrje shqiptarësh në mbledhjet e tyre.

— Po këto fjalët e fundit të letrës – *Dariu të zëvendësoi* – ç'janë? u interesua ish-detektivi.

— Vëllai yt është Dariu? e pyeti mjeku.

— Po.

— Ja si është puna: Anglezët kanë tërhequr për specializim në Londër një kontigjent detektivësh shqiptarë me moshë të re. Do t'i fusin në kurse nga një deri në trevjeçare. Bashkë me ta, kanë tërhequr edhe vëllanë tënd. Shumë shokë shfaqën mospajtimin e tyre me këtë transferim të Dariut, duke i mëshuar faktit se ai nuk ishte detektiv i mirëfilltë dhe ndodhej aksidentalisht në DSJ. Një ditë u ndodha rastësisht kur një shoku yt, Fatmir Merdari, u grind me dy kuadro angleze për këtë punë. Ata iu kundërvunë atij me këto fjalë:

— Ne e kemi gjetur Dariun të inkuadruar në DSJ; nuk e kemi sjellë ne këtu. Meqenëse ai nuk e paska mbaruar shkollën e shërbimit sekret, atëherë ne do ta fusim në një kurs trevjeçar atë.

— Mirë, atëherë – ua priti Fatmiri – të paktën i jepni leje të shkojë të takohet me të vëllanë, para se të niset për në Angli.

— Jo, jo, nuk është nevoja – iu përgjigjën ata. – Dariu do të vijë me leje prej andej; atëherë le ta takojë. Si gjithë detektivët e tjerë që po transferojmë, edhe Dariu shkon në Londër për interesat e vendit të tij.

— Ose për peng – shtoi i revoltuar Fatmiri dhe doli nga salla ku po diskutonin.

«Të prekur nga ky gjest proteste, anglezët e ndoqën me sy në heshtje, por kuptohej qartë që ky veprim i Fatmirit u qëndroi rëndë.

Mjeku u largua po atë ditë nga kampi, mbasi la në infermieri një kurë për Melin. Ky nuk e pa të arsyeshme t'iu dërgonte ndonjë mesazh shokëve me mjekun. Pas largimit të këtij, në kamp mbretëroi e njëjta heshtje deri ditët e fundit të prillit.

LII

ANGLEZI KËRCËLLIN DHËMBËT

“*Ku mungon forca, e drejta zhduket;*
ku shfaqet forca, e drejta nis të rrezatojë.”
M. Barré

Ishte 26 prilli 1984. Një muaj ditë më ditë prej takimit të parë të anglezëve me detektivin e burgosur. Mysafiri i tij ishte përsëri zyrtari anglez, që kryesonte takimin më 26 mars, ose *Unaza* e *Bardhë*, siç e thërrisnin midis tyre shokët e Melit në DSJ, për shkak të unazës së gjerë e të bardhë që mbante.

Kur kartelisti e njoftoi Melin se do të kishte përsëri takim atë ditë, detektivit të burgosur nuk i shkonte ndërmend kurrë, se mund të ishte përsëri zyrtari i moshuar anglez vizitor i tij. Sa e pa kur hyri në dhomën e takimit, u shqetësua. Ardhja e zyrtarit të moshuar për të dytën herë brenda muajit duhej të kishte motive serioze. Dhe nuk gabohej.

Anglezi, pa e zgjatur, hyri drejt në temë:

— E di që do t'ju vijë keq – dhe keni të drejtë për këtë –, por me hidhërim ju njoftoj se shoku juaj i shkollës, Fatmir Merdari, është plagosur rëndë para tre-katër ditësh dhe gjendet nën kontrollin e rreptë të mjekëve. Më ka ardhur keq se në muajin nëntor mbushte 35 vjeç; shumë i ri.

«*Keqardhja* e tij është vetëm fasadë; anglezi po shijon me ëndje hakmarrjen ndaj Fatmirit për fyerjen që u bëri», mendoi me vete Meli i brengosur prej lajmit të keq.

— Në ç'rrethana është plagosur? pyeti me një fije zëri, dyllë i verdhë në fytyrë.

— Gjatë një loje të kombinuar stërvitore për zbulimin dhe asgjësimin e bandave diversioniste. Fatmiri ishte drejtuesi i përgjithshëm i saj dhe është goditur aksidentalisht në errësirë. Një humbje e madhe për të gjithë – shtoi anglezi me zë më të ulët.

— A ka shpresa për shpëtimin e tij? pyeti ish-detektivi, duke gëlltitur pështymën me zor.

— 90 % është i ikur. Plumbat i kanë dëmtuar të dy mushkëritë. Po bëhet ç'është e mundur për shpëtimin e tij, por vetëm ndonjë mrekulli mjekësore mund ta rikthejë në jetë.

— Po njerëzit tuaj morën pjesë në lojën stërvitore? guxoi të pyeste Meli.

Anglezi bëri sikur nuk e nuhati domethënien e kësaj pyetjeje dhe, si pa të keq, iu kundërpërgjigj po me pyetje:

— Për ç'njerëz tanët e keni fjalën? Unë i komandoj të gjithë në DSJ.

Nga mënyra jo e zakonshme me të cilën ai po shprehej, kuptohej se anglezi kishte edhe shumë për të thënë. Krejt ndryshe nga hera e kaluar, ai ishte i gatshëm ta sakrifikonte në çast etiketën e mirësjelljes, për ta vendosur piketën atje ku duhej në marrdhëniet me detektivin e burgosur.

Duke pasur parasysh këtë, Meli u mundua që ta riformulonte në mënyrë sa më paqësore pyetjen e mëparshme:

— E di që ju i komandoni të gjithë atje, falë përvojës suaj të madhe. Por e kisha fjalën për kuadrot anglezë që veprojnë në DSJ.

— Edhe nga ata merrnin pjesë, posi, – u përgjigj anlgezi. – Vetë qëllimi i asaj loje stërvitore ishte pikërisht shkëmbimi i eksperiencave respektive. Veçse të gjitha veprimet i drejtonte vetë Fatmiri.

— Fatmiri ka realizuar gjithë ata misione me sukses kudo nëpër Evropë, duke qënë më i ri dhe me më pak eksperiencë. Tani, në kulmin e përvojës, ai shkon e humbet jetën në periferi të Tiranës! pështpëriti si me vete të tij Meli.

Këto fjalë i dhanë shkas *Unazës së Bardhë* të nxirte shaptën nga milli:

— Kështu i shikojnë gjërat, të përmbysura, të gjithë ata që mendojnë se vetëm Amerika do të ishte aleate e denjë për vendin tuaj.

Detektivi i burgosur ia priti me të parën:

— Unë jam shqiptar, zotëri. Nuk jam lindur as në San-Françisko, as në Liverpul. Prindërit e mi nuk kanë folur as anglishten tuaj, as atë amerikane. Dhe, së fundi, unë mendoj se çdo popull, që e do vërtet lirinë dhe pavarësinë e vendit të tij, nuk ka nevojë për aleatë të fshehtë.

Anglezi u kundërpërgjigj me zjarr:

— Nuk ka asnjë rëndësi se çfarë mendoni ju. Përpiquni t’i bëni aleatë amerikanët, futuni në shërbim të tyre dhe sakrifikoni për të bashkëpunuar me ta; kjo është puna juaj dhe përgjegjësitë për ato që bëni mbi shpatulla do t'ju rëndojnë. Një gjë duhet ta dini mirë dhe të mos ta harroni asnjëherë [në këtë çast anglezi u shkëput nga kolltuku dhe zgjati të dy duart përpara]: çelësat e Shqipërisë ndodhen në duart tona! Le të përpëlitet sa të dojë Hamit Meli me shokët e tij bashkëpuntorë, për të ndryshuar gjendjen. Patjetër do të vijë një ditë që ju do ta pohoni me gojën tuaj: «anglezët paskan qenë vërtet të fortë!» Nuk po ua fsheh as këtë: midis anglezëve dhe amerikanëve nuk krijohet kurrë hapësirë për të depërtuar ndokush tjetër. Përplasja e interesave ne nuk na kalon asnjëherë në armiqësi. Ndërkohë mos harroni se, tani për tani, ju jeni një i burgosur politik, për të ardhmen e të cilit ne nuk do t'iu bëjmë asnjë lëshim amerikanëve.

Meli u përgjigj duke ngritur zërin:

— Më flisni më hapur, ju lutem. Unë nuk kam kontakt me amerikanët dhe nuk e kuptoj pse m'i përmendni ata.

— E kuptoni ju, e kuptoni mirë – ia priti anglezi. – Në qoftë se aktualisht nuk keni ndonjë kontakt me amerikanët, po e synoni diçka të tillë. Por po ja u përsëris (dhe këtë e bëj për të mirën tuaj), se fatet e këtij vendi janë përfundimisht në duart tona. Cilatdo qofshin përpjekjet tuaja në favor të ndërhyrjes amerikane, në çastin vendimtar të zgjidhjeve përkatëse, ndërmjet atyre dhe neve nuk do të ketë vend për ju, shqiptarët. Mundohuni ta mbani mend këtë, se do t'ju duhet për tu orientuar më mirë në të ardhmen.

«Para se të largoheni, dua t'ju vë në dijeni se qendra jonë më ka ngarkuar të drejtoj misoinin tonë të përgjithshëm në Shqipëri. Kjo do të na krijojë mundësi që të rishikohemi. Mirëupafshim!

Meli u ngrit, tha *natën e mirë*, dhe doli.

Takimi kishte zgjatur vetëm një orë, brenda limiteve të së cilës ishin përmendur gjëra të rëndësishme. Nga mënyra e të shprehurit të anglezit, Meli kuptoi se shokët e tij duhej të kishin bërë ndonjë përçapje në adresë të amerikanëve. Fakti që anglezët ishin në dijeni të këtyre veprimeve ia shtoi shqetësimin.

*

Pas pak ditësh erdhi përsëri mjeku nga Tirana, për të verifikuar efektin e kurës që kishte lënë për Melin. Ai ndenji vetëm gjysmë ore me detektivin e burgosur. Sipas tij, Merdari ishte në gjendje shumë rëndë. Ishte goditur natën me dy plumba nga pas krahëve, prej një distance të afërt. Kishin menduar ta nisnin për kurim në një klinikë italiane, por e kishin tërhequr më pas këtë mendim, ngaqë tronditja gjatë udhëtimit mund t'ia shpejtonte fundin. Mjekët në Tiranë po bënin gjithçka për shpëtimin e tij, por shpresat ishin të zbehta.

LIII

HAKMARRJE TINËZARE

"*Nuk ka asgjë mbi të cilën bien aq*
mashtrime e mallëkime sa mbi një sekret."
S. Kirkegaard

Më 10 maj Afrim Pahia mbërriti në zyrat e komandës së kampit të Qafë-Barit i veshur civil. Nëpërmjet kartelistit, ai e thirri Melin në dhomën e posaçme të DSJsë, ku ishin zhvilluar takimet me *Dofenin*. Pahia ishte dobësuar shumë dhe, me të hyrë Meli brenda, iu derdhën lotët.

— Çfarë ke kështu, mos ka vdekur Fatmiri? hamendësoi i tronditur Meli.

Pahia nuk iu përgjigj dot me fjalë, vetëm i bëri një shenjë pohuese me kokë. Padashje edhe Melit i shkuan lot, duke menduar se një muaj e gjysmë më parë ai e priste nga dita në ditë Merdarin, ndërsa tani i erdhi mandata e tij. Shpejt detektivi i burgosur e mblodhi veten, duke e ndjerë për detyrë që të qetësonte shokun. Ai u ul afër Pahisë, i hodhi dorën në qafë e i tha me një ton të ngrohtë:

— Nuk duhet të derdhim lot, Afrim. Rruga që kemi zgjedhur është plot rreziqe. E kush mund të na sigurojë ne të dy se edhe pas një muaji mund t'ia hedhim përsëri dorën në qafë shoku-shokut, si tani? Askush. Dhe po të përpiqej njeri të na mbushte mendjen për të kundërtën, ne nuk do ta besonim. Në situatën e tendosur që po përjetojmë lotët krijojnë përshtypjen sikur jemi penduar për vendimin që kemi marrë.

— Ke të drejtë, Hamit, – iu përgjigj Pahia me zë të ulët duke nxjerrë shaminë nga xhepi. – Ke të drejtë, por vdekja e Mirit qe një goditje e rëndë për ne. Nuk e merr dot me mend, se me çfarë zelli të papërmbajtur i ishte përveshur ai punës. Vlente sa për tre. Nuk ndiente lodhje kurrë, pa le më frikë, të cilën ai nuk e kishte njohur ndonjëherë.

— Pa fatkeqësi të tilla, nuk mund të arrihet atje ku synojmë, Afrim. A thua dhuratë e *aleatëve* qenë plumbat për Fatmirin?

— Pa asnjë dyshim. Ne i qëndruam me radhë tek koka e krevatit gjatë agonisë; nuk e lamë për asnjë çast vetëm. Shpresonim mos përmendej momentalisht e na thoshte ndonjë fjalë. Por qe e pamundur.

— Grindja me kuadrot angleze për transferimin e Dariut u bë shkak që e goditën?

— Jo vetëm ajo. Kishte edhe arsye të tjera, më të rëndësishme, për të cilat do të të flas tani.

LIV

VIKTIMË DASHURIE

"*Nuk ndodh kurrë që miu ta bëjë folenë në veshin e një maçoku, veçse kur i vjen ngordhja*."

Proverb arab

Sipas planit që kishte diskutuar me Melin, Streto i kishte udhëzuar anëtarët e grupit të tij antidiktatorial të rrëmbenin dhe të hetonim privatisht ndonjë pjesëtar të elitës drejtuese të misoinarëve anglezë bujtës në hotel *Tirana*. Gjahu më i preferuar ishte pikërisht shefi i përgjithshëm i tyre, *Unaza e Bardhë*. Mirëpo ky tregohej i kursyer në lëvizje dhe gjithmonë i mbrojtur. Në pamundësi të tij, kolegët e Stretos ia vunë syrin një kuadri tjetër anglez, i cili flinte në një dhomë përballë asaj të *Unazës së Bardhë*. Nisur nga mbledhjet që organizonte në rreth të ngushtë elita e misionarëve anglezë në Tiranë, personi i vënë në shënjestër të grupit të Stretos ishte bashkëpunëtor i afërt i *Unazës së Bardhë*.

Sipas orientimit që u ishte dhënë forcave të ndjekjes të Sigurimit, *turistët e* sistemuar në katër katet e sipërm të hotel *Tiranës* nuk duheshin shqetësuar prej tyre, mbasi ishin miq ideologjikë të partisë, që meritonin respekt të veçantë. Madjé edhe kamerieret, që u shërbenin këtyre *miqve*, kishin udhëzim që të mos t'i refuzonin bakshishet e tyre, ndryshe prej rregullit të përgjithshëm. Duke përfituar prej kësaj tolerance të pazakontë, një pjesë e këtyre *turistëve* të privilegjuar kishin arritur të krijonin edhe marrëdhënie intime me femra shqiptare. Edhe personi i piketuar për sekuestrim prej grupit të Stretos e kishte arritur një favor të tillë. Dy anëtarë të grupit e kishin pikasur këtë gjë dhe po e përgjonin me shumë vëmendje.

Vajza banonte në një shtëpi private në periferi të Tiranës. E joshur prej ryshveteve të majme të këtij *turisti*, ajo i kishte dalë disa herë në takim. Një natë që dy përgjuesit e kishin kuptuar se anglezi do të takohej përsëri me vajzën, ndaj tij u organizua një ndjekje e posaçme prej grupit të Stretos. Dy përgjuesit u vunë në gjurmë pa e humbur për asnjë çast nga sytë, ndërsa pesë shokë të tjerë, në dy vetura, lëviznin sipas udhëzimeve që merrnin me radio prej tyre.

Atë natë anglezi e kishte lënë takinim më afër shtëpisë së vajzës, sesa qendrës së qytetit. Kur ai ndaloi në krye të një rruge me ndriçim të dobët dhe po shikonte herë pas here orën, dy përgjuesit i njoftuan shokët që të afroheshin sa më qetë tek vendi që po u përshkruanin, duke ndezur vetëm dritat e shkurtra.

Pas pak u duk vajza. Ajo ishte rreth 22-23 vjeçe, tërheqëse. Përgjuesit i njoftuan shokët, që në makina të mbeteshin vetëm shoferat me radio e në gjendje gatishmërie, ndërsa të tjerët të afroheshin sa më pranë dhe të ishin gati për arrestimin e anglezit. Vetëm njëri, pikërisht Merdari, do të merrej me vajzën, para se të tjerët të bënin punën e tyre.

Kur vajza u afrua 10-15 m nga ai që e priste, Merdari, duke dalë me vrap prej errësirës, u vërsul me grushta mbi të. Ajo humbi ndjenjat shpejt. Për një çast anglezi u befasua, duke menduar se kishte të bënte me ndonjë gangster. Mirëpo brenda disa sekondash, pa i lënë kohë që ta mblidhte veten, katër djem të fuqishëm u vërsulën mbi të, duke i vënë prangat në duart pas shpine. Sakaq veturat ia behën në vendin e ngjarjes. Anglezi, i tronditur, iu bind urdhërave që i jepeshin. Kur e futën në veturë, ai pyeti:

— Me cilët kam të bëj, zotërinj?

Ndanë sediles së tij kishte zënë vend një detektiv i ri, që e fliste rrjedhshëm anglishten.

— Me Sigurimin Shqiptar – iu përgjigj ai – i autorizuar prej shokëve.

Anglezi mblodhi shpatullat në një mënyrë të tillë sikur donte të thoshte: *po a jemi aleatë*? I hutuar, ai e endi shikimin mbi fytyrat që i ngjanin si hije të vagëlluara në veturën me drita të brendshme të fikura. Pas njëzet minutash udhëtim, duke preferuar rrugët periferike, të dy makinat mbërritën në bazën sekrete të grupit të Stretos. Si të tillë, ata përdorim një shtëpi të veçuar në mes të një kopshti pemësh të larta të rrethuar me kangjëlla. Vite më parë, ajo përdorej si bazë e DSJsë, ku çoheshin persona mbi të cilët ushtrohej presion për t'i rekrutuar ose që mbaheshin në arrest të përkohshëm. Qysh prej spastrimeve radikale që kishin ndodhur në Kryeministri dhe në MP të Brendshme, ajo nuk përdorej më, dhe për drejtuesit e rinj të DSJsë pothuajse nuk ekzistonte. Çelësat e saj i mbante vetëm Streto.

*

Pas mbërritjes së dy veturave me të sekuestruarin në bazë, ata e kishin lënë një shok të patrullonte në kopsht, dy të tjerë për të hapur një gropë në bodrumin e shtëpisë, ndërsa katër ishin marrë me hetuesinë e anglezit, e cila regjistrohej e filmohej.

Ata ia bënë të qartë qysh në fillim të sekuestruarit, se ngurrimi për tu përgjigjur do ta nënshtronte në tortura të pakursyera, ndërsa përgjigjet e sakta e të shpejta mund të bëheshin shkak që ta ruanim si peng për të ardhmen. Duke e vlerësuar drejt seriozitetin e situatës në të cilën ndodhej, anglezi u tregua i zellshëm në dhënien e përgjigjeve.

— Sa vjeç jeni?

— Dyzet e pesë.

— Ku keni vepruar, para se të vinit në Shqipëri?

— Në B. Sovjetik, në Francë dhe në SHBA.

— Na thoni sa më shumë emra të detektivave anglezë, që veprojnë aktualisht në Shqipëri.

Mbasi i hetuari përmendi një mori emrash, pasoi pyetja tjetër:

— Cili është qëllimi i vërtetë i misoinit të përgjithshëm anglez në Shqipëri?

— Stabilizimi i pushtetit në durat e udhëheqësit të sëmurë shqiptar, nëpërmjet riorganizimit të shërbimit tuaj sekret, pas ngjarjeve politike në Kryeministri dhe në M.P. të Brendshme.

— Kush ju ka thënë se udhëheqësi shqiptar është i sëmurë?

— Një mjeku ynë që e ka trajtuar kohët e fundit.

— Sa kohë do të veprojnë në Shqipëri misionet tuaja të fshehta?

— Derisa të vlerësohen të realizuara objektivat e përmendura më lart.

— Pas atij çasti, a do të mbeten më misionarë anglezë në Tiranë?

— Nuk mund të jap dot përgjigje të bazuar për këtë pyetje.

— Deri në çfarë posti ka arritur shefi juaj në Angli, para se të vinte në Shqipëri?

— Deri në zëvendësministër i brendshëm.

— A mund të na ndihmoni me ndonjë material tjetër, i cili do t'ju favorizonte mjaft në gjykimin që do t'ju bëjmë?

— Nuk kam dijeni për asgjë tjetër që të ketë lidhje me fatin e vendit tuaj. Siç ju thashë, unë kam vepruar larg atdheut tuaj, në shtete që nuk kishin ndonjë lidhje me Shqipërinë.

— Ç'mendim keni për gjendjen e popullit tonë, si dëshmitar okular i saj?

— Të shumë për të dëshiruar.

— Rrethanat e çastit ua diktojnë këtë vlerësim?

— Jo, unë e di që mendime të tilla, të shfaqura në këto rrethana, nuk do të ndikojnë aspak në vendimin tuaj. Thashë thjesht atë që mendoj.

— Në qoftë se mendoni vërtet kështu, përse i përvisheni punës me kaq zell në dobi të diktatorit shqiptar?

— Ju jeni profesionistë dhe mund t'ia jepni vetë përgjigjen kësaj pyetjeje. Unë jam ushtar dhe shkoj atje ku më urdhërojnë.

— Në ç'rrethana jeni njohur me vajzën që prisnit në takim?

— Krejt rastësisht, në një mapo industriale të Tiranës.

— Sqarojeni çështjen deri në fund!

— Ajo kishte qëndruar e vetme përpara disa xhakaventove të ekspozuara në varëse, duke i shikuar me zili. E kuptova gjendjen e saj shpirtërore...

Në fillim anglezi e uli zërin, pastaj heshti.

— Pasi e kuptuat gjendjen e saj shpirtërore, si vepruat më tej?

Pyetja iu bë me një ton të rreptë urdhërues.

— Në xhep kisha një tufë kartmonedhash, cepin e të cilave ia tregova vajzës...

Përsëri ai heshti.

— Po pastaj?

— Ajo shikoi me kujdes rreth e rrotul dhe, pasi më la të kuptoja se më priste t'i shkoja pas, u drejtua nga porta e doli jashtë.

Gjatë gjithë procesit hetimor Fatmir Merdari kishte qëndruar në heshtje përballë anglezit, me duar të kryqëzuara mbi gjoks. Kur i sekuestruari shqiptoi fjalët e fundit të përgjigjes së tij, Merdari shpërtheu si vullkan:

— Kështu ia paske qarë hallin popullit shqiptar, zotrote? (përkthimi vazhdonte). Pasi na keni shfrytëzuar e varfëruar për dyzetë vjet nëpërmjet agjentit tuaj diktator, tani dashkeni edhe të na shkërdh...

Duke thënë këto fjalë, ai iu vërsul anglezit i revoltuar. Me të dy krahët e tij të fuqishëm e kapi fort për fyti, ndërkohë që dy shokë të tjerë e kishin mbërthyer të sekuestruarin për supesh dhe për duart e lidhura pas shpine. Fillimisht anglezi e mbajti veten, duke menduar se fundi i tij nuk do të ishte i tillë. Por me kalimin e sekondave të mundimshme, nën shtrëngimin gjithmonë në rritje të morsës së pamëshirshme që e kishte mbërthyer, ai, duke u përpëlitur erdhi e u mavijos në fytyrë e sytë po i zgurdulloheshin. Me njërin gju mbi barkun e anglezit të mbështetur pas murit, Merdari po e ngushtonte pa ndërprerje lakun e kthetrave të tij. Rezistenca e trupit të anglezit erdhi duke u dobësuar dhe, më së fundi, u lëshua krejt. Merdari dhe dy shokët e tjerë hoqën duart; trupi i pajetë u shemb në tokë.

Të katër shokët e ngritën kufomën dhe e zbritën në bodrum, ku gropa ishte gati. E lëshuan brenda në të dhe u matën për të rrokur lopatat, kur Merdari ndërhyri energjikisht:

— Jo ashtu, jo. Ky nuk duhet varrosur për së mbari, si të gjithë njerëzit.

Duke thënë këto fjalë, ai kërceu brenda në gropë, e mbërtheu kufomën me të dy duart, dhe e ktheu përmbys.

— Ky e meriton kështu! – u shpreh i nervozuar. – Le të flejë gji për gji me këtë truall, që nuk i ka asnjë borxh atdheut të tij. T'i dëgjojë mirë rënkimet e kësaj toke prej plagëve që i ka shkaktuar Anglia me veglën e saj të verbër, diktatorin tonë të urryer!

Të nesërmen në radhët e anglezëve u vunë re shenja shqetësimi. Ndonëse në pamje nuk e jepnin veten, atë ditë ata zhvilluan dy herë mbledhje midis tyre.

*

— Ngjarjen që sapo të tregova, të filmuar e të regjistruar, e futëm në arkivin tonë sekret, të cilin e ruanim në një skutë të fshehtë të bazës sonë – vazhdoi ta sqaronte Pahia detektivin e burgosur. – Në këtë arkiv informativ kishim çuar gjithashtu një numër të madh fotografish të detektivëve anglezë që veprojnë në Shqipëri, nëntë seanca të hetusisë tënde speciale, regjistrimet e bisedave të zhvilluara në të gjitha takimet zyrtare me përfaqësuesit e DSJsë dhe me anglezët. Gjithashtu atje çuam edhe fotografinë e secilit prej anëtarëve të grupit tonë, të shoqëruar me një curriculum vitae të shkurtër. Por materiali më i rëndësishëm i arkivit ishin disa pjesë të bisedës shumë të rëndësishme që kishte zhvilluar diktatori Hoxha në Londër. Kjo arritje ishte meritë personale e Gurit, i cili, duke përfituar prej marrëdhënieve miqësore me *Dofenin* kishte arritur të incizonte një pjesë të tyre. Karakteri super-sekret i atyre bisedimeve kuptohej qartë prej faktit që vetë anglezët kishin çregjistruar një pjesë të tyre prej shiritave manjetikë, që kishte marrë diktatori Hoxha me vete.

«Sipas planit që kishit hartuar ti me Gurin, emrat e tre anëtarëve të grupit tonë nuk ua kemi bërë të njohur amerikanëve; pra, atyre nuk ua kemi futur fare emrat dhe asnjë të dhënë tjetër në listën përkatëse. Kjo ide e juaja na u duk shumë e arsyeshme edhe neve, pjesëtarëve të tjerë të grupit. Nuk i dihet si na shkojnë punët me CIAn, prandaj ne nuk duhet të dorëzohemi symbyllas atje. Atyre të treve ne u kemi përgatitur një arkiv të dytë, i cili është kopje e të parit me materialet filmike, fotografike apo të regjistruara. Këtë arkiv ata do ta ruajnë në një vend shumë të sigurtë, larg nga Tirana. Ata të tre do të jenë një celulë sekrete e grupit tonë në radhët e DSJsë në çdo kohë dhe do të na informojnë ne për të gjitha zhvillimet në radhët e shërbimit sekret shqiptar, sikur një ditë CIA ta tërheqë në Amerikë grupin tonë. Për ta kryer sa më mirë rolin e tyre, jashtë çdo dyshimi, Guri i ka orientuar ata të tre që të qëndrojnë larg anëtarëve të tjerë të grupit tonë dhe të tregohen sa më të devotshëm në kryerjen e detyrës që u ngarkohet prej drejtuesve të DSJsë.

«Pasi e plotësuam arkivin tonë informativ me materialet informative të cilësisë së parë që përmenda, lindi nevoja e domosdoshme për të siguruar ndërlidhjen me CIAn, konform vendimit që kishit marrë ti me Gurin. Për këtë qëllim e përqendruam vëmendjen tek ambasada franceze në Tiranë, meqenëse *turistët* amerikanë parashikohej të vinin në Shqipëri të pajisur me pasaporta të këtij shteti. Kërkonim me intuitë mos qëllonim në ndonjë person të dëshiruar. Por fati i kishte rezervuar zgjidhje tjetër këtij problemi të rëndësishëm.

LV

FAT PËR AMERIKANËT, FATKEQËSI PËR SHQIPTARËT

"*Fatkeqësia, si mëshira, mund të bëhet një zakon*."

G. Grin

Pahia përgatiti kafe për të dy dhe vazhdoi të shpjegonte veprimtarinë e mëtejshme të grupit:

«Dita nuk kishte zbardhur mirë, kur forcat tona të ndjekjes, me ndihmë të anglezëve, ranë në gjurmë të një bande zbulimi amerikane në periferi të Tiranës, për të cilën DSJ kishte pasur informacion qysh para dy ditësh. Ishin pesë vetë. Sipas *Dofenit*, kjo ishte inisiativë e *Kobrës* në bashkëveprim me CIAn. Të ndodhur nën trysninë e forcave të ndjekjes, ata të pesë hapën zjarr. Pas njëzet minutash shkëmbim zjarri, tre anëtarë të bandës mbetën të vrarë, ndërsa dy të tjerë u zunë robër. Këta të fundit u izoluan në birucat e nëndheshme të MP të Brendshme.

«Meqenëse kjo ndodhi pikërisht kur grupi ynë po bënte gjithë përpjekjet e mundshme për të siguruar lidhje me CIAn, Guri vendosi që ta shfrytëzonim rastin në funksion të këtij qëllimi. Pra, duhej të nxirnim prej birucave njërin prej robërve amerikanë, i cili do të arratisej me dy anëtarë të grupit tonë, që do të merrnin me vete arkivin. Me interesimin e Gurit, dy shokë tanët u caktuan për mbikqyrjen e atyre birucave. Sipas rregullit, njëri kishte çelësat e dy portave të hekurta të hyrjes, ndërsa tjetri kishte çelësat e dyerve të qelive. Dy robërit amerikanë ishin izoluar në dy biruca larg njëra-tjetrës. Ne do të nxirnim atë që ishte më afër hyrjes.

«Operacioni ishte me rrezikshmëri të lartë, se vendi para zbritjes për në birucat e nëndheshme është i ndriçuar mirë dhe ndonjë makinë policie mund të kalonte atje në çdo orë. Prandaj veprimet duheshin kryer me shpejtësi të madhe. Për këtë arsye vendosëm që në këtë aksion të merrnin pjesë gjithë anëtarët e grupit tonë, me përjashtim të Gurit, i cili do t'i bënte shoqëri inspektorit të MP të Brendshme, që ka të drejtë të ushtrojë kontroll të befasishëm tak ato biruca. Për drejtimin e operacionit shokët ngarkuan mua.

«Pasi ishin marrë të gjitha masat e nevojshme paraprake, në orën 23 e 20 minuta të datës 3 maj (pra, para një jave), nisëm aksionin. Në ato çaste dy kalimet që çonin tek qelitë e MP të Brendshme ishin të bllokura nga shokët tanë me uniforma oficerësh, me sinjale *ndalim qarkullimi* dhe, natyrisht… të armatosur mirë. Dështimi i këtij aksioni do të pasohej detyrimisht me veprime të armatosura, mbasi për ne nuk kishte më asnjë shpëtim. Ndërkohë dy vetura ndaluan tek oborri i ndriçuar para zbritjes për në birucat në fjalë. Prej tyre zbritën katër persona me uniforma oficerësh të MP të Brendshme; me ta edhe unë.

«Dy shokët që shërbenin atje hapën shpejt dyert dhe zbritëm në korridorin e birucave. Hapëm derën e qelisë së robit amerikan më afër hyrjes dhe i dhamë një uniformë oficeri për ta veshur shpejt. I hutuar në kulm, ai zbatoi urdhërin pa kuptuar asgjë se ç'po ndodhte. Ndërsa ne po dilnim jashtë, njëri prej shokëve që shërbenin tek birucat spërkati me një solucion gjurmëfshirës korridorin e tyre, shkallët dhe vendin deri tek veturat. Unë hipa në veturën e parë me robin amerikan dhe me dy shokët tanë që shërbenin tek birucat. Kjo treshe do të arratisej, duke marrë me vete arkivin.

«E porosita shokun në timon që të ecte me shpejtësinë maksimale të mundshme. Brenda natës duhej të shkonim në Qafë-Thanë dhe të ktheheshim përsëri në Tiranë. Për fat të mirë, në atë orë makinat ishin shumë të rralla dhe rruga krejt e lirë për të ecur me shpejtësi. Kur kaluam Plepat e Durrësit, i dhashë një cigare robit amerikan, i cili e kishte humbur busullën. Ia ndeza duke i buzëqeshur, për ta qetësuar disi. Papritur ai kërceu përpjetë: nga hutimi i tepërt, ai kishte vënë në buzë anën e ndezur të cigares.

«Arritëm në destinacion pak më herët nga ç'parashikonim. U takova me shokët, mandej i dhashë një revole amerikanit. Ky e mori i entuziazmuar dhe më puthi në ballë. Më së fundi kishte arritur ta kuptonte qëllimin e vërtetë të udhëtimit misterioz. Shikimi i tij shprehte një mirënjohje të pakufishme. Në atë çast e pashë me sytë e mi se ç'do të thotë të bësh një njeri të lumtur.

«Kur ata të tre u nisën për të kaluar kufirin, ne qëndruam njëzetë minuta pa lëvizur prej vendit. Kjo ishte kohë e mjaftueshme për tu garantuar që ata kaluan pa problem. Pastaj morëm rrugën e kthimit me të njëjtën shpejtësi. Secili shkoi në shtëpinë e tij, për tu paraqitur të nesërmen në DSJ si gjithmonë.

«Sapo u konstatua të nesërmen mungesa e robit amerikan dhe e dy oficerëve që survejonin birucat, plasi rrëmuja. Për kureshtje, shkova vetë atje. Një grup ekspertësh anglezë e shqiptarë po bënin ekzaminimin e vendngjarjes. Sipas diskutimeve, solucioni gjurmëfshirës e kishte bërë mirë efektin e tij.

«Mirëpo zhdukja e kuadrit anglez dhe arratisja e dy detektivëve tanë me robin amerikan bëri që pala angleze të reagonte ashpër. Revanshi i tyre nisi me goditjen e Fatmirit. Ndërkohë ata vendosën të tërhiqnin edhe Gurin në Londër. Një veprim i tillë nuk i pëlqeu aspak *Dofenit*, por ai heshti nga halli.

— Por si u veprua përfundimisht, a shkoi Guri në Londër? ndërhyri me rrëmbim Meli.

— Po, shkoi para pak ditësh.

— Oh, çfarë gabimi! thirri Meli i dëshpëruar.

— Po si të vepronte? pyeti Pahia i brengosur.

— Pas një riorganizimi urgjent të grupit, duhej të arratiseshit patjetër ju kryesorët, më të ekspozuarit e tij. Si u shkoka ashtu, more, si cjapi tek kasapi! Mos harroni se kur ke përballë Inteligjencë Servisin duhet t'i bësh sytë katër. Anglezët nuk janë *Dofenë*.

— Ata vepruan shumë shpejt, nuk na mbetej kohë për tu menduar. Para nisjes së Gurit për në Londër, mua më emëruan zëvendësdrejtor të DSJ, në vend të tij. Ky është një postë i dobishëm për grupin tonë.

— *Tahmaja e tepërt të lë pa gjë*, thotë populli. Pas zhdukjes së agjentit anglez dhe arratisjes së robit amerikan me dy shokët tanë, duhej pritur doemos nga ana juaj një reagim i ashpër i palës angleze. Ata janë të bindur që aksione kaq të rrezikshme në mes të Tiranës mund t'i realizojë me sukses vetëm një grup komplotist i përgatitur mirë. Madjé, falë intuitës së tyre të shquar profesionale, ata i kanë përcaktuar organizatorët e mundshëm të një grupi të tillë në DSJ. Jo më kot anglezët e vlerësuan gabim të rëndë të *Dofenit* dërgimin e shokëve të mi në misionin e burgut për të më përgjuar. Pavarësisht se tani për tani atyre u mungojnë provat e fajësisë sonë, po veprojnë me shpejtësi për t'i gjetur. Tërheqja e Gurit në Londër flet qartë për këtë.

— Ne e lamë me fjalë me Gurin që brenda dy-tri ditësh ai t'i telefononte patjetër nuses. Nëpërmjet shprehjeve të thjeshta, të koduara, ne do të merrnim vesh gjendjen e tij. Kur u nisa unë nga Tirana për këtu ishte dita e tretë e largimit të Gurit, por ai nuk kishte telefonuar ende.

— Po sikur anglezët ta kenë futur në hetuesi, me të mbërritur në Londër?

— Do të më vinte keq për të, por jam i sigurtë që ata nuk i nxjerrin dot asgjë.

— Sjellja juaj është një pakujdesi e madhe, por le të shpresojmë në ndihmën e fatit këtë herë. A keni propozuar ditë, orë e vend për ndonjë takim të mundshëm me të autorizuar të CIAs për vendosjen e ndërlidhjes, të paktën?

— Po, kemi caktuar datën 20 maj. Gjithashtu kemi fiksuar orën dhe vendin. Në rast mosrealizimi të takimit për arsye të paparashikuara, kemi lënë edhe dy mundësi rezervë: në të njëjtin vend pas çdo 48 orësh.

— Ju uroj sukses në këtë sipërmarrje të rëndësishme.

— Sukseset dhe dështimet i kemi të përbashkëta.

— Por për realizimin e tyre luftoni ju; unë jam sehirxhi.

— Ti e ke filluar me kohë luftën ndaj tyre, bilé i vetëm. Dhe nuk u dorëzove. Ne do të krenohemi gjithmonë me qëndrimin tënd stoik.

*

Të nesërmen e ditës që u zhvillua biseda e mësipërme, qendra e lajmëroi Pahinë se në mbrëmje Meli do të kishte takim me shefin anglez – *Unazën e Bardhë*.

— Nuk e shpjegoj dot këtë ardhje të papritur të anglezit – i tha Meli Pahisë, duke tundur kokën me mosbesim. – Pardje erdhe ti, sonte vjen ai! Ç'do të thotë kjo?

— As unë nuk i jap dot dum kësaj pune, Hamit – ia ktheu Pahia duke ngritur supet.

LVI

QESHJE ANGLEZE

"*Kur qesh një anglez, ruhu* !"
Proverb francez

Në orën 22 e 30 Meli u gjend përballë *Unazës së Bardhë* dhe *Dofenit*. Pahia kishte shkuar pak më përpara.

Anglezi i ofroi një cigare detektivit të burgosur, ia ndezi vetë, e i tha:

— Sikur ta njihja jetën tuaj të burgut para tri javësh siç e njoh tani, unë, pa vështirësi, do t'ju kisha bërë ta pranonit ofertën tonë.

Meli mblodhi shpatullat në heshtje. Zyrtari anglez vazhdoi:

— Isha në qyetin e Korçës. Më pëlqeu. Qytet i vogël, por i bukur dhe i pastër. Atje njoha edhe vajzën tuaj.

Ai nxori nga çanta një fotografi të zmadhuar, të cilën ia zgjati të burgosurit.

Meli e mori dhe fiksoi shikimin mbi profilin e vajzës së tij, që po rritej pa baba. Nga pozicioni sesi e kishte kapur aparati, ish-detektivi e kuptoi që e bija ishte fotografuar në padijeninë e saj. Melin e kishte marrë malli prej kohësh për vajzën. Takimi kalimthi natën që i erdhi nëna me vëllanë dhe të bijën vetëm sa ia kishte shtuar më shumë mallin. Në një rast Diksi e kishte dëgjuar Melin të pëshpëriste:

«Eh, Sonila ime, mendon se babai ka një copë akull në vend të zemrës? Sikur ta dije sa herë më ke dalë në ëndërr, do mendoje ndryshe për mua.»

Duke ia kthyer fotografinë anglezit, detektivi i burgosur i tha:

— Nuk do ta kisha besuar kurrë se shërbimet inteligjente britanike do të denjonin të spekulonin me dhëmbshurinë e prindit për fëmijën. Megjithatë ju siguroj se, edhe sikur të ma zhduknit vajzën, unë nuk do ta ndryshoja qëndrimin tim.

Anglezi, i tronditur, drejtoi trupin mbi kolltuk, dhe foli me një indinjatë të dukshme:

— Oh, më keqkuptuat rëndë! Ju referuat renditjes së çështjeve për të cilat po flasim dhe jo lidhjes së tyre logjike. Kur ju thashë se mund t'ju kisha bërë të pranonit ofertën tonë, e vura theksin atje ku duhej: pasi kisha njohur në detaje jetën tuaj të burgut. Kur e kalova bisedën tek vajza juaj, e quajta të mbyllur çështjen e mëparhshme. Veç me këtë rast doja t'ju njoftoja se tani e tutje bija juaj mund të jetojë e pavarur ekonomikisht prej familjes së mamasë së saj. Ne i kemi lidhur Sonilës një pension mujor prej 500 lekësh (të reja). Sipas vlerësimit të kolegëve shqiptarë, kjo shumë është e mjaftueshme për jetesën në nivel mesatar të një personi në Shqipëri. Sa për dijeni, shërbimet tona sekrete nuk ia kanë lejuar kurrë vetes të merren me fëmijë të pafajshëm. Po të merreshim me veprime të tilla, të padenja, ne nuk do të ishim këta që jemi.

— Nuk e kuptoj pse harxhoheni për një person, i cili nuk mundi ta plotësonte kërkesën tuaj – tha Meli me një ton që e vështirësonte dallimin e ironisë nga çiltërsia.

— Ne nuk harxhohemi aspak, përkundrazi. Me përjashtim të dy misioneve tuaj të parë, gjithë të tjerët që keni realizuar me sukses kanë qenë rekomanduar prej Inteligjencë Servisit anglez. Pavarësisht se ju e bënit këtë në padijeninë tuaj, ne nuk jemi mësuar t'ua hamë hakun atyre që na shërbejnë, në çfardo forme qoftë. E kundërta do të ishte një praktikë e gabuar, e cila do të kishte sjellë pasoja të padëshiruara për organet tona. Qysh prej misionit tuaj të tretë deri ditën që jeni përjashtuar nga DSJ, ju keni pasur rrogën tuaj mujore dhe shpërblimin përkatës për çdo mision të realizuar në një llogari bankare të shërbimeve tona sekrete mbi emrin tuaj. Ajo shumë administrohet me përgjegjësi në favorin tuaj. Ne e dinim që do të vinte një ditë, kur do të fillonte hapja e kartrave. Dhe në një ditë të tillë, unë ju njoftoj se shuma që ne i japim si ndihmë mujore vajzës suaj është larg nga përqindja e shtesës së shumës së depozituar në emrin tuaj. Kështu që, jo vetëm ne, por as ju vetë nuk shpenzoheni në këtë rast.

— Për punën që kam bërë, unë e kam marrë rrogën në DSJ.

— Ato janë vetëm bishtra, jo rrogë detektivi – ia ktheu anglezi, duke mbledhur buzët. – Se si shpërblehet një detektiv për punën që bën, do ta mësoni kur të njiheni me shumën e depozituar në emrin tuaj. Sa për dijeni, në fund të vitit 1972 qendra jonë ju ka graduar në mungesë. Dihet që rroga është në raport të drejtë me spaletën.

— Sidoqoftë, edhe po u prishëm bashkë, të drejtën e shumës së depozituar në emrin tim nuk do të ma mohoni, besoj – i tha duke qeshur Meli.

— Kurrën e kurrës – u përgjigj me vrull anglezi. – Respektimi me përpikmëri i ligjit në të gjitha rrethanat është tipari themelor i një kombi me të vërtetë të qytetëruar dhe i një shteti modern juridik. Cilido qoftë fundi i marrëdhënieve tona, shuma juaj është e garantuar me ligj dhe do të mbetet përjetësisht e juaja.

— Unë bëra shaka, zotëri – i tha Meli, të cilit i bëri përshtypje serioziteti i përgjigjes së anglezit. – Në gjendjen ku ndodhem unë, këto gjëra më duken si përralla.

— Kurse ne vetëm me ligjin nuk bëjmë dot shaka kurrë. Mosrespektimin e ligjit ne e përjashtojmë edhe nga tekstet e përrallave.

*

Për disa minuta ata po pinin kafe në heshtje. Duke vënë re që detektivi i burgosur nuk e preku pijen me ngjyrë, *Unaza e Bardhë* i tha me një buzëqeshje të lehtë:

— Paskeni ndryshuar sjellje edhe ndaj alkoolit, jo vetëm ndaj shërbimeve sekrete. Kam dëgjuar se keni qënë alkoolist i madh dikur, është e vërtetë?

— Po, e vërtetë është – u përgjigj Meli buzagaz.

— Edhe unë kam pirë mjaft kur isha i ri. Tani e kam kufizuar, ndonëse dëshirën e kam përsëri. Shpresoj se kur të pimë ndonjëherë bashkë, nuk do ta kursej veten. A do të pimë bashkë në Tiranë? pyeti papritur anglezi.

— Jo, do të pimë në Londër për herë të parë. Ju jeni moshatar dhe, në bazë të zakoneve tona, mosha respektohet shumë. Më takon mua të vij i pari tek ju.

— Po erdhët, do t'ju bëjmë dhuratë një angleze të zgjedhur, më të bukur nga ajo studentja e Sorbonës, emrin e së cilës na i fshehët.

Meli qeshi. Bashkëbisedimi përgjithësisht i ngrohtë i këtij takimi ia kishte fashitur dalëngadalë shqetësimin e fillimit për befasinë e tij. Me sa dukej *Unaza e Bardhë* kishte ardhur t'i bënte të ditur lidhjen e pensionit të vajzës.

Ndërsa ish-detektivit nuk i ishte shuar akoma buzëqeshja, anglezi ndryshoi temë:

— Qysh herët kam pasur respekt për djemtë e Shqipërisë. Kur u njoha nga afër me cilësitë e tyre në DSJ, ndjeva kënaqësi që nuk mbeta i zhgënjyer. Por që njeriu t'i evitojë sa më shumë zhgënjimet, duhet ta ketë në qendër të vëmendjes faktin e mirënjohur se çdo gjë është relative.

«Midis djelmoshave të shumtë shqiptarë, që pata rastin të njoh në DSJ, ishte edhe Guri Streto. Shpejt për të krijova një respekt të veçantë. I zgjuar, guximtar, organizator i aftë dhe modest, ai më kishte pëlqyer shumë. Lindi nevoja që, për interesat e çështjes shqiptare, disa detektivë të DSJsë të transferoheshin në Londër. E kush mund të ishte më i denjë se Guri për një gjë të tillë?

Unaza e Bardhë e endi shikimin, që poshtë syzeve të ndritshme, prej Melit tek Pahia dhe anasjelltas, sikur priste përgjigje nga ata për pyetjen e mbetur pezull. Pastaj vazhdoi:

— Pa i mbushur plot tri ditë në Londër, ky *yll* i shërbimit sekret shqiptar iku fshehurazi si hajdut, duke marrë me vete edhe vëllanë tuaj, Dariun.

Për Melin dhe Pahinë këto fjalë patën kumbimin e një bombe. Megjithëse gjakftohtë prej natyre, Pahia u zbeh krejt. Meli mbeti me vështrimin të ngrirë mbi fytyrën e *Unazës së Bardhë* dhe mendjen kushedi se ku.

I thinjur në profesion, anglezi ia kishte arritur plotësisht qëllimit të synuar. Duke parashikuar se ata të dy mund të dyshonin për këtë takim të befasishëm, ai krijoi një atmosferë lirshmërie e komunikimi të ngrohtë, si asnjë herë tjetër më parë. Kjo rrjedhë e studjuar e takimit i çliroi prej ankthit Melin dhe Pahinë. Kur anglezi e llogariti se ata të dy ishin lëshuar me ëndje në shtratin e iluzioneve të buta, ai u dha shuplakën për të cilën kishte ardhur. Që të ndëshkuarit e tij të vuanin sa më shumë pas përmendjes nga përgjumja e mashtrimit, finalja e skenarit të parapërgatitur kishte qenë paralajmërim i zhgënjimit që do të pësonin. Pikërisht kur ata të dy kishin hequr çdo dyshim për ndonjë të papritur të takimit, anglezi i kishte paralajmëruar: «që njeriu t'i evitojë sa më shumë zhgënjimet në jetë, duhet ta ketë në qendër të vëmendjes faktin, se çdo gjë është relative.»

Meli ndjeu t'i djersinte trupi. Tek përfytyronte anglezin duke qeshur gjatë pjesës së parë të takimit, i vinte ta hante veten me dhëmbë nga inati. Vrasja e Merdarit, tensioni i madh nervor i aksioneve të guximshme që kishin kryer dhe detyra e zëvendësdrejtorit të DSJsë e kishin dobësuar Pahinë. Tani atë e kërcënonte arrestimi. Mendja e ish-detektivit diçka bluante në ato çaste tensioni…

Duke i njohur rregullat, ai e dinte që Pahia nuk kishte të drejtë të vinte i armatosur në një takim të tillë. Në dhomë ishin dy kundër treve [veç *Dofenit*, shefi anglez shoqërohej përherë prej përkthyesit të tij), ndërsa në korridor qëndronin dy detektivë të tjerë të DSJsë, si gjithmonë.

Megjithatë Meli e gjykoi se dy peshkaqenët e mëdhenj që kishte përballë ia vlenin ta ndërronte lëkurën me ta. Për këtë duhej doemos miratimi i Pahisë. Me një shikim prej profesionisti detektivi i burgosur i la të kuptonte mikut të tij se ishte gati për gjithçka. Ndoshta ngaqë kërcënohej ai vetë prej arrestimit e jo Meli, Pahia nuk ia miratoi idenë. Nga ana tjetër ndikimi i mashtruesit më të madh të njeriut, shpresës: pas nëntë ditësh grupi komplotist siguronte ndërlidhjen me CIAn, ndërhyrja e së cilës e ndryshonte raportin e forcave në favor të tyre.

Melit nuk i kujtohej më asgjë sesi rrodhën minutat në prag të ndarjes me mikun e rrezikuar. Mbante mend, ashtu turbull, se sa herë që hidhte sytë mbi Pahinë, i dukej se e shikonte për herë të fundit. Kur ishte larguar, nuk kishte pasur fuqi t'ia shtrëngonte dorën. Ndërsa Pahia, me një buzëqeshje të sforcuar, mundohej ta qetësonte.

LVII

MEDITIM E DHIMBJE

"*E kaluar, e kaluar memece*! *Varre ditësh të përgjumura përgjithmonë*."
N. Lenali

Me duart të kryqëzuara mbi kraharor, çehrezymtë, në këmbë para dritares në fund të korridorit të fjetoreve të katit të dytë, detektivi i burgosur e kishte fiksuar shikimin mbi ujin e kthjellët të lumit. Në të vërtet sytë e tij nuk shikonin asgjë. Ai po bënte me imagjinatë një udhëtim në të kaluarën e vet, në vitet e rinisë së përgjakur. Ky fragment tronditës i jetës së tij nuk ishte i kthjellët si uji i lumit, por i turbullt, i kuqërremtë.

I lodhur prej jetës së tensionuar, ish-detektivi përpiqej të sodiste, matanë të kaluarës së trishtuar, portretin e nxënësit të zellshëm Hamit Meli, i cili kishte ëndërruar të bëhej një mjek i mirë. Këtë ëndërr të bukur ia kishte nxitur sëmundja e babait të plagosur në luftë. Meli i vogël e quante të pakuptimtë që të vdiste nga sëmundja në kushte paqeje një njeri, i cili kishte arritur të mbijetonte plagët e luftës. Sidomos babai i tij…

Ambulanca e lagjes pranë shtëpisë së tyre, u bë shtëpia e tij e dytë. Atje ai kishte mundësi të njihte nga afër profesionin e tij të preferuar. Një ditë ai kishte shkuar në ambulancë së bashku me babanë e sëmurë nga ethet. Megjithë interesimin e mjekut dhe të një infermiereje, babai kishte humbur ndjenjat. I përlotur tek koka e krevatit, Hamiti i vogël i murmurinte:

— Rezisto, baba, rezisto të lutem! Pas shtatë vjetësh unë do të bëhem mjek dhe do të të shëroj nga kjo sëmundje që po të mundon; të jap fjalën!

Atëherë ai vazhdonte vitin e dytë të gjimnazit dhe rezultatet i kishte premtuese. Kur i përgatiste shpejt mësimet e ditës së nesërme, ai vraponte në ambulancë. Midis bluzave të bardha, shikonte të ardhmen e tij. Gjatë kohës që qëndronte në ambulancë, edhe ai vishte një bluzë të bardhë. Kur ndonjë infermiere e thërriste ta ndihmonte në ndonjë shërbim, djaloshi i papërtuar vraponte atje i ngazëlluar. Kështu ai e ndiente veten anëtar i personelit mjekësor. Nën mbikqyrjen e infermiereve, ai kishte mësuar t'iu bënte shiringa të sëmurëve që shkonin në ambulancë. Me kalimin e kohës, Hamiti u specializua aq mirë në bërjen e injeksioneve, saqë kishte pacientë që preferonin dorën e tij të lehtë.

Një ditë një infermiere i tha në mirëbesim:

— Hamit, këto ditë na ka ardhur një kurë e re, e cila mund të jetë e efektshme për sëmundjen e babait tënd. Por mjekët nuk guxojnë t'ia bëjnë shiringat për shkak të grupit të tij të gjakut.

— Pse efektshmëria e një ilaçi varet edhe prej grupit të gjakut të pacientit?

— Jo, efektshmëria e kurës është e njëjtë për të gjithë grupet e gjakut, por bëhet fjalë për efektet e padëshirueshme anësore të saj në organizmin e të sëmurit. Pas përdorimit të kësaj kure në spitalet tona, mjaft pacientë kanë gjetur

shërim prej saj, por ka pasur edhe tre të vdekur. Që të tre i përkisnin grupit të gjakut të babait tënd. Kura përbëhet nga 24 shiringa, por vetëm tri të parat janë problematike.

— Në cilën pjesë të trupit bëhen ato shiringa?

— Në mishra, në të ndenjura.

— Po unë të njëjtin grup gjaku kam me babanë tim?

— Jo, nuk është e thënë. Por për të përcaktuar grupin e gjakut duhet bërë analiza e tij.

Hamiti i kërkoi një infermiereje tjetër t'i bënte analizat e gjakut, që ta njihte *për kuriozitet* grupin e gjakut të tij. Analizat treguan se ai kishte të njëjtin grup gjaku me babanë. Ndërkohë ai u interesua dhe i pa me sy shiringat e kurës së re.

Pas një jave djaloshi takoi mjekun përgjegjës të ambulancës e i tha:

— Babai ynë është i ri në moshë dhe unë nuk dëshiroj që ai të na lërë jetimë kaq herët. Prandaj mendoj t'ia bëni kurën e re që ka ardhur, se organizmi i tij do ta përballojë pa probleme atë, pavarësisht prej grupit të gjakut.

— Nga nisesh ti që organizmi i babait me atë grup gjaku mund ta përballojë pa pasoja kurën? e pyeti i buzëqeshur mjeku, duke sistemuar dy dosje që kishte në duar.

Hamiti u skuq në fytyrë para se të përgjigjej me zë të ulët:

— Fillimisht dua t'ju kërkoj falje për atë që kam bërë, doktor. Megjithëse unë kam të njëjtin grup gjaku me babanë, organizmi im i përballoi pa problem tri gjilpërat e para të asaj kure.

Mjeku i shkëputi sytë prej dosjeve që po rregullonte dhe, me një çehre të ndryshuar, e pyeti:

— Seriozisht po flet, Hamit?

— Po.

— Por kjo është një marrëzi për moshën tënde – bërtiti mjeku duke i flakur matanë dosjet që po rregullonte. – Cili qe ai i çmendur që ka guxuar të bëjë një eksperiment të tillë me organizmin e një adoleshenti? Më thuaj emrin e tij, shpejt!

— I kam bërë vetë në mishra çdo…

— E pamundur! – thirri me zë të lartë, i bërë spec i kuq në fytyrë mjeku. – Edhe për një profesionist është shumë e vështirë t'i bëjë gjilpërë vetes.

— Unë u kam bërë me dhjetëra gjilpëra të tjerëve. Për t'i bërë tri gjilpëra vetes nuk ishte aspak problem. Nëse më lejoni, unë mund ta bëj të katërtën në praninë tuaj, tani.

— Je duke folur përçart, Hamit? Ç'janë këto që thua? Babai yt nuk do ta pranonte kurrë një sakrificë të tillë nga ana jote. Ti nuk duhet të shkelësh më në ambulancë.

— I bëni kurën babait, ju lutem! Pastaj unë nuk do të vij më këtu, po nuk më pranuat ju.

Duke vrenjtur vetullat, mjeku e pyeti:

— Çfarë shqetësimi ndieje pas bërjes së gjilpërës?

— Një shtim etjeje gjatë ditës dhe një marrje mendsh të lehtë në mbrëmje; asgjë tjetër. Mos u bëni merak fare, doktor.

*

Vdekja e babait pas shtatë muajsh e detyroi adoleshentin e papërmbajtur të mos shkonte më në ambulancë, e cila i ngjallte kujtime të hidhura. Mirëpo akti i tij i guximshëm me eksperimentimin e gjilpërave dhe temperamenti i zhdërvjellët i djaloshit me biografi të shkëlqyer tërhoqën vëmendjen e ekspertëve të DSJsë, që zgjidhnin studentët e ardhshëm të shkollës së shërbimit sekret. Megjithë amanetin e babait, që asnjëri prej djemve të tij të mos kryenin studime ushtarake, pushteti diktatorial arriti t'ia mbushte mendjen nënës dhe vëllait të madh, që të miratonin regjistrimin e Hamitit në shkollën speciale të DSJsë.

«Kjo ka qenë kthesa fatale e jetës sime prej jetimi, që ma dogji të ardhmen përgjithmonë. Më mirë do të kishte qenë të kisha vdekur nga gjilpërat, sesa të kryeja studime ushtarake kundër amanetit të babait. Ndoshta mosrespektimi i këtij amaneti qe mallëkim për të ardhmen time», tha me vete detektivi i burgosur me sytë mbi rrjedhën e lumit.

Sa dhimbje ndiente ai duke bërë bilancin e ngjarjeve të fundit: Daka e Merdari të vrarë, fati i Stretos i panjohur, Pahia në kthetrat e anglezëve, ai vetë i mbetur fillikat… Si një anije pa timonier e përzënë nga dallgët, grupi që vepronte në Tiranë do të përpiqej të merrte kontakt me të autorizuar të CIAs më 20 maj. Kjo ishte e vetmja shpresë shpëtimi për Pahinë. Por a do të realizohej dot ky takim i rëndësishëm për të siguruar qysh atë natë ndërlidhjen me shërbimin sekret amerikan? Meli nuk i jepte dot përgjigje kësaj pyetjeje, mbasi qysh prej ndarjes me Pahinë, ai nuk kishte më asnjë informacion, se ç'ndodhte në Tiranë. Kjo e mundonte së tepërmi.

— Hamit, sonte do të kesh përsëri vizitorë – i pëshpëriti një zë i njohur.

Detektivi i burgosur i shkëputi sytë prej ujit të kthjellët të lumit dhe u përqendrua tek personi që i foli: kartelisti i kampit ndodhej një metër larg tij.

LVIII

FYTYRA E VËRTETË E KOLONIZATORIT

"*Keqbërësi synon të hedhë mbi të*
tjerët përgjegjësinë që nuk pranohet."
J. Kortazar

U*naza e Bardhë* dhe *Dofeni* do të ishin vizitorët e natës të ish-detektivit. Këtë herë secili prej tyre kishte përkthyesin e tij. Fjalët e zyrtarit anglez i përkthetheshin *Dofenit* prej një kuadri të DSJsë që e shoqëronte. Midis Melit dhe secilit prej të dy shefave kishte zënë vend përkthyesi respektiv. Ky fakt i krijoi përshtypjen detektivit të burgosur, se dy përkthyesit luanin njëherësh edhe rolin e badigardëve, gjë që linte të kuptohej se takimi do të ishte më i nxehtë se herët e tjera. Natyrisht, ardhja e tyre vetëm pas katër ditësh nga takimi i fundit me praninë e Pahisë sinjalonte një ballafaqim me dhëmbë të shtrënguar midis të dy palëve, një lloj larje hesapesh.

Fjalët e para të anglezit e qartësuan skenarin:

— Megjithëse më kishit thënë se për ju ishte njësoj e huaj si anglishtja jonë, ashtu edhe ajo e amerikanëve, ju zgjodhët këtë të fundit. Shokët tuaj e kryen me sukses detyrën, që u kishit besuar. Megjithatë, pavarësisht nga përpjekjet tuaja, nuk besoj se do të arrini të shpëtoni prej zhgënjimeve.

— Flisni më konkretisht, ju lutem; për çfarë zhgënjimi e keni fjalën?

— Autori e njeh veprën e tij edhe kur i lexohen vetëm pak rreshta të saj. Meqenëse ju preferoni të luani rolin e naivit, ju bëj të ditur se kjo nuk i përshtatet aspak natyrës suaj serioze. Është e drejta juaj që edhe të mos flisni fare, por është më e denjë që, kur të fislni, të mos të përpiqeni të mbuloni diellin me shoshë. Tradhëtinë që na keni bërë, Hamit Meli, na i keni borxh brez pas brezi.

Sulmi qe i beftë dhe brutal. I pikëlluar për fatin e dukshëm të Pahisë, detektivi i burgosur u përgjigj me të njëjtin ton:

— Unë nuk jam nënshtetas anglez dhe as kuadër i shkollës suaj të shërbimit sekret, që të keni të drejtë të më akuzoni për tradhëti. Unë nuk kam bërë asgjë, por edhe sikur të kisha bërë gjithçka mundja në dëm të interesave tuaja ilegale në atdheun tim, ju mund të më përpilonit çdo lloj akuze, por jo atë të tradhëtisë, se tingëllon absurde kur e shqiptoni.

— Atëherë dëgjoje nga unë shqiptimin e asaj akuze, që të mos të të tingëllojë absurde – ndërhyri energjikisht në bisedë *Dofeni*. – Brez pas brezi borxh na i ke tradhëtinë që ke nxitur dhe ke organizuar ndaj nesh, Hamit Meli. Kurrë nuk do të ta harrojmë e as nuk do të ta falim.

— Nuk ju kam kërkuar ndonjëherë falje, megjithëse më keni dënuar tre herë me vdekje në mungesë, – ia priti Meli me zjarr.

— Katër herë, jo tre, – u hodh e tha shefi anglez. – Dy herë të kanë shpëtuar komplotistët e tu, ndërsa dy herë të tjera unë. Dhe të dy palëve na i shpërbleve mirë – shtoi ai me zë pak më të ulët.

I tensionuar, detektivi i burgosur nuk ishte i sigurte se cilët përfshinte saktësisht termi *të dy palët*. Por, pa arritur ai të shprehet, foli *Dofeni*:

— Afrimin e arrestuam – i tha ai, duke e kuptuar se ky sqarim ishte i nevojshëm në atë çast për Melin. – Por ndodhet në spital, jo në hetuesi. Bëri tentativë vetëvrasjeje, duke i rënë murit me kokë. Është rëndë.

Detektivi i burgosur mezi dëgjonte nga veshët që i gumëzhinin. Shikimi iu errësua, ndërsa zëri i *Dofenit* i dukej sikur i vinte nga ndonjë pus i thellë. Shpresa e fundit që kishte pasur për shpëtimin e Pahisë ishte 20 maji. Por ai kishte bërë tentativë vetëvrasjeje dhe *Dofeni* pohonte me gojë të tij se ishte rëndë. Ndofta edhe nuk ishte më. Ndërsa ai vetë, edhe pas katër dënimeve me vdekje në mungesë dhe me një koleksion sëmundjesh në trup, vazhdonte të jetonte falë sakrificave të këtyre shokëve, të cilët po flijoheshin në lulen e moshës dhe në kulmin e shëndetit. Për shpirtin e detektivit të burgosur, të mbushur ding me vrer, kjo ishte një mbingarkesë e papërballueshme. Atij iu kujtua buzëqeshja e fundit e Pahisë tek përpiqej të qetësonte mikun e burgosur, ndërsa vetë po shembej në greminën e fatalitetit.

Në ato çaste Melit i dukej se nga çdo pore e trupit i dilte flakë. Harroi gjithçka dhe u pushtua i tëri nga një dëshirë e papërmbajtur: të shkarkonte mbi të dy shefat që kishte përballë hidhërimin e madh që po i farmakoste gjakun, pastaj le të vdiste i qetë.

Për t'i krijuar terren të përshtatshëm një starti të fuqishëm të shpërthimit të tij, bëri këtë pyetje të shkurtër me një zë fantazme:

— Pse e arrestuat?

— Për tradhëti të lartë – iu përgjigj *Dofeni*.

— Kush je ti që paske të drejtë të arrestosh të tjerët për atë krim që kryen vetë? A di gjë populli shqiptar që ti sonte je këtu dhe me cilin je? bërtiti i burgosuri krejt i çakorduar.

I shqetësuar më tepër nga toni shumë i lartë i të folurit të Melit, sesa nga fjalët e tij, *Dofeni* i tha me nxitim:

— Ule zërin, Hamit, ule zërin se dëgjohesh jashtë.

Pa ua vënë veshin vërejtjeve të *Dofenit*, detektivi i burgosur vazhdoi me të njëjtin ton:

— Si guxon ti, njeri i papërgjegjshëm, të përmendësh shprehjen *tradhëti e lartë* i ulur në të njëjtën tavolinë me pushtuesit e fshehtë të atdheut? Kush të ka mësuar ty të...,

Atë çast Melit i shpërtheu gjaku nga goja dhe ra pa ndjenja mbi tavolinë.

Anglezi, i cili ishte bërë gati të ndërhynte në bisedë, u shqetësua shumë. Gjithashtu edhe *Dofeni*. Dy përkthyesit i pastruan gjakun dhe po përpiqeshin t'i vinin në ndihmë të burgosurit të raskapitur.

— Vuan nga zemra – i shpjegoi *Dofeni* mysafirit anglez. – Hemorragjia i ndodh sa herë që acarohet së tepërmi nga nervat, më ka thënë një mjeku ynë që e ka kuruar rishtas.

— Ndonjë e papritur e padëshirueshme sot do të ishte me përgjegjësi. Kemi ardhur t'i japim njoftimin e mbrotjes së tij nga pala amerikane dhe një vdekje e befasishme mund të quhej e inskenuar. CIA ka në dispozicion të saj pengjet tona, të cilët to t'i shkëmbejmë me Melin. Ky sot duhet të firmosë patjetër dokumentin përkatës, që u vu në dijeni për mbrojtjen e akorduar – i tha i preokupuar anglezi.

Dy përkthyesit e kishin shtritur Melin mbi një divan të butë rrëzë dritares. Pas disa minutash i burgosuri u përmend e hapi sytë. Përkthyesi anglez i dha menjëherë një hape dhe pak ujë. Ndërsa shqiptari e pyeti duke i buzëqeshur:

— A jeni më mirë?

— Po, po, kaloi tani, – belbëzoi me zor Meli.

Duke u rrudhur në fytyrë, ai u ngrit ndenjur. I sollën një kafe, në të cilën përkthyesi anglez diçka shtiu. Ish-detektivi e piu dhe e ndjeu që i bëri mirë. Pas pak ai u çua ngadalë dhe shkoi e u ul në vendin e tij.

— A ndjeheni më i fortë tani? e pyeti anglezi.

— Disi, – u përgjigj nëpër dhëmbë Meli.

I mësuar që të fyente të tjerët pa guxuar kush që ta fyente atë vetë, *Dofenit* nuk iu durua pa e ngacmuar:

— Kur flet keq, e keqja të gjen, Hamit.

Detektivi i burgosur ktheu ngadalë fytyrën në drejtim të atij dhe iu përgjigj me një zë të mekur:

— Që kur jam larguar nga DSJ, kam preferuar më mirë të keqen fizike, se atë morale.

Dofeni u vrenjt në fytyrë dhe u kundërpërgjigj:

— Mos harro se biografia jote fillon para se të largoheshe nga DSJ.

Anglezi, i cili deri atëherë kishte dëgjuar në heshtje, mori fjalën duke iu drejtuar *Dofenit*:

— Acarimi nervor ekstrem është njësoj si dehja nga alkooli. Në një gjendje të tillë njeriu e humbet vetëkontrollin. Atëherë maska bie dhe del fytyra e vërtetë e njeriut. Ashtu ndodhi pak më parë me Hamitin. Ai nxori fytyrën e tij të vërtetë, atë të hetuesisë speciale: tamam një nepërkë nën gur.

Detektivi i burgosur, i cili akoma nuk ishte qetësuar sa duhej, shpërtheu përsëri. Ndonëse fuqitë e kishin lënë dhe djersë të ftohta po i njomnin ballin, ai i tha *Dofenit* me zë të dobët:

— Kur e bën të huajin zot në vatrën tënde, ai ka të drejtë të të gjykojë si t’i dojë qejfi. Por mos harro *Dofen*, se ai gjarpër me syze [Meli tregoi me dorë anglezin] do të të pickojë edhe ty vetë një ditë.

— Kjo është ofezë e hapur – bërtiti anglezi, duke përplasur grushtin mbi tavolinë.

Dyllë i verdhë në fytyrë, detektivi i burgosur iu drejtua atij:

— Mos mendoni se poshtërimin moral që miratojnë veglat tuaja të verbëra, për hir të interesave të ngushta, e pranon çdo gjak shqiptari. Historikisht çdo pupull, krahas heronjve të tij, ka nxjerrë edhe tradhtarë.

I egërsuar në kulm, *Dofeni* replikoi gjithë mllef:

— Ke të drejtë të flasësh tani si të të vijë për mbarë, Hamit. I vendosnim në letër dënimet me vdekje për një armik të betuar si ti dhe përsëri na dhimbseshe. Nuk kanë thënë kot: *Mëshira është tradhëti ndaj vetvetes*. Tani zotërinë tënde e merr në mbrojtje Daj Sami.

— Unë nuk kam nevojë për mbrojtjen e askujt – thirri Meli me aq zë sa kishte. – Ndonëse i ri, unë jam i tejngopur me jetën dhe zgjatja e saj është vazhdim i një të keqeje për mua. Jeto ti, o njeri i llastuar i fatit dhe i atyre që të mbrojnë. Por mos e harro atë që tha mbrojtësi yt anglez herën e kaluar: *që njeriu të mos përfundojë i zhgënjyer, duhet ta ketë në qendër të vëmendjes faktin se çdo gjë është relative*. Nga ky parim nuk bën përjashtim as mbrojtja jote e trashëguar.

Anglezi ndërhyri prerazi, për t'i dhënë fund polemikës:

— Firmoseni këtë dokument që jeni vënë në dijeni se, qysh prej katër ditësh, ndodheni nën mbrojtjen e CIAs – i tha ai Melit, duke i zgjatur një dosje të hollë, e cila duhej firmosur në disa vende.

Ndërsa detektivi i burgosur po firmoste si me pahir aty ku po i thoshte përkthyesi anglez, *Unaza e Bardhë* shtoi:

— Në mbrëmjen e 20 majit do të kontaktoni me palën që ju ka marrë në mbrojtje. Tani mund të largoheni.

LIX

ANKORIM ZHGËNJYES I SHPRESAVE

“Politika nuk ka zemër, por vetëm kokë”
Napoleon

Në datën 20 maj 1984 oficer roje në kampin e Qafë-Barit ishte përsëri kartelist Et’hemi. Ai i bëri të ditur Melit se në orën 22 e 30 një kuadër i DSJsë do ta shoqëronte jashtë kampit, për të shkuar në takimin e rëndësishëm të asaj nate, i cili do të zhvillohej në një dhomë të posaçme afër zyrave të komandës së kampit. Ashtu ndodhi. Në orën e caktuar shoqëruesi e çoi Melin deri tek dera dhe i tha me mirësjellje:

— Këtu detyra ime mbaron.

Këtë herë ish-detektivi pranoi që të shkonte në takim me rroba të sjella posaçërisht. Ai e falënderoi shoqëruesin dhe hapi derën. Gjithë sa ishin në atë dhomë të madhe, të mobiluar në mënyrë luksoze, u çuan në këmbë.

Pasi takoi treshen amerikane, detektivi i burgosur i dha dorën *Unazës së Bardhë* e përkthyesit të tij dhe ul në vendin e rezervuar, pa u takuar me *Dofenin*.

Zyrtari kryesor amerikan [shef i seksionit evropian të CIAs – sipas prezantimit] ishte rreth të pesëdhjetave. Në krahun e majtë të tij kishte zënë vend përkthyesi, ndërsa në krahun tjetër një koleg i përafërt në moshë. Të tre këta ia shtrënguan dorën Melit me të dy pëllëmbët e tyre.

Si u ulën të gjithë, bisedën e çeli kryezyrtari amerkan:

— Si keni qenë me shëndet këto kohët e fundit, z. Meli? Kemi dijeni se vuani nga disa sëmundje.

— Nuk kam qenë keq, mbasi janë përpjekur të më kurojnë.

— Dua t'ju them qysh në fillim, se keni shumë të fala nga Guri dhe Dariu. Janë mirë që të dy. Guri tani për tani është me pushime. Më vonë besoj se do të vijë t’ju takojë.

Detektivit të burgosur i gufoi zemra kur dëgjoi emrin e Gurit. Fakti që ai ishte mirë dhe që ndodhej jashtë çdo rreziku e qetësoi pa masë, duke ia lehtësuar njëfarësoj brengën për fatkeqësinë e Pahisë. Atij nuk iu durua pa pyetur:

— Në SHBA ndodhet Guri?

— Po, por e ndien veten njësoj si në shtëpinë e tij – iu përgjigj i buzëqeshur amerikani.

Melit i shkuan sytë atë çast tek baxhanaku i Stretos. *Dofeni* kishte ulur kokën dhe, në heshtje të plotë, po vërtiste paketën e cigareve nëpër gishtat e dorës së djathtë.

— I bëni të fala nga ana ime Gurit, ju lutem. Të mos mërzitet për shokun që i arrestuan për inat të tij.

— E vizituam Afrimin në spital; është mjaft i sëmurë.

— Ai tentoi të vetëvritej, për t'iu shpëtuar torturave të DSJsë dhe të anglezëve – tha Meli i zymtë në fytyrë.

— Për kurimin e tij ne nuk do të kursejmë asgjë – premtoi shefi amerikan. – Trima të tillë meritojnë respektin e të gjithëve.

Angloshqiptarët, si *zotër të shtëpisë*, përgatitën kafet e para dhe i servirën të shoqëruara me pije. Meli e refuzoi në shenjë proteste për replikat që kishte shkëmbyer me ta pak ditë më parë.

Duke pirë kafen, zyrtari i parë amerikan e pyeti:

— Si është gjendja e përgjithshme e kampit ku po vuani dënimin, z. Meli?

— Si mos më keq. Dhuna fizike, psikike e shpirtërore dhe, krahas tyre, mjerimi ekonomik, janë shoqëruesit e përhershëm të jetës së këtushme. Puna e rëndë në minierë në kushte krejtësisht çnjerëzore dhe me norma të detyruara shumë të larta, i shkatërron me shpejtësi të burgosurit. Dënimet janë drakoniane, thjesht për shprehjen e pakënaqësisë më të vogël ndaj diktaturës në fuqi. Ushqimi nuk vlen as për kafshët: pesë muaj speca të ziera dhe shtatë muaj presh të zier – të freskët ose të thatë.

Të dy përkthyesit ngecën në përkthimin e fjalës *presh*. Siç i shpjeguan më vonë Melit, këtë fjalë të gjuhës shqipe ata e kishin takuar nëpër fjalorë me sinonimin e saj *pras*. Vetëm pasi ua skicoi ish-detektivi në një copë letër formën e kësaj bime, dy përkthyesit arritën ta merrnin vesh se kush ishte *mbreti* i menusë së burgut.

— Ju thatë se dënimet janë drakoniane; a mund ta ilustroni këtë me shembuj, z. Meli? u interesua shefi i seksionit evropian të CIAs.

— Për mua do të ishte e vështirë të flisja për këtë çështje në mungesë të autoriteve shqiptare, mbasi ju do të kishit të drejtë të dyshonit në sinqeritetin tim: kaq larg koncepteve bashkëkohore të ligjit dhe të drejtësisë janë dënimet pa shkak të kundërshtarëve politikë në Shqipëri. Meqenëse është i pranishëm drejtori i shërbimit sekret shqiptar, unë ju bëj të ditur se në këtë kamp pune janë dyzetë e një të burgosur që kanë vuajtur më tepër se njëzet vjet burg pa ndërprerje dhe kanë ende vite të tjerë për të vuajtur. Ndërsa i burgosuri Sami Dangllia nga Korça, i arrestuar qysh në tetor të vitit 1944, është dënuar edhe dy herë të tjera *për veprimtari armiqësore* brenda në burg me nga 25 vjet heqje lirie. Ai nuk e ka parë ende me sy Shqipërinë pas Luftës së Dytë Botërore.

Përkthyesi amerikan vuri të dy duart në kokë dhe shikoi shefin e tij. Pastaj, sikur ta kishin bërë me fjalë, të gjithë e fiksuan shikimin mbi *Dofenin*.

Me atë rast përkthyesi amerikan i tha Melit:

— I burgosuri i shumëvuajtur, z. Dangllia, është një martir i vërtetë. Mua më dhimbset jo vetëm si njeri e si shqiptar, por edhe si korçar. Me origjinë unë jam nga një fshat i Korçës. Isha fëmijë kur prindërit e mi u arratisën nga Shqipëria, duke më marrë me vete. Jeta e skëterrshme e z. Dangllia është një dramë tronditëse.

— Ka edhe të tjerë të burgosur politikë shqiptarë me fat të ngjashëm si të z. Dangllia. Pa llogaritur disa mijëra të pushkatuar e qindra të burgosur të tjerë të zhdukur në hetuesi, apo të vdekur në kampet e punës dhe burgjet e diktaturës.

— Po ju, i dashur koleg, a keni punuar në minierë? e pyeti përkthyesi Melin.

— Po, kam punuar rreth një vit. Galeritë janë të ulëta sa mezi qëndron në këmbë. Sigurimi teknik i të burgosurve figuron vetëm në letër. Acidi sulfurik të djeg rrobat dhe lëkurën. Jeta është në rrezik sapo kapërcen hyrjen e minierës në gjendje të mjeruar teknikisht.

LX

SFIDË INJORUESE

"*Të jesh i skllavëruar në vetvete*
është skllavëria më e mundimshme."
Seneka

Amerikanët ofruan kafe nga ana e tyre. Meli e mori së bashku me pijen me ngjyrë. Kryezyrtari amerikan hyri në temën qendrore të takimit:

— Siç jeni vënë në dijeni, z. Meli, CIA ju ka marrë nën mbrojtje. Nuk e patëm të lehtë t'ia arrinim këtij qëllimi, mbasi pala angleze dhe ajo shqiptare u treguan shumë të ngurta në trajtimin e çështjes suaj. Sidoqoftë, me përpjekjet dhe me ofertat tona, arritëm t'ju nxirrnim nga kthetrat e vdekjes, që po ju trokiste tek dera. Si shkëmbim me ju, pala angleze kërkoi lirimin e gjashtë detektivëve të saj që ndodhen në duart tona. Raporti nuk ishte i drejtë, por ne nuk do të ngurronim fare edhe sikur njëqind me një të pretendonin ata, aq të kënaqur e mirënjohës jemi për punën tuaj të shkëlqyer. Në të ardhmen ne do të përpiqemi që t'ju krijojmë edhe favore të tjera, mbasi ju i meritoni plotësisht.

— Ne nuk do të bëjmë asnjë lëshim të mëtejshem për Melin, – deklaroi *Unaza e Bardhë* duke ndërhyrë në bisedë.

Si kundërpërgjigje, shefi amerikan filloi të fërkonte gishtin e madh me atë tregues, sikur po numëronte të holla, duke shikuar buzagas anglezin. Pastaj ai iu drejtua sërish detektivit të burgosur:

— Një gjë duhet ta kuptoni mirë, z. Meli. Mbrojtja që ofron CIA nuk është vullnet privat i një individi apo i një grupi të cakturar personalitetesh të shërbimeve tona sekrete, por një vendim qeveritar, i cili do të jetë në fuqi derisa të ekzistojë shteti amerikan. S'ka rëndësi pse vdes unë nesër, apo edhe kolegët që më shoqërojnë mua sonte. Vlerat e kësaj mbrojtjeje janë të garantuara me ligj dhe nuk vdesin kurrë.

Duke thënë fjalët e fundit, ai nxori nga çanta një dosje me letër të lustruar dhe ia ofroi Melit. Përkthyesi amerikan filloi t'i tregonte vendet se ku duhej të firmoste. Ndërsa me detektivin e burgosur vazhdonte procedura e nënshkrimeve, *Unaza e Bardhë* i tha kolegut amerikan:

— Në shkollat tona të shërbimeve sekrete, si në tonën ashtu dhe në tuajën, nuk i jepet prioritet letërsisë, përkundrazi. Le më në shkollën e këtyre! – tha ai, duke treguar me dorë *Dofenin*. – Prandaj më ka bërë përshtypje një dell letrar që e përshkonte mbrojtjen e Melit natën e parë të takimit tonë me të. Ishte përgatitur me letër në mënyrë mbresëlënëse.

— Ju e njihni më mirë, sigurisht. Unë sonte po e shikoj për herë të parë.

— Megjithëse sonte e shikoni për herë të parë, si mendoni, a e përfundon dot me sukses një mision Meli në këtë gjendje shëndetësore?

Amerikani u përgjigj duke mbledhur supet:

— Çdo përgjigje që të jap unë nuk e argumentoj dot, sepse më mungon ajo shkallë e domosdoshme njohjeje, që e bën të mundshëm vlerësimin real.

— Ja ku po ju a them unë që e zotëroj tashmë atë shkallë njohjeje. Edhe në këtë gjendje shëndetësore që është, Meli, me cilësitë që ka, mund ta realizojë me sukses një mision.

Kur detektivi i burgosur mbaroi punë me dosjen, shefi i seksionit evropian të CIAs e pyeti:

— Prej librave që keni lexuar, cilët ju kanë lënë më shumë mbresa, z. Meli?

— *Martin Iden* dhe *Rreziku anglo-american për Shqipërinë* – u përgjigj me qetësi ai dhe shtoi: – ky i fundit është vepër e liderit të shtetit shqiptar.

Të tre amerikanët qeshën me gjithë shpirt. Instiktivisht atyre u shkuan sytë tek *Dofeni*, i cili po përpiqej ta kalonte si pa rënë në sy sfidën që i ishte bërë. As *Unaza e Bardhë* me përkthyesin e tij nuk e kursyen buzëqeshjen këtë herë.

Meli iu drejtua shefit amerikan:

— Dëshiroj të bëj një ekspozé të shkurtër të ngjarjeve që sollën takimin tonë të kësaj nate, nëse e jeni dakord.

Amerikani shikoi *Unazën e Bardhë*. Ky nuk reagoi fare.

— Po ju dëgjojmë me kënaqësi, z. Meli, – i tha shefi i seksionit evropian të CIAs.

LXII

MELI I DREJTOHET SHTËPISË SË BARDHË

"*Ylli i ndikimit të fortë shkon drejt perëndimit*."
Xh. Adams

Detektivi i burgosur u ngrit në këmbë, nxori disa fije letre nga xhepi dhe filloi të lexonte me një zë të shtruar:

Zotërinj të Nnderuar,

Jam sa i befasuar nga mbrojtja e paparashikuar e shtetit më të fuqishëm të botës, aq edhe i indinjuar prej shtypjes së pamëshirshme, që i është bërë e po i bëhet popullit shqiptar nga një diktatori i mbështetur fuqimisht prej Londrës. Anglezët e adhurojnë lirinë, por kjo nuk i pengon ata për të mbështetur despotët që bëjnë lojën e tyre në prapaskenat e politikës, duke skllavëruar popuj të pafajshëm.

Jam i befasuar prej takimit të sotëm për faktin se regjimi ynë në fuqi nuk i ka njohur praktika të tilla në marrëdhëniet midis shteteve. Por duket qartë se vezullimet e një qytetërimi, që nis mesazhe në emër të njerëzimit me sonda ndërplanetare, nuk mund të mos ta depërtonin klonin e Shqipërisë hermetike, e cila ka filluar t'i mbyllë portat me çelësa të markave britanike.

Eshtë fakt që pranohet prej të gjithëve, se t'i shikosh atdheut plagët e hapura në fshehtësi prej një diktatori agjent dhe të mos përpiqesh t'ia mjekosh, është një dezertim i turpshëm. Në shtigje të tilla më ka tërhequr për dore fati im dhe unë jam përpjekur të bëja sa të mundja, nën diktatin e shpirtit tim të lënduar nga pendesa.

Jam bir i një populli të thjeshtë, të ndershëm, punëtor e liridashës, por, mjerisht, i një populli të pakulturuar në nivelin e kontinentit; jo për faj të tij. Për shkak të ndërhyrjeve jo dashamirëse të fuqive të mëdha, si edhe të papjekurisë së tij politike, populli shqiptar doli i humbur prej të dy luftërave botërore, si në planin shoqëror, ashtu edhe në atë kombëtar. Fajet e rënda politike sjellin pasoja të rënda për të ardhmen e çdo populli. Për analogji të fatit të popullit tim, po ju sjell fatin tim:

Në rininë e hershme kam ëndërruar të bëhesha një mjek i mirë, për t'iu qetësuar dhimbjet njerëzve e për t'iu zgjatur jetën. Por ata që e kishin në dorë fatin tim ditën ta manipulonin atë, duke devijuar aspiratat e mia. Dhe unë u shndërrova në të kundërtën e atij që ëndërroja të bëhesha. I lidhur pazgjidhmësisht me profesionin e detektivit, unë u shkurtoja jetën njerëzve e u shkaktoja dhimbje. Me kalimin e viteve, duke u kthjelluar, brejtjet e forta të ndërgjegjes më fundosën në një pendesë gjithnjë në rritje, pa kthim. I dëshpëruar prej gjendjes sime, ndieja neveri ndaj profesionit dhe fillova ta manifestoja hapur atë.

Për këto dukuri të sjelljes sime të dyshimtë në punë e në jetë, u shpalla i padëshirueshëm nga eprorët e mi dhe u përjashtova prej radhëve të DSJsë. Ky qe një çlirim i pjesshëm për mua, i cili nuk më shkarkonte kurrsesi nga përgjegjësia e misioneve të kryera.

Rënia në burg më shërbeu si një dritare prej nga unë pashë me sytë e mi atë lloj barbarie të regjimit që i kisha shërbyer verbërisht, të cilën nuk do ta kisha besuar kurrë me të dëgjuar. Nuk më dhimbsej vetja për vuajtjet që kaloja. Ato ishin një kurë e mirë për shpirtin tim të pllakosur nga pendesa. I lehtësuar nga pozicioni im i ri në jetë, sillja ndërmend fjalët e shkrimtarit amerikan, Toro:

«Për një njeri të ndershëm, *burgu është vendi më i përshtatshëm* në një shtet ku skllavëria mbrohet me anë të ligjit.»

Por edhe atje erdhi e më trokiti në derë profesioni im i vjetër. DSJ më bënte thirrje të kryesoja një mision të rëndësishëm «për interesat e larta të atdheut.*» E njihja mirë hipokrizinë e këtyre sloganeve dhe isha i vendosur në refuzimin tim. Në qoftë se një ditë do të m'i imponin me forcë ato armë, të cilat kisha vendosur të mos t'i prekja më me dorë, do t'i përdorja pa ngurrim kundër atyre që do të më detyronin të rikthehesha në shërbimin sekret.*

S'vonoi shumë dhe doli në skenë një kundërshtar shumë më i fuqishëm e më i specializuar e, deri atëherë sekret: Inteligjencë Servisi britanik. Në pritje të takimit tim të parë me zyrtarët anglezë, më rrihnin si çekan në mendje pyetjet:

Kush ua kishte hapur derën e pasme të oborrit këtyre mysafirëve të natës që do të më vizitonin? Çfarë përfaqësonte në të vërtet epoka dyzetëvjeçare e ndërtimit të socializmit në Shqipëri? Sa marksist paskej qenë diktatori ynë? A dinte gjë populli shqiptar, si ishte luajtur e po luhej me fatet e tij?

Në qoftë se populli nuk kishte nga ta dinte këtë të vërtetë dramatike, unë, biri i tij fajtor, e mësova për shkak të koniukturave në shërbimin sekret. Për mua ajo tani ishte lakuriq. I dalë nga xhunglat e politikës së fshehtë, silueta e luanit britanik po shfaqej kërcënueshëm në horizontin e të ardhmes së atdheut. Do të takohesha me bashkatdhetarët e Shekspirit, për të cilët punonte një Makbeth shqiptar shumë më mizor nga ai i Skotlandës.

Takimi me ta nuk solli ndonjë ndryshim në gjendjen time, veç dyfishimit të rrethit të hekurt që më shtrëngonte për t'iu kthyer profesionit të dikurshëm. Ndërkohë më kujtoheshin fjalët e një poeti e patrioti të shquar shqiptar të viteve njëzetë–tridhjetë:

«Anglia, kjo fuqi e madhe dhe dinake, asnjëherë nuk ia ka dashur të mirën vendit tim. Unë, si një individ i pafuqishëm për t'ia ndaluar dorën e sprovuar në bëmat e saj, shpreh publikisht protestën, duke deklaruar se nuk do ta mësoj gjuhën angleze sa të jem i gjallë.»

Për të penetruar lirshëm në radhët e shërbimit sekret shqiptar, anglezët filluan spastrimet e kundërshtarëve të mundshëm. Pas pushkatimit të detektivit Genc Daka dhe dënimit me burgime të rënda të disa të tjerëve, një muaj më parë u vra me dy plumba pas shpine detektivi Fatmir Merdari. Nën akuzën recetë "tradhëti e lartë"*, ditët e fundit u arrestua detektivi Afrim Pahia, i cili u detyrua*

të bënte vetvrasje, për të mos u rënë pré e torturave çnjerëzore të hetuesisë shqiptare. Tradhëtarët e atdheut akuzojnë gjithmonë për tradhëti të tjerët. Ky është një mësim i mirënjohur i historisë.

Disa ditë më parë anglezët tërhoqën në Londër nëndrejtorin e DSJsë, Guri Streto. Prej trysnisë së rreziqeve që i kanoseshin nën mjegullën londineze, ai u detyrua të arratisej. Inteligjencë Servisi reagoi menjëherë në mënyrë cinike: arrestoi zëvendësuesin e tij në detyrë në DSJ, Afrim Pahia. Ky tentoi të vetëvritej, për të mos iu nënshtruar torturave që e prisnin. Nëpërmjet këtyre masave të paarsyeshme represive shërbimet sekrete britanike synojnë të mposhtin rezistencën e detektivëve shqiptarë ndaj planeve të tyre të errëta, në bashkëpunim me klanin diktatorial të Tiranës. Qeveria amerikane duhet të bëjë ç'është e mundur që t'iu ndalojë dorën regjisorëve të Inteligjencë Servisit, për të mos ta shtjellur më tej dramën shqiptare.

Populli shqiptar, numerikisht i vogël, disponon forca të mëdha shpirtërore për t'iu kundërvënë së keqes. Ne jemi një popull shumë mirënjohës ndaj atyre që na ndihmojnë, por nuk i harrojmë kollaj edhe atë që na bëjnë të keqen.

*Duke përfituar nga rrethanat speciale që m'u krijuan, shpreh me zë të lartë vullnetin e ndrydhur të popullit tim të shumëvuajtur, duke i bërë thirrje qeverisë amerikane që te kontribuojë në zgjidhjen e drejtë të "*çështjes shqiptare*", megjithë kompleksitetin e saj. Ky është amaneti i një të burgosuri politik, që kërkon mjekim për plagët e popullit të tij.*

*Dëshiroj që zërin tim, të pajisur me këtë cilësi, ta përcillni deri në sferat më të larta të shtetit e të qeverisë suaj, mundësisht deri në katin e sipërm të Shtëpisë së Bardhë, në zyrën e Shkëlqesisë së Tij Presidenciale, Zotit Regan [*të pranishmit çohen në këmbë, me përjashtim të *Dofenit*]. *Përfitoj nga rasti, t'i uroj Shkëlqesisë së Tij sukses të plotë në zgjedhjet e afërta, për të mirën e popullit amerikan, të aspiratave të popujve në zhvillim, si* dhe për plotësimin me sukses *të misionit që i ka ngarkuar historia, si Kampion i Lirisë dhe i Paqes në botë. Ju falënderoj për vëmendjen.*

*

Kur detektivi i burgosur mbaroi së lexuari, shefi i seksionit evropian të CIAs i mori letrat e tij, i palosi me kujdes dhe i futi në portofolin personal [jo në çantë], duke i premtuar në mënyrë solemne:

— Zoti Meli, ju jap fjalën se këtë letër do t'ia dorëzoj Zotit Regan me dorën time.

Pastaj, duke iu drejtuar *Unazës së Bardhë,* ai e pyeti:

— Keni gjë për të thënë?

Anglezi u përgjigj në mënyrë domethënëse:

— Meli thotë gjithmonë të vërtetën.

Pas disa minutash, shefi anglez, përkthyesi i tij dhe *Dofeni* dolën jashtë, duke lënë në dhomë vetëm mbrojtësit dhe të mbrojturin.

LXII

MIDIS MIQSH

"*Fjala mik ndodh të jetë e zhveshur nga kuptimi; fjala armik, jo*."
V. Hygo

Treshja amerikane e mori pranë detektivin e burgosur dhe nisi me të një bisedë të ngrohtë.

— Mos u kurseni për ta ndihmuar këtë popull fatkeq – u tha Meli me një ton keqardhjeje. – Mos dëgjoni duartrokitjet e inskenuara nga diktatura, ju lutem. Po të mbani vesh mirë, në Shqipëri dëgjohen vetëm psherëtima.

— E dimë, e dimë – ia ktheu shefi amerikan. – Këtë e tregon më së miri veprimtaria juaj e kohëve të fundit. Sot, siç e dini, duhet të jetë vendosur ndërlidhja midis grupit tuaj që vepron në Tiranë dhe CIAs. Me rekomandim të Gurit, takimin tonë e caktuam enkas për sonte. Ai tha se ky takim do të tërhiqte nga Tirana një pjesë të mirë të përgjuesve në këtë zonë, duke krijuar kështu mundësi më të mëdha për ndërlidhjen.

Me përmendjen e emrit të Gurit, ish-detektivi nxitoi të pyeste:

— Si është në të vërtetë Guri? Si mundi të ikte nga Londra?

— Eshtë shumë mirë. Natën e arratisjes u plagos në kofshën e djathtë, por çdo gjë kaloi pa pasoja. Vëllai juaj, Dariu, e ka transportuar me shumë mundim Gurin e plagosur deri në ambasadën tonë në Londër, ku u morën masat e duhura.

— E paguam me Afrimin; na e morën nëpër duar – foli si me vete të tij Meli.

— Mos u bëni merak as për atë – ia priti shefi i seksionit evropian të CIAs. – Së shpejti do të vijë nga Shtetet e Bashkuara një profesor i mjekësisë amerikane me famë botërore. Për shkak të përplasjes së fortë të pjesës së pasme të kokës pas murit, Afrimi është verbuar në të dy sytë dhe nuk do të shikojë më. Por, po e shpëtuam nga vdekja, ne do ta tërheqim në Amerikë përgjithmonë. Atje do t'ia krijojmë të gjitha kushtet; shpresoj se diçka mund të bëhet dhe për problemin e shikimit. Kemi shumë respekt për ju, djelmosha shqiptarë. Nuk na i merrte mendja kurrë që nga radhët e shërbimit sekret shqiptar të dilnin djem me ndjenja kaq të fuqishme atdhedashurie dhe me shpirt të tillë vetëmohues. Në këtë drejtim ua kaluat edhe polakëve, të cilët shquhen për një gjë të tillë midis vendeve të Evropës Lindore. Angazhimi i drejtpërdrejtë amerikan nën ndikimin e veprimtarisë së grupit tuaj do të mundësojë një kthesë pozitive të rëndësishme në politikën shqiptare. Ka të ngjarë që brenda dy vjetësh Shqipëria të ketë një pamje tjetër dhe ju do të të jeni krenarë për kontributin që dhatë në dobi të së ardhmes së atdheut tuaj.

— Faleminderit shumë; ky është lajmi më i mirë që prisja.

— Kjo nuk është dhuratë nga ana jonë, z. Meli. Ju e meritoni lirinë, gjersa jeni të gatshëm të flijoheni për të.

— A ishte me interes për CIAn arkivi informativ që ju solli grupi i të arratisurve?

— Ato informacione patën një vlerë të pallogaritshme për ne. Dua të veçoj këtu regjistrimet e bisedimeve ultrasekrete midis diktatorit tuaj dhe Londrës, të siguruara prej Gurit. Informacione të tilla janë perla të vërteta edhe për detektivët më të mëdhenj të botës. Ato i shërbyen CIAs si *levë* për të spostuar paksa Inteligjencë Servisin prej pozicionit dominues në Shqipëri.

— Po robin tjetër arritët ta shpëtoni, pasi e morët vesh ku gjendjej?

— Po, po, e shpëtuam. Pasi erdhën në Amerikë shokët tuaj me robin e arratisur, ne folëm menjëherë me anglezët dhe e tërhoqëm edhe robin e dytë, kundrejt një dëmshpërblimi ndaj qeverisë shqiptare. Shpëtimi i dy detektivëve tanë robër është një detyrim tjetër moral që ne kemi kundrejt grupit tuaj të mrekullueshëm, anëtarët e të cilit CIA i ka dekoruar.

— Si paska pranuar diktatori ynë të bëjë lëshime të tilla! Ai ka deklaruar shpesh që nuk bën pazarllëqe me parimet e marksizmit, – tha me ironi detektivi i burgosur.

— Për çfarë parimesh bëni fjalë, z. Meli? Diktatori juaj firmos e vulos symbyllas gjithçka i thonë anglezët. Me këtë rast dua t'ju bëj një pyetje, z. Meli. Cilin vlerësoni më shumë profesionalisht prej shokëve tuaj, që ndodhen aktualisht në SHBA?

— Megjithëse kam mjaft kohë që jam larguar prej DSJsë, mendoj se Guri është më i kompletuari prej tyre.

— Jemi të një mendimi. Ai ka dhunti organizative të spikatura në fushën e shërbimeve sekrete. Dua t'ju bëj edhe një pyetje, që nuk ka lidhje me këto që po diskutojmë, por është kureshtje e imja: sikur t'ju linin të zgjidhnit, ku do të dëshironit të jetonit?

— Në Paris – u përgjigj buzagaz Meli.

— Paskemi shije të njëjta – i tha me të qeshur zyrtari amerikan. – Edhe unë, kur të dal në pension, atje dua t'i kaloj vitet e fundit të jetës, po më lejojë qeveria ime. Amerika ka gjithçka, por Paris jo. Ata që ju njohin mirë, na kanë thënë se juve ju mërziten shpejt mjediset që ju rrethojnë dhe preferoni larminë. Në fakt ky është një tipar i vetë amerikanëve, të cilët e kanë të vështirë ta kalojnë jetën në të njëjtin vend. Në SHBA besoj se nuk do t'ju mungojë larmia. Megjithëse ne nuk kemi Paris, një bukuroshe nga Florida, krahas dhuntive natyrore të atij vendi të begatë, besoj se do t'i kënaqin si duhet ëndjet tuaja.

Meli qeshi; shefi amerikan, gjithashtu. Pastaj ky u rikthye në temë:

— Në bazë të marrëveshjes së arritur me anglezët në kuadër të mbrojtjes suaj, ne kemi të drejtë të dërgojmë njerëzit tanë këtu dy herë në muaj, për tu takuar me ju. Po të jetë nevoja, mund të takohemi edhe më shpesh; kjo nuk përbën ndonjë problem. Ne do të autorizojmë të vijnë këtu persona të ndryshëm nga radhët tona, të cilët do të dëshironin t'ju njihnin nga afër. Gurit dhe shokëve të tjerë të arratisur ne iu kemi dhënë nënshetësi amerikane. Kështuqë, nën mbrojtjen e drejtpërdrejt të CIA-s, ata mund të vijnë t'ju takojnë lirisht. Kur

them *lirisht*, ju si profesionist e kuptoni vetë që ata nuk mund të vijnë në Shqipëri pa maskë, se janë persona të njohur.

Në prag të ndarjes me ta, detektivi i burgosur shtrëngoi dorën e butë të shefit, ndërkohë që zyrtari tjetër po i fotografonte. Të njëjtën gjë bëri vetë shefi i seksionit evropian të CIAs, kur Meli po takohej me dy të tjerët.

LXIII

PARANDJENJË ?

"*Zemra ka arsyet e saj që arsyeja nuk i njeh*."

Paskal

Kur doli jashtë, detektivin e burgosur e impresionoi bukuria e asaj nate të mrekullueshme maji. Duke thithur aromën e këndshme të çliruar prej pishave në lulëzim të plotë dhe rrëshirës së avulluar, kënaqësia iu kthye në një dehje të lehtë. Për një çast ai harroi se ku ndodhej. U mbështet në bordurën e derës së jashtme të godinës ku ishte zhvilluar takimi dhe me gjithë fuqinë e qenies së tij e përqendroi shikimin në horizont. Priste që atje të ravijëzohej e ardhmja e afërt e Shqipërisë, për të cilën i kishte folur shefi i seksionit evropian të CIAs.

Detektivi i DSJsë, që e kishte shoqëruar për të shkuar në takim, doli prej dhomës së policit të shërbimit dhe iu afrua Melit. Hapat e tij nuk e përmëndën të burgosurin ëndërrimtar. Shoqëruesi e goditi lehtë në sup, duke i pëshpëritur:

— Eja të shkojmë, Hamit, se po afron ora e zgjimit në kamp.

Ish-detektivit i kaluan mornica dhe shikoi i hutuar personin që i rrinte përballë. Ky dalloi lot në sytë e të burgosurit. Ai nuk e shqetësoi më, por filloi të ecte me hapa të ngadalshëm drejt portës së madhe prej hekuri të kampit. Meli i shkoi pas.

Kur kaloi portën e dytë të hekurt dhe po i drejtohej së tretës, për të hyrë në kampin e përgjumur, detektivit të burgosur i zunë sytë dy mace që po haheshin egërsisht me njëra-tjetrën për një copë zorrë, ndanë të një kthine që shërbente si thertore. Pak më tej tyre, një mace tjetër qëndronte shtrirë. Meli ngadalësoi hapat dhe e përqendroi vëmendjen mbi këtë skenë. Ndonëse kjo ishte një dukuri e zakonshme e luftës për epërsi në përplasjen e interesave të botës shtazore, atë çast ajo pati një efekt të çuditshëm në ndërgjegjen e të burgosurit. Macet po kacafyteshin ndanë presë së tyre, pa i lëshuar rrugë njëra-tjetrës. Papritmas macja e tretë rrëshqiti drejt copës së zorrës, e rrëmbeu dhe u zhduk matanë telave me gjemba. Dy macet e tjera vazhdonin të grindeshin.

Melit iu kujtua fjala e urtë: «Kur zihen dy, përfiton i treti»

Ai tundi kokën i menduar, psherëtiu, dhe mori rrugën për në *maune*.

LXIV

TERROR ...

"*Kufijtë e tiranisë janë ata që lejon durimi i atyre që ajo shtyp*."
F. Dugllas

Kamioni i ngarkuar me pirit ndaloi para portës së madhe të hekurt të kampit, si zakonisht. Dy policë dolën nga vendstrehimi për të bërë kontrollin rutinë. I hipur sipër kamionit, njëri prej tyre ngulte me dhjetra herë një levë hekuri në materialin e ngarkuar. Polici i dytë kontrollonte me një llampë elektrike pjesën e poshtme të karrocerisë së kamionit. Gjithë preokupimi i tyre konsistonte në eliminimin e mundësisë së tentativës për arratisje nga burgu të ndonjë armiku të partisë.

Pas një seri nguljesh së levës në materialin e shkrifur të piritit, polici sipër karrocerisë klithi me sa zë kishte:

— Një armik është fshehur në pirit.

Thirrja e tij pati efektin e një alarmi. Pesë policë të tjerë, së bashku me oficerin e rojës, vrapuan tek kamioni. Gardianët i hodhën prangat e rënda të ofiçinës në duart pas shpine të burgosurit, sapo ky doli prej piritit. Atje, sipër karrocerisë, ata filluan ta torturonin kush të mundte më tepër. Më i fituari ishte polici me levën e hekurit, mbasi atij nuk i vriteshin duart. Kur i burgosuri i humbi plotësisht ndjenjat, policët e kapën tek shpatullat e tek këmbët dhe e flakën prej karrocerisë së *Saurelit* në tokë, sikur të ishte një thes me pleh.

Të burgosurit që ndodheshin në kamp dhe po e shikonin skenën, menduan se bashkëvuajtësi i tyre pogradecar vdiq. Për fat (të mirë apo të keq, nuk dihej), ai e mbijetoi barbarinë policore, por vitet e burgut të mbetur kapën përsëri shifrën maksimale të Kodit Penal, 25.

Me rastin e afrimit të festës së 40 vjetorit të instalimit të diktaturës në Shqipëri, trajtimi i të burgosurve në kamp vinte duke u shtrënguar. Meqenëse *oreksi vjen duke ngrënë*, drejtoria e Kampe-Burgjeve ia kishte ngritur planin vjetor të nxjerrjes së mineralit komandës së kampit. Kjo, nga ana e saj, ishte zotuar se do ta tejkalonte edhe planin e ri të fryrë që i propozonte MP të Brendshme me rastin e festës jubilare. Për realizimin e këtij zotimi, komanda e kampit u jepte urdhër policëve që ta torturonin pa mëshirë e pa përgjegjësi çdo të burgosur, që nuk realizonte normën e detyruar të ngritur rishtas. Gardianët, të shndërruar në robotë krimi, nuk kishin nevojë për më tepër. Ky progresion aritmetik i rritjes së përmasave të shfrytëzimit çnjerëzor i bënte të burgosurit viktima të një makutërie shtazarake të zyrtarizuar.

Në funksion të synimeve makute të komandës së kampit, për të nxjerrë sa më shumë vagona me mineral dhe për shfrytëzimin maksimal të të burgosurve armiq partie, u vunë në qarkullim terma *revolucionare* ekzistuese e të sajuara:

aksion, aksion me goditje të përqendruar, aksion sulmues, aksion rrufe, aksion i paparë, superaksion, etj, etj.

Në bazë të të gjithë këtyre termave banalë të emulacionit absurd socialist edhe pranë të flijuarve të *socializmit*, qëndronte fjala *aksion* (*veprim),* i cili, me cilësitë shfrytëzuese që mbartte, ishte mjeti më efikas për t'i shndërruar të burgosurit e pafajshëm në vegla pune, të ardhurat e së cilës ishin një investim për fatkeqësinë e tyre.

Bunkerët e mineralit mbusheshin plot dhe shpesh detyroheshin t'i derdhnin në tokë, për t'iu liruar vendin vagonave të tjerë me mineral, që vërshonin nga miniera në të tre turnet e punës dhe që nuk kishin ku të shkarkoheshin. Megjithëse parku automobilistik i Fushë-Arrësit kishte vënë në dispozicion të transportimit të mineralit edhe makina të ardhura nga rrethet e tjerë, bunkerët përsëri bllokoheshin dhe komanda triumfatore e kampit i dërgonte telegram komitetit të partisë në Pukë:

Merrni masa urgjente për transportimin e mineralit. Nuk kemi ku ta hedhim dhe po e derdhim në tokë. Në saje të punës sqaruese dhe bindëse të organizatës bazë të partisë në kamp, të burgosurit janë hedhur në aksion të përgjithshëm për të realizuar tre muaj para afatit planin e ri vjetor, duke punuar pa ditë pushimi deri në festën e jubileut të madh.

Komanda e kampit i fuste me marifet policët në garë me njëri-tjetrin në veprën e tyre makabre. Ajo i joshte rekordmenët e dhunës me shpërblime suplementare në të holla për tejkalim plani, me strehim të parakohshëm në qytet për familjet e tyre, ose me të drejtën për kurse kualifikimi, që u hapnin rrugën e karrierës së mëtejshme të krimit.

Frutet e kësaj prapësie njerëzore, e cila i ndërsente policët injorantë kundër të burgosurve të pafajshëm gjithmonë e më shumë, dukeshin më qartë se kudo në të ashtuquajturat *dhomat e riedukimit të sforcuar*. Një e tillë ishte tek zyrat e komandës dhe një tjetër tek hyrja e minierës.

Mund të numëroheshin me gishtat e njërës dorë ato ditë të pakta të vitit, kur muret e këtyre dhomave ishin vetëm të bardhë. Katër policë të zgjedhur, të cilët quheshin *të gatshmit*, rrinin në gatishmëri tek dhoma e torturave pranë komandës, në pritje për të ushtruar *zanatin* ndaj të burgosurve që silleshin aty. Në orën që linte punën secili prej turneve, *të gatshmit* shkonin tek *dhoma e riedukimit të sforcuar* në hyrje të minierës. Atje u bënin *riedukim të sforcuar* të burgosurve që nuk kishin realizuar normën, të ndihmuar edhe prej policëve që shoqëronin brigadat e punës.

Gjaku i të burgosurve, që i nënshtroheshin sistematikisht torturave, duhej t'i njolloste patjetër muret e dhomave *edukuese*, përndryshe *të gatshmit* akuzoheshin për "liberalizëm në detyrë" dhe zëvendësoheshin. Veç të tjerash, kjo ishte një minus në karakteristikën e tyre profesionale, e cila u kompromentonte të ardhmen e karrierës. Prandaj *gabime* të tilla nuk bëheshin dhe muret e këtyre dhomave s'mbeteshin kurrë pa njolla gjaku.

Lidhur me këtë dukuri, vetë *të gatshmit* tregonin me krenari një ndodhí, e cila kishte lënë gjurmë edhe në alias-ndërgjegjen e atyre robotëve jeshilë.

*

Një i burgosur fizikisht i dobët, i cili nuk e realizonte dot normën në minierë, kishte qenë i detyruar t'i nënshtrohej rregullisht *normës* tjetër në dhomat e sipërpërmendura. Këtij klienti të rregullt të tyre *të gatshmit* i kishin ngjitur nofkën *qiraxhiu*. Sipas tyre, ky fatkeq i kishte zënë me *qira* këto dhoma.

Një ditë *qiraxhiu*, tek po hynte si zakonisht në njërën prej këtyre dhomave, duke parë muret të lyer rishtas me gëlqere, i bëri kaq shumë përshtypje saqë e harroi për një çast sikletin që e priste, dhe thirri i befasuar:

— Të faleminderit, o Zot, që bëri vaki dhe kjo gjë! Nuk e besoja dot kurrë se do të arrija t'i shikoja një ditë vetëm të bardhë muret e kësaj dhome, ku unë kam vuajtur më shumë sesa vetë Krishti!

Por shpejt ata mure nuk mbetën ashtu siç ishin…

Mirëpo asnjë lloj torture, në çfarëdolloj përmasash, nuk arrinte dot t'i kënaqte sa duhej komandën e kampit dhe policët e saj. Rrugës prej kampit në minierë ishin të pranishme dëshmitë e *humanizmit socialist*: njolla gjaku të thara, copra rrobash të flakura me gjak të ngrirë, shkopinj gome të këputur nga pasioni i përdoruesve, tri shtylla të pajisura me çengelë, ku lidheshin në mes të borës, shiut apo erës, ditën ose natën (sipas turneve të punës), të burgosurit që ndëshkoheshin prej gardianëve gjatë orarit të punës.

E megjithatë kjo histori krimi, e shkruar me gjakun e viktimave, i kishte të palodhur heronjtë e saj. Në garë të pandërprerë me njëri-tjetrin, policët shtrydhnin mendjen e tyre shterpe, për të shpikur ndonjë lloj torture të re, e cila mund të meritonte edhe shpërblim nga komanda e kampit.

Njërit prej tyre i shkoi mendja (dhe kjo u duartrokit nga kolegët e tij të pranishëm në këtë leksion praktik të "artit të torturës" si shpikja e vitit) që një të burgosuri me mustaqe, të cilit i kishte lidhur fort duart pas shpine me fitil dinamiti, t'ia shkulte mustaqet me tufa qimesh me pincë. Ndërsa të burgosurit që përpiqej të mos nxirrte zë, po i rridhnin padashje lotët nga dhimbja, policët, që e mbanin të mos lëvizte, gajaseshin së qeshuri me asimetrinë e mustaqeve: nga njëra anë ato ishin të rregullta, ndërsa nga ana tjetër rridhnin gjak.

Kur mbaroi punë me mustaqet, duke i bërë të dy palët e pranishme me lot – policët nga gajasja dhe të burgosurin prej dhimbjeve – autori i këtij krimspektakli u mërzit prej rezistencës së të burgosurit që nuk nxori zë. Duke i fërkuar vendin e përgjakur të mustaqeve me një bisht kazme që mbante në dorë, gardiani i shkrofëtiu tërë mllef:

— Hiqe mendsh se kena maru bashkë, pse marun mustakët. Pa të ba me bërtit përsmari, Nuja s'ka me shku n'kamp sot!

Ndërsa vetë i burgosuri i sfilitur priste që ai t'ia niste avazit me bishtin e kazmës, as policët e tjerë s'po e kutponin dot se ç'do të bënte kolegu i tyre, kur

Nuja nxori shkrepsen nga xhepi. Ai i porositi gardianët e tjerë ta kthenin të burgosurin me fytyrë nga muri. Pastaj ndezi një fije shkrepëse dhe e takoi me zemrën e fitilit të dinamitit. Fitili i ndezur, i futur thellë në kyçet e enjtura të duarve dhe i përdredhur tri herë përreth tyre, duke u djegur digjte edhe lëkurën.

Pas disa sekondash i burgosuri lëshoi një *oh!* të mbytur dhe u përplas në mur nga dhimbja. Policët që e mbanin, e lëshuan dhe u tërhoqën pas. I burgosuri u shemb mbi dysheme dhe, pas një rënkimi të mekur, humbi ndjenjat.

Kur policët prenë fitilin e djegur, ai u hoq bashkë me një rryp lëkure. Spektatorët gjakftohtë të krimspektaklit, të mrekulluar nga e papritura që përjetuan prej *novatorizmit policor* të kolegut të tyre, shprehën admirim për fantazinë e tij:

— Po ku t'ka shku menia, mor Nu; paske ken pernjimen mjeshtër!

Qysh prej asaj dite shokët e tij e thërrisnin polic Nduen – *mjeshtri*.

Një *novatorizëm policor* i barasvlefshëm me atë të *mjeshtrit* u çmua edhe ky propozim i një kolegu të tij: i burgosuri që nuk do të realizonte dot normën brenda tetëorëshit të turnit të tij të punës, pasi të kalonte nëpër duart e *të gatshmëve*, duhej të rikthehej në punë me ndërresën pasardhëse. Natyrisht, të nesërmen i burgosuri në fjalë do të shkonte përsëri në punë me turnin përkatës të brigadës së tij. Kështu që, pas 16 orësh punë, atij i mbetej fare pak kohë të pushonte, për të rifilluar çdo gjë nga e para.

Të burgosurit protestuan për heqjen e kësaj mase ekstreme ndëshkimore. Duke konstatuar reagimet e dëshpëruara të të burgosurve, komanda e kampit e vlerësoi si shumë efikase këtë masë ndëshkimore dhe urdhëroi përdorimin e rregullt të saj.

LXV

… DHE REVOLTË

"*Tortura pyet, dhimbja përgjigjet*."
Renuàr

Një portë e vogël prej hekuri, në pjesën juglindore të rrethimit të brendshëm të kampit të Qafë-Barit, të nxirte në rrugën që çonte në minierë. Para kësaj porte u bëhej kontrolli fizik të burgosurve që niseshin për në punë, apo atyre që ktheheshin nga puna.

Më 22 maj 1984, ndërsa rrezet e para të diellit po ndriçonin kampin e zymtë, brigadat e të burgosurve të turnit të tretë ishin rreshtuar para portës në fjalë. Pritej oficeri i rojës me dy nënoficerët, për të bërë kontrollin dhe numërimin e të burgosurve, që do të hynin në kamp. Pas një gjysmë ore ata erdhën tek porta.

— Para se të fillojmë numërimin e tyre, i veçoni prej brigadave të burgosurit që nuk kanë realizuar normën e detyruar në minierë – i urdhëroi oficeri i rojës policët që shoqëronin brigadat e punës.

Sipas rregullit të miratuar nga komanda e kampit, këta të burgosur do të ktheheshin përsëri në punë të shoqëruar prej një polici. Pasi kishin punuar gjithë natën në minierë, ata do të punonin edhe gjithë ditën bashkë me turnin e parë, me të cilin do të ktheheshin në kamp rreth orës katër e gjysmë pasdite. Natyrisht, në darkë ata do të niseshin përsëri për në minierë bashkë me brigadën e tyre që punonte turni i tretë atë javë.

Kur oficeri i rojës me ndihmësit e tij mbaruan punë me numërimin dhe po përgatiteshin ta mbyllnin portën, matanë së cilës mbetën të burgosurit që do të riktheheshin në punë, brigadieri i burgosur i njërës prej brigadave të turnit të tretë iu drejtua atij:

— Zoti oficer i rojës, ky i burgosuri i ri [*ai tregoi me dorë njërin prej atyre që ngelën matanë portës*] e ka realizuar normën e detyruar dhe nuk meriton të kthehet prapë në minierë.

Polici shoqërues i asaj brigade i foli me një ton përçmues brigadierit të burgosur:

— Ti je një i burgosur si gjithë të tjerët, Zef, pavarësisht se të kemi caktuar brigadier. Prandaj mbaj vendin që të takon, mbasi është detyra ime t'i them oficerit të rojës kush e ka realizuar normën e detyruar e kush jo.

— Po ju doni ta ndëshkoni pa të drejtë atë djalë të ri dhe unë di edhe arsyen pse e bëni këtë – ia ktheu brigadieri i burgosur policit.

Dhe duke iu drejtuar përsëri oficerit të rojës, ai shtoi:

— Zoti oficer i rojës, ai i burgosur ka mbushur një vagon mineral më shumë sesa norma e tij e detyruar.

— Mos e mat veten me hijen e mëngjesit, Zef, se je i burgosur dhe nuk ke të drejtë të bësh polemikë me policin. Hajt, ik tani! – ia preu shkurt oficeri i rojës.

Mirëpo Zef Zefi, një kolos i vërtetë nga trupi, nuk lëvizi prej vendit. Në çastin që oficeri i rojës deshi të mbyllte portën, ai mbërtheu kanatën e hapur. Duke e shikuar drejt në sy oficerin e rojës, Zefi i tha:

— Unë vërtet jam i burgosur, por ju vetë më keni caktuar brigadier. Gjersa polici i brigadës do që ta ndëshkojë për tekat e tij këtë djalë të ri, ju duhet të më dëgjoni edhe mua, për ta zbardhur të vërtetën.

— Guxon të më pengosh mua të mbyll portën? U marrose, Zef? i tha oficeri i rojë çehreprishur.

— Akoma s'jam marrosur. Por kjo mund të ndodhë, në rast se polici i brigadës nuk pranon të heq dorë nga ndëshkimi tendencioz i atij djali.

— Surrati yt do na vërë kushte ne? Arrestojeni! i urdhëroi oficeri i rojës policët e pranishëm.

Njëri prej gardianëve e goditi fort me shkop gome në krah Zefin. Mjaftoi ky veprim që gjithçka të merrte të tatëpjetën.

Një grusht i Zefit e hodhi për tokë agresorin e tij. Oficeri i rojës u largua nga porta. Policët e sulmuan njëkohësisht Zefin. Disa shokë të brigadës së Zefit, që nuk ishin larguar, dhe të burgosurit që prisnin matanë portës për tu rikthyer në minierë u futën në përleshje. Oficeri i rojës ia mbathi vrapit; tre të burgosur iu vunë pas. Oficerit i ra kapelja nga koka, por nuk u kthye ta merrte. Njëri prej të burgosurve filloi të lozte me të.

Nën breshërinë e goditjeve të të burgosurve të revoltuar, policët u mposhtën dhe vrapuan nën shembullin e oficerit të rojës. *Trofeve* të të burgosurve iu shtuan edhe tri kapele të tjera ushtarake.

*

Ishte ora tetë e 22 majit 1984; më pak se tridhjetë orë prej ndarjes së detektivit të burgosur me të dërguarit e CIAs. Ishte dita e 11 vjetorit të revoltës së parë të të burgosurve politikë shqiptarë, Spaç '73.

Sirena e alarmit nuk pushonte. Ushtarët në truprojë u dubluan. Ndërsa në distancat midis truprojeve u vendosën policë e ushtarë të tjerë. Një helikopter e përshkoi dy herë ulët qiellin e ngushtë të kampit. Një turmë e madhe të burgosurish vërshoi në shesh. Disa prej tyre hoqën xhaketat e dokut bojë kafe dhe po i valëvisin në erë. Salutonin apo kërcënonin helikopterin? Ky nuk vonoi të bënte një inkursion të dytë ajror.

Pasi kaloi ora nëntë, rreth gjashtëdhjetë oficerë e policë, të ardhur me urgjencë nga DP të Brendshme të Pukës, iu afruan portës së kampit. Të gjithë të pajisur me uniformë gatishëmrie luftarake: me skafandra, kaska plastike dhe shkopinj gome me shkarkesë elektrike. Në krye të tyre, oficeri i rojës. Duke parë

Zefin me një grup shokësh që po shkonin ngadalë drejt tyre, oficeri i rojës hoqi kaskën plastike dhe foli me një megafon:

— Të burgosur, hiqni dorë prej marrëzive sa nuk është tepër vonë. Në qoftë se situata rëndohet, ne do të detyrohemi ta shtypim revoltën me dhunë. Atëherë përgjegjësia juaj do të jetë e rëndë dhe do të gjykoheni e do të dënoheni për këtë. Le të vijnë vetëm tre nga ju përbrenda portës që të merremi vesh. Të tjerët të qëndrojnë aty.

— Me kusht që edhe ju të jeni vetëm tre nga ana tjetër e portës – thirri Zefi. – Të tjerët të qëndrojnë në të njëjtën distancë prej portës si shokët tanë.

Pasi u këshillua me kolegët e tij, oficeri i rojës e pranoi kushtin.

Bisedimet qenë të shkurtra, marrëveshja u arrit dhe Zefi me dy të tjerët u kthyen tek shokët. Sipas marrëveshjes, të gjithë të burgosurit duhej të hynin në mensë, ku do të vinte oficeri i rojës me tre kolegë dhe pesë policë të DP të Brendshme të Pukës. Ushtarakët e tjerë duhej të qëndronin tek zyrat e komandës së kampit. Të burgosurit që nuk kishin realizuar normën e detyruar në minierë do t'i fusnin në birucë, pa i torturuar. Nuk do të merrej asnjë masë ndëshkimore ndaj Zefit dhe shokëve të tij. Të burgosurit e turnit të tretë, të cilët ishin akoma esëll, do të hanin mëngjes dhe gjithçka do të normalizohej.

Mbasi hyri në mensë me shoqëruesit e tij, oficeri i rojës u bëri thirrje të burgosurve ta harronin atë që ndodhi dhe të respektonin rregulloren e brendshme të kampit si gjithmonë. Pastaj Zefi u bëri thirrje të burgosurve që nuk e kishin realizuar normën në minierë që të dilnin jashtë dhe t'iu dorëzoheshin pesë policëve, të cilët do t'i shoqëronin për në biruca.

Mirëpo pas pak u dëgjuan britmat e tyre: policët po i torturonin. Të revoltuar prej pabesisë, Zefi dhe shokët e tij sulmuan oficerët, të cilët dolën me vrap nga mensa. Kur turma e të burgosurve doli jashtë, sheshi midis mensës dhe fjetoreve ishte i mbushur plot me ushtarakë, të cilët po torturonin të shtatë të burgosurit që kishin dalë prej mensës sipas marrëveshjes. Përleshja qe e pamëshirshme. Një duartrokitje e fortë e të burgosurve pasoi ikjen me vrap të ushtarakëve të thyer e të frikësuar. Me britma e të qeshura, të burgosurit u shpërndanë në gjithë territorin e kampit të braktisur prej forcave policore.

Një çerek ore më vonë, njëri prej oficerëve të komandës goditi me revole që nga jashtë rrethimit mbi një grup të burgosurish. Plumbi plagosi në shpatull të burgosurin Kostandin Gjordeni. Në të njëjtin çast, truprojet e rrethimit filluan të hapnin zjarr me radhë për të frikësuar të burgosurit, që të mos t'i afroheshin rrethimit. Trembeshin nga ndonjë mësymje masive mbi truprojet, për t'iu marrë armët. Helikopteri u duk përsëri, më ulët se herën e fundit. Të burgosurit u bënë zotër të ferrit të tyre. Po ç'mund të bënin me të?

Një grup të burgosurish po fshinin citatet e diktatorit të shkruara në fasadën e godinave. Disa të tjerë hapën me forcë derën e bibliotekës së kampit dhe nxorën prej andej *veprat* e diktatorit. I çuan tek sheshi dhe u vunë zjarrin, me shpresë se ishin duke djegur diktaturën.

Ndërkohë diktatura vetë nuk flinte. Tri makina ushtarake ndaluan përballë mjediseve të kampit. Mbi karroceritë e tyre u pozicionuan policë të armatosur. Dy tankse bllokuan rrugën automobilistike tek kthesa përballë kampit. Shumë policë e ushtarë përforcuan rrethimin e kampit.

Në orën tre pasdite u hap porta e madhe prej hekuri e kampit. Policët mbi karroceritë e makinave mbushën armët. Komandanti i kampit me një grup oficerësh me kaska e skafandra iu afruan rrethimit të brendshëm. Komandanti i kampit foli në megafon:

— Të burgosur, durimi ynë nuk zgjat më. Me hir ose me pahir, ne do ta vendosim rregullin dhe ju do t'i nënshtroheni regjimit të kampit të riedukimit. Ne kemi përgatitur një listë me emrat e njëzet e katër personave, të cilët janë shkaktarët e revoltës. Ata duhet t'i dorëzohen patjetër policisë. Me të burgosurit e tjerë nuk kemi probleme.

Ai nxori një listë nga xhepi dhe lexoi emrat e të burgosurve të akuzuar për organizimin e revoltës; emri i Zef Zefit ishte i pari.

Pasi përfundoi së lexuari emrat, komandanti i kampit lëshoi ultimatumin:

— Në qoftë se personat që dëgjuan emrat nuk do t'i dorëzohen vullnetarisht policisë brenda njëzet minutash, ne do ta sulmojmë kampin duke përdorur gaz lotsjellës. Mendohuni dhe vendosni. Mos i merrni në qafë bashkëvuajtësit tuaj të pafajshëm. Luftën me qeverinë nuk e fitoni dot kurrë.

LXVI

I MUNDURI – FAJTOR I PËRHERSHËM

"*Shpëtimi i të mundurve është të mos presin shpëtim*."

Rakan

Ata të njëzet e katër u mblodhën bashkë për të vendosur si do të vepronin. Nuk vonoi shumë dhe u nisën të dorëzoheshin. Kur iu afruan portës së parë, komandanti i kampit u thirri përsëri me megafon:

— Të burgosur, ndaloni aty, derisa t'ju japim urdhër tjetër.

Rreth pesëdhjetë sampistë u futën në kamp dhe u grupuan tek sheshi i vogël nga ana e pasme e godinës së infermierisë së kampit.

Komandanti i kampit mori përsëri megafonin:

— Të burgosur, do të shkoni një e nga një tek policët brenda kampit, kur të dëgjoni emrin tuaj.

Natyrisht, emri i parë që lexoi komandanti i kampit qe ai i Zef Zefit.

Sampistët i lidhnin fort duart pas shpine çdo të burgosuri që paraqitej tek ata, por nuk e preknin me dorë. Mbasi përfunduan në pranga të njëzet e katër, filloi *ceremonia*. Policët shtatmëdhenj, të zgjedhur posaçërisht, nxorën drurin e fshehur poshtë xhaketës dhe filluan t'i godisnin me gjithë forcën e krahut ku të mundnin. Ulërimat e të torturuarve dëgjoheshin anembanë kampit. Me kalimin e minutave, ato u rralluan, mbasi shumica e të torturuarve humbisnin ndjenjat. Kur u vendos qetësia, për shkak të falimentimit fizik të të burgosurve, një autoburg i madh hyri brenda portës së kampit. Sampistët filluan t'i tërhiqnin zvarrë të burgosurit pa ndjenja dhe i flaknin brenda autoburgut pa kokëçarje.

Mbasi autoburgu i mbushur me njerëz të alivanosur u nis, ushtarakët dezertorë, oficerë e policë, së bashku me pesëdhjetë sampistët e zgjedhur, u futën në kamp.

— Të gjithë të burgosurit të hyjnë në mensë! – qe thirrja e parë e tellallit pas mposhtjes së revoltës.

Policë, sampistë e gardianë me shkopinj gome në duar kishin krijuar dy rreshta midis të cilëve duhej të kalonin të burgosurit për të hyrë në mensë. Pa bërë dallim moshe apo gjendjeje shëndetësore, ata i godisnin pa reshtur të burgosurit derisa futeshin brenda. Kur u grumbulluan të gjithë në mensë, policia ua mbylli derën nga jashtë.

Pas një copë here dera u hap me vërtik. I shoqëruar prej një grupi të madh oficerësh, zëvendësministri i brendshëm hyri në mensë, ku nuk pipëtinte as miza. Fjala e tij e dhunshme ishte lajmëtare e stuhisë ndëshkimore që i priste të burgosurit pas revoltës:

— Partia jonë nuk është trembur ndonjëherë prej armiqve të saj të shumtë, të cilët përfundimisht hanë kokat e tyre. Falë kurajës dhe vendosmërisë së partisë sonë, ne ndërtojmë socializmin nën hundën e imperializmit, që po heq

shpirt. Udhëheqësi legjendar i partisë sonë, shoku E. Hoxha, e ka bërë Shqipërinë farin ideologjik të proletariatit botëror. Të mjerët ju që kujtoni se do të na shtini frikën, duke ulëritur si qenër të tërbuar brenda telave me gjemba!

«Partia jonë e udhëheq popullin sipas parimit të madh të diktuar nga shoku Enver: *Njeriu është kapitali më i çmuar, por ai mund të bëhet gjithashtu edhe armiku më i rrezikshëm i shoqërisë.* Sjellja juaj e sotme vërteton largpamësinë e mendimit politik të udhëheqësit të partisë sonë. Kuadrot tona ushtarake, që ju survejojnë, kanë shpalosur humanizmin e tyre, duke e braktisur përkohësisht kampin, për të evituar një përplasje që juve do t'ju kushtonte shtrenjtë. Ata shpresonin se ju nuk do të abuzonit me tolerancën e tyre, por ju e keni prezantuar edhe një herë tjetër veten armiq të papajtuar të komunizmit. Ju dogjët disa libra të udhëheqësit tonë të lavdishëm, por mendimi i tij politik do t'ju djegë përgjithmonë. Sot e tutje oficerët dhe policët e kampit do të dinë të mbajnë qëndrimin e duhur ndaj armiqve të betuar të partisë sonë si puna juaj.

Një heshtje e thellë e pasoi fjalimin kërcënues të zëvendësministrit. Ky e endi shikimin midis radhëve të shtrënguara të të burgosurve në stolat e pamjaftueshëm. Shumë prej tyre qëndronin në këmbë në fund të mensës.

— Do ta paguani atë që bëtë – tha përfaqësuesi i shtetit, para se të dilte, i shoqëruar prej shpurës së madhe.

Mandej u erdhi radha të burgosurve të dilnin.

*

— Sazan, këtu qenke? Oh, shyqyr! – ia bëri Meli duke e parë shokun e tij të dilte nga dera e mensës.

Atë javë Diksi punonte turni i dytë dhe ndodhej në kamp kur u zhvillua revolta. Ndërsa brigada e ndërtimit punonte tek hyrja e minierës. Ndërtohej një sallë për elektromotorat e rinj. Meli dhe shokët e tij të punës e kishin parë nga larg zhvillimin e ngjarjeve në kamp. Turni i parë, e bashkë me ta dhe brigada e ndërtimit, u lejuan të futeshin në kamp vetëm pas arrestimit të njëzetë e katër të burgosurve.

Diksit i bëri përshtypje shqetësimi i ish-detektivit dhe i tha duke qeshur:

— Po sikur të mos isha këtu, ç'do të bëje, Hamit?

— Do t'i kërkoja kartelistit të kampit të lajmëronte DSJnë, për të dërguar një njeri kastile të flisja me të. Prandaj dola me të parët nga mensa dhe po prisja këtu, nëse do të dilje edhe ti apo jo. Dyshoja mos kishte shfrytëzuar rastin kartelisti dhe të kishin përfshirë me ata të tjerët që arrestuan. Tani u bë e domosdoshme që unë t'iu flas për ty të dërguarve të CIAs me rastin e parë. Vetëkuptohet që situata do të tensionohet shumë, pas kësaj që ndodhi. Nuk parashikohen dot më pasojat dhe mua më vret ndërgjegjja po vunë dorë tek ti për shkakun tim. Prandaj po të vë në dijeni që unë do ta trajtoj me amerikanët çështjen tënde, por nuk të pyes nëse je dakord për këtë apo jo.

LXII

INTENSIFIKIM I DHUNËS

"*Padrejtësia sjell padrejtësi; dhuna sjell dhunë*."

Lakorder

Ridënimet e njëzet e katër të arrestuarve qenë drastike. Dy të pushkatuar: Zef Zefi, kolosi 32 vjeçar, dhe shoku i tij i ngushtë, Tom Ndoja – 29 vjeç. Të dy nga rrethi i Shkodrës. Katërmbëdhjetë prej të arrestuarve u dënuan me një shumë të përgjithshme prej 240 vjet burg. Ndërsa tetë të tjerët, pas dhjetë ditë torturash në birucat e DP të Brendshme të Pukës, u transferuan në kampin e Zejmenit, në rrethin e Lezhës.

Pas shtypjes së revoltës shpërtheu terrori masiv kundër të gjithëve e për çdo gjë. Më se njëqind policë të ndërhyrjes së shpejtë (sampistë), të stërvitur posaçërisht për shtypje revoltash, erdhën urgjentisht nga Tirana. Me urdhër të MP të Brendshme, të gjitha degët e punëve të brendshme të rretheve të kategorisë së parë dërguan një kontingjent policësh në kampin e Qafë-Barit për të fituar eksperiencë në shtypjen e revoltave kundër *pushtetit popullor*. Gjatë muajit të parë pas revoltës kampi u militarizua deri në atë shkallë, saqë çdo i burgosur kishte policin e tij. Javën e parë policia merrte të burgosur natën nëpër dhoma dhe i torturonte në sheshin e shtruar me çimento midis fjetoreve dhe mensës. Në mëngjes ky shesh gdhihej i qëndisur me njolla gjaku.

Çdo brigadë e nëntokës shkonte e kthehej nga puna e shoqëruar prej një grupi policësh me nga një bisht kazme në dorë. Me vendim të komandës së kampit, norma u rrit 25 %. Që të arrinin të realizonin normën, të burgosurit shpërndaheshin nëpër frontet e punës me vrap kur hynin në minierë, për të mos humbur kohë. Gjithashtu ata e fillonin punën pa pritur që frontet të pastroheshin mirë prej gazrave helmues, që çliroheshin pas plasjes së eksplozivit. Kur të burgosurit trulloseshin nga këto gazra dhe villnin, detyroheshin ta ndërprisnin punën nga pamundësia. Atëherë policia i torturonte, duke i akuzuar se një gjë të tillë e kishin bërë me qëllim, që të mos realizonin normën.

Pikërisht në këtë periudhë terrori masiv hyri në fuqi *vagoni i partisë*. Me propozimin e shefit të policisë së kampit – një sadist i lindur me emrin Edmond Caja, i cili më vonë do të bëhej komandant i kampit – pas realizimit të normës së detyruar, çdo i burgosur duhej të mbushte edhe një vagon suplementar me mineral për nder të partisë, e cila u kishte sjellë *ditët e lumtura* që po jetonin...

Si të mos realizonin normën dhe të mos mbushnin atë vagon ishte njësoj; të burgosurit i priste i njëjti ndëshkim. Kjo do të thoshte një ringritje tjetër e normës 20 %. Pra, brenda pesë ditësh norma u ngrit nga katër vagona elektrovozi në gjashtë. I gjashti ishte *vagoni i partisë*.

Kjo garë e shfrenuar midis makuterisë së komandës e të policisë dhe sakrificave të të burgosurve për ta nginjur atë, nxirte gjithmonë fitimtarë të

parët. Ato ditë të nxehta terrori ekstrem *vagoni i partisë* u bë për të burgosurit politikë po aq i rrezikshëm sa edhe vetë partia.

*

Të nesërmen e revoltës, më 23 maj, Melin e thirri një oficer i DSJsë tek zyrat e komandës. Meqenëse në kampin e Qafë-Barit do të intensifikohej dhuna me urdhër qeveritar, qendra e orientonte Melin të pranonte të transferohej në kampin e të burgosurve ordinerë në Tiranë.

Në vazhdim të bisedës, i dëguari i DSJsë i tha Melit:

— Ne nuk mund ta sqarojmë komandën e kampit – pa le më policinë – rreth çështjes tënde. Prandaj, që t'iu shpëtosh ndëshkimeve të mundshme, duhet të pranosh patjetër transferimin.

— Jo, unë nuk do të largohem nga ky kamp, – iu përgjigj prerë Meli. – As nuk jam aq naiv, sa të kërkoj të sqaroni komandën e kampit për pozicionin tim. Unë do të bëj çmos vetë, që ta evitoj me përpjekjet e mia përplasjen me policinë.

— Kjo është e pamundur. Me vendim qeveritar, ky kamp është dënuar me një vit dhunë ekstreme, për shkak të revoltës. Policia do t'i sajojë shkaqet e ndëshkimit për çdo të burgosur, pa pritur pakujdesitë e tyre.

— Sidoqoftë, unë do të qëndroj këtu – i dha karar Meli.

— Atëherë DSJ nuk mban asnjë përgjegjësi për çdo gjë që mund të të ndodhë ty.

— Me përjashtim të rasteve që do t'i organizojë vetë DSJ – e plotësoi Meli.

— Kjo nuk ndodh kurrë, mbasi mbahet përgjegjësi e rëndë për një gjë të tillë. Pikërisht për këtë arsye ne po interesohemi posaçërisht. Në qoftë se e ke mbledhur mendjen për të qëndruar këtu, duhet të firmosësh këtë dokument – i tha ai detektivit të burgosur, duke i zgjatur një letër.

Meli firmosi dhe u kthye sërish në kampin e tensionuar.

*

Ditën tjetër, më 24 maj 1984, u bënë flijimet për dyzetëvjetorin e kongresit të Përmetit: arrestimet e dyta në masë, pas njëzet e katër të parëve.

Këto u kryen në kushtet e një dhune të egër fizike dhe psikike. Të burgosurit i detyruan të uleshin ndenjur në sheshin e shtruar me çimento midis godinës së fjetoreve dhe asaj të mensës. Ky ishte rreth 25 m i gjatë dhe 8-10 m i gjerë. Të dy daljet e tij në ballë të godinave kufizuese paralele ishin bllokuar nga dy turma të mëdha policësh dhe ushtarësh.

Pasi u kthye nga puna, turni i parë shkoi e u bashkua me të burgosurit e tjerë, që kishin mbi dy orë në pritje. Rreth orës katër mbasdite gjithçka ishte gati për të filluar operacioni i *spastrimit* të armiqve në një kamp armiqsh! Të katërqind e gjashtëdhjetë të burgosurit ishin ulur sup më sup, ngjeshur pas

njëri-tjetrit. Policë e ushtarë lëviznin nëpër ta, duke u shkelur shpesh mbi këmbë kastile për t'i bezdisur.

Pas një pritjeje të gjatë, sekretari i ministrit të Brendshëm për ndjekjet penale, Lek Imeri, i shoqëruar nga një tjetër oficer i lartë i Sigurimit të Shtetit me mbiemër Mëlyshi [me siguri gjak i të neveritshmit Pal Mëlyshi] doli para të burgosurve për të nisur serinë e arrestimeve. Si dikur në Spaç, çdo arrestimi i paraprinte një lojë cinike e oficerëve dhe policëve të kampit të Qafë-Barit. Ata shkelnin pa kujdes midis të burgosurve të ulur, ndalonin sikur do të këshilloheshin me njëri-tjetrin, përmendnin emrin e ndonjë të burgosuri, i drejtoheshin pastaj dikujt tjetër, e çonin në këmbë e, pasi i bënin ndonjë pyetje formale, sa për të justifikuar ngritjen, thërrisnin emrin e atij që do të arrestohej. Mbasi i hidhnin prangat në mes të të burgosurve, e shoqëronin të arrestuarin me disa policë. Këta kalonin nga dalja jugore e sheshit, prej nga nuk dukeshin më prej të burgosurve të ulur. Turma e madhe e sampistëve që zinin daljen shpërthente në pasthirrma habie e tmerri fiktiv, tek shikonin se ç'ndodhte më tej me të arrestuarit. Krijohej kështu përshtypja se të bursogurit e arrestuar po i kalonin në satër.

Në këtë ciklon terrori pati edhe vepra të përçudnuara xhelatësh mizorë, të cilat rrëqethin edhe vetë krimin. I tillë qe fati i të burgosurit Sandër Sokoli, me origjinë nga Tropoja, ish-shef i kontrollit të cilësisë në uzinën e prodhimit të armëve në Poliçan. Viktima në fjalë e dha shpirtin nga inskenimi i përbindshëm i një lloj krimi, që jo vetëm s'ishte parë e dëgjuar ndonjëherë, por vështirë se mund ta kishte lexuar ndokush nëpër analet e kriminalistikës botërore. Ky lloj i veçante ekzekutimi do të kishte mbetur i panjohur, sikur dy policë të kampit të Qafë-Barit, të pranishëm në kryerjen e tij, të mos ishin mahnitur prej talentit vrastar të kolegëve sampistë dhe ta përshkruanin me mburrje më vonë këtë *mrekulli* të krimit.

Ekzekutimi origjinal kishte qenë vepër e pesë sampistëve të zgjedhur posaçërisht. Dy prej tyre e kishin kapur të burgosurin për secilën shpatull, ndërsa dy të tjerë e kishin mbërthyer fort në secilin gju. Mandej e kishin fiksuar trupin e të burgosurit në pozicionin përmbys, me fytyrë nga dyshemeja, duke e mbajtur pezull rreth 80 cm prej saj. Sampisti i pestë, më i rëndi në peshën trupore, kishte hipur mbi një karrige të vendosur mbi tavolinë. Me një kërcim të fuqishëm, ai ishte hedhur prej andej, me të dy këmbët të bashkuara, mbi kolonën vertebrore të të burgosurit, në drejtim të veshkave. Veç thyerjes së kolonës, trupi i fiksuar pësoi edhe dëmtime të tjera të rënda organike, të cilat i sollën si pasojë një vdekje të denjë për *humanizmin socialist* fatkeqit Sandër Sokoli.

LXVIII

SHËMTIA TEJ FASADËS

"Të krahasosh nganjëherë mizorinë e njeriut me atë të kafshëve, i ofendon këto të fundit."

F. Dostojevski

I revoltuar nga ç'po ndodhte në kampin e Qafë-Barit pas revoltës, Meli i tha një ditë Diksit:

— Marrëzitë e diktaturës nuk kanë fund, pa përfunduar ajo vetë. E ç'mund t'i bëjnë pesëqind të burgosur të raskapitur, të çarmatosur, të izoluar në mes të alpeve brenda tre rrethimesh tela me gjemba, një shteti diktatorial të konsoliduar me hekur e gjak prej katër dekadash? Por diktatori dhe klani i tij janë të panikosur në shpirt dhe nuk iu besojnë më as ligjeve të tyre të rrepta, prandaj kalojnë në veprime anormale. Në kamp kanë futur aq policë sa jemi dhe të burgosur, forca të tjera ushtarake përforcojnë rrethimin, tankset tek kthesa e rrugës nuk po i largojnë akoma. Çfarë tragji-komedie! Kjo më kujton një ngjarje të kahershme në DSJ, e cila na ka lënë pa mend të gjithëve atëherë.

«Ishte tetori i vitit 1974. Një detektiv i DSJsë u nis me shërbim në Portugali. Ky detektiv kishte kryer një seri misionesh të sukseshme në Greqi. Qe një befasi e vërtetë për DSJnë kur ditën e tretë pas mbërritjes së tij në Porto [Portugali], ai u arrestua atje prej shërbimit sekret grek në bashkëpunim me atë portugez. Në fakt kuptohej që ishte bërë një spiunim i qartë e i saktë prej shërbimit sekret shqiptar. Natyrisht, nuk ishte e lehtë të gjendej agjenti progrek në radhët tona, mbasi ne vepronim me pseudonime që i dinin vetëm pak kuadro në DSJ. Por diktatura mendonte se dhuna mund të arrinte gjithçka, përfshirë edhe ruajtjen e sekretit me forcë. Në mes të muajit nëntor 1974 u arrestua një kuadër i DSJsë, i akuzuar për spiunazh. Nuk dihej nëse vërtet ishte gjynahqar për rastin në fjalë, apo dikush ia vuri gishtin për të mbjellë panik në DSJ. Mënyra sesi u ekzekutua ky person linte shumë për të dyshuar në variantin e dytë.

«Në prag të Krishtlindjeve të vitit 1974 ai u var në litar në një palestër të DSJsë. I gjithë personeli drejtues i shërbimit sekret shqiptar, përfshirë edhe ne detektivët, u detyruam të asistonim në atë shfaqje makabër. Me duart të lidhura pas shpinës, të dënuarin me vdekje e futën në një tip thesi deri përmbi shpatulla. Në qafën e zbulur iu hodh litari jo aq i trashë. Ashtu, me litar në qafë, atij iu komunikua motivacioni i dënimit me vdekje, i cili ishte miratuar edhe prej presidiumit të kuvendit popullor. I kërkuan të thoshte fjalën e fundit, por ai vetëm heshtte. Kishte të ngjarë që ai të mos ishte në gjendje për të folur prej torturave. Pastaj filloi ekzekutimi i tij dy herë i jashtëligjshëm: Së pari, ekzekutimi me varje në litar ndalohej nga ligji në atë kohë. Së dyti, ajo nuk ishte një varje e mirëfilltë në litar, por një shpirtmarrje e paklasifikueshme.

«Nuk kishte fare trekëmbësh dhe i dënuari qëndronte me këmbët në tokë, jo mbi një karrige. Litari kalonte në një sistem makarashë të posaçme në tavanin e palestrës dhe përfundonte në një makara më të madhe të pajisur me elektromotor në njërin cep të palestrës. Pranë saj qëndronte një person, i cili do të ishte xhelati. Me të marrë sinjalin, ky filloi të mblidhte litarin shumë ngadalë. Për aq sa i dënuari nuk ishte shkëputur plotësisht nga dyshemeja e palestrës, ai nuk nxirte zë. Por sapo thesi i zi u shkëput, fytyra e tij u mavijos dhe dëgjoheshin rënkime të sikletshme, që bënin të të kalonin mornica në trup. Vdekja qe dhuratë për të dënuarin, ndërsa leksioni moral vlente për ne, spektatorët e detyruar.

LXVIII

MELI I SHQETËSUAR PËR DIKSIN

“*Gjithë madhështitë e kësaj bote nuk vlejnë sa një mik i mirë*.”

Volter

Ndërsa mjediset e kampit të Qafë-Barit po ktheheshin në arena të përgjakura, shërbimet sekrete vazhdonin punën e tyre. Duke marrë shkas prej revoltës së të burgosurve, amerikanët i shpeshtuan vizitat tek i mbrojturi i tyre.

Më 25 maj kartelisti e njoftoi detektivin e burgosur se kishte përsëri takim zyrtar. Mysafiri i Melit këtë herë ishte shefi i seksionit ballkanik të CIAs me të njëjtin përkthyes. Ishin të pranishëm në takim edhe dy vëzhgues: një shqiptar dhe një anglez. Gjatë takimit, vëzhguesi shqiptar i përkthente bisedën kolegut anglez.

Mysafiri u habit prej kokës së qethur zero të ish-detektivit.

— Pse ua bëjnë këtë? e pyeti kureshtar.

— Objektivi i një sitemi të shëmtuar shoqëror është pikërisht shëmtimi fizik dhe moral i njeriut – iu përgjigj Meli.

— Për çdo muaj ju qethin?

— Po, për çdo muaj. Bilé nuk na lejojnë të mbamë as kapele.

— Edhe në dimër pa kapele ju lënë?

— Të katër stinët. Edhe kur bie dëborë dhe ne jemi të rreshtuar, nuk na lënë të vendosim qoftë edhe një shami dore në kokë.

— Po rrobat që keni veshur, nuk janë tuajat?

— Jo, këto rroba janë të DSJsë. Sikur ju të më shikonit mua të veshur me rrobat e burgut pas një ore, nuk do të më njihnit dot. Ngjyra dhe cilësia e uniformës së kampit të shtie krupën.

— A u vra ndonjë i burgosur gjatë revoltës? – hyri më së fundi në temë amerikani.

— Jo, gjatë përleshjeve pati vetëm plagosje. Të gjitha truprojet e rrethimit hapën zjarr mbi objektet e kampit, por kryesisht për trysni.

— A ju kanë provokuar personalisht? – u interesua kuadri i lartë i CIAs.

— Mua personalisht jo, por dyshoj se në vendin tim mund të provokojnë dikë tjetër.

Duke thënë këto fjalë, detektivi i burgosur nxori nga xhepi një copë letër, e bëri shuk dhe e rrëshqiti mbi tavolinë drejt përkthyesit. Të dy vëzhguesit e ndoqën në heshtje veprimin e Melit. Përkthyesi e shpalosi letrën dhe filloi t'ia përkthente eprorit të tij në një faqe të bllokut:

Meqenëse gjendja në kamp është bërë mjaft kërcënuese pas revoltës për elementin e ndershëm, ndihem i detyruar t'ju rekomandoj të merrni në mbrojtje tuaj bashkëvuajtësin tim më të afërt, Sazan Diksi. Një veprim të tillë ju duhet ta

ndërmerrni vetëm nëse jeni të bindur në arritjen e qëllimit. Në rast të kundërt, interesimi juaj për të do ta ekspozonte Diksin ndaj një rreziku të paevitueshëm.

H.M.

Pasi e lexoi tekstin e letrës të përkthyer në anglisht, zyrtari amerikan iu përgjigj verbalisht Melit:

— Mbrojtja e personit në fjalë parashikohet qartë brenda kuadrit të mbrojtjes suaj, z. Meli. Mbrojtja juaj përfshin në vetvete mbrojtjen e familjes suaj dhe të gjithë personave të tjerë të afërt në jetën e lirë, jo më shokun tuaj të burgut. Ne e kuptojmë dhe e vlerësojmë shqetësimin tuaj, por njëherësh ju sigurojmë, se nuk ekziston asnjë arsye reale që tani e tutje të jeni akoma i shqetësuar për këtë çështje. Në qoftë se mbrojtje të tilla do të linin shteg për hakmarrje ndaj personave tuaj të afërt, ato jo vetëm që nuk do të ishin aspak të dobishme, por, përkundrazi, do të ishin mjaft të dëmshme, se do të merrnin në qafë njerëz të pafajshëm. Prandaj duhet të jeni i qetë. A mund të shpresoj se u kuptuam, z. Meli? – e pyeti amerikani për tu bindur se i burgosuri nuk ishte më i shqetësuar.

— Ju kuptova shumë mirë dhe ju falënderoj për sqarimin tuaj të plotë – iu përgjigj Meli i çliruar prej një ankthi të madh.

Pasi ndenjën edhe një copë herë me detektivin e burgosur, duke biseduar për çështje të ndryshnne, vizitorët u ndanë me të, duke u takuar përzemërsisht.

LXIX

KURTHI I *ALEATËVE*

"*Aleanca me të fuqishmin nuk është asnjëherë e sigurtë*."

Seneka

Natyrisht, takimi më i rëndësishëm që priste Meli me padurim ishte ai me Streton. Prej tij detektivi i burgosur do të merrte informacione të rëndësishme, që do t'i shërbenin për të kuptuar më mirë natyrën e marrëdhënieve midis grupit që vepronte në Tiranë dhe CIAs.

Nuk vonoi shumë dhe i erdhi radha edhe këtij takimi. Buzëqeshja karakteristike e Stretos, trupi i tij elegant dhe një shkrepitje e lehtë çalimi në këmbën e djathtë, e ndihmuan Melin që ta njihte shokun e tij edhe nën maskën e detektivit amerikan. Kohët e fundit ai e kishte takuar Streton me maskën e të burgosurit, origjinal natën kur shoqëronte në takim *Dofenin* dhe tani me veshje, maskë, pasaportë e nënshtetësi amerikane.

Të dy shokët u përqafuan përmallshëm dhe për disa çaste qëndruan të pushtuar në krahët e njëri-tjetrit. Kur u shkëputën, Meli vuri re se Streto i kishte sytë me lot. Ai u mallëngjye dhe duke treguar me kokë dy vëzhguesit, i tha:

— Pse ia lejon vetes një gjë të tillë, t'iu bësh qejfin atyre?

— Më duket sikur e dënova unë Afrimin, për të shpëtuar vetë, Hamit. Sa për vëzhguesit, mos e ki problem se detektivi shqiptar është i grupit tonë. E kanë nisur këtu, mbasi e njeh shumë mirë anglishten.

Në të vërtet dy vëzhguesit po qëndronin përballë dritares duke soditur rrethimin e trefishtë të kampit të qëndisur me drita elektrike.

— Aq më mirë atëherë, ç'pret, gjersa ata nuk na shqetësojnë. Më sqaro si munde të arratiseshe nga Londra.

— Patjetër. Unë e ndiej të nevojshme të flas për këtë çështje, që pati aq shumë pasoja të padëshirueshme:

«Kur u paraqita në qendrën e Inteligjencë Servisit në Londër, më pritën ftohtë. S'kaloi shumë dhe e kuptova se rrethohesha nga njerëz që nuk më shikonin me sy të mirë. Ditën e dytë u kërkova leje për të komunikuar me familjen në Tiranë. Ata ma refuzuan kërkesën për telefonatë, pa e marrë mundimin ta justifikonin në ndonjë farë mënyre këtë, ose të më premtonin se do më lejonin të flisja më vonë. E kuptova se rrathët po më shtrëngoheshin më shpejt nga ç'mund ta prisja unë dhe vendosa që të mos bija në asnjë mënyrë i gjallë në duart e tyre. Për këtë i kisha marrë masat e duhura, që kur u nisa nga Tirana. Ndërkohë nuk do të bëja asnjë hap të parakohshëm, pa më ardhur rreziku përpara këmbëve, mbasi e dija që çdo veprim i imi në këtë drejtim do të kishte pasoja, kryesisht për Afrimin, i cili më zëvendësoi në detyrë me rekomandimin tim tek *Dofeni*.

«Natën e dytë mua dhe Dariun na caktuan të flinim në të njëjtën dhomë. E kuptova pse e bënin këtë dhe, me tu futur në dhomë, i shkrova Dariut në një copë letër këto fjalë: *Mos fillo asnjë bisedë sadopak të dyshimtë; duhet të jesh gati për gjithçka. Mundohu të më qëndrosh pranë, me sa të të lejojnë rrethanat*. Të nesërmen, kur dolëm nga dhoma, zhvillova këtë bisedë me Dariun:

— Para se të niseshe nga Tirana për në Londër të dhashë dy porosi të rëndësishme. E para, je interesuar të njohësh ndonjë detektiv me origjinë shqiptare?

— Njoha nja dy që punojnë këtu, në qendër, por vetëm njëri prej tyre tregoi pak interes karshi meje – m'u përgjigj Dariu.

— Tjetra: rrugën prej këtej në ambasadën amerikane, e ke mësuar?

— Po, e njoh shumë mirë. Për tu siguruar, e kam përshkuar edhe natën në formë shëtitjeje.

«Ditën e tretë të qëndrimit tim në Londër, unë kërkova përsëri leje t'i telefonoja nuses në Tiranë. Një zyrtar i qendrës angleze më tha me buzëqeshjen e tyre karakteristike:

— Nuk besoj të shqetësohet aq shumë bashkëshortja, në qoftë se nuk i keni thënë që do shkonit në luftë.

— Përkundrazi, – ia ktheva unë me të njëjtën cilësi buzëqeshjeje – i kam thënë se po shkoj midis miqsh e aleatësh besnikë e të fuqishëm, por ngaqë ajo nuk e di konkretisht se për çfarë miqsh e aleatësh bëhet fjalë, shqetësohet si nuse e re që është.

— Besoj se do t'ia plotësojmë dëshirën së shpejti edhe nuses suaj të re – më premtoi ai duke më kthyer krahët.

«Por ky mbeti vetëm premtim. Vetëkuptohet që ata dyshonin se kjo telefonatë e thjeshtë, për mua mund të kryente funksion të madh informativ.

«Në mbrëmjen e ditës së tretë ndodhi gjithçka. U organizua një mbledhje, në të cilën merrnin pjesë shumë kuadro e detektivë të Inteligjencë Servisit. Ishim ftuar edhe ne, detektivët shqiptarë të tërhequr nga Tirana. Gjatë diskutimeve u fol edhe për bashkëpunimin e dy shërbimeve sekrete *aletate*. Në këtë kuadër, anglezët shprehën pakënaqësinë e tyre për *rebelimet* në radhët e shërbimit sekret shqiptar. Prandaj u bë thirrje të tregohej shumë kujdes në të ardhmen dhe t'i jepej ndihma përkatëse DSJsë për pastrimin e radhëve nga ky element.

«Rreth orës dhjetë të darkës u bë një pushim. Unë dhe Dariu po rrinim në një nga hollet e godinës ku po zhvillohej mbledhja, në gjendje alarmi. Pranë nesh kaloi një detektiv anglez, i cili më bëri shenjë me kokë të ikja. Isha i bindur që ky nuk ishte provokim, mbasi po ky detektiv më kishte thënë kalimthi të djeshmen: *Nuk do t'ju lejojnë për të telefonuar; kujdes*! Sa për dijeni, po të them se ky detektiv pas dy ditësh kaloi me amerikanët. Sinjali i tij i dha formë të prerë vendimit tim. Më duhej të tentoja arratinë me çdo çmim. E kisha të qartë se do të ishte shumë e vështirë të dilja pa pasoja nga ajo strofë ujqërish, por e vetmja rrugë që më mbetej ishte nënshtrimi pasiv ndaj arrestimit që më priste. Në fund të hollit ku gjendeshim ishin një palë shkallë që të nxirnin jashtë.

«I bëra të ditur Dariut planin tim dhe ai u zotua se do të më shoqëronte në çdo rrethanë. Duke biseduar si pa gjë të keq, iu afruam kreut të shkallëve. Shkallinat e para i zbritëm normalisht, pastaj u vërsulëm nëpër to si të tërbuar. Dolëm jashtë dhe po zbrisnim shkallët e një lulishteje, kur filloi ndjekja e menjëhershme. Pa arritur të zbrisnim në rrugën kryesore, ndjekësit më plagosën në kofshën e djathtë. Sigurisht, pasi kishin shtirë shumë herë me revolverët e tyre me silenciator. Kur dolëm në rrugën e gjerë e me qarkullim të dendur, ata nuk mundnin të shtinin më mbi ne.

«Plagën e kisha të ngrohtë dhe nën trysninë e rrezikut të afërt, i mbështetur në supin e Dariut, po largoheshim shpejt. Kaluam rrugën, u futëm në një lulishte të vogël dhe e ndryshuam 90° drejtimin e ecjes. Kapërcyem disa radhë pallatesh, ku qarkullimi ishte më i rrallë dhe ndryshuam përsëri drejtim. Pastaj u strukëm në një qoshe të errët dhe, me ndihmën e Dariut, e lidha fort plagën me shall. Ndërsa me dy shami dore të bashkuara lidhëm fundin e këmbës së pantallonave, për të mos rrjedhur më gjak në këpucë e të linte shenja rrugës. Si i kryem me shpejtësi këto veprime, i thashë Dariut të vrojtonte me kujdes, nëse dukeshin ndjekësit tanë apo jo. Pasi më siguroi se nuk dukej njeri i dyshimtë përqark, u drejtuam për në një park të afërt. Plaga po ftohej dhe këmba gradualisht po më mpihej. Si ecëm ca nëpër park, shkuam tek një kaçube e madhe dhe u futëm brenda saj. Pozicioni ishte mjaft i përshtatshëm për tu fshehur, por edhe po aq i dyshimtë, nëse ndjekësit do të binin në gjurmët tona. Nxora nga xhepi i posaçëm dy ampula dhe ia dhashë Dariut, duke i thënë:

— Unë mund të humbas ndjenjat së shpejti. Ti je i vetëm dhe më i vogël nga unë në trup. Kështuqë nuk më ndihmon dot më tej. Prandaj po të lë një porosi të rëndësishme: po qe se do të vijë njeri këtu, njërën prej këtyre ampulave do ma fusësh mua në gojë, patjetër. Me tjetrën vepro si të duash. Mos harro për asnjë çast se është detyrë e jotja si shok, si bashkëluftëtar dhe si shqiptar, që të mos më lësh të bie i gjallë në duart e anglezëve. Ndryshe më ke tradhtuar.

«E ndihmova Dariun të më ulte pantallonat dhe kur ai po merrej me plagën, humba ndjenjat. Kur erdha në vete, gjendesha në krevat dhe me mjek pranë. Shumë i tronditur, pyeta anglisht: *ku ndodhem*?

«Më qetësuan duke më thënë se isha në duar të sigurta, në ambasadën amerikane në Londër. Më pas, personeli i ambasadës më shpjegoi se në orën tre pasmesnate Dariu, gjithë djersë e i çoroditur, i kishte alarmuar duke kërkuar ndihmë urgjente për mua. Se si arriti ky djalosh i vëtem e pa eksperiencën e duhur të më shpëtonte jetën në ato rrethana, unë as tani nuk e kuptoj dot – shtoi Streto i menduar.

— Nuk ka bërë asgjë më tepër nga detyra – ia ktheu Meli duke ndezur një cigare nga paketa që i kishte lëshuar përpara bashkëfolësi. – Veç, para se të ndahemi, dua të më përshkruash shkurt sesi e vlerësuan amerikanët punën tuaj si grup.

— Punën tonë si grup, thuaj – e korrigjoi Streto, para se të jepte shpjegimet përkatëse:

«Amerikanët e vlerësuan me superlativa punën tonë. Me materialet informative të arkivit që çuan atje dy shokët tanë me robin amerikan të arratisur, specialistët e CIAs kishin përgatitur një film interesant, të cilin e shfaqën në mënyrë ceremoniale në një prej sallave të korpusit qendror të shërbimeve sekrete amerikane. Gjatë transmetimit të materialeve filmike origjinale, spikeri që komentonte ngjarjet shprehej herë pas here: *Imagjinoni, gjithë kjo punë kolosale është vepër e vetëm pesë detektivëve shqiptarë.* Ata aludonin në këtë mënyrë për ne të ekspozuarit në sytë e anglezëve: Fatmiri, Afrimi, dy shokët që u arratisën me robin amerikan dhe unë. Në shfaqjen e filmit asistuan zyrtarë të lartë të CIAs dhe një numër i madh detektivësh. Filmi bëri shumë përshtypje tek të pranishmit. Në përfundim të tij, detektivët me origjinë shqiptare erdhën dhe na shtrënguan duart mua dhe dy shokëve të arratisur me arkivin tonë informativ.

«Dua të theksoj, Hamit, se ditët e fundit para se të nisesha për këtu, unë kam qenë i ftuar në katër mbledhje të rëndësishme të CIAs. Në dy prej tyre ishte i pranishëm edhe vetë drejtori i saj i përgjithshëm. Në të katër mbledhjet është folur edhe për vendin tonë, si një çështje prioritare e shërbimeve sekrete amerikane. Më tej ata e dinë se ç'do të bëhet.

— Eshtë e qartë. Tekefundit vullneti dhe interesat e atyre do të përcaktojnë edhe të ardhmen tonë si popull e si shtet. Ne bëjmë aq sa mundim në shërbim të atyre për hir të së ardhmes së vendit tonë; amerikanët do të bëjnë për Shqipërinë aq sa do t'iu lejojnë interesat e tyre. Këtë e dinte edhe Hanko Tepelena, e cila i thoshte shpesh të birit, Ali Pashës, kur ishte i ri: *Biro, kjo botë nuk është e askujt, por bëhet e më të fortit*! Edhe vendi ynë, si pjesë e kësaj bote, nuk bën përjashtim nga ky parim, Guri.

Në përfundim të takimit të dy shokët u përqafuan përsëri, ndërsa Streto premtoi se nuk do të vonohej për ta vizituar prapë mikun e tij të burgosur.

LXX

ENIGMA *FILBI*

“*Politika është si sfinksi i përrallës: ajo i gëlltit ata që nuk i kuptojnë enigmat e saj*.”

Rivarol

Por ndryshe nga sa i premtoi Melit, ardhja e Stretos qe e vonuar.

Kartelisti i kampit vetëm se e lajmëronte detektivin e burgosur për orarin dhe dhomën ku do të zhvillohej takimi i tij me mysafirët e natës, por nuk i jepte asnjë informacion tjetër. Rrjedhimisht Meli e merrte vesh se cilët do të ishin bashkëbiseduesit e tij vetëm kur takohej me ta.

Streto kishte ardhur bashkë me përkthyesin amerikan, me origjinë nga Korça. Si zakonisht, dy vëzhgues ishin të pranishëm. Sapo hyri Meli në dhomë, Stretos iu mbushën sytë me lot dhe uli kokën. Përkthyesi u çua në këmbë dhe i zgjati paketën e cigareve detektivit të burgosur duke i thënë:

— Afrimi na la.

Meli hoqi kapalen me të majtën dhe i shtrëngoi dorën përkthyesit, që po respektonte zakonin shqiptar në rast vdekjeje.

Ish-detektivi dhe dy vizitorët e tij mbajtën një minutë heshtje në drejtqëndrim; dy vëzhguesit dolën jashtë.

Pasi u ulën, të tre po pinin cigare pa folur. I pari e theu heshtjen Meli:

— Afrimi tentoi vetëvrasjen nëntë ditë para se CIA të merrte në mbrojtje grupin tonë. Ai e dinte mirë këtë, por nëpërmjet aktit të tij sublim, Afrimi, si drejtues i grupit pas largimit të Gurit, donte të bëhej shembull frymëzimi për shokët e tij të armëve në situatën e vështirë që gjendeshin.

— Ju jemi shumë mirënjohës, vëllezër, na nderuat para të gjithëve – i tha përkthyesi. – Këta djem trima, të cilët po e japin jetën sot nën mantelin e luftës së heshtur, një ditë do të kujtohen me respekt nga populli shqiptar. Gjaku i njeriut nuk shkon kurrë dëm dhe një ditë ky gjak do t'i bëjë dritë Shqipërisë.

— Ju tashmë e dini që unë kam një shok besnik në kamp, me të cilin i karn ndarë të gjitha hallet kohët e fundit. Me sa më ka thënë Guri, babai i tij ka punuar për CIAn. Ai ka vdekur para 5-6 vjetësh, jo në moshë të thyer. Në pozicionin tim aktual, mua më vjen rëndë që të mos mund ta informoj dot shokun tim bashkëvuajtës lidhur me jetën dhe vdekjen e babait të tij, pavarësisht se ai vetë nuk ka asnjë pretendim në këtë drejtim. Jam interesuar nëpërmjet Gurit dhe ndonjë shoku tjetër për fatin e tij. Më kanë thënë se, çuditërisht, vihet re një farë hezitimi për të informuar saktë e qartë të interesuarit lidhur me këtë çështje. Do të dëshiroja të dëgjoja edhe mendimin tuaj për ketë.

Përkthyesi shkundi hirin e cigares në tavëll dhe u përgjigj:

— E di cili është shoku juaj dhe babai i tij, jo vetëm nëpërmjet letrës që më dhatë atë ditë, por edhe nga bisedat me Gurin. Lidhur me vdekjen e babait të tij

mund t’ju informoj mbështetur në informacionin që figuron në dosjen përkatëse. Ai ka vdekur më 3 shtator 1978 në Dyseldorf të RF Gjermane. Pas autopsisë është konstatuar një dozë helmi në organizmin e tij. CIA ka kërkuar shpjegime për këtë dhe autoritetet gjermanoperëndimore janë përgjigjur, se ai person njihej si turist prej organeve tona dhe nuk ekzistonte asnjë motiv që ne t’i shikonim me dyshim apo vëmendje të posaçme rezultatet e autopsisë. Përsa i përket ngurrimit për të dhënë informacione të detajuara rreth veprimtarisë dhe vdekjes së babait të shokut tuaj, tani për tani mund t'ju them vetëm kaq:

«Kur Guri erdhi në SHBA, na foli edhe për lidhjet tuaja me shokun në fjalë. Ne u entuziazmuam që biri i një ish-kolegut tonë mbështeste nga afër bashkryetarin e grupit komplotist antikomunist të kuadrove të rëndësishëm të shërbimit sekret shqiptar. Me gëzim e transmetova këtë sihariq pranë eprorëve të të CIAs, me të cilët më kishte lidhur puna më parë. Megjithëse buzagazë, ata ma pritën disi ftohtë lajmin. Unë kisha mjaft përvojë që ta gjykoja objektivisht qëndrimin e tyre ndaj njoftimit tim. Në rrethana normale, ata do ta kishin pritur shumë ngrohtë sihariqin e rrallë që iu dhashë. Shkaqet e atij qëndrimi të pakuptueshëm nuk i gjeja dot me intuitë. Me kalimin e kohës fillova të interesohesha me takt (më shumë si shqiptar), për të mësuar sesi qëndronte puna. Nuk mund të them se e zgjidha enigmën, por mësova diçka që, ndofta, mund të ketë lidhje me fatin e personit në fjalë.

«Unë kam kohë që njihem nga afër me përgjegjësin e CIAs për seksionin evropian, të cilin e kam shoqëruar edhe këtu pranë jush. Një natë e kam dëgjuar të fliste me një farë revolte për *qindshen shqiptare*. Nga aq pak sa tha, arrita të marr vesh se bëhej fjalë për një grup shqiptarësh – 100 persona –, të cilët kishin shërbyer në radhët e CIAs dhe që kishin shprehur në formë të hapur protestën ndaj qeverisë amerikane, për qëndrimin dashamirës që mbahej ndaj regjimit komunist të Tiranës. Por, siç mund ta merrni kollaj me mend, veprime të tilla përbëjnë shkelje të rënda të disiplinës profesionale në shërbimin sekret. Ato shpallën rebelime dhe, si të tilla, ndëshkohen. A mos vallë dhe babai i shokut tuaj ka qenë pjesëtar i *qindshes shqiptare*? Në rast se po, ju e kuptoni që hetimet këmbëngulëse për fundin e tij janë të vështira dhe jo pa pasoja.

Meli po i dëgjonte i përqendruar shpjegimet e vlefshme të përkthyesit. Ndërkohë, me sytë mbi lëngun e kafes që përkundej në filxhan, ai po mendonte me vete:

«Çfarë fundi i trishtuar! Ja se ç'do të thotë ta lësh veten peng në duart e të huajve! Lufton një jetë të tërë për të ardhmen e premtuar të vendit tënd, pastaj vdes si *rebel* vetëm pse guxon t’iu thuash manipulatorëve të politikës: *na keni përkundur me mashtrime në dëm të së ardhmes së vendit e të popullit tonë*! Të presësh moral, ndërgjegje e humanizëm prej politikës së të plotfuqishmit është një naivitet që paguhet shtrenjtë. Politika e tyre ka vetëm një objektiv: interesin me çdo kusht. Të kërkosh moralin në politikë do të thotë se je injorant i politikës. Fjala *qindshja* është si një varrezë kolektive që mbulon njëqind

shqiptarë nën mantelin e të njëjtës akuzë tendencioze: *rebelim*. Kjo është e tmerrshme!»

Dukja dhe zhdukja e faqes së brendshme e të bardhë të filxhanit nën vajtje-ardhjet e lëngut të kafes në përkundje, i shëmbëllente Melit me buzëqeshjen cinike të *Unazës së Bardhë*, kur i kishte thënë:

«…do të vijë një ditë që ju do ta pohoni me gojën tuaj: "anglezët paskan qenë vërtet të fortë!".»

Duke bluar në mendje këto ide lënduese, detektivi i burgosur i drejtoi përkthyesit një pyetje që ai nuk e priste:

— Pse e ka akuzuar Kim Filbin për tradhëti qeveria angleze? Nëpërmjet aktivitetit të tij prej spiuni në favor të KGBsë, Kim Filbi ka ndihmuar shumë diktatorin Hoxha, njeriun e Londrës. Në këtë këndvështrim ekziston një harmoni e plotë midis aktivitetit të diplomacisë së fshehtë angleze në mbështetje të jetëgjatësisë së karrierës së diktatorit tonë dhe spiunimeve të Filbit tek KGBja, të cilat përfundonin në duart e këshillëtarëve sovjetikë që vepronin pranë MP të Brendshme në Tiranë. Sakrifikimi i *qindshes shqiptare* lë të kuptohet se CIA dhe Inteligjencë Servisi nuk paskan qenë dashamirëse ndaj desantimeve të emigracionit politik shqiptar, që organizonin vetë. Kështuqë Kim Filbi ka bërë gjithçka në pajtim me synimet e vërteta anglo-amerikane në Shqipëri. Atëherë, ku konsiston tradhtia e tij?

Përkthyesi me origjinë korçare bëri një shenjë miratimi me kokë për sa tha detektivi i burgosur, pastaj u përgjigj me një buzëqeshje mjaft shprehëse:

— Çështja *Filbi* është komplekse, z. Meli. Një ditë në SHBA unë isha duke lexuar një artikull të gazetës *New York Times* që bënte fjalë për dekorimin e Kim Filbit prej KGBsë, me rastin e përvjetorit të ditëlindjes. Përgjegjësi i CIAs për Evropën, me të cilin siç ju thashë njihem herët, u afrua pranë meje e më tha duke qeshur:

— Unë jam gati të vë bast, se dekorata që i ka akorduar në heshtje Kim Filbit Inteligjencë Servisi me këtë rast, është dy herë më e madhe nga kjo që i ka dhënë KGBja.

«Në ambientet e CIAs në Amerikë tashmë thuhet nën zë, se Kim Filbi është një nga agjentët e dyfishtë më të suksesshëm të historisë së shërbimeve sekrete.

— A nuk është ky një burim pesimizmi edhe për të ardhmen e Shqipërisë sot? – pyeti i vrenjtur ish-detektivi.

— Mos u shqetësoni për këtë, z. Meli. Kohët kanë ndryshuar dhe objektivat e politikës amerikane në Ballkan gjithashtu. Ju e dëgjuat vetë shefin e seksionit evropian të CIAs kur ju tha se: *brenda dy vjetësh pamja e Shqipërisë do të ndryshojë dhe ju do të jeni krenarë për këtë*.

Kjo bisedë e mërziti detektivin e burgosur. Me dëshirën e tij, ai nuk e zgjati më tej takimin. Përshëndeti përkthyesin duke e falënderuar, takoi edhe Streton dhe doli.

LXXI

RESPEKT DHE MALL PËR SHOKËT E RËNË

"*Kujtimi është si një zambak uji që tregon fytyrën e tij prej të mbyturi brenda në ujë.*"

Zh. Karrera Andrade

Një javë më vonë, detektivit të burgosur i erdhi për ta takuar përsëri shefi i seksionit evropian të CIAs. Këtë herë ai shoqërohej prej një zyrtari tjetër dhe përkthyesit të zakonshëm. Streto mungonte. *Unaza e Bardhë* me përkthyesin e tij dhe *Dofeni* ishin gjithashtu të pranishëm.

Shefi amerikan e nisi bisedën me vdekjen e Pahisë. Ai fliste mjaft serioz, duke lënë një përshtypje bindëse, se i ndiente ato që thoshte. Pastaj nxori nga çanta tri fotografi dhe duke i mbajtur në pëllëmbën e hapur të dorës së djathtë, tha me një ton solemn:

— Këtyre djelmoshave të pavdekshëm pouplli shqiptar do t'iu ngrejë lapidar një ditë.

Ai ia zgjati tri fotografitë detektivit të burgosur.

Meli i shikoi me mall tre shokët e dikurshëm të shkollës [ata ishin një datëlindje me të e me Streton] dhe bashkëluftëtarët e vendosur të muajve të fundit. Të tre ishin fotografuar në momentet e fundit të jetës së tyre. Asnjëri nga ata nuk i kishte plotësuar të 35 vjetët.

Fotografia e tregonte Gencin në çastin që toga e ekzekutimit kishte marrë urdhërin *zjarr*! Era e kishte fryrë anash xhakaventon e tij të zbërthyer dhe flokët e gjatë e të bukur ia kishte shpupurisur. Fytyra e tij e tendosur me shikim të mprehtë [ai nuk kishte pranuar t'i lidheshin sytë] ishte shumë shprehëse. Buzët i kishte paksa të zgjatura përpara. Aparati ishte shkrepur në çastin që Daka, duke treguar me dorë fundin e barkut, u kishte thënë spektatorëve të vdekjes së tij: *plumbat tuaj do t'i pres këtu*! dhe po pështynte në drejtim të ekzekutorëve.

Tek po shikonte me vëmendje fotografinë, Melit iu kujtuan fjalët me të cilat ishte shprehur Streto për kurajën e jashtëzakonshme të Gencit: *vdekje më dinjitoze, as në filma nuk kam parë.*

Merdari ishte fotografuar pasi e kishin shtritur të plagosur rëndë mbi një pelerinë bojë qielli. Dy plumbat që kishte marrë nga pas krahëve ia kishin bluar mushkëritë, por trupi i tij muskuloz i rezistoi plot dy javë vdekjes. Para se ta fotografonin, ia kishin fshirë mirë gjakun që i rridhte nga goja. Fytyra e tij burrërore, e argasur si fytyra e një detari, ishte tkurrur nga dhimbjet e mëdha, prej të cilave dergjej në një humbje të thellë. Duke vëzhguar me vëmendje fytyrën e njërit prej shokëve më të afërt që kishte pasur gjatë aktivitetit në DSJ, Melit iu krijua përshtypja se Merdarin e kishte munduar po aq sa dhimbjet e mëdha fizike edhe pamundësia për të shprehur diçka të rëndësishme: ai kishte rënë prej plumbave të një vrasësi, që merrte pjesë në lojën stërvitore si *aleat*.

Në fotografinë e tretë shfaqej pamja e zbehtë dhe fisnike e fytyrës vezake të Pahisë. Ai dukej krejt i qetë, sikur flinte pas një lodhjeje të madhe..

«Vërtet pas një veprimtarie me ngarkesa të mëdha psikike i erdhi kjo *prehje*», tha me vete Meli dhe shtoi: «Të takon të jesh i qetë, vëlla. Aq sa bëri gjysma e grupit, ti e realizove vetëm.»

Detektivi i burgosur i rreshtoi njërën pas tjetrës të tri fotografitë, sipas radhës së vdekjes, dhe belbëzoi: *në krye tuaj duhej të ishte fotografia ime*.

Tek po ia kthente fotografitë amerikanit, Melit iu duk se po i dorëzonte shokët e tij tek të huajt dhe sytë iu njomën. Shefi i seksionit evropian të CIAs e vuri re këtë dhe i tha:

— Kolegu anglez më ka vënë në dijeni të një dukurie interesante të temperamentit tuaj: burgu ju ka mprehur ndjenjat ose, më saktë, ju ka bërë më të vrazhdë se normalja me ata që urreni dhe më të ndjeshëm nga sa mund të jetë zakonisht njeriu kundrejt atyre që i do. Tani po e konstatoj edhe vetë këtë.

Meli fshiu sytë me shami dhe u përgjigj me zë të ulët:

— Në qoftë se është vërtetë ashtu, i jam mirënjohës burgut.

LXXII

«BARBARËT E QYTETËRIMIT» DHE TË QYTETËRUARIT E BARBARISË

"*Jo drejtësia por potenca është arbitri i çdo kundërshtimi apo marrëveshjeje dhe i çdo fati*."

F. Niçe

Amerikani buzëqeshi dhe ndërroi bisedë në dukje, por jo në esencë:

— Më kanë thënë se keni qenë i shqetësuar për shokun tuaj të burgut gjatë revoltës që u zhvillua në kamp e pas saj. Eshtë e vërtetë?

— Po, e vërtetë është. Ai që kur ka lindur vetëm të këqija ka parë në këtë jetë. Unë do ta kisha barrë në ndërgjegje, sa të isha i gjallë, humbjen e atij shoku për neglixhencën time. Prandaj kam qenë i shqetësuar, ndofta edhe më tepër nga sa ju kanë thënë.

— Atëherë qetësohuni përfundimisht tani. Sikur i gjithë ky kamp të shfaroset me urdhër qeveritar, ju do të jeni i parafundit që mund t'ju gjejë e keqja, ndërsa ai do të jetë i fundit. Qeveria jonë ka marrë në mbrojtje edhe njerëz të thjeshtë, jo atë që tekefundit është shoku dhe bashkëpunëtori juaj dhe i burgosur politik.

— Njëkohësisht edhe biri i një personi, që ka milituar në radhët e shërbimeve tuaja sekrete – e plotësoi me takt Meli.

Pak i befasuar nga paranteza e papritur e bisedës, shefi amerikan ia nguli sytë për një çast bashkëfolësit në heshtje. Pastaj e vazhdoi dialogun me një ton tjetër:

— Dëshiroj t'ju flas pak edhe për këtë çështje, meqenëse e sollët fjalën aty, z. Meli. Ne i kemi respektuar gjithmonë kuadrot shqiptare të çdo niveli që kanë milituar për CIAn. Por marrëdhëniet me ta nuk kanë përfunduar gjithmonë siç kemi dëshiruar ne, në mirëkuptim të plotë reciprok. Një lloj mosmirënjohjeje kundrejt qytetërimit amerikan e ka karakterizuar veprimtarinë e një pjese të tyre.

Shefi i seksionit evropian të CIAs e theksoi shprehjen e fundit.

Detektivi i burgosur pati përshtypjen se dëgjoi kërcitjen e një thyerje. Përkthyesi me origjinë korçare manifestoi shenja shqetësimi në pamjen e tij deri atëherë të qeshur.

Pasi e ruajti heshtjen për disa çaste, ndoshta për të tërhequr vëmendjen e të pranishmëve, kuadri i lartë i CIAs vazhdoi fjalën e ndërprerë. Buzëqeshja e përkthyesit u shua përfundimisht. Në vend që t'i përkthente fjalët e shefit detektivit të burgosur, ai nisi një dialog të shkurtër me eprorin e tij. Ky përsëriti të njëjtën frazë me ton urdhërues. Përkthyesi iu rikthye detyrës. Me një pamje të zbehtë në fytyrë, ai i transmetoi Melit fjalët e shefit të seksionit evropian të CIAs:

— Babai i shokut tuaj të burgut ka tradhtuar inetresat e shtetit amerikan, të cilit i shërbente.

Detektivi i burgosur nuk u besoi veshëve. Ai i kërkoi përkthyesit t'ia përsëriste shprehjen.

Ka raste në jetë kur njeriu, megjithëse e dëgjon dhe e kupton mirë atë ç’ka i thuhet, duke mos dashur që ta besojë si të vërtetë, bën një orvajtje të dëshpëruar drejt së pamundurës, për të ndryshuar mesazhin e realitetit të padëshiruar. Përkthyesi, i cili mendoi se më së fundi e kishte shkarkuar barrën e shrehjes-akuzë, u detyrua t'i nënshtrohej për së dyti atij sikleti. Ai po i shqiptonte fjalët ngadalë, qartë, e të plota, edhe kur mbaronin në fund me bashkëtingllore. Sikur po jepte mësim në abetare. Me shikimin e tij të trishtuar, përkthyesi me origjinë shqiptare dukej sikur i kërkonte ndjesë të burgosurit për *mëkatin* që po bënte.

Pas goditjes së dytë, Meli u dorëzua. Falë intuitës së tij profesionale, ish-detektivi e ndjeu në çast se ky lajm do të kishte pasoja në marrëdhëniet e tij me amerikanët. Akuza e rëndë që binte mbi babanë e shokut të tij të ngushtë mund të sillte diferencimin midis tij dhe Diksit, në trajtimin e mëtejshëm që do t’i bënte CIA çështjes *Meli*. Ndërkohë ky ishte i vendosur për të mos lejuar kurrë që shoku i tij të bëhej përsëri viktimë e biografisë, por këtë herë me kah të kundërt. Ndërsa deri atë ditë ai ishte luftuar pa mëshirë nga diktatura si bir i një *shërbëtori të imperializmit amerikan*, sipas gjasave tani e tutje do të ishin vetë amerikanët ata që do ta diskriminonin si djali i një «barbari» të qytetërimit amerikan. Nëse amerikanët nuk do të kishin ndërmend ta bënin diçka të tillë, nuk do të kishte qenë e nevojshme që ata ta përmendnin këtë çështje. Në të ardhmen mund të gjendeshin lehtësisht zgjidhje të përshtatshme e të pranueshme nga të dy palët – gjykonte në heshtje detektivi i burgosur.

LXXIII

NEVERI...

“*Na mësojnë të mendojmë si pulat, por ne nuk duhet ta pandehim veten pula, mbasi jemi shqiponja. Hapni krahët dhe fluturoni*! *Dhe mos u kënaqni kurrë me kokrrat e grurit që ju hedhin*.”

Xh. Aggrei

Shefi i seksionit evropian të CIAs, i cili nuk e kishte aspak të vështirë ta merrte me mend efektin që kishte bërë deklarata e tij tek i burgosuri, po rrinte i qetë duke shfletuar bllokun e tij të shënimeve. Ndërsa ish-detektivi po bluante në kokë mendimet e mësipërme, sytë i shkuan tek zyrtari i lartë i CIAs. Kënaqësia e heshtur që ndiente ai (për të cilën Meli nuk kishte më asnjë dyshim) e revoltoi në çast detektivin e burgosur.

«Pabesi e veshur me arrogancën e të fortit», e cilësoi në vetvete Meli qëndrimin në pamje indiferent të amerikanit, duke e krahasuar me përkushtimin me rrezikshmëri të lartë të Diksit në mbështetje të tij.

Kjo ide i shkaktoi një pështjellim neverie të brendshme ish-detektivit me nerva të acaruara. Për t'ia cenuar sadopak kënaqësinë e heshtur që po përjetonte shefi amerikan, ai e pyeti me qëllim të dukshëm:

— Po vdekja e babait të shokut tim të burgut, si është?

— Patologjike – u përgjigj vetëm me një fjalë amerikani.

— Në dobi të kujt e ka kryer ai tradhtinë e lartë ndaj interesave të shtetit tuaj? – qe pyetja e dytë e padëshirueshme për amerikanin.

— Nuk ka më rëndësi kjo – u përgjigj pa qejf shefi i seksionit evropian të CIAs. – Ne nuk kemi ndërmend të ngremë padi ndaj një të vdekuri për këtë çështje tashmë të kaluar.

— Edhe sikur ta ngrinit një padi të tillë, unë nuk besoj se ligji amerikan do të fajësonte edhe të birin e të ndjerit – vërejti Meli serioz.

— Nuk ia vlen të merremi me supozime pa dobi – sugjeroi shefi amerikan me një hije pakënaqësie në fytyrë. – Megjithëse ju duhet ta keni vetë parasysh një gjë të tillë, jam i mendimit që të mos i flisni fare shokut tuaj për këtë çështje. Kështu do të ishte më mirë për ju vetë, për atë, edhe për ne. Sigurisht mbi shokun tuaj bashkëvuajtës nuk rëndon aspak fajësia e babait të tij. Përkundrazi, ne e vlerësojmë së tepërmi kontributin e tij si mbështetësi juaj më i afërt. Ai do të jetë përherë nën mbrojtjen tonë, siç ju kemi vënë tashmë në dijeni.

«Bukur e paskeni *vlerësuar* kontributin e tij dhe shumë mirë po ia *shpërbleni*. E kam të qartë që dëshira juaj tani do të ishte që Sazanin ta paloste ndonjë copë shkëmbi në minierë» – tha me vete ish-detektivi i brengosur.

Ai nuk foli më fare derisa u ndanë, pas një çerek ore. Kjo heshtje kuptimplote e të mbrojturit të CIAs në prani të *Unazës së Bardhë* e të *Dofenit*, të

cilët qenë vetëm dëgjues në këtë takim, nuk i la shije të mirë amerikanit. Kur u ndanë, ai ia zgjati dorën me një buzëqeshje të shtirë të burgosurit; ky ia ktheu reston me të njëjtën monedhë.

*

Kur Meli ia përshkroi shokut të tij të burgut bisedën bajate me shefin e seksionit evropian të CIAs, Diksi i tha:

— Amerikanët janë të bindur që ti do ta bisedosh patjetër me mua çështjen e babait tim. Ne kemi folur së bashku për probleme të një karakteri të përgjitshëm, jo më për një çështje të familjes sime. *Porosia* e tyre që të mos më flasësh për këtë problem është thjesht një fshirje buzësh; me demek u vjen keq për mua. Një arsyetim që të bën për të qeshur, sikur ne kemi trutë e një pule.

— Por të bën edhe për të qarë, kur mendon sesa shumë u shërbyem ne atyre dhe sa mosmirënjohës po tregohen ata ndaj nesh. Ne e dinim që CIA do ta përdorte kryesisht për interesat e saj gjithë atë mori informacionesh të cilësisë së parë që iu vu në dispozicion, por agresiviteti i tyre ndaj teje i ngjan atij të diktaturës shqiptare. Sikur ti të më kishe tradhtuar, DSJja jo vetëm që do të të kishte nxjerrë nga burgu, por edhe do të të kishte shpërblyer më së miri.

— Më vjen keq, Hamit, që merre me supozime të tilla. Ti e di mirë që angazhimi im në mbështetje tënde nuk nxitej nga interesa egoiste, përkundrazi. As ti e as unë nuk e parashikonim dot atëherë zhvillimin e ngjarjeve që pasuan. Në qoftë se unë do të shikoja vetëm interesin tim atëherë, duhej të qëndroja patjetër sa më larg ty, për t'iu shpëtuar kurtheve të mundshëm të Sigurimit. Ishte dëshira ime për të luftuar së bashku kundër diktaturës, që më nxiti në marrjen e atij vendimi. Prandaj ti nuk ke as më të voglin faj, nëse qëndrimi i CIAs ndaj meje lë për të dëshiruar. Po e gjykuam ndryshe këtë problem, ne rrezikojmë ta banalizojmë qëllimin e vërtetë të bashkëpunimit tonë.

— Të kuptoj, Sazan, por shkaku i vërtetë i revoltës sime nuk është keqardhja për trajtimin tendencioz që synon të të rezervojë ty CIA. Kjo është e keqja më e vogël. E keqja e madhe e kësaj çështjeje është motivi i vërtetë i diskriminimit tënd nga ana e CIAs, i cili në realitet nuk ka lidhje fare me problemin e babait tënd.

— Nuk po të kuptoj dot, Hamit.

— Ke të drejtë; do shpjegohem më qartë. Në SHBA dhe në demokracitë e tjera perëndimore është e ndaluar me ligj trashëgimia e fajësisë. Madjé edhe në Kinë fëmijët e Liu Shao Çishë nuk i lëvizi njeri prej vendeve të preferuara të punës, pas dënimit ideologjik që iu bë babait të tyre. Në këtë këndvështrim është krejt absurde hapja e letrave të çështjes së babait tënd (edhe sikur ajo të mos ishte e sajuar) nga ana e CIAs, ndërkohë që ti nuk e ke njohur fare babanë dhe aktualisht je një i burgosur politik dhe bashkëpunëtori im i përditshëm. Po pse e bënë amerikanët këtë? Një nxitim apo gabim nga ana e tyre? Kurrën e kurrës. Ata nuk nxitohen asnjëherë në gjykimin e këtyre çështjeve delikate.

Përkundrazi, i kalojnë imtësisht në sitë, para se të marrin një vendim përfundimtar lidhur me to. Aq më tepër që edhe në planin humanitar çështja jote është mjaft delikate. Qysh prej moshës dy vjeç që përfunduat familjarisht në internim e deri sot, që po thinjesh në burg, ti je luftuar egërsisht nga diktatura si bir i një agjenti të CIAs. Tani është kjo e fundit vetë që po të bën luftë klase në drejtim të kundërt. Mendon ti se ata nuk i kanë peshuar mirë të gjithë këta tregues, para se të autorizonin shefin e seksionit evropian të CIAs të ma përplaste mua në fytyrë akuzën ndaj babait tënd pa asnjë shkak? Jo, Sazan, ky veprim është bërë me një qëllim të caktuar dhe natyra e këtij qëllimi mua më shtie frikë e më revolton.

«Në qoftë se amerikanët, në marrëveshje me anglezët, do të vendosnin t'ia ndryshonin pamjen Shqipërisë brenda dy vjetësh – siç më premtoi shefi i seksionit evropian të CIAs natën e 20 majit – atëherë nuk do të lindte fare nevoja që amerikanët ta përmendnin çështjen e babait tënd. Përkundrazi, ata do të të trajtonin ty si gjithë pjesëtarët e tjerë të grupit tonë, ndoshta edhe më mirë, mbasi ti nuk ishe profesionist dhe u angazhove vullnetarisht në çështjen time. Zgjidhja e shpejtë e çështjes shqiptare do të ishte kapak i florinjtë për gjithçka lidhur me të kaluarën.

«Mirëpo, siç duken bathët, ata nuk paskan ndërmend të vënë dorë për mirë lidhur me të ardhmen e Shqipërisë, prandaj detyrohen të të godisin ty ballas, që të të veçojnë patjetër nga grupi ynë. Ti je një qytetar i lirë, i angazhuar aksidentalisht në këto ngjarje, dhe nuk ke asnjë detyrim ligjor për të ruajtur sekretin e tyre, në qoftë se ato nuk do t'i garantonin të ardhmen e dëshiruar vendin tonë. Ne të tjerët jemi profesionistë dhe kemi nënshkruar deklaratë për ruajtje sekreti në kuadër të shërbimit inteligjent në të gjitha rrethanat. Kjo është në fuqi edhe për mua sot, pavarësisht se kam vite i shkëputur prej shërbimeve sekrete; ajo deklaratë mbetet gjithmonë aktuale. Është kjo arsyeja e vërtetë që më shqetëson mua shumë lidhur me qëndrimin e amerikanëve ndaj çështjes tënde. Ajo është një shenjë paralajmëruese, se bashkëpunimin me grupin tonë ata do ta shfrytëzojnë vetëm për interesat e tyre e jo për të ndryhshuar gjendjen në Shqipëri. Për më tepër, në këtë rast amerikanët me një gur duan të vrasin dy zogj: shmangin ty në të ardhmen prej nesh dhe njëherësh i shtrëngojnë frerin edhe vetë grupit tonë, për të hequr dorë prej synimeve të tij fillestare dhe t'i nënshtrohet pa kushte CIAs, jo të ndihmohet prej saj për të goditur nga brenda diktaturën.

— Nuk duhet ta shikosh gjithçka me syze të errëta, Hamit, vetëm pse CIA diskriminon mua për qëllimet e saj.

— Pjesë e këtyre qëllimeve është edhe kjo që sapo thashë, Sazan. Madjé është pjesa më e qartë që do të ndodhë në mënyrë të paevitueshme. Unë dhe shefi i seksionit evropian të CIAs u ndamë buzëvarur me njëri-tjetrin mbrëmë. Vetëkuptohet që unë nuk mund të pajtohem aq lehtë me diskriminimin tënd nga ana e tyre, se ky do të ishte një injorim për mua vetë në sy të amerikanëve, si edhe për çështjen tonë në tërësi. Sigurisht në të ardhmen ata do të hedhin edhe

hapa të tjerë në këtë drejtim dhe unë nuk kam ndërmend t'i duartrokas djallëzitë e tyre, se kështu pështyj mbi veten time. Ata e kanë parashikuar tamam këtë dhe duke bërë mua fajtor, do t'iu shtrëngojnë rripat anëtarëve të grupit në aktivitet, për të hequr dorë prej synimit të kundërvënies ndaj diktaturës. Ky është falimentim i grupit tonë, i llogaritur mirë prej ekspertëve të CIAs. Në këto kushte është detyra ime ta denoncoj zyrtarisht mbrojtjen e tyre fiktive. Një kundërshtar i deklaruar, si anglezët, është më i denjë se një sabotues i kamufluar i idealeve tona, që na hiqet si mik.

— Më duket se po flet përçart, Hamit. Të denoncosh zyrtarisht mbrojtjen e CIAs në kushtet që ndodhesh është vetëvrasje.

— Vetëvrasja është më e hijshme sesa poshtërimi i mbrojtësve tinëzarë, që nuk do të ngurronin fare të më sakrifikonin një ditë për interesat e tyre djallëzore.

— I kuptoj shkaqet e revoltës tënde dhe nuk mund të them që ti s'ke të drejtë. Mirëpo kemi kërkuar ne ndihmën e atyre, Hamit, jo ata tonën. Kështuqë nuk është i përligjur pretendimi ynë që amerikanët të na trajtojnë patjetër si palë e jo si vartës të tyre. Janë ata që e bëjnë ligjin, ndërsa ne mbetemi skllevër rrethanash, gjersa nuk jemi në gjendje t'i kryejmë punët tona pa ndihmën e tyre. Prandaj duhet të qetësohesh e t'i gjykosh veprimet me gjakftohtësi. Ti e rrezikove jetën në shërbim të një çështjeje, për të cilën luftojnë sot gjithë pjesëtarët e grupit. Pra, ti nuk i përket më vetëm vetes tënde dhe nuk ke të drejtë të mendosh për vetëvrasjen në një çast revolte apo dëshpërimi. Mirë pjesëtarët e grupit që jetojnë, po Fatmiri dhe Afrimi, që ranë në këtë luftë të heshtur, a do të ta falnin idenë e vetëvrasjes për shkak të vështirësive në rritje të një komploti ku ti i ftove vetë? E kam të qartë gjendjen tënde shpirtërore, por cilidoqoftë trajtimi që do t'i bëjë CIA pjesëtarëve të grupit, ti duhet të japësh shembullin e mirë për të tjerët, jo shembullin e keq.

— Por ne tani nuk bëjmë dot më atë që duhet, por atë që do të na thonë.

— Sepse jemi ne që kemi trokitur në portën e atyre e jo ata tek ne. Këtë nuk duhet ta harrojmë në asnjë çast.

— Por ne nuk trokitëm si lypsarë në portën e tyre, Sazan. U shpëtuam dy detektivë prej vdekjes së sigurtë dhe i furnizuam me një bollëk informacionesh shumë të rëndësishme për ta. Ndërsa ata, për të të veçuar ty nga grupi ynë, përdorën inskenimin banal të fajësisë së babait tënd, ngaqë u mungonin mjetet ligjore.

— Unë nuk do të pranoja kurrë që emri i familjes sime të bëhet shkak për një divorc problematik, me pasoja të paparashikuara, midis grupit tuaj dhe CIAs. Prandaj, në qoftë se deri sot kam pasur të drejtë vote për çfarë kemi diskutuar bashkë, në këtë rast kam të drejtën morale të vetos. Nuk pranoj në asnjë mënyrë që prishja e grupit tuaj me CIAn të lidhet me problemin e babait tim.

— Të respektosh ata që të përbuzin, kjo është diçka bajate, Sazan - e kundërshtoi Meli. – Megjithatë, gjersa ti po luan kartën e fundit, unë jam i detyruar t'i nënshtrohem kërkesës tënde. Veçse dua të nënvizoj rëndësinë e këtij

fakti: njerëzit e zakonshëm shikojnë vetëm fytyrën me makijazh politik të shoqërisë, ndërsa agjentët e shërbimit sekret shikojnë fytyrën e vërtetë të saj. Mbaj mend ç'po të them: bota jonë është e sëmurë, miku im, dhe dominuesit e saj – brutalë. Ata nuk synojnë ta shërojnë botën, por vetëm të përfitojnë prej plagëve të saj. Të ruash me fanatizëm pafajësinë në një botë të tillë është pak a shumë mohim i vetvetes.

LXXIV

MANOVËR AMERIKANE

"*Mos i bëni lajka së keqes me gojët tuaja*."

E. Suterland

Ndonëse në bisedat me Melin ai nuk donte t'i përziente ndjenjat me logjikën, kjo ndodhí i la gjurmë të thellë në shpirt Diksit. Ai çuditej me këtë kombinim të jashtëzakonshëm rrethanash. Pas gjithë atij informacioni të rëndësishëm që hidhte dritë mbi dramën shqiptare, për hir të të cilit ai e bënte hallall edhe burgun e pësuar, Diksi merrte lajmin e hidhur për fundin e trishtuar të babait të tij, që nuk kishte arritur as ta njihte. Gjithë kjo rrjedhë ngjarjesh të jashtëzakonshme atij po i krijonte përshtypjen, se po ballafaqohej me një skenar lufte nervore të kompozuar prej fatit të tij. I lodhur duke u munduar më kot t'iu jepte shpjegim këtyre zhvillimeve të pashpjegueshme, Diksi buzëqeshte me vete i brengosur.

Ndërkohë dyshimet e Melit rreth diferencimit të trajtimit të Diksit prej amerikanëve u konkretizuan më shpejt nga ç'mendonin ata të dy.

*

Ishte dita më e gjatë e vitit 1984: 22 qershori. Diksi ishte shtritur të pushonte, se e kishte punën natën, turni i tretë. Ora ishte rreth katër pasdite.

Muajt e fundit atij i ishte bërë zakon që, sado i lodhur të ishte, para se ta zinte gjumi do të vërtiste nëpër mendje pjesët kryesore të bisedave që kishte zhvilluar me Melin ditët e fundit. Atë ditë mendja i shkoi tek babai i tij, për shkak të të cilit kishte vuajtur e po vuante tërë jetën, ndonëse nuk e arriti dot ditën që i ndërgjegjësuar të thërriste edhe ai një herë *baba*! Megjithëse ai vetë tani ishte në një moshë që, në kushte normale, do të kishte pasur fëmijët e vet, përsëri ajo dëshirë nuk i ishte zbehur asnjëherë.

Nëna e tij dhe të gjithë ata që e kishin njohur babanë e Diksit, i kishin thënë se një prej virtyteteve të tij më të spikatura kishte qenë shpirtmirësia. Si ilustrim të këtij fakti, nëna i kishte treguar këtë ndodhí interesante:

Meqënëse babai i Duksit gjithë jetën ishte marrë me punë intelektuale, nuk i kishte qëlluar rasti të therte bagëti me dorën e tij. Duke qenë djalë i vetëm (pa vëlla ose motër), ai ishte dashur mjaft me kushërinjtë e tij të shumtë. Një ditë bajrami të vogël, njëri prej kushërinjve i kishte çuar në shtëpi një qengj për kurban, duke e këshilluar se ishte mirë ta therte me dorën e tij.

Pasi ia la në duar thikën dhe qengjin, kushëriri po vërente veprimet e babait të Sazanit. Ky e shtriu qengjin në pozicionin e duhur dhe me dorën që i dridhej i kaloi thikën në qafë. Qengji lëvizi dhe blegëriu, ndërsa ai, i tronditur, i lëshoi thikën dhe qengjin e përgjakur. Kur i kushëriri i tërhoqi vërejtjen se ishte mëkat

ta lëshonte qengjin të përgjakur, ai ishte përpjekur të shfajësohej me sytë të njomur:

— Kur lëvizi dhe blegëriu, ashtu i vogël, i bardhë e i pafajshëm, m'u duk sikur po therja Sazanin.

Sazani atëherë nuk i kishte plotësuar ende dy vjetët e parë të jetës së tij. Ishte pikërisht koha kur babai do ta braktiste atë dhe familjen, për të mos i parë më kurrë. Kjo ishte një arsye më tepër, që e debolonte edhe më shumë shpirtin e tij të ndjeshëm nga natyra, duke e penguar për të therur qengjin.

I shtritur mbi dyshekun e kashtës, Diksi buzëqeshi kur iu kujtua kjo ndodhí. Nëpërmjet fotografive ku kishte parë të atin, ai u përpoq ta përfytyronte me sy të përlotur në çastin që kishte lëshuar qengjin qafëpërgjakur. Edhe atij vetë iu mbushën sytë me lot dhe, për të larguar mendimet që e brengosnin, e hodhi shikimin në dritare.

Në anën e djathtë të dritares, ku kishte fiksuar sytë Diksi, lagështia e vazhdueshme i kishte hequr një cipë të hollë suvasë së murit, duke sajuar një shëmbëlltyrë të hartës së SHB të Amerikës. Ai u përpoq ta lodhte mendjen ndryshe, për ta zënë gjumi. U mundua të gjente me intuitë, në hartën e imprivzuar nga lagështia, vendndodhjen e qyteteve amerikane ku kishte jetuar babai i tij, në bazë të adresave. Pasi lokalizoi pozicionin e Bostonit dhe të Detroitit, ai po orvatej të saktësonte vendndodhjen e Çikagos, kur e zuri gjumi.

Nuk dihej sesa kishte fjetur, kur në ëndërr iu shfaq përsëri babai, ashtu siç ishte përpjekur ta përfytyronte Diksi me ndihmën e mbresave të fotografive që kishte parë. Ai ishte në buzë të një lumi të rrëmbyeshëm e me shtrat të ngushtë dhe mbante në dorë thikën e sapopërgjakur, ndërsa sytë i kishte të përlotur. Sazani vetë ndodhej në anën tjetër të shtratit të lumit të rrëmbyeshëm dhe u afrua në buzë të tij. Ai hoqi këmishën dhe po përpiqej ta tendoste në drejtim të të atit, i cili, pak i përkulur përpara, po mundohej ta kapte. Tek po përpiqej që të zgjatej sa më shumë, për të kapur këmishën që do ta bashkonte me të birin, ai u lëkund për një çast, humbi përfundimisht ekuilibrin dhe u rrëzua në rrjedhën e rrëmbyeshme të lumit. Diksi bërtiti *oh*, *babë*! dhe lëvizi në krevat.

Në të njëjtën kohë një dorë po i tundte batanien e vjetër të burgut.

*

Ai u përmend dhe, duke hapur sytë, pa Melin që po i bënte shenjë të vishej dhe të dilte jashtë, për të mos shqetësuar shokët e dhomës së gjumit. Duke fërkuar sytë, Diksi doli në korridor, ndërsa Meli nisi të fliste me nxitim:

— Amerikanët kanë vendosur të më tërheqin në SHBA, pas një marrëveshjeje të përfunduar rishtas me anglezët dhe DSJnë.

— Nga e more vesh ti? e pyeti Diksi i pakthjelluar ende pas zgjimit të beftë.

— Më sqaroi një kuadër i DSJsë, i cili më ka sjellë dhe një valixhe me tesha.

— Ku ishte? Ku e takove?

— Brenda në kamp, tek dhoma ku kam zhvilluar shumicën e takimeve. Më njoftoi me kartelistin.

— Sa është ora?

— Pesë e gjysmë.

— Si i the?

— I thashë të vinte majat nga kishte vënë thembrat. Sipas ujdisë së arritur, unë duhej të largohesha nga territori i Shqipërisë brenda 24 orësh, pa të drejtë kthimi. Që nga çasti i daljes prej kufijve të Shqipërisë, do të shoqërohesha përherë prej një detektivi anglez.

— Nuk do të kishe vepruar gabim, po të kishe ikur bashkë me të. *Dora që s'mundet, puthet* – thotë populli.

— Kohës nuk i rezistojnë dot të gjitha proverbat. Ka duar që nuk mund të puthen dot, se t'i bëjnë buzët me gjakun e bashkatdhetarëve të tu.

— Sidoqoftë, unë mendoj se do të kishe bërë mirë edhe për shokët, po të kishe shkuar. Edhe tërheqja nuk rregullon dot gjë – i tha Diksi duke tundur lehtë kokën.

— Nuk mbetet rregullimi zgjidhja më e drejtë në të gjitha rastet – ia priti Meli – Nganjëherë është më e dobishme dhe më e përshtatshme prishja.

— Por jo në pozicionin tënd aktual. Një i burgosur i sëmurë.

— Ky është një faktor favorizues për kundërshtimin tim. *I mbyturi nuk pyet prej të lagurit*.

— A pritet të takohesh përsëri sonte me ta?

— Po, kuadrin e DSJsë e kishin autorizuar të më njoftonte se, në qoftë se nuk do të shkoja me të, në orën 22 e 30 do të kem një takim zyrtar. Me sa më tha ai, në Fushë-Arrëz janë edhe *Dofeni* dhe *Unaza e Bardhë* me amerikanët.

— Po Guri është?

— Nuk e di. Megjithatë, nesër do ta marrësh vesh çdo gjë me hollësi. Tani shko fli, se je i lodhur e i pagjumë dhe do të të merren këmbët në minierë.

Diksi hyri në dhomën e nxehur nga terraca e betonit, u zhvesh shpejt dhe u mbulua vetëm me çarçaf. Pas pak e zuri një gjumë i thellë, prej të cilit mezi u përmend, kur çanga e turnit të tretë po alarmonte gjithë kampin.

LXXV

AMERIKANI BUZËVARUR

"*Kush thotë atë që i pëlqen*
dëgjon atë që nuk i pëlqen."
Heizod

Në mbrëmje Meli u takua me ata që kishin pritur t'iu shkonte në Fushë-Arrës i veshur si qytetar i lirë amerikan.

Kishte ardhur shefi i seksionit evropian të CIAs i shoqëruar nga dy kolegë dhe përkthyesi i zakonshëm. Ishin gjithashtu të pranishëm *Unaza e Bardhë* me përkthyesin e tij dhe *Dofeni*.

Sapo hyri detektivi i burgosur në dhomë, njëri prej shoqëruesve të zyrtarit të lartë të CIAs i buzëqeshi çiltërsisht. Ishte robi amerikan që i kishte shpëtuar vdekjes falë aksionit të arratisjes së tij të kryesuar nga Pahia. Kur u takuan, ai i puthi të dy duart Melit.

Shefi amerikan, i zymtë si asnjëherë më parë, nisi dialogun:

— Ky takim mund të mos ishte zhvilluar këtu. Ne ju prisnim në Fushë-Arrëz, z. Meli, dhe prej andej shpresonim të shkonim së bashku në Tiranë, ndofta edhe shumë më larg…– tha ai, duke e ulur gradualisht zërin.

Ish-detektivi e kuptoi se shefi i seksionit evropian të CIAs nuk po e fshihte qejfmbetjen, prandaj u përpoq ta qetësonte sa të mundej situatën në krizë:

— Ju kërkoj ndjesë që nuk ju a plotësova dot dëshirën, por nuk mundja të veproja dot ndryshe.

— Çfarë ju pengonte për këtë? pyeti me ton të qetë amerikani, por i vendosur për ta çuar deri në fund hetimin.

— Ndërgjegjja – iu përgjigj Meli, pa hequr dorë nga lakonizmi.

— As ne nuk dëshirojmë që ju të kryeni veprime për hir tonë e kundër zërit të ndërgjegjes suaj. Gjithashtu ne mendojmë se me veprimet tona nuk shtyjmë asnjeri në këtë rrugë. A mos vallë, në këtë rast, keni ndonjë pakënaqësi ndaj qëndrimit tonë karshi shokut tuaj? pyeti shefi i seksionit evropian të CIAs, duke e vendosur gishtin në plagë.

— Nuk kam të drejtë të fajësoj njeri pa argumentet e nevojshëm. Në rastin konkret unë fajësoj fatin e keq timin dhe të shokut tim, gjersa punët ndërlikohen në një mënyrë të tillë, sikur i përgatit njeri me dorë.

— Deridiku keni të drejtë. Megjithatë kam përshtypjen se, me një vullnet më të fortë, mund të arrihej në një zgjidhje më të arsyeshme.

Detektivi i burgosur nuk foli më. As shefi i seksionit evropian të CIAs nuk e zgjati më tej polemikën, duke u ngujuar sërish në zymtësinë e tij.

Pas pak, robi amerikan i shpëtuar prej grupit të Stretos, e pyeti Melin:

— A i keni biseduar me shokun tuaj të burgut të gjitha ndodhitë e kohëve të fundit, z. Meli?

— Pa asnjë përjashtim – u përgjigj me plot gojën ish-detektivi. – Gjithçka di unë, e di edhe ai.

— A e keni njohur para se të binit në burg?

— Jo.

Ky dialog i papritur e krejt i veçantë po ndiqej me vëmendje të madhe nga gjithë të pranishmit. As pala shqiptare, as ajo angleze e as vetë amerikanët, nuk e kishin dëgjuar ndonjëherë detektivin e burgosur të fliste për shokun e tij bashkëvuajtës. Kureshtja dhe interesi i këtij informacioni, që erdhi aq rastësisht, krijuan një qetësi të plotë, e cila i bëri shumë përshtypje Melit.

Detektivi amerikan, sikur të ishte porositur për këtë punë, i vazhdoi pyetjet me një ton miqësor:

— Prej sa kohësh njiheni bashkë?

— Për ç'lloj njohjeje e keni fjalën?

— Në qoftë se nuk e keni bezdi, mund t'i përcaktoni në kohë të dy fazat e njohjes suaj: në radhë të parë thjesht si të burgosur e, pastaj, si shokë besnikë.

— Si të burgosur njihemi prej rreth 16 muajsh. Në afërsi jemi njohur para një viti.

— Pasi u bindët se ai ishte njeri besnik dhe i aftë për t'ju kuptuar, a ia thatë hapur se cila ishte e kaluara juaj e vërtetë?

— Po, më kujtohet se i kam folur gjatë e gjerë mbi këtë çështje.

Në këtë çast Melit i shkuan sytë tek *Dofeni*. Ai ishte vrenjtur në fytyrë dhe e shikonte sikur do ta përpinte me sy. E bluante marazi që nuk kishte ditur të përfitonte nga këto pakujdesi fatale të ish-detektivit të pabindur.

Si për të justifikuar kureshtjen e tij, autori i pyetjeve i tha:

— E dini pse ju pyeta kaq gjatë, z. Meli? Unë kam një shok fëmijërie të moshës sime, i cili është aviator ushtarak. Megjithëse ne të dy jemi në shërbime të karakterit sekret, ai nuk më ka pyetur ndonjëherë për punët e mia dhe as unë nuk e kam pyetur atë për të tijat. Eshtë diçka e jashtëzakonshme të bisedosh me një person të jashtëm sekrete kaq të mëdha, i nderuar koleg! Aq më tepër në një burg politik si i juaji ku, me sa kam dëgjuar, ushtrohet dhunë e fortë dhe kontroll i rreptë mbi të gjithë të burgosurit.

— Zhvillimin e çdo ngjarjeje e kupton po aq mirë sa njeh edhe rrethanat në të cilat ajo zhvillohet – ia ktheu ish-detektivi dhe filloi ta sqaronte:

«Ju p.sh. shprehët mendimin se në burgun komunist, ku kontrolli dhe terrori arrijnë kulmet e tyre, ju duket i pamundur komunikimi i qetë dhe i sigurtë me një njeri besnik. Ndërsa unë, që e kam përjetuar dhe e përjetoj përditë atë mbikqyrje dhe atë terror, ju them me bindje se nuk ka vend më të përshtatshëm nga burgu politik i tipit komunist ku mund të maten vlerat e e një personi, sesa i denjë është për sekretin dhe për besën. Për të njohur njeriun atje i referohesh më tepër syrit, sesa veshëve; ke nevojë më pak për intuitën, sesa për analizën logjike të fakteve që të shtron përpara jeta e përditshme. Gjatë gjithë kohës që unë bashkëpunova me këtë shok, megjithëse i kontrolluar në mënyrë të posaçme,

asnjëherë nuk dyshova në garancinë e *prapavijës* sime të aftë. Kjo mua më jepte krahë dhe ma bënte çdo gjë më të lehtë nga ç'ishte në realitet.

Papritur në bisedë ndërhyri *Unaza e Bardhë*, i cili deri atëherë kishte dëgjuar me vëmendje, si gjithë të tjerët:

— A mendon shoku juaj, se ju sonte edhe mund ta braktisni?

— Kurrë – iu përgjigj prerazi Meli. – Megjithëse ai këmbëngulte në të kundërtën, unë i thashë se nuk do të largohesha. Dhe ai e di mirë që unë nuk e kthej pas zotimin.

— A mos vallë mospranimi juaj për të ardhur me ne është një zotim që keni marrë karshi shokut tuaj? – pyeti shefi i seksionit evropian të CIAs.

— Unë ju thashë edhe më parë dhe tani po e përsëris, zotëri, se e vetmja pengesë që nuk më lejon t'ju plotësoj dëshirën për të ardhur në SHBA, është ndërgjegjja ime. Edhe zotimin se nuk do të ndahem nga shoku im besnik, unë e kam marrë vetëm para ndërgjegjes sime dhe në kundërshtim me dëshirën e atij. Por ja ku po ju a them – vazhdoi Meli duke e ngritur zërin – se nuk të braktisja kurrë një njeri që do të kishte dhënë qoftë edhe një të qindën e ndihmës që më ka dhënë ai, e jo më një shok që vështirë se mund ta gjej përsëri. Unë e gjykoj veprim amoral braktisjen e një shoku në këto kushte, zotëri. Jam i bindur se dhe ju vetë nuk do të vepronit ndryshe, po të ndodheshit në pozicionin tim.

— Ne do të bëjmë lëshime edhe në adresë të shokut tuaj, në qoftë se ju do ta pranonit ofertën që ju ka bërë CIA – u hodh e tha *Unaza e Bardhë* i cili, për arsye që Meli nuk arrinte t'i kuptonte dot, dëshironte që detektivi i burgosur ta pranonte ofertën amerikane. – P. sh. ne mund ta transferojmë atë në kampin e Lezhës, ku do të jetë më i qetë dhe i çliruar nga puna e rëndë e minierës. Kur ju të largoheni nga Shqipëria, persona të autorizuar nga ju vetë mund të shkojnë ta takojnë shokun tuaj atje dhe do t'ju njoftojnë rregullisht rreth gjendjes së tij.

— Burgjet shqiptare nuk kanë asnjë lloj garancie – ia ktheu Meli. – Këtu e keqja mund të të vijë kur nuk e pret fare dhe pa asnjë shkak.

— Mos harroni që ai është nën mbrojtjen tonë – deklaroi shefi amerikan.

— Por jo nga shkëmbenjtë e minierës, shkopinjtë e gomës të policisë, apo nga ndonjë kurth i saj.

— Nuk mund të bëhet kurrë kurth ndaj një të mbrojturit tonë. Prej rreziqeve të tjera që përmendët, nuk mund ta shpëtoni dot as ju, duke qëndruar këtu – vërejti shefi i seksionit evropian të CIAs gjithmonë me pamje serioze.

— Sigurisht që nuk mund ta shpëtoj dot pa ndihmën tuaj, por do të jem i qetë në ndërgjegje duke mos e braktisur.

— Po sikur atë ta lironin nga burgu, do të pranonit të vinit me ne? e pyeti amerikani.

— Ajo mund të ndodhte sa për momentin, pastaj do t'i ngrinin ndonjë kurth në jetën e lirë, do ta provokonin dhe do ta dënonin sërish për ndonjë krim të sajuar ordiner – iu përgjigj detektivi i burgosur.

— Në ç'rrethana do ta miratonit ju ofertën tonë, z. Meli? u interesua shefi i seksionit evropian të CIAs.

— Vetëm po ta nxjerr shokun tim jashtë kufijve shtetërorë të Shqipërisë me duart e mia.

Pas kësaj deklarate verbale të detektivit të burgosur të dy palët heshtën.

LXXVI

KOMPLIMENTE

"*Skllavëria kushton më shtrenjtë se lufta*."

Vovënarg

Shefi i seksionit evropian të CIAs nisi të bisedonte me kolegun anglez për gjëra, që nuk kishin lidhje me qëllimin e ardhjes së tyre në atë kamp pune në zemër të Alpeve shqiptare. I pari e mori fjalën *Unaza e Bardhë*:

— Besoj se jeni në dijeni që, para disa muajsh, KGBja arrestoi njërin prej agjentëve tanë të atjeshëm. Ndërhyrja jonë qe urgjente dhe efikase. Agjenti ynë iu nënshtrua hetuesisë sovjetike vetëm tri javë. Pas kthimit të tij në Angli, mjekët diktuan tek ai shenjat e qarta të një traume psikike. Megjithë ndihmën e pakursyer mjekësore, ai doli në pension të parakohshëm për paaftësi.

«Ndërkohë ne kemi parë të filmuara seancat e vrazhda hetimore ndaj Melit. Gjendja e tij shëndetësore lë shumë për të dëshiruar; kushtet e jetesës në kampin e punës janë shumë të vështira. Takim me familjen nuk i lejohet, bile as korrespondencë. Imagjinoni çfarë përkushtimi i është dashur atij në këto kushte për të kontribuar në drejtimin e një grupi komplotues! Nëpërmjet këtij aktiviteti të jashtëzakonshëm disamujor Meli ka shpalosur edhe një herë tjetër kapacitetin e tij prej një detektivi të madh. Jam befasuar prej disa cilësive të veçanta të detektivëve shqiptarë, gjatë kësaj periudhe që ndodhem në Tiranë.

— Çfarë ju ka impresionuar më tepër në këtë drejtim? u interesua shefi i seksionit evropian të CIAs.

— Do të shprehem kryesisht për detektivët shqiptarë që iu kundërvunë interesave tona këtu. Trima, profesionalisht mjaft të aftë dhe mbi të gjitha, modestë.

— Të njëjtën konsideratë keni edhe për z. Meli, megjithëse e keni njohur në një kamp pune e jo në aktivitet?

— Ai qëndron në krye të listës për cilësitë që përmenda. Dua të theksoj se unë e kam njohur vetëm fizikisht në këtë kamp pune Melin, por për veprimtarinë e tij të suksesshme e njoh prej kohësh. Ai ka realizuar një mori misionesh të rëndësishëm në dobi të Inteligjencë Servisit. Dua të veçoj me këtë rast kryerjen me lehtësi prej tij të një misioni në Belgjikë, për të cilin kishte shkuar dy herë një detektivi ynë i shquar dhe nuk e kishte realizuar dot.

— Sipas informacioneve që disponojmë ne tani, shërbimi sekret shqiptar ka kryer disa misione të rëndësishëm në Evropën Lindore, për të cilët CIA ka shpërblyer Inteligjencë Servisin, sipas marrëveshjes së nënshkruar midis nesh.

— DSJ dhe Inteligjencë Servisi janë aleatë – deklaroi *Unaza e Bardhë* duke shikuar i buzëqeshur *Dofenin*.

Një buzëqeshje servile e shërbëtorit iu përgjigj buzëqeshjes krenare të padronit.

*

Pas një copë here, shefi i seksionit evropian të CIAs i drejtoi pyetjen e fundit detektivit të burgosur:

— Pra ju, z. Meli, e quani kusht vendimtar dhe të pandryshueshëm nxjerrjen e shokut tuaj jashtë kufijve të Shqipërisë, para se të pranoni ofertën tonë për të ardhur në SHBA?

— Më vjen keq, zotëri, por nuk veproj dot ndryshe.

Amerikani u çua dhe ata të dy ia dhanë dorën njëri-tjetrit me buzëqeshje të shtirë. Pastaj ish-detektivi u takua edhe me të tjerët e doli.

Tek po kthehej për në *manue*, Melit iu kujtua një shprehje e Gollsuorthit:

«Nga të gjtha gjërat që mund të durojë njeriu, disfata që pëson vullneti është më e vështira, për atë që është mësuar të bëjë gjithmonë ashtu siç i thotë mendja.»

Dhe tha me vete:

«Sonte ishte nata më e shkurtër e vitit, por mysafirëve të mi amerikanë do t'iu jetë dukur më e gjata, ngaqë janë mësuar që vullneti i tyre të bëjë kurdoherë ligjin.»

LXXVII

OFERTË BEFASUESE E ANGLEZËVE

"*Dyshimi është fillimi i diturisë*."
Anaksagora

Më 3 korrik 1984 kartelisti e lajmëroi ish-detektivin se e kërkonin urgjentisht në një takim tjetër zyrtar. Ora ishte 18.

Kur shkoi në dhomën e zakonshme të takimeve, Meli gjeti *Unazën* e *Bardhë* me përkthyesin e tij dhe *Dofenin*. Qysh në fillim të takimit, *Dofeni* u përpoq të shfajësohej për tentativën e vetëvrasjes së Pahisë, duke i folur detektivit të burgosur me një ton konfidencial:

— Më ke rënë në qafë herën e kaluar, Hamit. Ne nuk kishim asnjë përfitim që ta sakrifikonim para kohe Afrimin, përkundrazi. Për ne ishte e domosdoshme që ai t'i nënshtrohej hetuesisë; për këtë arsye e arrestuam. Po të vendosnim për ta vrarë, ne mund ta dënonim me vdekje nëpërmjet gjyqit; askush s'na i ndalte dot dorën. Gjithë faji për atë që ndodhi ishte i atyre që e shoqëronin. Tek këndi i dhomës së tretë, kur del nga salla e mbledhjeve të DSJsë, Afrimi i arrestuar i ra fort murit me kokë. Kjo ndofta nuk do të kishte sjellë pasoja fatale për të, sikur shoqëruesit e tij të mos ishin hutuar. Duke përfituar prej hutimit të tyre, ai e goditi për herë të dytë murin me pjesën e pasme të kokës dhe u shemb përtokë, pa ndjenja.

Ndërkohë që *Dofeni* po i jepte këto shpjegime Melit, me një preokupim të dukshëm për tu mirëkuptuar me të, *Unaza e Bardhë* po shikonte një album me ngjyra. Pastaj, nëpërmjet përkthyesit, ai ia kaloi albumin ish-detektivit, duke i thënë:

— I hidhni një sy dhe do të më tregoni nëse konstatoni ndonjë ndryshim, në krahasim me 7 vjet më parë që ju keni qenë në aktivitet.

Albumi titullohej *Evropa sot*. Meli nisi ta shfletonte, duke i shikuar me kureshtje veprat më të spikatura arkitektonike të Evropës moderne. Pas disa minutash, ai i tha shefit anglez:

— Ka vepra që mua nuk më kujtohen t'i kem parë, por shumicën e tyre i mbaj mend mirë.

Pas një heshtjeje të shkurtër, *Unaza* e *Bardhë* rimori fjalën:

— Në bazë të marrëveshjes sonë me palën amerikane, juve ju takon të zhvilloni vetëm dy takime në muaj me ata. Megjithatë ne nuk i kemi ndaluar vizitat e tyre më të shpeshta. Këtë e kemi bërë vetëm për t'ju krijuar një farë variacioni në jetën monotone të burgut.

— Unë nuk i kam drejtuar kërkesë ndokujt, për të më bërë një favor të tillë – ia priti detektivi i burgosur. – Monotonia e jetës së burgut nuk ndryshohet dot nga dy biseda më shumë me shokët e mi të lirë.

— Ashtu është, por ne bëjmë në dobi tuaj aq sa kemi në dorë, pa i shkelur rregullat dhe ligjet që mbrojmë vetë. Me këtë doja të thosha, se ne personin tuaj e quajmë gjithmonë tonin, sidoqë të vërtiten punët.

— Unë jam shqiptar dhe i përkas poupllit dhe atdheut tim. Në qoftë se dikur kam punuar për llogari tuaj, kjo nuk ka ndodhur me dëshirën time. Edhe sot që jam nën mbrojtijen e shtetit amerikan, unë përpiqem të kontribuoj, me sa të mundem, për të mirën e vendit tim. Gjersa amerikanët janë arbitrat e përpjekjeve tona, vetëkuptohe që ata kanë pjesën e tyre në frutin e këtyre përpjekjeve; ndoshta pjesën e luanit.

— Luani jemi ne – u hodh e tha *Unaza e Bardhë*, me një vrull të pazakontë për moshën dhe maturinë e tij karakteristike.

Duke thënë këto fjalë, ai kishte drejtuar trupin mbi kolltuk dhe me shuplakën e dorës së majtë, ku zbardhte unaza e gjerë, tregonte gjoksin e tij.

Po me të njëjtin vrull vazhdoi të shprehej më tej:

— Ju mendoni se amerikanët, si superfuqi që janë, mund të diktojnë vullnetin e tyre për zgjidhjen e çështjes shqiptare. Ja ku po ju them se gaboheni; gaboheni rëndë, bile. Dhe nuk është hera e parë që ju ndodh kjo ju shqiptarëve.

—Se ç'do të bëjnë amerikanët, është puna e tyre, zotëri, ashtu siç janë pjesë e punës sonë gabimet që bëjmë ne vetë. Në qoftë se keni ndonjë gjë tjetër për të më thënë, po ju dëgjoj.

Anglezi e mori në konsideratë sugjerimin e ish-detektivit dhe u fut në temë:

— Eshtë e dobishme për ju që t'i kuptoni drejt mendimet tona. Ne dëshirojmë që ju ta pranoni ofertën amerikane, për të shkuar në SHBA, i shoqëruar përherë nga një detektiv i yni, konform marrëveshjes së arritur me ata. Atje të vazhdoni rregullisht veprimtarinë në favor të CIAs. Për ne do të kryeni vetëm një mision: kur të njoftoheni nga qendra jonë nëpërmjet detektivit që do të keni në krah, ju duhet të zhdukni *Kobrën*, me të cilin do të krijoni lehtësisht marrëdhënie atje. Po qe se do të biem dakord, siç shpresojmë ne, kompensimi i këtij shërbimi do të jetë ky: ju do të keni të drejtë të nxirrni jashtë kufijve shtetërorë të Shqipërisë 100 persona, emrat e të cilëve do të na i paraqisni vetë.

— Më parë më ngjallni shokët që më keni vrarë, pastaj mund të diskutojmë për çështje të tilla.

— U kuptuam. Sonte do të keni takim me palën amerikane. Dëshirojmë të mos shprehni gjë, lidhur me propozimin tonë. Në këtë takim do të jemi edhe ne të pranishëm. Më këtë rast, erdhëm pak më përpara tek ju. Takimi i natës së ardhshme do të jetë i fundit midis nesh. Jeni i lirë të largoheni.

Meli u përshëndet me ta dhe doli, për tu rikthyer në mbrëmje.

LXXVIII

FUNDI I *MUAJIT TË MJALTIT*

"*Mirënjohja plaket shpejt*."
Aristoti

Detektivi i burgosur po shtrydhte një bluzë që sapo kishte larë, kur Diksi e goditi lehtë në shpatull:

— Eja ta shtrydhim bashkë, – i tha – se nuk të vjen mbarë vetëm.

Kur mbaruan punë, Diksi i pëshpëriti duke qeshur:

— Do ta veshësh sonte këtë bluzë të zezë, me rastin e takimit të fundit me *Unazën e Bardhë* dhe me *Dofenin*?

— Ka mundësi të jetë takimi i fundit edhe me amerikanët.

— Po ti më dhé fjalën që hoqe dorë prej idesë së denoncimit të mbrojtjes së tyre.

— Fjalën e dhënë unë nuk e shkel kurrë, Sazan; ti e di mirë këtë. Por *Unaza e Bardhë* dhe *Dofeni* kanë qenë gjithmonë të pranishëm në takimet e mia me shefin e seksionit evropian të CIAs. Meqenëse ata nuk do të vijnë më këtu, kjo do të thotë se as zyrtari i lartë i CIAs nuk parashikohet të vijë më.

— Natyrisht, ai nuk mund të rrijë gjatë në Shqipëri. Është përgjegjës i shërbimeve sekrete amerikane për gjithë kontinentin evropian, jo vetëm për vendin tonë.

— Sipas shenjave, CIA do e trajtojë grupin tonë si një koshere bletësh që mbasi i vilet mjalti, i vihet flaka.

— Ndofta jo deri në këtë shkallë, Hamit.

— *Ndofta*… një iluzion ngushëllues – ia bëri ish-detektivi, duke nderur bluzën.

*

Në takimin e mbrëmjes detektivit të burgosur i ra sërish në sy ftohtësia e shefit të seksionit evropian të CIAs.

— Meqenëse nuk i dihet se kur mund të më paraqitet rasti për tu takuar përsëri bashkë, erdha që të shihemi edhe një herë, para se të largohem nga Shqipëria – i tha ai Melit.

— Ju faleminderit dhe më falni që nuk munda t'ju a plotësoj dëshirën, për të ardhur në atdheun tuaj të bukur.

— S'ka gjë; unë e kuptoj si e kani hallin, – ia ktheu zyrtari i lartë i CIAs. – Veçanësia e veprimtarisë dhe e sjelljes suaj ka një ndryshim të dukshëm cilësor prej parametrave të këtyre treguesve të parapëlqyer nga ana jonë. Ju i ngjani një meteori, i cili shndrit fuqishëm por për një interval të shkurtër kohe, ndërsa ne parapëlqejmë një yll me dritë më të venitur, por që ndriçon gjatë. Ju do të ishit një kuadër i preferuar për Hitlerin.

Vrazhdësia e të shprehurit të amerikanit zbulonte dëshpërimin e tij për sfidën e kthimit në Amerikë pa detektivin e burgosur. Për mentalitetin e tij kishte qenë i papranueshëm supozimi, se i burgosuri i sëmurë mund të pranonte të jepte shpirt në një kamp pune, por jo të braktiste një bashkëvuajtës të pafajshëm, me të cilin i kishin përballuar së toku vështirësitë dhe rreziqet e kohëve të fundit. Zhgënjimi fyes që kishte pësuar e detyronte shefin e seksionit evropian të CIAs që, në takimin e fundit me detektivin e burgosur, të çlironte një pjesë të vrerit që do të merrte me vete në Amerikë, ku do t'i duhej t'i paraqiste shefit të madh relacionin përkatës të turneut sekret në Shqipëri.

I indinjuar prej krahasimit brutal me kuadrot e Hitlerit, ish-detektivi fiksoi një shikim flakërues mbi fytyrën e shëndetshme të zyrtarit të lartë të CIAs. Kush mund të ishte më afër figurës së një kuadri të Hitlerit midis një të burgosuri, që hiqte shpirt në një kamp shfarosjeje të tipit hitlerian, dhe një kuadri të lartë të CIAs, i cili në marrëveshje me vëllezërit anglezë ndanin bashkë përshpirtjet e kolonisë së fshehtë shqiptare?

Një buzëqeshje e zbehtë – nuancë skërmitjeje – u ravijëzua në cepat e buzëve të detektivit të burgosur, tek po i përgjigjej shefit të seksionit evropian të CIAs:

— Eksperienca profesionale dhe aftësitë tuaja intelektuale ju mundësojnë që të arrini në disa përfundime, që mua më duken vërtet të çuditshme. Nuk më kishte shkuar ndërmend kurrë, se ndonjë kuadër i preferuar i Hitlerit do të kishte pranuar të vdiste në një kamp pune si ky ku ndodhem unë, vetëm e vetëm që të mos tradhëtonte një mik besnik. Megjithatë, një ndodhi e ditëve të fundit tregoi se unë dyshoj me të drejtë për pasigurinë e gjendjes së shokut tim në burg. Para pak ditësh, policia e kampit, e ndërsyer nga oficeri i DSJsë që punon aty si kartelist, e torturoi atë, pa asnjë shkak.

— Siç ju kemi thënë, Sazan Diksi është nën mbrojtjen e CIAs – deklaroi shefi amerikan, që e kishte kuptuar mirë mesazhin e fjalëve të të burgosurit. – Ja ku është drejtori i DSJsë dhe përfaqësuesi më i lartë i Inteligjencë Servisit në Shqipëri [ai tregoi me dorë *Dofenin* dhe *Unazën e Bardhë*], me të cilët kemi përfunduar një marrëveshje serioze. Le të shërbejë ky incident si paralajmërim i fundit. Ne nuk i kemi formale mbrojtjet tona. Përkundrazi, për garancinë e zbatimit të tyre caktohen pengje. Si të na sillen, do t'iu sillemi. Një me gjashtë e kemi raportin e shkëmbimeve të bëra – u shpreh ai fytyrëvrenjtur.

Detektivi i burgosur bëri një propozim:

— Meqenëse Sazan Diksi është i mbrojturi juaj, a nuk do të ishte më mirë, zotëri, që ai të çlirohej prej punës së rëndë të detyruar në minierë?

— Ne e kemi trajtuar këtë problem, pa na i sugjeruar ju, z. Meli. Mirëpo drejtori i DSJsë është kategorik në kundërshtimin e tij, për të mos bërë asnjë lëshim në favor të Sazan Diksit. Ndërkohë ai figuron ligjërisht *i burgosur politik* dhe ne vetëm nëpërmjet marrëveshjesh me drejtorin e DSJsë mund ta lehtësojmë gjendjen e tij. Përndryshe, të qenët nën mbrojtjen e CIAs atij i siguron paprekshmërinë nga qeveria shqiptare, por jo telashet policore të burgut.

Ndryshon puna kur këto organizohen prej një oficeri të DSJsë, siç përmendët ju më parë. Për shkelje të tilla, marrëveshja që kemi nënshkruar parashikon sanksione të rënda, për të cilat është i ndërgjegjshëm drejtori i DSJsë.

Në këtë çast hyri në bisedë *Dofeni*, i cili iu drejtua Melit gjithë mllef:

— Pak se na i nxore nga kthetrat një armik tradicional si Sazan Diksi, por tani dashke edhe ta shlodhësh shokun tënd antikomunist, ë? Unë jo vetëm që nuk do të bëj kurrë lëshim në dobi të atij armiku të betuar, që ka ndikuar ndjeshëm në fajësinë tënde, por, sikur të mundja, do t'i dyfishoja normat në shkallë Republike, që të lodhej sa më shumë ai armik.

Duke thënë këto fjalë me dhëmbë të shtrënguar, *Dofeni* nxori një fotografi nga çanta dhe ia zgjati pa folur Melit.

Fotografia paraqiste detektivin e burgosur dhe Diksin duke biseduar tek sheshi sipër kampit, i cili mbulohej nga dëbora. Personi që kishte fotografuar (patjetër profesionist i DSJsë) kishte zgjedhur një çast domethënës. Ishte ballë muzgu dhe në të gjithë sheshin e bardhë nuk dukej i burgosur tjetër. Në fotografi ish-detektivi paraqitej i zgjatur pak përpara, me fytyrën e drejtuar nga Diksi, i cili e shikonte në sy.

Me sytë mbi fotografinë, detektivi i burgosur tha me vete: “me siguri punim i *Brinjashit*.” Meli ndjeu një çlodhje të brendshme, kur mendoi se ai gjarpër i DSJsë – kundërshtari i tij i përhershëm – nuk jetonte më. Streto e kishte implikuar me mjeshtëri *Brinjashin* në një fajësi fiktive, lidhur me vetëvrasjen brenda në zyrë të një kuadri të DSJsë, dhe baxhanaku i tij i atëhershëm ia kishte hequr lëkurën këtij gjarpri të rrezikshëm të DSJsë.

Duke ia kthyer fotografinë *Dofenit*, detektivi i burgosur i tha:

— Unë mendoj që ta çlodh shokun tim, se ai nuk e meriton këtë stërmundim, ashtu siç nuk e meritonte të përfundonte në kthetrat tuaja. Por edhe në qoftë se nuk do t'i hiqet barra e rëndë e punës së detyruar, ai do të dijë t'i bëjë ballë, siç i ka bërë deri më sot. Aq më tepër kur është i ndërgjegjshëm që nuk do të vuaj më sa ka vuajtur.

Drejtori i DSJsë bëri një buzëqeshje skërmitëse në heshtje.

LXXIX

VAGONI I PARTISË VRET

"*Ka disa marrëzi që bëhen sëmundje ngjitëse*."

La Roshëfukó

Pas gjysmë ore takimi u mbyll. Meli u kthye në kampin e përfshirë nga një atmosferë e përgjithshme zie. Pikërisht atë natë që po zhvillohej takimi i sipërpërmendur (3 korrik 1984), shembja e një galerire në minierë kishte zënë brenda dy të burgosur të turnit të dytë. Dilaver Hysi nga Vlora, 33 vjeç, i dënuar 10 vjet burg për agjitacion e propagandë. I kishin mbetur për të vuajtur akoma më pak se dy vjet. Dhe Hilmi Çoçka nga Korça. I internuar familjarisht në rrethin e Lushnjës. Ishte 49 vjeç. I dënuar 13 vjet burg për *përgatitje për arratisje, krim* që gjoja e kishte kryer gjatë shërbimit të detyrueshëm ushtarak – para 28 vjetësh nga dita e arrestimit!! I kishin mbetur për të vuajtur edhe katër vjet akoma.

Të dy viktimat kishin qenë të burgosur të ndershëm, të urtë e shumë të sjellshëm. Të gjithë bashkëvuajtësit u pikëlluan. Të nesërmen mbrëma të burgosurit nuk pranuan të shkonin në sallën e televizorit (mensa ku hanin), për të ndjekur lajmet e detyruara të orës 20. Si kundërpërgjigje, policia zbatoi masa ndëshkimore me rekomandim të komandës së kampit.

Brigada e avari–shpëtimit, e ardhur enkas nga Tirana, dhe një grup të burgosurish të zgjedhur vazhdonin punën për të nxjerrë kufomat, të cilat dergjeshin nën shkëmbenj. Kjo vrasje e dyfishtë (as e para dhe as e fundit) ishte pasojë e drejtpërdrejtë e terrorit shtetëror, që ishte intensifikuar maksimalisht pas revoltës së 22 majit.

*

Më 4 korrik pasdite erdhi në minierë një ekip specialistësh të ministrisë së Industri-Minierave, për të verifikuar në vend kushtet e punës. Jo rrallë të burgosurit i kishin nisur letra proteste qeverisë, për kushtet e vështira të punës në minierë, por përgjigjet ua kthente policia me bishta kazme.

Personi që drejtonte ekipin e kontrollit ministror pyeti për normën e detyruar të të burgosurve komandantin dhe shefin e policisë së kampit, të cilët e shoqëronin në minierë. Kur shefi i policisë i tregoi normën që aplikohej në punë, ai u habit dhe tha vetëm: *mjaft e lartë*.

Kjo bisedë po zhvilloej tek vendi ku po punohej për të nxjerrë kufomat e dy viktimave. Për hir të rrethanave të veçanta, ajo po zhvillohej disi *demokratike*: në prani të të burgosurve. Kryesuesi i ekipit iu drejtua komandantit të kampit me një sugjerim:

— Jam i mendmit se çështja e normës duhet rishikuar, shoku komandant. Besoj se duhet ulur.

Në çast ndërhyri në bisedë një i burgosur, i cili dallohej si punëtor i fortë:

— Më falni, zotëri, por edhe sikur të mos ta ulin normën, të paktën të mos na kërkojnë *vagonin e partisë*.

— Ç'është ky vagon? pyeti i habitur komandantin e kampit specialisti i ministrisë.

— Eshtë një nismë e vetë të burgosurve me rastin e dyzetëvjetorit të çlirimit që, kur të mundin, të mbushin edhe nga një vagon mbi normën, duke e quajtur *vagoni i partisë*, për nder të saj – ndërhyri me nxitim në bisedë shefi i policisë së kampit, autori i vërtetë i vagonit në fjalë.

— Jo, jo, – tha i vendosur i burgosuri, duke u afruar më pranë. – Nuk është ashtu e vërteta. Ky vagon nuk është nismë e të burgosurve, por e vetë shefit të policisë, dhe mbushja e tij nuk është aspak fakultative, por pjesë e pandarë e normës së detyruar. Emërtimi i këtij vagoni prej shefit të policisë nuk është aspak i rastësishëm dhe vetëkuptohet interpretimi i mosmbushjes së tij. Edhe dy të burgosurit, kufomat e të cilëve nuk po i nxjerrim dot, kanë qenë duke mbushur pikërisht vagonin e dytë të partisë, të fundit, në kohën që iu ndodhi aksidenti. Ja, ai që po rregullon llampën e karbitit atje është njëri prej policëve të brigadës ku bënin pjesë edhe viktimat. Mund ta pyesni vetë, nëse dëshironi ta mësoni të vërtetën.

Specialisti i ministrisë nuk i ktheu përgjigje të burgosurit. Por kur polici, që i kishte treguar ai, u afrua tek të tjerët, i deleguari i ministrisë e pyeti me takt:

— Ti ke qenë njëri prej policëve të turnit që i ndodhi fatkeqësia?

— Po.

— Shokët e komandës më thanë se ishit dëshpëruar shumë, ngaqë fatkeqësia ju ndodhi pikërisht në fund të punës, apo jo?

— Po, na erdhi shumë keq, mbasi ata për pak po e mbushnin edhe *vagonin* e dytë *të partisë*, kur ndodhi shembja.

Inxhinieri i ministrisë e falënderoi dhe, pasi u futi krahun komandantit dhe shefit të policisë së kampit, ai u shkëput me ata prej të pranishmëve të tjerë.

LXXX

I MUNDURI S'KA TË DREJTË

"*E drejta i përket më të ndershmit,*
por përvetësohet prej më të fortit."
M. Ikbal

Si u larguan rreth njëzet metra më tej, përgjegjësi i ekipit ministror u foli komandantit të kampit dhe shefit të policisë me zë të ulët:

— Duhet ta shikoni më me përgjegjësi këtë punë. Vagoni mbingarkesë (ai nuk guxoi ta përmendte emrin *parti*) mendoj se është i tepërt. Norma e tyre është dy herë më e lartë se e punonjësve të lirë në minierë, ndonëse realizohet në kushte pune që teknikisht lënë shumë për të dëshiruar. Këtë informacion unë do ta bëj të njohur edhe në ministri.

Pas kontrollit të ekipit ministror, oficerët e komandës u kthyen në kamp. Një orë më vonë, u kthyen edhe të burgosurit që punonin për nxjerrjen e kufomave. Këta do të hanin drekë dhe do të riktheheshin sërish në minierë, për të vazhduar punën. Por pa u drekosur akoma, njëri prej policëve të shërbimit të brendshëm të kampit çoi tek zyrat e komandës të burgosurin që ishte ankuar në minierë për *vagonin e partisë*, duke e akuzuar për pirje duhani në dhomën e fjetjes, veprim ky i ndaluar prej rregullores. I akuzuari pa faj përpiqej të vërtetonte se ai nuk e pinte fare duhanin, duke përmendur emra të burgosurish, të cilët mund të dëshmonin për këtë të vërtetë.

Mirëpo shefi i policisë iu afrua pranë e i tha duke u skërmitur:

— Je profesionist për të mashtruar ti. Edhe inxhinierit të ministrisë në minierë ia mbushe mëndjen, se ju detyrokemi ne për tejkalim norme.

Duke iu drejtuar *të gatshmëve*, të cilët mezi prisnin në këmbë, ai i urdhëroi:

— Lidheni dhe çojeni në birucë. Por para se ta fusni atje, *sqarojeni* mirë.

Sqarimi policor nënkuptonte rrahjen e të burgosurit, deri në humbjen e plotë të ndjenjave. *Të gatshmit* i hodhën prangat e rënda, të përgatitura enkas në ofiçinën e kampit, dhe e çuan të burgosurin në korridorin e ngushtë të birucave, ku filloi *sqarimi* intensiv.

Një çerek ore më vonë, *të gatshmit* thirrën urgjent atje mjekun e dënuar të kampit. Siç tregonte më vonë, mjeku i dënuar e kishte gjetur të burgosurin në një pellg gjaku, pa ndjenja. Nga goja vazhdonte t'i rridhte akoma gjak, ndërsa fytyra i ishte enjtur e mavijosur e tëra.

— Por më e keqja është se nuk më lanë ta merrja të burgosurin në infermieri – i sqaroi mjeku muhabetçinjtë e tij. – Ata i kanë thyer dorën e majtë dhe duhej t'ia hidhja në allçi patjetër. Nuk më lanë ta bëja këtë, se kanë ndërmend ta izolojnë në burgun e Burrelit së shpejti dhe nuk duan ta ketë krahun në allçi. Unë u përpoqa t'ia lidhja sa më mirë frakturën, por jam i sigurtë që ai vuan shumë prej dhimbjeve të padurueshme.

LXXXI

NDARJE

"*Një shekull apo një ditë? Është e njëjta gjë. Të presësh qëllimin, kjo ka rëndësi*."

I. Madah

Zymtësia e jetës në kamp po theksohej. Nga njëra anë punohej për të nxjerrë kufomat e mbuluara prej shkëmbenjve, nga ana tjetër i detyronin të burgosurit të provonin të njëjtin rrezik, për të tejkaluar planin e nxjerrjes së mineralit. Lehtësia me të cilën komanda e kampit i detyronte ata për të vdekur i nxiste të burgosurit të mendonin, se xhelatët e tyre nuk ishin njerëz normalë.

Më 5 korrik 1984, nxorën viktimën e parë nga miniera, Hilmiun. Në kohën që një grup të burgosurish me barelën në krahë dolën nga miniera, të gjithë të burgosurit e tjerë, që ndodheshin në kamp, u rreshtuan vullnetarisht anash telave me gjemba. Në drejtqëndrim e në heshtje të plotë, ata shoqëruan të përlotur Hilmiun e urtë e fjalëpakët, i cili për 36 orë kishte mbetur nën peshën e rëndë të shkëmbenjve.

Pikërisht në kohën që viktimën e futën në infermieri, në kamp hyri kartelisti me një listë emrash në dorë. Duke kaluar, ai u hodhi një shikim të shpejt Melit dhe Diksi që po rrinin bashkë.

Kartelisti thirri policët e shërbimit të brendshëm dhe, duke u dhënë listën, i porositi:

— I lexoni këta emra dhe i njoftoni personat përkatës, se do të transferohen urgjentisht.

— Më duket i dyshimtë interesimi i vetë kartelistit për këtë transferim urgjent, Hamit – i tha Diksi. – Mos kërkon revanshin sot sedra e lënduar amerikane, duke na ndarë?

— Po e bënë vërtet këtë gjë, unë do të insistoj të transferohem atje ku të jesh ti – u përgjigj ish-detektivi.

— Më vjen keq që po ta them, por është e vështirë që ta kesh të drejtën e zgjedhjes përsëri. Në qoftë se do të ndodhë kjo, ne na ndajnë per të mos na bashkuar më.

Tellalli u bëri thirrje të burgosurve që të grumbulloheshin, për të dëgjuar emrat që do të lexoheshin.

Polici filloi t'ia thoshte me zë të ulët emrat e listës tellallit, ndërsa ky bërtiti:

— Sazan Diksi!

Ky ishte emri i parë në listë.

Diksi qeshi dhe i zgjati dorën Melit, i cili u zverdh në fytyrë dhe kafshoi buzën e poshtme. Pastaj ai e mblodhi shpejt veten dhe i tha:

— Të ardhmes nuk i dihet si vjen, prandaj më duhet të të lë ndonjë porosi, Sazan. Me trajtimin që po i bën CIA çështjes së grupit tonë, ne nuk do të arrijmë

as ndonjë fitore si të Pirros, më duket. Të detyruar nga rrethanat, ne do ta përqendrojmë vëmendjen në planin B. Pikërisht për këtë arsye shokët e grupit kanë ruajtur një kopje të plotë të arkivit informativ që iu dorëzua CIAs. Gjithashtu për të njëjtin qëllim u lanë në hije tre anëtarë të grupit tonë, emrat e të cilëve nuk u përfshinë në listën e përbërjes së grupit. Ata do të jenë gjithmonë tentakula e grupit tonë në DSJ dhe do të na vënë në dijeni për gjithë zhvillimet e atjeshme. Ata e dinë që të tre vendin e sigurtë, ku është fshehur arkivi informativ. Në çdo kohë që ata do të marrën urdhër sipas një parulle të caktuar, do të vënë në dispozicion të synimeve tona në të ardhmen materiale të arkivit.

«Pjesë e detyrës tënde për të ardhmen mbetet të shkruash një libër mbi veprimtarinë e detajuar të grupit tonë. Duke e bërë këtë, ti nuk shkel asnjë ligj e asnjë rregull, mbasi nuk je profesionist dhe nuk ke nënshkruar asnjë lloj dokumenti për ruajtje sekreti. Veçse për hir të sigurisë së anëtarëve të grupit tonë në aktivitet, ne duhet të respektojmë një parim bazë të shërbimeve sekrete: ngjarjet e këtij karakteri nuk duhet të publikohen pa kaluar 15 vjet prej datës së zhvillimit të tyre. Natyrisht, librin ti do ta shkruash para kohe, por për botimin e tij do të respektohet afati i lartpërmendur.

«Pasi ti të lirohesh nga burgu, në një moment të përshtatshëm, njëri prej tre shokëve tanë në Tiranë do të të vërë në dispozicion një ditar të posaçëm, i cili trajton me korrektesë veprimtarinë e grupit tonë. Sido që të rrjedhin ngjarjet, anëtarët e grupit tonë në aktivitet do të interesohen gjithmonë për ty, mbasi sigurimi apo rrezikimi i jetës tënde do të jetë shumë domethënës për trajtimin në perspektivë të vetë anëtarëve të grupit. Atyre u është bërë gjithçka e qartë nga Guri, kur kanë diskutuar për planin B.

«Ne e kemi për detyrë të bëjmë përpjekjet tona të mundshme deri në fund, Sazan. Natyrisht, e pamundura nuk bëhet dot e mundur. Dihet tashmë që drejtësia është pengesa kryesore e politikës së më të fortit dhe viktima e parë dhe më e rëndësishme e saj.

Duke parë kartelistin e kampit që po shkonte drejt tyre, detektivi i burgosur pushoi së foluri.

*

Kur u afrua pranë, kartelisti iu drejtua Diksit:

— Sazan, ju që transferoheni duhet të shkoni përbrenda portës së madhe të kampit qysh tani.

Meqenëse ish-detektivi kërkonte shkak për të zbrazur mllefin ndaj një personi që kishte dijeni për gjendjen e tij, i tha me një ton të revoltuar:

— Vetëm për Sazanin bëhet ky transferim, që interesoheni posaçërisht?

— Atë e dinë ata që japin urdhëra; unë jam thjesht një urdhërzbatues – ia ktheu pa ngurrim kartelisti.

Pastaj, duke iu drejtuar Diksit që kishte ndaluar në vend, ai i tha:

— Vazhdo rrugën, Sazan; ti je i zgjuar dhe nuk ke nevojë për shumë sqarime.

Diksi ia nguli sytë kartelistit, i cili po e shikonte po me aq vëmendje.

— Kam çantat e veshmbathjes dhe të ushqimeve personale lart në depo – i tha i qetë e me zë të shtruar Diksi.

— Ato do t'ju a sjellim ne tek porta. Veçse ju që transferoheni nuk duhet të keni më kontakt me shokët që mbeten në këtë kamp.

Duke thënë këto fjalë, ai e endi shikimin nga ish-detektivi tek Diksi dhe anasjelltas.

— Ik, Sazan, ik, – i tha Meli duke konstatuar këmbënguljen e kartelistit. – Ik se do të mundohem të t'i sjell vetë dy çantat e tua.

Diksi u nis me hap të menduar drejt zyrave të komandës. Të dhjetë të burgosurit që do të transferoheshin u grumbulluan përpara portës së madhe prej hekuri. Përveç Sazanit dhe një të burgosuri tjetër, tetë të tjerët u lejuan që t'i merrnin vetë çantat e tyre me sendet personale.

Makina që do t'i transportonte të burgosurit që transferoheshin u fut brenda portës së hekurt. Prej saj zbritën katër policë të kampit të Spaçit. Diksi i njihte. Prania e këtyre policëve tregonte se të transferuarit do të shkonin në Spaç, i cili ishte paraardhësi gjakatar i kampit të Qafë-Barit.

Kur të burgosurit e tjerë po ngarkonin plaçkat e tyre në makinë, kartelisti u nis bashkë me ish-detektivin për tek Diksi. Si shkuan disa metra pranë, kartelisti e urdhëroi Melin t'i lëshonte çantat përdhe e të largohej.

— Më lejoni vetëm t'i jap dorën – i tha ish-detektivi, duke e vështruar drejt në sy kartelistin.

— Sazan, eja merri çantat e tua – ia plotësoi tërthorazi kërkesën ish-detektivit oficeri i DSJsë.

Diksi u afrua dhe të dy shokët iu hodhën në krahë njëri-tjetrit. Tek po përqafoheshin, Meli i pëshpëriti me zë të ulët:

— Mos u mërzit, Sazan; ajo që po na ndan sot, do të na bashkojë nesër.

— Mirëupafshim, Hamit! Zoti qoftë me ne!

*

Pasi dhjetë të burgosurit zunë vend në kamionin e zbuluar, policët i lidhën ata dorë për dorë me pranga. Pastaj kaluan një litar perloni nëpër të gjitha prangat dhe e mbërthyen në disa vende pas karrocerisë së kamionit. Ndërsa të burgosurit qëndronin ulur, policët me shkopinj në duar zunë vend anash spondeve.

Makina u nis. Të burgosurit e kampit po përshëndesnin me duar bashkëvuajtësit që largoneshin. Në ballë të tyre Diksi dalloi ish-detektivin, i cili po e përshëndeste duke përkundur në erë një rryp rrobe të bardhë. Ndarja pas një transferimi e dy shokëve të burgosur mbjell në zemrën e secilit atë ndjenjë që

provon njeriu, kur përcjell për në sallën e kirurgjisë një të afërm, i cili do t'i nënshtrohet një operacioni të rëndë.

Pas kthesës së parë kampi u zhduk nga sytë dhe u rishfaq përsëri kur kamioni, pasi kaloi në shpatin tjetër të malit, po ndiqte një rrugë më të shkurtër për në Spaç. Diksi ktheu kokën dhe dalloi përsëri kordelen e bardhë që valëvitej në erë. Makina u mbush me gaz dhe kapërceu një qafë të vogël. Kordelja e bardhë në përkundje u zhduk.

Duke hedhur shikimin përpara, drejt grykës së malit që nxinte, Diksi tha me vete:

— A do të takohem më, vallë, me Hamitin?

LXXXI

PËRSËRI NË SPAÇ

"*Koha, në luftë kundër njeriut, luan*
me të dhe, kur ai mërzitet, ajo e vret."
K. Zh. Sela

Diksi e njihte mirë kampin e Spaçit. Atje ai kishte kaluar më se katër vjet, para se të transferohej në Qafë-Bari. I vetmi ndryshim që gjeti atje ishte kalimi i të burgosurve politikë prej dy pallateve në kapanonat e gjatë buzë përroit. Edhe këtu krevatat kolektivë prej dërrase ishin trekatësh. Dy pallatet ishin të mbushur me mbi 1400 të burgosur ordinerë. Ndërkohë në Spaç kishte rreth 500 të burgosur politikë.

Diksi kishte vetëm një vit e gjysmë i transferuar prej këtij kampi dhe i njihte të burgosurit e atyshëm, me përjashtim të atyre të ardhur gjatë kohës që ai vetë ndodhej në kampin e Qafë-Barit. Brenda pak ditësh ai filloi punën në minierë me njerëz të tjerë, mjedis tjetër e problematikë tjetër. Por në kujtesë Diksi ruante gjithmonë të freskët atë ngjarje të madhe, më të rëndësishmen e jetës së tij të deriatëhershme.

Synimi i këtij transferimi ishte shkëputja e lidhjeve të Diksit me zhvillimin e mëtejshëm të ngjarjeve dhe, si pasojë, fillimi i procesit të shuarjes nga kujtesa i atyre ngjarjeve. Amerikanët e njihnin mirë burgun politik shqiptar dhe, jo më kot, shpresonin në erozionin e fuqishëm të terrorit, urisë, stërmundimit, luftës nervore, brengave të gjithanshme e gjithnjë në rritje. Dhe kjo tramundanë, me të cilën Diksit do t'i duhej të përballej edhe për pesë vjet akoma, i detyronte viktimat e saj të harronin edhe ditëlindjet, gjithë duke i mallëkuar ato. E pastaj, ku i dihej se çfarë mund t'i ndodhte gjatë këtyre pesë vjetëve Diksit? Qysh prej gjashtë vjetësh ai punonte me tre turne në minierë. Sa bashkëvuajtës të tij kishin hyrë me këmbët e tyre në minierë dhe kishin dalë me barela! Zoti, që i kishte ndihmuar gjithmonë ata në bëmat antishqiptare, s'kishte pse të mos t'i ndihmonte edhe për një gjë kaq të vogël. Ai ose do t'ia fshinte Diksit nga mendja këtë ngjarje, ose do ta përfshinte nga kjo botë me gjithë të.

Mirëpo tre anëtarë të grupit të Stretos, të panjohur prej amerikanëve, do të vepronin gjithmonë të pavarur në Tiranë. Ata përbënin garancinë e vazhdimësisë së veprimtarisë së grupit jashtë tutelës së CIAs. Diksi ishte i sigurtë se një ditë ata do t'i sillnin ditarin e posaçëm, për të shkruar librin sipas porosisë së detektivit të burgosur. Pra, plani djallëzor amerikan për shkëputjen përfundimtare të lidhjeve të Diksit me zhvillimin e mëtejshëm të ngjarjeve ishte i dështuar. Në të ardhmen ata do ta kuptonin këtë një ditë.

*

Ndërkohë Diksi, pak i kërrusur nga barra e rëndë e halleve të mëdha të jetës së tij të vështirë dhe të nënës plakë, e cila mezi i shkruante pesë fjalë me

shkronja shtypi në ndonjë fletë letre të zverdhur, edhe në çastet më të vështira të jetës së mundimshme të burgut nuk ligështohej. Puna e rëndë e detyruar me tre turne në minierë për vite me radhë, terrori i vazhdueshëm fizik e shpirtëror, mjerimi material e moral që e rrethonin, e kishin plakur para kohe. Një pjesë e flokëve të tij të dendur e kaçurela kishin rënë; pjesa tjetër ishin thinjur.

Ndonëse ishte në një moshë relativisht të re, të burgosurit ordinerë, të cilët punonin në të njëjtën galeri me të në minierën e Spaçit, e thërrisnin *xhaxha*. Diksi qeshte me vete, por thellë në shpirt ndiente një therje të mprehtë, kur kujtonte thënien e një njeriu të shquar:

Të vdesësh nuk është asgjë, të mos jetosh është e tmerrshe.

Për mendimin e Diksi, kjo thënie e goditur nuk arrinte ta shprehte gjithë dramacitetin e jetës së tij. Ajo i përshtatej më shumë ngrysjes së ditëve të një fshatari që i kufizon kërkeat e tij vetëm në kënaqësitë e rëndomta materiale, duke qëndruar jashtë rrjedhës intensive të jetës, për ta shijuar atë me kapacitet të plotë. Me gjuhë matematike kjo mund të shprehet kështu, mendonte Diksi:

— Në qoftë se vdekja, që s'është asgjë, simbolizon zeron, jeta e fshatarit të kënaqur pothuajse me asgjë dhe që realisht është tmerr, simbolizon pragvdekjen, njëshin. Ndërsa kur jeta, jo vetëm që nuk shijohet si e papërsëritshme, por të kthehet në një skëterrë vuajtjesh praktikisht të paperceptueshme dhe logjikisht të pabesueshme për një njeri që nuk i ka provuar vetë, atëherë tmerri është i dyfishtë dhe, si i tillë, shndërrohet në llahtarë. Llahtara e bën jetën më kërcënuese nga vdekja; ajo është - 1.

Ky përfundim i logjkës së ftohtë e pajiste ndërgjegjen e Diksit me një arësye të dyfishtë për të mos iu trembur zeros.

Me këtë vendim të dekretuar nga mendja, të miratur nga zemra e të arkivuar në ndërgjegje, Diksi vazhdonte rrugën e vështirë të daljes një ditë nga burgu.

LXXXII

RIKTHIMI NË BURGUN E MADH

"*Numri i njerëzve të zhveshur, që «stolisin» një popull, tregon nivelin që ka arritur shtypja*."

L. M. Santos

Koha rridhte dhe njësitë e saj, duke u rrokullisur në këtë rrjedhë, po i afronin Diksit ditën e lirimit nga burgu. Më së fundi, pas dhjetë vjet e gjysmë vegjetim torturues, ai e pa veten matanë telave me gjemba, brenda të cilëve kishte vuajtur aq shumë, sa as atij vetë nuk i besohej më.

Si për çudi të tij, Diksi kishte lozur symbyllas me vdekjen disa herë gjatë viteve të burgut. Ai as nuk ishte plagosur, kur të tjerët ishin vrarë pranë tij në një aksident miniere. I dërrmuar nga tejlodhja e i përgjumur në orët e vona të pasmesnatës, ai kishte rrëshqitur nëpër shkallët e galerive dhe kishte ngecur, pa e kuptuar as vetë se si, disa shkallë më poshtë, në vend që të binte në fund të tyre e të copëtohej.

Gjatë gjithë kohës së burgut, ai nuk ishte sëmurur ndonjëherë, me përjashtim të rasteve kur kishte pllakosur epidemia e gripit. Dhe atëherë Diksi nuk ishte shtruar as në infermierinë e kampit, ndërsa spitalin e të burgosurve në Tiranë nuk e kishte parë ndonjëherë. Të dhjetë dimrat a egër të Spaçit e të Qafë-Barit ai, veç uniformës së kampit, i kishte kaluar vetëm me një triko leshi që i kishte punuar nëna në fillim të burgut. Me përjashtim të thinjave e të rrudhave të parakohshme, organikisht ai po dilte pa pasoja prej telave me gjemba.

Diksit i kujtoheshin si nëpër ëndërr gjithë ato fytyra djemsh të fuqishëm, të cilët, brenda disa vjetësh pune të detyruar në minierë, burgu i kishte shkatërruar fizikisht dhe ose dergjeshin nëpër sanatoriume, ose e kryenin dënimin në regjim burgu, për shkak paaftësie fizike. Këta ishin kaq të shumtë dhe kaq superiorë në treguesit fizikë krahasuar me Diksin, sa që ky vetë, kur i kalonte nëpër mendje, hutohej e nuk e shpjegonte dot sesi ai vetë e kishte përshkuar pa ndonjë pasojë të dukshme atë rrugë të llogaritur enkas për shkatërrimin e njeriut.

*

— Erdha Nënë – thirri i qeshur Diksi, teksa po shkelte mbi myshkun e shkallëve të vjetra dhe, duke e shtrënguar në krahë, i pëshpëriti: – Tani nuk do të ndahemi më!

— Biri i nënës, që më thave sytë! – mundi të thoshte ajo me një fije zëri, duke u lëshuar në krahët e Sazanit. – A ta besoj se u ktheve vërtet?

E mallëngjyer nëna sodiste të birin, por sytë e saj të jeshiltë nuk kishin më fuqi as për të derdhur lotë gëzimi.

*

Diksit i ra në sy një mjerim më i zymtë nga ai që kishte lënë para një dekade në *jetën e lirë*. Fukarallëku ekstrem nxirte brirët tek pragu i derës, pa qenë nevoja ta kapërceje atë.

Suksesi më i madh që arrijnë diktaturat ndaj masave të shtypura është instikti që u imponojnë atyre, për të menduar se ka edhe më keq, duke ua fshirë nga kujtesa të mirën. Pra, për të shikuar pas në jetë, jo përpara. Ai që e ha bukën me djathë e me qepë i gëzohet gjendjes së tij kur shikon se tjetri edhe qepën e ka me kursim; ky ndjehet superior ndaj atij që nuk ngopet as me bukë, ndërsa ky i fundit ngushëllohet kur mendon se shumë të tjerë dergjen nëpër spitale, apo më keq akoma, në internime e në burgje. Ky koncept regresiv i vlerësimit të jetës u siguron diktaturave të shpallura e të kamufluara skllevër të bindur e të vetëkënaqur.

Diksi e konstatoi sërish këtë, qysh ditët e para pas daljes nga burgu. Të gjithë ata që e kishin njohur para se të binte në burg habiteshin me ndryshimin e tij të madh. E mbanin mënd djalosh të freskët e të mirëmbajtur dhe po e shikonin *xhaxho* me thinja e rrudha. Jo rrallë, edhe ia kishin shprehur habinë e tyre:

— Pse ke ndryshuar kaq shumë ti, Sazan? Në kemi parë edhe të tjerë që kanë dalë nga burgu, por një rënie të tillë nuk e kemi vënë re tek ata.

Diksi u buzëqeshte miqësisht të interesuarve dhe u përgjigjej buzagaz:

— Kjo ka ndodhur pa e kuptuar unë vetë dhe dukuritë që nuk kuptohen, as nuk shpjegohen dot.

Ndërkohë ai e konstatonte se bashkëbiseduesi ndiente një kënaqësi të brendshme që nuk kishte pësuar të njëjtin fat. Kjo shërbente si provë lumturie për të.

LXXXIII

DIKTATURA NË ZGRIP

"*Pushteti ka prirje për tu shthurur dhe pushteti absolut shthuret në mënyrë absolute*."

Xh. Dalberg

Një vit pas daljes së Diksit nga burgu, filloi shembja e *perandorisë së kuqe*. Ky proces historik i paevitueshëm po zhvillohej në raport me kulturën dhe traditën për liri e demokraci të secilit prej popujve të Evropës Lindore. Diku kasta komuniste transformohej si me magji në kapitaliste, gjetkë komunizmi vdiste vërtet dhe varrosej pa mëdyshje.

Diksi nuk ishte optimist për përmbysjen reale të komunizmit në vendin e tij. Regjimi diktatorial shqiptar ishte i lidhur vetëm simbolikisht me komunizmin, ndërkohë që Shqipëria ishte një koloni e fshehtë britanike. Londra dhe aleatët e tyre strategjikë të Washingtonit ishin mburoja e padukshme e regjimit diktatorial shqiptar. Ata do ta ndihmonin diktaturën shqiptare të bënte makijazhin demokratik në modë, pa ndryshuar realisht asgjë – veç demagogjisë – në strukturat e regjimit diktatorial dhe kursin politik të kahershëm.

Ndërkohë regjisorët anglo-amerikanë të prapaskenave të politikës mjerane shqiptare e dinin mirë, se i njëjti sabotim politik duhej bërë edhe në Kosovë, me qëllim që skenari i tyre i kobshëm antishqiptar të ishte i sukseshëm në gjithë trojet shqiptare dhe këto të mbeteshin masha politike të diplomacisë së tyre, për të trazuar zjarret e Ballkanit, në përshtatje me interesat anglo-amerikane në këtë rajon delikat, për të sfiduar Bashkimin Evropian. Me urdhër të tyre, më 2 korrik 1990, ndërkohë që Parlamenti i Kosovës votonte shpalljen e Republikës, regjimi agjenturor i Tiranës hapi dyert e ambasadave, për të tërhequr vëmendjen e diplomacisë evropiane e botërore, duke i lënë kështu dorë të lirë Milosheviçit për ta shpërndarë Parlamentin e Kosovës me dhunë.

Anglo-amerikanët do ta krijonin me ngé shtetin e Kosovës, mbasi ta manipulonin mirë lidershipin kosovar, duke e bërë zëdhënës të interesave të tyre rajonale e në dëm të së ardhmes së vetë popullit të Kosovës. Një shtet i shëndetshëm kosovar do të ndikonte në përmirësimin e gjendjes në Shqipëri, gjë që nuk ishte në pajtim as të regjimit kukull të Tiranës e as të padronëve të tyre në prapaskenë.

*

Pikërisht në këtë periudhë Diksit iu vu në dispozicion ditari i posaçëm i ngjarjeve të grupit komplotist të shërbimit sekret shqiptar. Ngjarjet duhej të trajtoheshin në dorëshkrim para kohe, me qëllim që të përkthehej, për tu botuar edhe jashtë Shqipërisë në datën e parashikuar.

Një muaj më vonë, sipas një rekomandimi mjekësor, Diksi çoi nënën në Tiranë për ta vizituar. Atje arriti në orët e pasdites. Ai e la nënën tek një i afërm për tu çlodhur, ndërsa vetë doli në qytet. Trupat e përqendruara rreth ambasadave, prania e uniformave të policisë dhe të ushtrisë anembanë kryeqytetit dhe ndalimi i grupimit të qytetarëve nëpër sheshet dhe rrugët kryesore, dëshmonin qartë panikun e regjimit terrorist e të terrorizuar.

Duke çarë përmes sheshit *Skënderbej*, Diksi shkoi e u mbështet tek një kolonë para Pallatit të Kulturës, nga ana e hotel *Tiranës*. Hodhi sytë në katet e sipërm të tij. Në disa dhoma grilat e dritareve ishin të ngritura. Vetvetiu i lindi një pyetje në mendje:

«A do të jetë, vallë, aty brenda *Unaza e Bardhë*?»

Lëvizi instiktivisht nga ana tjetër e kolonës dhe sytë i shkuan tek monumenti i Heroit Kombëtar. Mbi kalin e hakërruar, me shpatën në dorë dhe shikimin mbi hotel *Tiranën*, ai dukej sikur do ta lëshonte kalin me të katra nga çasti në çast dhe do të vërsulej me furinë e tij të pashoqe, për të shkatërruar këtë çerdhe intrigash e prapaskenash, të cilat edhe pas pesë shekujsh e gjysmë nuk po e linin të qetë atdheun e tij.

Diksit të emocionuar i dukej sikur ai do të vërsulej me të vërtet, kur papritur sytë i shkuan tek djali plangprishës i atdheut, antiheroi kombëtar, i cili, edhe i derdhur në bronx, kërkonte t'iu vinte në ndihmë ish-padronëve të tij. Diktatori kishte hedhur hapin përpara dhe dukej sikur po nxitonte për tu futur midis Heroit Kombëtar dhe hotel *Tiranës*, për të mbrojtur ish-padronët e tij.

Diksit i theri në zemër që Heroi Kombëtar ishte i detyruar të qëndronte në të njëjtin shesh me Diktatorin.

«Nderi dhe Turpi i atdheut, të ngritur të dy në piedestal», belbëzoi dhe sytë iu njomën.

Nisi të zbriste ngadalë shkallët duke shikuar herë njërin, herë tjetrin, si për të marrë me mend sesa bezdi i shkaktonte Antiheroi Heroit. Zbriti në shesh dhe me hapa të menduar u drejtua midis monumentit të Turpit dhe Muzeut Historik Kombëtar. Karroca e një shitësi ambulant të vonuar i fshiku supin. Një shuk letre i fluturoi përpara fytyrës, ndërsa një zë i ngjirrur i thirri:

— Ej, matuf, ku e ke mendjen?

Pa ia vënë veshin shukut të letrës e as zërit të ngjirrur, Diksi, me sytë mbi monumentin e Diktatorit, vazhdoi monologun e trishtuar:

«Edhe sa kohë mund të qëdrosh këtu, o arkitekt i skëterrës shqiptare, që i vure aq mirë në jetë parimet famëkeqe të Luigjëve francezë: *l'état, c'est moi* (shteti jam unë) dhe *après moi, le déluge*! (pas mua, u bëftë kijameti!)?

Dy fotoreporterë të huaj, me aparate në qafë, u shkëmbyen me Diksin dhe u drejtuan për tek shatërvani në qendër të sheshit. Ai vetë u drejtua për tek *rruga e Durrësit*. Dëshironte të takonte berberin e pasionuar Fredi.

LXXXIV

KLIENT I PANJOHUR

"*Rrugën e miqësisë e mbulojnë ferrat, kur atje nuk kalohet shpesh*."

Rivarol

Diksi gjeti një person tjetër që priste radhën për tek berberi i zënë me punë. Fredi ishte vetëm në lokal. Kur hyri Diksi, ai e salutoi me kokë i buzëqeshur, siç vepronte me çdo klient të ardhur rishtas.

Diksi u ul në një karrige dhe filloi të shfletonte gazetën. Ndërkohë ai shikonte herë pas here me bisht të syrit Fredin. Përveç rritjes së barkut, tek berberi pasionant binin në sy shenjat e para të plakjes. Ai tashmë punonte me syze, flokët në tëmtha i ishin thinjur krejt, ndërkohë që mbi ballë i ishin rralluar. Por zhdërvjelltësia e lëvizjeve të tij gjatë punës kishte mbetur e njëjta. Kjo tregonte se ai vazhdonte ta ushtronte profesionin me pasion si dikur.

Pas njëzetë minutash, Fredi e ftoi Diksin që të ulej për tu qethur. Ata kishin ngelur tashmë vetëm në lokal.

— Një shkurtim të përgjithshëm – e porositi Diksi.

— Me kënaqësi, se Zoti ma ka lehtësuar detyrën, – u përgjigj berberi buzagaz, duke fërkuar pjesën pa flokë të sheshit të kokës së klientit.

— Mua m'i ka rrëzuar flokët i Paudhi, jo Zoti. Nuk ia vlen, besoj, t'i shprehni mirënjohje edhe atij.

— Pse i Paudhi nuk është krijesë e Zotit? pyeti berberi duke qeshur.

Diksi nuk foli dhe u rregullua në pozicionin e duhur, që Fredi të fillonte nga puna. Duke ndjekur lëvizjet e berberit në pasqyrë, Diksit i shkoi mendja tek Meli, i cili kushedi sa herë ishte qethur aty dhe buzëqeshi. Mirëpo duke vënë re që Fredit nuk po i tërhiqnin vëmendjen fare flokët e mbetur të klientit të tij dikur të preferuar, buzëqeshja iu fik gradualisht.

— 250 lekë të vjetra, ju lutem – i tha berberi pasi e kishte parfumuar dhe krehur.

Në vend që të nxirte paratë, Diksi ia ktheu serioz:

— Nuk më kishte shkuar kurrë ndërmend, se ju do ta shkelnit një ditë premtimin që më keni bërë.

I habitur prej fjalëve të klientit të panjohur, Fredi u skuq lehtë e i tha:

— Nuk ju kuptoj se ç'po thoni.

Gjithmonë serioz në pamje, Diksi iu përgjigj:

— Ju më keni dhënë fjalën, se do të më qethni pa lekë, sa herë që të vij në lokalin tuaj.

— Është e pamundur. Në këtë botë s'ka asgjë falas, veç vdekjes, – buzëqeshi berberi. – Ju siguroj se është hera e parë që unë po qeth flokët tuaj të thinjur.

— Këta flokë nuk kanë qenë gjithmonë të thinjur…

— Sigurisht, por unë nuk ju njoh.

— Më shikoni pak i përqendruar dhe gërmoni në kujtesën tuaj, ndoshta…

I buzëqeshur e i hutuar, Fredi fiksoi sytë mbi fytyrën e klientit të bezdisshëm.

— Asnjë detaj i tipareve tuaja nuk po më kujton gjë.

— Po kjo fotografi, ju kujton gjë?

Diksi i zgjati pozën që kishin bërë bashkë dikur.

I turbulluar, Fredi po rrëshqiste shikimin nga fotografia tek fytyra e Diksit dhe anasjelltas.

— Vërtet ti je, Sazan? pyeti i emocionuar berberi.

— Po të tregoj pasaportën, Fredi – buzëqeshi Diksi.

— S'është nevoja; u binda nga zëri tani – i tha ai duke e rrokur për qafe.

Ata u përqafuan të përmalluar.

— Mungesa jote e gjatë dhe transformimi fizik më bëjnë të mendoj se ke pësuar ndonjë fatkeqësi në jetë, Sazan. Nuk besoj se bëhet fjalë për ndonjë sëmundje të rëndë, mbasi nga ana shëndetësore ngjan mirë. Mos ke qenë në burg? e pyeti berberi buzagaz.

— E zgjidhe enigmën me pyetjen e parë, – u përgjigj Diksi me të qeshur.

— Agjitacion e propagandë?

— Pothuajse.

— Të shkuara qofshin! Edhe vëllai i gruas sime u dënua 7 vjet me këtë nen. Vjet u lirua nga burgu. Tani të kërkoj ndjesë për kujtesën time të dobët. Të kam dhënë fjalën, se do të të qeth pa lekë dhe këtë premtim nuk e tund as topi. Unë do e mbyll lokalin tani, se nuk ka më as klientë dhe do shkojmë të të jap kafe me rastin e lirimit nga burgu.

Fredi e mbylli me çelës derën dhe u futën në një pijetore pranë.

LXXXV

PLAGË QË VAZHDOJNË TË RRJEDHIN

"*Mjerë i munduri*!"
Napoleon

— **N**ga cili kamp pune u lirove? e pyeti Fredi pasi u ulën.

— Nga Spaçi.

— Mornica i kalojnë në trup njeriut nga emri i këtij kampi të tmerrshëm! – tha duke psherëtirë Fredi. – Sa vjet punove në minierë me tre turne?

— Pak më shumë se dhjetë.

— Oh, flokët e tu të bukur nuk mund të rezistonin dot kaq gjatë në atë skëterrë! Rekuiem për diktaturën që po jep shpirt.

Një zhurmë e papritur u tërhoqi vëmendjen. Pas pak, ata dalluan përmes xhamave të pijetores një turmë të madhe njerëzish.

— Janë demonstrues, – i shpjegoi me zë të ulët Fredi Diksit, duke u zgjatur mbi tavolinë. – Këto kohët e fundit ka pasur trazira, megjithë shtypjen e egër të Sigurimit pas ngjarjes së ambasadave.

Një kordon i gjatë policësh e civilësh po qarkonin gradualisht turmën, e cila në intervale të rregullta kohe ngrinte dy gishta lart. Në ballë të demostruesve Diksi dalloi qartë profilin e një vajze të re të veshur me një bluzë të kuqe, me një shqiponjë të zezë krahëhapur pikturuar në kraharor. Ylli mungonte...

Derën e pijetores e bllokuan dy civila dhe një polic. Pasi fundi i demonstruesve e kaloi hyrjen e lokalit ku gjendeshin ata, dy oficerët e Sigurimit të veshur civilë u futën në lokal, duke i paralajmëruar të pranishmit të nxirnin letërnjoftimet. Polici mbante të bllokuar derën e pijetores. Vetëm rekomandimi mjekësor, që kishte marrë për nënën, e shpëtoi Diksin pa futur në *Fordin* e policisë, që u afrua tek dera e lokalit.

Nga të gjitha anët kishin shpërthyer raprezaljet. *Gazet* dhe *Ford*-et të mbushur ding, kryesisht me persona që nuk ishin me banim në Tiranë, shkarkoheshin nëpër rajone policie dhe dilnin përsëri për *gjueti*.

*

Për çudinë e Diksit, asnjë radiostacion i huaj, nga ata që dëgjonte ai, nuk i përmendi ato ngjarje që ai i kishte përjetuar vetë, megjithëse Shqipëria kishte mbetur e vetmja kështjellë e kuqe e bllokut lindor. Diksit iu kujtuan dy fotoreporterët e huaj, të cilët kishin qenë dëshmitarë okularë të ngjarjes. Kjo heshtje favorizonte diktaturën e kalbur, që po i merreshin këmbët.

«Çelësat e Shqipërisë ndodhen në duart tona», i kishte deklaruar në revoltë e sipër *Unaza e Bardhë* detektivit të burgosur natën e 26 prillit 1984.

Diksi përfytyroi profilin e vajzës së re që udhëhiqte demonstratën, e cila, me siguri, do të kishte përfunduar, me shumë shokë të tjerë demonstrues, në ndonjë varr kolektiv në Malin me Gropa.

Dramaciteti i dyfishtë i ngjarjeve që po zhvilloheshin në Shqipëri, ndërkohë që shtetet e tjerë të Evropës Lindore ishin çliruar nga zgjedha e kuqe, i kujtoi Diksit shprehjen-psherëtimë të themeluesit të shtetit modern shqiptar, Ismail Qemalit, në vigjilje të shpalljes së pavarësisë kombëtare:

FATET E KOMBEVE TË VEGJËL DALIN NGA DYERT E TRAGJEDIVE TË MËDHA.

Fund i vëllimit të parë